
بسم الله الرحمن الرحیم

Shakir Hadi Shukr

I PARI...ALIU

(Paqja qoftë mbi të!)

TIRANË, 2015

Titulli: ***I PARI...ALIU (Paqja qoftë mbi të!)***

Autori: ***Shakir Hadi Shukr***

Recensent: ***Vullnet MERJA***

E përktheu nga arabishtja: ***Edmond ABAZI***

E redaktoi: ***Sonila QAZIMI***

Korrektura teknike: ***Brunilda QAZIMI***

Përkujdesja grafike: ***Sabrie FEZA***

Kapaku: ***Sabrie FEZA***

Botoi: ***Shoqata "FLLADI"***

Copyright: ***Shoqata "FLLADI"***

Botimi i parë, 2015

Tirazhi: 1000

Shtypshkronja e shtëpisë botuese ***LILO***

Dedikim

Për ty, o i Nderuar, o i Dërguari i Allahut, o Ti që e ke bërë mesazhin, shpërblimin për ymetin tënd, respekt dhe dashuri për të afërmit e tu. Ky libër është për djalin e xhaxhait tënd, kështilltarin dhe besnikun tënd, i cili duroi gjendjen e vështirë të të varfrit. Kjo është një dhuratë që i shkon për shtat aftësisë dhe vlerësimit tim, të cilat janë shumë larg nga dhuratat më të larta e më të pastra që meriton pozita dhe vlera juaj. Shpresoj në ndërmjetësimin tënd, o ndërmjetësuesi i gjynahqarëve në ditën e frikës së madhe. *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Ty që të ka dërguar Allahu, mëshirë për të gjithë botërat, mbi familjen tënd të pastër e të mirë dhe për shokët besnikë.

PARATHËNIE

Me emrin e Allahut, Gjithmëshirshmit, Mëshirëbërësit

Falenderimi i takon Allahut, i cili më ndriçoi në rrugën e udhëzimit dhe më dha sukses në kapjen e litarit të fortë të islamit. Ai e bëri pasionin tim ndjekës të pasionit të të Dërguarit të Tij të nderuar (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij*!) dhe dashurinë për Ehli Bejtit të Tij. Ashtu siç udhëzon në fjalën e Tij (xh. sh) Thuaj: **"Unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim për thirrjen time vetëm se respektin e dashurisë për hir të farefisnisë.**"[1] Ndërsa në fjalën e të Dërguarit të Tij besnik, transmestohet: "Me të vërtetë unë ju kam lënë ju trashëgimi dy gjëra të rënda, që nëse ju kapeni fort pas tyre nuk do të humbisni kurrë, Librin e Allahut dhe dashurinë e Ehli Bejtit tim. Pa dyshim ato të dyja nuk duhet të ndaheshin kurrë nga njëra-tjetra, edhe sikur të hidheshin në kazan të valuar".

Për më shumë se 20 vjet kam shpresuar që Allahu të më japë sukses në shkrimin e një libri për prijësin e besimtarëve *(paqja e Allahut qoftë mbi të!)*, për të treguar jo vetëm ato që janë fshehur prej mirësisë dhe etikës së tij, apo të zbuloj detaje të reja nga historia e tij aromatike, pasi ato janë më të qarta se dielli. Prej vitesh me dhjetra myslimanë dhe jomyslimanë, nga lindja në perëndim kanë shkruar me qindra shkrime për historinë dhe

1 Sure "Shura", ajeti 23.

virtytet e tij. Ata të cilët kanë treguar interes për librat e letërsisë, historisë, etikës dhe traditës profetike të cilat flasin dhe tregojnë për të dhe jetën e tij. *(Paqja q Allahut qoftë mbi të!).*

Autorët e këtyre librave nuk kanë lënë gjë për të treguar, mirëpo qëllimi im është të afrohem më shumë drejt Allahut të Lartësuar dhe të kapem fort pas Pejgamberit dhe Ehli Bejtit të Tij *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me shpresën se mund të përfitoj ndërmjetësimin e tyre ditën e Gjykimit.

Kjo ide më ka nxitur dhe më ka shoqëruar gjatë gjithë këtyre viteve të gjata, pa marrë një vendim. Gjithçka ndodhi një ditë kur një shoku im, më foli se një arab nga jugu i largët i Irakut, i cili kishte vizituar Nexhefin e nderuar. Ai ishte një burrë i moshuar që i kishte kaluar të shtatëdhjetat, teksa ecte në këmbë dhe në vapë, në shpinë mbante një çantë të mbushur me lastarë[1], kjo ishte gjithçka që ai kishte përgatitur për udhëtimin e tij, vajtje-ardhje. Menjëherë sa hyri në shtëpinë fisnike u hodh mbi varr, kapi me dorë dorezën e derës dhe me një zë kumbues e me një dialekt beduin tha:

(O babai i Hasanit, kam ardhur tek ti nga Iraku i largët, kam ecur për njëzet e dy ditë duke të kërkuar ty derisa të gjeta, më janë enjtur dhe më janë fryrë shputat e këmbëve dhe ja tek po rrjedhin gjak. Tani jam shtrirë në varrin tënd duke kërkuar mbrojtjen tënde, duke shpresuar se do kërkosh për mua në ditën e Kijametit, derisa të më gjesh e pastaj të thuash: "Nuk e kam gjetur atë, qoftë larg teje o mbrojtësi i komshiut, unë kërkoj prej teje që të kontrollosh për mua derisa të më gjesh, ashtu si unë të gjeta ty).

Me thjeshtësinë e tij, ky tregim më nxiti që të ndjek këtë arab dhe çdo njeri që ka pasur nijet, që unë të kapem pas Imamit,

1 Hurmë i mbështjellë me miell elbi bashkë me pak gjalp.

kështu vendosa të nxitoj në zbatimin e asaj që vendosa. Në këtë mënyrë më lindi ideja dhe shpresa ta shpreh diturinë time, ashtu si të gjithë autorët që shquan imamin me shkrimet e tyre të shumta.

Jeta e tij *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*është e mbushur me punë të mëdha dhe unike. Edhe nëse autorët vazhdojnë të shkruajnë rreth tij, fusha dhe tema vazhdon të jetë e gjerë dhe e virgjër, në të njëjtën kohë e vështirë dhe delikate. Sistemi mutezilit i (Ibrahim bin Sejar) ka goditur organin jetësor të së vërtetës. Në fjalën e tij, Aliu, djali Ebu Talibit është një fatkeqësi për folësin, nëse i jep atë që i takon, është i shtrenjtë, e nëse nuk ia jep atë që i takon nga haku i tij, e dëmton. Ndërkohë shkalla e mesme është një peshore e saktë dhe një ngjitje e vështirë, përveç atij që është shumë i devotshëm.

Në këtë mënyrë shtrëngova rripin dhe i dhashë besën Allahut dhe të Dërguarit të Tij, se do të ndjek rrugën e mesme dhe se do të aspiroj të vërtetën, në çdo fjalë që do të shkruaj. Allahu është mbrojtës për atë që unë them dhe Ai të jep suksesin e të vërtetës.

Nga ajo ditë, përcaktimi i subjektit u bë preukopimi im, të cilën ma lehtësoi Allahu *(Të bekuar qofshin emrat e Tij!).* Ai i cili, nëse dëshiron diçka i përgatit shkaqet, më bëri mua që të zgjas duart drejt pjesës së parë nga libri i çelësit të lumturisë dhe llampadarit të të nderuarit shejkh Ahmed Mustafa, i njohur si guximtari i madh, më shtoi edhe më tepër kohën kur unë isha duke kërkuar pjesën e parë nga libri "Akhbarul Kudati" i Vekiut. Këto dy libra ishin afër njëri-tjetrit në raft.

Kërkimi më orientoi drejt përparësive të tjera, të cilat i vërtetoi edhe autori, se ai *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*është i pari që zbuloi shkencën e mistikës, i pari që vuri themelet e shkencës

së shpatullave. Shkencë që hulumton vijat dhe format që vihen re tek delet dhe dhitë nëse shihen në rreze të diellit, duke treguar për fuqitë e mëdha të botës, që nga luftërat që kanë ndodhur mes mbretërve, fuqive të florës dhe faunës e të tjera si këto. Imami ka jetuar në të gjitha rrethanat e jetës së tij, i angazhuar në çështjet e islamit dhe të myslimanëve dhe duke ndenjur larg zbavitjes.

Me mbarimin e shembujve nga shkencat e imamit, më forcoi tema hyjnore në të cilën gjeta humbjen time dhe thashë me vete: "Le të jeta subjekti i librit tim" (Parësoret[1] e imam Aliut), ato janë aq të rëndësishme saqë ibn Ethiri tek "*Usdul Gabe*", tregon se disa shokë të Pejgamberit kanë thënë: "Aliu, i biri i Ebu Talibit, ka patur aq shumë përparësi, saqë edhe sikur një përparësi e vetme të ishte në mesin e krijesave, do t'i përfshinte ato tek e mira".

Para se të filloj punën, nisa të kontrolloj nëse më kishte paraprirë njeri në përpilimin e përparësive të tij. Nuk gjeta më shumë se tre libra që autorët kishin shkruar për përparësitë, të cilat ishin vetëm në mënyrë të përgjithshme dhe nuk kishin specifikuar asnjë përcaktim. I pari nga libri i përparësive ishte Ebu Hilal Askerijut; I dyti "Metodat e bisedës së ngrohtë", "Të parët e Sujutijut" dhe e treta "Leksionet e të parëve dhe bisedat e ngrohta të pasardhësve" nga Alau Din Ali Sekenvari. Secila prej tyre ishte larg subjektit të librit tim, metodikën e të cilës e kam projektuar dhe zyrtarizuar.

Në libër kam kthyer hadithe, histori profetike, virtyte të imamit, historinë e tij, përkthimet e shokëve, librave të historisë

1 Evelijatun"është shumësi i" evelijjetun", lidhet me të parin, numrin një, ajo që synohet me të është mirësia që veçohet me ato me imam Aliun, apo që i ka paraprirë të tjerët.

dhe letërsisë, duke u larguar aq sa të mundesha nga librat e shiitëve.

Nuk dyshoj në vërtetësinë e librave të tyre, por i lutem Allahut të më ruajë që dyshimi të rrjedhë për vërtetësinë e atyre që lidhen me imamin. Unë e di se prej besimeve të forta të këtij grupi është "Imamati i të dymbëdhjetëve" i udhëhequr në rrugën e imamëve të saj që janë: "Gënjeshtra për Allahun, për të Dërguarin e Tij dhe imamët e Ehli Bejtit është prej gjynaheve të mëdha". Qëllimi im ka qenë shumë i rezervuar në mbështetjen tek librat e të tjerëve, për hir të afrimit të çështjes me zemrat e të gjithë myslimanëve. Kush e lexon librin përciptas dhe i referohet burimeve që kanë derivuar prej tyre, vërtetohet qartë se mes të gjitha grupeve islamike, ka lidhje të afërta dhe të forta në transmetimin e lajmeve dhe haditheve lidhur me prijësin e besimtarëve, Aliun. Të gjitha ato janë në një shkallë në pozitën e tij, në gradë, të cilën e meriton dhe se të gjitha ato dallime janë të garantuara me argumente që kanë zbritur në të drejtën e tij. Hadithet e përhapura nga Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk mund t'i mohojë ose t'i shtojë asnjë. Për këtë arsye imami ka treguar se: "Dy njerëz janë të shkatërruar, ekstremisti që dashuron shtrenjtësinë dhe ekstremisti në të folur".

Përparësitë e pranuara i kanë kaluar pesëdhjetë pjesë, ndërsa unë e pashë të përshtatshme që ta mbyll çdo pjesë me një poezi apo fragment nga lavdërimet e poetëve për poseduesin e përparësive. Pjesa më e madhe e tyre i përshtatej temës, ndërsa mbylljen e bëra me një pjesë që përfshinte copa nga thëniet e personaliteteve joislamikë. Së bashku me këtë e kaloi numrin prej gjashtëdhjetë pjesësh, nga ku bëra të mundur shkurtimin e tyre aq

sa munda. Edhe sikur të doja që t'i shkruaja lajmet në disa volume do të gjeja aq shumë lëndë sa do të ndihmonte për atë gjë.

Falënderoj Allahun e Lartësuar për begatinë që më dha! E falënderoj Atë për çfarë më frymëzoi, i lutem Atij që të më pranojë veprat që kanë nijetin e mirë dhe kërkoj ndihmën e Tij që të më mbrojë nga e keqja e vetes time. Pasi nefsi dhe egoja të urdhërojnë për punë të këqija, përveç atij që mëshiron Allahu, *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi Muhammedin, vulën e pejgamberëve dhe plotësuesin e numrit të të dërguarve, mbi familjen e tij të mirë e të pastër, mbi shokët e tij besnikë dhe të gjithë ata që e ndjekin atë në mirësi derisa të vijë Kijameti).*



I PARI QË KA LINDUR NË QABE [1]

Aliu (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)ka qenë djali më i vogël i Ebu Talibit nga gruaja e tij e vetme Fatime, e bija e Esedit të birit të Hishamit. Ajo grua e lartë e cila për të Dërguarin e Allahut ka qenë në vend të nënës së tij, sepse Ai *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është rritur në prehrin e saj. Ai ishte falënderues në respektin e saj, e besoi që në fillim dhe që migroi bashkë me të me të gjithë migruesit. Ai e thërriste atë "o nëna ime", i jepte asaj vendin e dhembshurisë së nënës dhe kur Allahu *(xh.xh)* ia mori shpirtin, ai e qefinosi atë me këmishën e tij dhe u mbështet në varrin e saj dhe i thanë atij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!): "Ne nuk të kemi parë ty të veprosh kështu për askënd siç po vepron për të?" Ai tha: "Pas Ebu Talibit nuk ka pasur njeri më të dashur e më të repektuar me mua se sa ajo, prandaj edhe unë i vesha këmishën time që të vishet me liritë e Xhenetit, u ula në varrin e saj që t'i lehtësohej asaj ngushtimi i varrit".

E bija e Esedit është prej grave më të forta të Hashimitëve, kur doli në Qabe për të bërë tavafin rreth saj ishte në muajin e nëntë të shtatzënisë, por në atë kohë akoma nuk po i ndiente

1 Dijuan Es Sejjid El Humejri/ 155, Muruxhu Dheheb 2/385, udhëzimi / 9, Udsul Gabe, 5/517, Keshful Gummeh 1/ 60, Esijretul Halebijeh, 3/ 398, Nurul Ebsar, /87, A'janu Shi'atu 3/ kap ¼, Delailu Sidk, 2/ 326, Er Rrai ue err Rraijeh, /20 Fadailul Khamseti fi Sihahi Es Sitetit, 1/176, El Gadijr 6/23, I'jdul Gadijr /37.

dhembjet e lindjes. Sapo arriti në Qabe, preku gurin, ngriti duart dhe kokën drejt qiellit dhe tha: Zoti im, me të vërtetë se unë jam besimtar tek Ti, e besoj edhe atë që Ti ke sjellë dhe e besoj edhe atë që solli gjyshi im Ibrahimi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, prandaj për hir të kësaj shtëpie dhe të atij që e ka ndërtuar ma lehtëso mua lindjen.

Në atë çast Fatimeja ndjeu dhembjet e para të lindjes dhe u shtri brenda Qabes. Dhembjet e lindjes filluan duke iu shtuar, pas pak minutash foshnja doli në dritë i kthyer me fytyrën e tij sikur të ishte në sexhde. Atë nuk e çuditi çështja e sexhdes së foshnjes ndaj Krijuesit të tij, pasi është Ai i cili ditën kur ishte fëmijë, e pengoi atë që t'i përulej putave, mirëpo, kur njëra prej grave e ngriti atë nga toka, e frikësoi ulërima e tij njësoj si të ishte gjëmim vetëtime që e interferon gurgullima e luanit grabitqar.

Ai ka lindur ditën e xhuma, në ditën e trembëdhjetë të muajit të ndaluar Rexhep, tridhjetë vite pas vitit të elefantit. Sipas transmetimeve të sakta, askush para dhe pas tij nuk ka lindur në Qabe. Me këtë mirësi Allahu e dalloi atë, që prej lindjes ai ishte nën kujdesin e Allahut, i cili e bëri vendin e lindjes në një nga shtëpitë më të mëdha të adhurimit të Tij, i dha ushqimin e tij të parë nga gjuha e djalit të xhaxhait të tij, më të nderuarin e krijesave, ndërsa duke prekur atë, ai flinte i qetë. Allahu i Madhëruar i dha atij shumë begati, i përgatiti atij kushtet që të edukohej që në fëmijëri e deri sa të arrinte moshën e pjekurisë, të cilat më pas e ngjitën në gurin e vulave të pejgamberëve dhe të parit të dërguarve *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që të ishte pas tij shembulli i imamëve dhe këshilltari besnik, paqja qoftë mbi të ditën kur lindi dhe ditën kur ra dëshmor në një nga shtëpitë e mëdha të Allahut.



I PARI QË I PARAPRIU NË ISLAM TË TJERËT[1]

Historianët janë kontradiktorë përsa i përket se kush ishte i pari që parapriu në islam, disa prej tyre kanë thënë: Aliu është i pari i cili e besoi Pejgamberin dhe pas tij e ndoqën krijesat e tjera. Askush nuk e parapriu atë nga meshkujt apo nga femrat, kjo sipas fjalës së prijësit të besimtarëve në njërën nga hytbet e tij *(O Allah, me të vërtetë se unë jam i pari që u kthye tek Ti, që dëgjoi dhe u përgjigj, askush nuk më ka paraprirë mua përveç të Dërguarit të Allahut, jam i heshtur në atë që iu lejua atij në paralajmërim dhe përcjellje).*

Ka prej tyre që thonë: Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u ngarkua me shpallje ditën e hënë dhe Hatixheja e besoi atë në fund të ditës. Ndërsa Aliu e besoi mëngjesin e së mërkurës, këtë gjë e konfirmon pjesa më e madhe e dy grupeve të asanmblesë.

---

1 Dijuan Sejjid Humejri/193 dhe 225, Sijretu i ibn Hishamit 1/245 dhe 146. Et-Tabekatu e ibn Sa'dit 3/21. El Mearifu /165, El Akdul Ferijd 4/311 dhe 5/ 94. Muruxhu Dheheb 2/283. El Bed'u wet-Tarikhu 4/145. Mukatilu Talibijne /26. El-Evailu i Ebu Hilal Askerij /107 dhe 110 dhe 113. El Istiabu /1090 dhe 1095. El-Menakibu 2/4 e më tej. Usdul Gabeh 4/18Shrh Nexhul Beklaga, 1/15 dhe 4/122 dhe 13/225 e më tej. Keshful gummeh 1/77. El Mukhtasar fi Akhbaril Besher 1/115. Ujunul Ether 1/91. Es Siretul Halbijjeh 1/431 dhe 436. Ujunu Shi-ia 3/kap 1/145. El Alevijjatul ishrune /45 dhe 102. Delailu Sidki 2/329-331. Hajatu Muhamed /140. Ajetul Birr'rri /333. El Abkarijjatu 675. El Fitnetul Kubra 1/151. Idul Gadir /39.

Nga ana tjetër ka prej tyre që thonë se Ebu Bekri është bërë mysliman pas nënës së besimtarëve, Hatixhesë, të cilën e pasoi prijësi i besimtarëve Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*. Ndërsa disa të tjerë thonë se i pari që besoi pas Hatixhesë ishte Zejdi i biri i Harithit, pastaj Ebu Bekri dhe më pas Aliu i biri i Ebu Talibit *(Paqja q Allahut qoftë mbi të!)*.

Por, ka të tjerë që besojnë se i pari që i ka besuar Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është Zejdi i biri i Harithit, pas tij Hatixheja e më pas Aliu i biri i Ebu Talibit *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*.

Disa thënie të tjera nuk dalin nga korniza e këtij prezantimi. Mirëpo kush e kthen kokën nga historia dhe i qëndron fjalëve të vërtetuesve, transmetuesve historianë dhe njerëzve të mençur e qëndron përballë hadithеve të vlerësuara, do të gjejë se Aliu dhe Hatixheja *(Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!)* kanë besuar të dy së bashku, në profetësinë e më të nderuarit të krijesave Muhamedit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata e kanë besuar menjëherë zbritjen e shpalljes dhe asnjëri prej tyre nuk ka mbetur pas. Kjo sepse ata të dy jetojnë në një shtëpi dhe se janë krijesat më të afërt me të Dërguarin e Allahut dhe më të bindurit e tij. Ata të dy zbaviteshin bashkë me të në shtëpinë e tij para shpalljes, kurse Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*veçohej bashkë me të duke u falur në shpellën Hira, në vende të tjera adhurimi dhe që të dy prisnin zbritjen e shpalljes për Muhamedin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për një kohë jo të shkurtër.

Mes'udi ka thënë: "Është dyshuar për Aliun duke e mërzitur, se shumë prej njerëzve kanë thënë se ai nuk i ka vënë shok Allahut, prandaj le të vazhdojë në islam. Ai ishte ndjekës i Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi*

familjen e tij!) në të gjitha veprimet e tij dhe i lidhur me të, Allahu e mbrojti atë nga gjynahet dhe e frenoi ashtu siç e mbrojti Ai, Pejgamberin e Tij. Ata të dy nuk kanë qenë të detyruar dhe as të obliguar në veprimin e bindjeve ndaj Tij, përkundrazi ata kanë qenë vetë zgjedhës të aftë dhe të dy zgjodhën bindjen ndaj Allahut, zbatimit të urdhërit të Tij dhe largimit nga ndalesat e Tij. Ibn Sa'di tek Shtresat ka thënë: "Aliu i biri i Ebu Talibit është i pari që është bërë mysliman, i pari që ka falur namaz dhe është është bërë mysliman pas Hatixhesë."

Ibn Hishami në histori ka thënë: "Një nga mirësitë e Allahut ndaj Aliut ishte se atë e mori i Dërguari i Allahut para islamit, e mbajti afër dhe vazhdoi të qëndronte me të Dërguarin derisa Allahu i Madhërueshëm i dërgoi atij shpalljen. Aliu e ndoqi, i besoi dhe i qëndroi besnik atij, pastaj ishte Zejdi, i biri i Harithit që u bë mysliman dhe pas tij Ebu Bekri.

I biri i Abdu Rabbi Andaluzi në kontratën e vetme transmeton se: "Me të vërtetë Aliu është i pari që ka dëshmuar se "*Nuk ka tjetër Zot veç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij*". Ukadi te gjenialet e tij është shprehur: "Aliu, i biri i Ebu Talibit ka lindur mysliman. Nëse ne shikojmë lindjen e besimit dhe të shpirtit, pa dyshim se ai hap sytë e tij në islam dhe se nuk e ka njohur kurrë adhurimin e putave. Ai është edukuar në shtëpinë nga ku ka dalë thirrja islame dhe e ka njohur adhurimin nga namazi i Pejgamberit ". Doktor Ta'ha Husejni ka thënë: "Veçoria e Aliut është se ai vazhdoi në islamin e tij, në dhomat e Pejgamberit, ai nuk i ka menduar kurrë idhujt dhe u rrit në shtëpinë e shpalljes me kuptimet më të holla të kësaj fjale."

Hadithet për paraprirjen e tij në islam janë të shumta, disa tyre janë:

Selman Farisijju *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*ka thënë: "Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të thotë: "I pari nga njerëzit që do të vijë në rezervuarin e ditës së Kijametit është i pari i tyre që ka hyrë në islam, Aliu i biri i Ebu Talibit."

Ibn Abbasi ka thënë: I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* transmeton: "Melaiket kanë rënë në salavate për mua dhe për Aliun të birin e Ebu Talibit për shtatë vjet, për këtë është thënë: "Po përse, o i Dërguari i Allahut? Ai ka thënë: Asnjë burrë nuk ka qenë bashkë me mua përveç tij."

Fatimeja e bija e Esedit ka thënë: "Ajo kishte dashur që t'i përulej Hebelit kur kishte qenë shtatzënë me Aliun, por ai u kthye në barkun e saj dhe e ndali që të përulej.

Gjithashtu kundërshtime kanë pasur edhe në përcaktimin e moshës së tij, ditën kur i ka ardhur shpallja Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Transmetohet se ai është bërë mysliman kur ka qenë shtatë vjeç, tetë, nëntë ose dhjetë vjeç, kurse fjala e fundit që është ndjekëse e atij thotë: "Me të vërtetë, ai ka lindur tridhjetë vite pas vitit të elefantit".
Disa herë të tjera është thënë se është bërë mysliman kur ka qenë njëmbëdhjetë vjeç dhe këtë e ka vërtetuar Ebu Ferexhi në librin (mekatilu talibine).

Transmetohet se: "Ai është bërë mysliman kur ai ka qenë dymbëdhjetë vjeç, kjo në bazë të asaj se ai ka jetuar gjashtëdhjetë e pesë vite".

Biri i Abul Berrit tek Asimilimet ka thënë trembëdhjetë vjeç. Ebu Omer transmeton se: "Kjo është më e vërteta nga ato që janë thënë në këtë".

Një grup prej ibn Ethiri në librin "Usdul Gabe" ka thënë: "Pesëmbëdhjetë vjeç"
Gjashtëmbëdhjetë vjeç! Kjo është mosha që flitet më shumë për ditën e dërgimit të shpalljes së Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).*

Ata të cilët mendojnë se Aliu nuk ka qenë në moshën e përgjegjshmërisë e i kanë klasifikuar ata që kanë hyrë të parët në islam në tre lloje, kanë thënë: Njerëzit e parë që kanë hyrë në islam janë: "Nga gratë është nëna e besimtarëve Hatixheja, kurse nga burrat është Ebu Bekër Siddiku (i sinqerti), ndërsa nga fëmijët ka qenë prijësi i besimtarëve, Aliu". Disa prej tyre kanë pretenduar për mosvërtetësinë e islamit të fëmijës sepse ai është i papërgjegjshëm, por ky është një argument imagjinar, i cila nuk vërtetohet para realitetit dhe logjikës. Është Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ai i cili e ftoi Aliun në islam, i'u përgjigj dhe nuk ka ftuar askënd përveç tij, që t'i thuhet se është i pari që u bë mysliman prej fëmijëve. Me këtë kalifi Me'mun ibn Reshidi debatoi me dijetarët e jurispudencës islame, debat të cilin ibn Abdu Rabih e ka përmendur të plotë në librin "Kontrata e vetme", ndërsa ne mjaftohemi me të aq sa na ka thënë dëshmitari, Me'muni:

O Is'hak, cilat vepra kanë qenë më të mira ditën kur Allahu dërgoi të Dërguarin e Tij? Unë thashë: Sinqeriteti në dëshminë e shehadetit. Ai tha: A nuk është të qënit i pari në islam? Unë thashë: Posi jo. Ai tha: Lexoje atë në librin e Allahut të Lartësuar ku Ai thotë: "**dhe ata që kanë prirë** (në besim) **e që do të prijnë** (edhe në Xhenet)**. Ata janë të afërtit (tek Allahu)**".[1] Me të vërtetë është kujdesur për ata që kanë hyrë të parët në islam, po a njeh ti ndonjë që ta ketë paraprirë Aliun? Unë thashë: O prijësi i

1 Sure Vakia/ajeti 10-11

besimtarëve! Me të vërtetë Aliu është bërë mysliman kur ka qenë i ri, në një moshë kur nuk i lejohej as vendimi dhe gjykimi. Ndërsa Ebu Bekri është bërë mysliman kur ishte i plotësuar dhe i lejohej vendimi. Ai tha: "Më thuaj mua se cili prej atyre të dyve u bë mysliman më parë? Pastaj unë do të debatoj me ty në lidhje me të qënit i ri, minoren dhe i plotësuar. Unë thashë: Aliu është bërë mysliman para Ebu Bekrit, me këtë kusht ai tha: "Po, dhe më lajmëroi mua për Pslamin e Aliut kur u bë mysliman, pa harruar të përmendë se a ishte i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që e ftoi në islam apo ishte frymëzim nga Allahu? Ai tha: "Unë heshta dhe ai më tha mua: O Is'hak mos thuaj frymëzim, sepse ia paraprin të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* , sepse Ai nuk e ka njohur islamin derisa i erdhi Xhebraili *(a.s)* nga ana e Allahut të Lartësuar. Unë thashë: "Vërtetë, atë e ftoi i Dërguari i Allahut në islam. Ai tha: O Is'hak, a është i pavlefshëm i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* kur e ftoi atë në islam dhe a ka qenë ftesa e tij me urdhërin e Allahut që ta obligojë atë nga vetja e tij? Ai tha: O Is'hak, mos ia atribuo të Dërguarit të Allahut obligimin, sepse vërtetë Allahu thotë: **"Unë nuk jam prej obilguesve"**. Unë thashë: "Vërtet, o prijësi i besimtarëve, pa dyshim, Allahu thotë: "**A është në cilësinë e të Fortit *(xh.xh)* që t'ia obligojë të dërguarve të Tij ftesën që nuk i lejohet vendimi?** Unë thashë: Allahu na ruajtë, e ai tha: A mendon ti se Aliu që u bë mysliman që i vogël, kur nuk i lejohet vendimmarrja. Ai e ka bërë të qartë vendin dhe mirësinë e tij, edhe sikur Allahu i Madhërueshëm ta ketë urdhëruar atë për ftesën e fëmijëve, a do t'i ftonte ai ata, ashtu siç ftoi Aliun?

Unë thashë: Po! Më pas tha: A di ti nëse i Dërguari *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka ftuar ndonjë fëmijë prej familjes së tij apo të afërmve, pa thënë se Aliu është djali i xhaxhait të tij? Unë thashë: Nuk e di nëse e ka bërë apo jo një gjë të tillë? Ai tha: O Is'hak, a ke pyetur ti për atë që nuk e di dhe nuk e ke njohur? Unë thashë: Jo! Ai tha: Atëherë, lëre mënjanë atë që Allahu e ka larguar prej nesh dhe prej teje.



I PARI QË ËSHTË FALUR ME PEJGAMBERIN

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) [1]

Lajmet dhe hadithet se Aliu *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij!,)* ka qenë i pari që është falur bashkë me Pejgamberin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* janë të vazhdueshme. Ato janë aq shumë sa është e pamundur citimi i të gjithave, prandaj ne mjaftohemi me citimin e disa dëshmive prej tyre. Kush dëshiron që t'i njohë, atëherë ai duhet të shohë burimet e përmendura në shënimet në fund të faqes, e të tjera veç tyre prej librave të hadithit, historisë dhe etikës.

-Nga Zejdi, i biri i Erkamit dhe Muxhahidi, i biri i Abbasit transmetohet se: "Aliu është i pari që është falur bashkë me Pejgamberin *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*".

- I biri i Abbasit *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*thotë: "Aliu kishte pesë atribute që nuk i kishte askush veç tij, ai ishte arabi

1 Dijuanu K'ab ibn Zehirit /254. Dijuanu Sejjid Humejrit /63,64,112 dhe 250. Es Siretu e ibn Hishamit 1/246. Tabekat e ibn Sa'dit 3/21. Tarikhu Taberij 2/309 e më tutje. El Irshadu /21 dhe 22. Esbabu Nuzuli i El Uahidi /241 dhe Mexhmeul Bejani komentimi i xhuzit të dhjetë/31. El Menakibu i ibn Shehri Ashubit 2/13-21. Usdul Gabe 4/18. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebu Hadidit 13/262. Keshful Gumme, 1/79-86, Ujunul Ethijr i ibn sejjidi nas, 1/91, Tefsir Ibn Kethirit 2/314. El gadiru 3/220-224 dhe 242, Fadailu Khamseti fi Sihahi Es Siteti 1/191.

dhe jo arabi i parë që është falur bashkë me të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai ishte flamuri i Pejgamberit në çdo mobilizim dhe ishte ai i cili bëri durim bashkë me të, ditën kur të tjerët u larguan prej tij, ishte ai i cili e lau dhe e futi në varrin e tij".

- Aliu, i biri i Ibrahimit, i biri i Hishamit ka thënë: "Kur Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* arriti moshën tridhjetë e shtatë vjeç, shikonte në ëndërr sikur dikush i afrohej dhe i thonte: O i Dërguari i Allahut! Por ai e injoronte atë. Kur kjo çështje iu përsërit gjatë, teksa një ditë ndodhej në mes maleve, pa një person që i tha: O i Dërguari i Allahut! Dhe ai iu përgjigj: Kush je ti? Ai tha: Unë jam Xhebraili, më ka dërguar Allahu tek ti për të të zgjedhur ty si të dërguar. Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* lajmëroi vetëm Hatixhenë për atë që i ndodhi dhe ajo i tha: O Muhamed, vërtetë unë uroj që të jetë kështu. Atij i zbriti Xhebraili *(a.s)* dhe bashkë me të nga qielli kishte zbritur edhe ujë. Më pas i tha atij: "O Muhamed, çohu dhe merr abdes që të falesh". Xhebraili e mësoi që të merrte abdes, sexhden dhe rukunë. Kur Pejgamberi i mbushi të dyzetat, Xhebraili *(a.s)* e urdhëroi atë për namazin dhe i mësoi kufijtë e tij, mirëpo atij nuk i ishin zbritur akoma kohët e namazit. I Dërguari i Allahut i falte çdo ditë dy rekate namaz, kurse Aliu, i biri i Ebu Talibit ishte me të kur shkonte dhe kur kthehej duke mos iu ndarë. Ndërkohë që Pejgamberi po falej, ai hyri, e pa atë dhe tha: O babai i Kasemit çfarë është kjo? Ai tha: Ky është namazi për të cilën më ka urdhëruar Allahu që ta fal dhe e ftoi atë në islam. Ai u fal bashkë me të dhe sa herë që falej i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, Aliu ishte me të, kurse Hatixheja pas tyre.

Abdullah ibn Mes'udi ka thënë: Gjëja e parë që mësova nga çështja e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* kur erdha në Mekë bashkë me xhaxhallarët e mi, ishte një ndodhi që pashë kur na drejtuan tek Abbas ibn Abdul Muttalib. Kur arritëm tek ai, pamë që ishte ulur tek pusi zemzem, u ulëm pranë tij dhe aty erdhi një njeri nga porta e Safasë. Ai ishte i bardhë, anonte pak nga e kuqja, me flokë të dendur kaçurrela, me hundë të kuqe, dhëmbë të parë vezullues dhe dy sy të zi të mëdhenj, me mjekër të dendur, i veshur me rroba të bardha, si të ishte Hëna e natës së Bedrit. Në të djathtë të tij ecte një fëmijë adoleshent pa mjekër, me fytyrë të ëmbël dhe një grua që kishte mbuluar bukuritë e saj e që rrinte pranë tyre. U drejtua drejt gurit dhe e preku atë, pastaj e preku djali i vogël, e pastaj gruaja. U rrotullua rreth shtëpisë shtatë herë, kurse djali i vogël dhe gruaja bënin tavaf bashkë me të. Ne thamë: O njeri i mirë, me të vëretë këtë nuk e kemi njohur në mesin tuaj, çfarë ka ngjarë? Ai tha: Ky është djali i vëllait tim Muhamedi, i biri i Abdullahut, kurse djali i vogël është djali i xhaxhait të tij Aliu, i biri i Ebu Talibit, ndërsa gruaja është bashkëshortja e tij Hatixheja, e bija e Huvejlidit. Për Zotin nuk njohim njeri tjetër në faqen e tokës që të adhurojnë këtë fe' përveç këtyre të treve.

Hakim Meula Zadani ka thënë: Kam dëgjuar Aliun të thotë: "Jam falur shtatë vjet para se të faleshin njerëzit, ne vetëm bënim sexhde, por jo ruku dhe namazi i parë që kemi bërë në të ruku, ka qenë namazi i asrit (pasdites)".

Prijësi i besimtarëve, Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*transmeton: Unë jam rob i Allahut dhe vëllai i të Dërguarit të Allahut. Unë jam besniku më i madh dhe pas meje nuk e thotë njeri, përveç ndonjë gënjeshtari mashtrues, se unë jam falur bashkë me të Dërguarin e Allahut shtatë vite para njerëzve.

Ai *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*në një vend tjetër ka thënë: "Kam adhuruar bashkë me të Dërguarin e Allahut shtatë vite para se dikush tjetër nga ymeti të adhuronte Atë".

Në një tjetër transmetim ai *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*ka thënë duke e përsëritur tre herë: "O Allah, unë nuk kam njohur ndonjë rob prej këtij ymeti që të ka adhuruar Ty para meje, përveç Pejgamberit Tënd".

Talha ibn Shejbe është mburrur duke thënë: "Unë jam pronari i shtëpisë, në dorën time janë çelësat e saj dhe nëse dua fle në të, tek unë janë rrobat e shtëpisë së tij".

Abbas ibn Abdul Muttalib *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)* transmeton: "Unë jam pronari i kanalit ujitës dhe përgjegjësi i saj." Aliu i biri i Ebu Talibit *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*ka thënë: Unë nuk e di se çfarë thoni ju të dy, pasi unë jam falur gjashtë muaj para se të faleshin njerëzit dhe unë jam pronari i luftës së shenjtë. Për këtë Allahu i Madhërueshëm zbriti ajetin: "**Vërtet mendoni se ai që u jep ujë haxhilerëve dhe mirëmban Xhaminë e Shenjtë është njësoj me atë që beson në Allahun dhe Ditën e Fundit dhe që lufton në rrugën e Allahut?! Këta nuk janë të njëjtë para Allahut. Ai nuk i udhëzon në rrugë të drejtë njerëzit keqbërës**".[1]

Nga Ebu Ejub Ensarijju transmetohet se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "Melaiket kanë rënë në salavate për mua dhe për Aliun, të birin e Ebu Talibit, shtatë vite dhe kjo sepse askush veç tij nuk është falur me mua".

Nga lajmet dhe hadithet që u thanë më parë bëhet e qartë se prijësi i besimtarëve *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*është falur bashkë me Pejgamberin shtatë vite para të gjithë myslimanëve. Nga ky motiv, namazi është bërë obligim pa asnjë kundërshtim.

1 Suretu Teube/ajeti 19.

Kjo ndodhur natën e israsë tre vite para hixhretit, sepse Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka qëndruar në Mekë dhjetë vite pasi ishte dërguar shpallja dhe Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*shkonte bashkë me të. Gjatë këtyre shtatë viteve, ka ndenjur në shpellën Hira ose tek populli duke adhuruar të dy dhe qëndruan në atë situatë derisa namazet u bënë obligim të shkruajtura.



NXËNËSI I PARË I PEJGAMBERIT

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) [1]

Ka qenë vullneti i Allahut të Madhërueshëm, i cili ka caktuar që mençuria e Tij të mbushi zemrën e vulës së pejgamberëve, Muhammedit, të birin e Abdullahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me dashurinë e djalit të xhaxhait të tij, Aliut të birit të Ebu Talibit. Ta fusë në zemrën e tij, ta adoptojë dhe ta bashkonte me të, me këtë u shfaqën pozitat e veçorisë së tij. Që në çastin kur lindi Aliu, Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nisi ta pastrojë me dorën e tij fisnike në kohën e larjes, ta ushqente me qumësht, u kujdes për disa ditë ta ushqente me djersën e tij të bekuar. I tundte djepin e tij kur i vinte për të fjetur, i fliste atij ëmbëlsisht kur ai ishte zgjuar dhe e mbante në gjoksin e tij. I vinte rrotull maleve të Mekës, rrugëve dhe luginave të saj, kur e pyesnin për të ai thoshte: "Ky është vëllai dhe mbrojtësi im, ndihmësi, besniku dhe reporteri im".

---

1 Dijuanu Sejjid Humiri/ 370 dhe 460. El Lem'u i E Tusij /456. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebi Hadid, v 10, fq 10 dhe v 13 fq 197. Hilijetul Eulija1/64-66. El Menakibu i ibn Shehri Ashubi 2/35,36 dhe 45 dhe 55 dhe 226. Nihajetu derbi i Neuevijut 20/6. Es Siretul Halbijjeh 1/432. Jenabiul Meuedeh /102. A'janu Shi'ia 3/k 1/95,96. El Aleuijjatul Ishrune 43 dhe 77. Delailu Sidki 2/333. Dijuanu Abdulbaki el Umerij El Farukij /74.

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u kujdes për djalin e xhaxhait të tij deri kur arriti moshën katërmbëdhjetë vjeç, derisa e ndau nga prindërit dhe e bashkoi tek shtëpia e tij.

Imam Aliu *(Paqja q Allahut qoftë mbi të!),* në hytben e tij të quajtur "Përplasja" thotë: E keni mësuar pozitën time tek i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për nga afërsia e madhe dhe e gradës së veçantë. Më ka vendosur mua tek dhoma e tij e gjumit kur unë kam qenë fëmijë i vogël, më shtrëngonte fort në gjoksin e tij, më ruante në krevatin e tij dhe më merrte erë. Ai e përtypte diçka dhe ma kalonte mua, nuk ka gjetur tek unë asnjë gënjeshtër në fjalë dhe asnjë budallallik në vepra.

Djali i vogël u rrit nën kujdesin e djalit të xhaxhait dhe profesorit të tij, duke e ndjekur atë ashtu siç ndjek hija në mëngjesin e hershëm. Rehatia e shoqëronte në izolimet e adhurimit dhe merrte prej tij mësimet dhe moralet e larta. Përfitonte prej çdo gjëje që e afron atë me Allahun e Lartësuar dhe u largonte nga idiotësitë e idhujtarëve dhe injorancat e tyre. Për këtë imami në hytben e tij përmend:

Unë e kam ndjekur atë njësoj siç e ndjek i vogli i devesë nënën e tij, duke më ngritur mua çdo ditë prej moraleve të tij në dituri. Më urdhëronte që ta ndiqja nga pas, më fliste për çdo traditë në mënyrë të qartë, unë e shikoja e askush tjetër veç meje nuk e shikonte. Duke parë dritën e shpalljes dhe mesazhit, nuhasja aromën e profetësisë. Kam dëgjuar tringëllimën e shejtanëve kur shpallja ka zbritur te Ai *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).* I thashë: O i Dërguari i Allahut çfarë janë këto tringëllima? Ai tha: Ky është shejtani i cili është bërë pesimist nga adhurimi i tij dhe se ti dëgjon atë që dëgjoj unë, shikon atë që

unë shikoj vetëm se ti nuk je pejgamber, mirëpo ti je një ministër dhe ti je në një rrugë të mbarë.

Kur nxënësi arriti moshën e pjekurisë, u bë burrë, gjuha e tij shqiptoi atë që kishte marrë prej mësimeve profetike. Fjalët e bukura të profesorit të tij të madh u dukën qartë të mishëruara në llogjikën e tij, që i kishte lexuar nga ajetet Kur'anore të bekuara të cilat i zbrisnin atij. Duke ndjekur dhe shpjeguar hollësitë e kuptimeve, qëllimeve dhe mençurive të larta. Kishte futur në të këshilla. Kështu nxënësi vazhdoi duke ndjekur profesorin dhe djalin e xhaxhait të tij në shtëpi, xhami, në male, lugina, në fushat e betejës dhe të luftës. Duke shkruar shpalljen dhe çështjet e tij, duke dëgjuar fetvatë dhe duke e pyetur atë. Kur Pejgamberit i zbriste shpallja natën, lajmëronte Aliun sapo të agonte dhe kur zbriste ditën, nuk do të ngryste derisa ta lajmëronte Aliun.

Për nxënësin kishte një gjendje të brendshme çdo mëngjes dhe mbrëmje për të marrë nga dituria dhe udhëzimet e të Dërguari të bekuar *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, derisa e nxorri atë nga shembulli i tij. Ai solli dëshminë shqiptuese me përparimin e pashembullt, duke thënë: *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) :* "Unë jam qyteti i diturisë, kurse Aliu është porta e saj, kush e dëshiron qytetin le të hyjë nga porta e saj". Përsëri Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "Unë jam shtëpia e urtësisë, kurse Aliu është dera e saj". Ndërsa imam Aliu thënë: "I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* më ka mësuar mua shtatëdhjetë dyer të diturisë, të cilat nuk i dinte askush tjetër veç tij".

Një herë tjetër ka thënë: "Mua më ka mësuar i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e*

tij!) njëmijë dyer të diturisë dhe nga çdo derë, më hapeshin njëmijë dyer të tjera".

Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*në njërin prej fjalimeve të tij ka thënë: "Pasha Allahun, nëse të doja të lajmëroja çdonjerin prej jush për hyrjet dhe daljet e tij dhe për të gjitha që ka bërë, do ta bëja. Por, unë kam frikë se me mua, ju do të mohonit të Dërguarin e Allahut. A nuk jam unë mysafiri i tij special, fakt që garantohet edhe prej tij! Pasha Atë që e ka dërguar atë Pejgamber, me të vërtetë Ai është zgjedhur nga të gjitha krijesat, unë nuk them vetëm të vërtetën, ai ma ka premtuar mua të gjithë atë. Për të vdekurin kush vdes dhe për shpëtimtarin kush shpëton dhe në përfundim të kësaj çështjeje nuk mbetet gjë në kokën time, vetëm nëse e largoj nga veshët e mi dhe e gjeneroj në veten time.



I PARI QË I DHA FJALËN PEJGAMBERIT

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)

DHE DEKLAROI MBËSHTETJEN E TIJ[1]

Në fillimin e thirrjes islame dhe para shfaqjes së islamit në Mekën e bekuar, Allahu i Madhërueshëm mbi Pejgamberin e Tij të nderuar zbriti ajetin: "**Paralajmëroje farefisin tënd më të afërm**"[2] atëherë Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e urdhëroi Aliun që të përgatiste ushqim dhe të ftonte bijtë e Abdul Muttalibit në shtëpinë e xhaxhait të tij Ebu Talibit. Në atë kohë ata ishin dyzetë burra dhe në mesin e tyre ishin xhaxhallarët e tij, Ebu Talibi, Hamzai, Abbasi dhe Ebu LehEbu . Pasi u mblodhën dhe mbaruan së ngrëni, Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "O bijtë e Abdul Muttalibit, vërtetë, pasha Allahun ju kam sjellë juve më të mirën e dynjasë dhe begatinë e Ahiretit. Allahu i Lartësuar më ka dhënë urdhër që t'ju ftoj juve tek Ai, pra cili prej jush do të më mbështesë mua në këtë çështje që ai të jetë vëllai, këshilltari dhe mëkëmbësi im në mesin tuaj? Njerëzit heshtën, pastaj e

1 Dijvanu Sejjid Humejri/118 dhe 436. Tarikhu Tabari 2/319. El Irshadu /29. Mexhmeul Bejan i Tabarsij, komentimi i xhuzit 19/187,188. El Menakibu 2/24-28. El Kamilu i ibn Ethirit 2/41. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebi Hadid 13/244,245. El Mukhtasar fi Akhbaril Bashar, 1/116. A'janu Shi-ia 3/k 1/110 dhe 142-144. El Aleuijatul Ishrun /103. Hajatu Muhamed lil hejkel, botimi i parë/104. El Muraxheatu /130-132. El Gadiru 2/278-287.

2 Suretu Shu'ara/ajeti 214

përsëriti fjalën tre herë dhe në secilën herë ngrihej vetëm Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe thoshte: Unë të ndihmoj ty o i Dërguari i Allahut me atë që ke sjellë, të mbështes dhe të jap besën. Pa prej te ftuarëve pesimizëm dhe braktisje, kurse tek Aliu pa mbështetje. Pa prej tyre kundërshtimin, gjynahun, kurse prej tij (Aliut) bindjen "Ky është vëllai, këshilltari dhe mëkëmbësi im pas meje". Ata u ngritën duke u tallur dhe duke qeshur duke i thonin Ebu Talibit: "*Bindju tani djalit tënd, sepse ai e zgjodhi atë para teje*".

Ebu Xha'fer Iskafiju el mu'teziliu për këtë lajm ka një koment me një argumentim të pjekur, të cilën e ka përmendur në librin e tij "Nakdul Uthmanijeh" dhe në të thuhet se osmanllinjtë kanë thënë: "Aliu, i biri i Ebu Talibit nuk ka ndonjë avantazh me paraprijen e tij në islam, sepse ai u bë mysliman kur ishte fëmijë dhe jo në moshën e përgjegjshmërisë".

A i besohet sekreti i profetësisë një fëmije të moshës pesë apo shtatë vjeçare? A pranohet në mbledhjen e burrave dhe njerëzve të vjetër, përveç atyre që janë të arsyeshëm të mençur? A e lë i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në dorën e tij? A mundet t'i japë atij fjalën e besës me vëllazëri, këshillim dhe trashëgimi vetëm duke qenë meritor për atë gjë? Duke kapërcyer kufirin e obligimit, bartës të mbrojtjes së Allahut dhe armiqësisë së armiqve të tij? Si është puna me këtë fëmijë që nuk shoqërohet me moshatarët e tij dhe nuk merret me problemet si një pjesë e tyre në njohurinë e tij? Po si nuk shembëllton të shkojë tek ata në një nga orët e tij dhe të thuhet: Është lutja e thirrësit të rinisë dhe është lëkundje prej lëkundjeve të dynjasë? E ka preokupuar atë hutimi dhe të qënit i ri që të marrë pjesë në zbavitjen dhe të hynte në gjendjen e tyre. Ne nuk e kemi parë atë vetëm se duke ecur në islam, i vendosur në çështjen, fjalët dhe veprat e tij. I qëndroi islamit me modesti,

qëndroi larg interesave të dynjasë dhe iu ngjit të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në mesin e të gjithëve me prezencën e tij, pasi ai është besniku dhe shoku i tij në dynjanë dhe Ahiretin e tij. Ai e mposhti pasionin dhe i shndërroi idetë e tij duke duruar, sepse shpresonte fundin fitimtar dhe shpërblimin e Ahiretit. Ai *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*e ka përmendur hapjen e çështjes, në fjalën dhe hytbet e tij fillimin e situatës, kur u bë mysliman. Kur i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e ftoi pemën në islam dhe ajo erdhi duke çarë tokën dhe kurejshët thanë: Ai bëri një magji të lehtë, e ndërsa Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*tha: O i Dërguari i Allahut, unë jam besimtari i parë që besova tek ty, besova tek Allahu dhe tek i Dërguari i Tij, të qëndroj besnik me atë që ti ke sjellë dhe unë dëshmoj se pema e bëri atë me urdhërin e Allahut, duke konfirmuar profetësinë tënde, argument i gjallë i vërtetësisë së thirrjes tënde.



I PARI I SHKRUAJTËSVE TË SHPALLJES[1]

Transmetuesit kanë dhënë mendime të ndryshme në lidhje me numrin e shkruajtësve të shpalljes, të cilët arrijnë deri në dyzet apo më shumë. Ata u përzien mes shkruajtësve të shpalljes dhe shkruajtësve të çështjeve të përgjithshme, në eksplorimin e librave të historisë profetike. Në historinë dhe jetën e sahabeve shfaqet qartë se shkruajtësit e shpalljes janë katër persona, Ali ibn Ebu Talibi, Osman ibn Affan dhe nëse këta të dy nuk ishin prezentë i zëvendësonin Ebu ibn Ka'bi dhe Zejd ibn Thabit. Por, a është e mundur që përcaktimi i fillimit të punëve të këtyre katër shkruajtësve të jetë pas njohjes së historisë islame nga secili prej tyre?

Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*e praktikoi shkrimin e shpalljes i vetëm për trembëdhjetë vite, duke filluar që nga dita e dytë e zbritjes së shpalljes deri në migrimin e Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* .

1 Dijuan Sejjid Humejri /82. El Akdul Ferijd 4/161. El Uzerau ul Kuttabu /12,13. Dijuan Sahib ibn Ubadi/82, 83. El Istiab, 1/65,66. El Menakibu 2/35 dhe 42. Usdul Gabe 1/49,50 dhe 2/221 dhe 3/173. Mukhtasar Tarijkh ibn Kazeruni m 55, dhe Jenabiul Meude, 39 fq 141,142.

Ndërsa Osmani edhe pse ishte prej myslimanëve të parë, ai nuk ishte i stabilizuar në Mekë pas islamit të tij. Ai emigroi dy herë bashkë me familjarët e shtëpisë së tij në Abisini dhe sapo u kthye nga atje herën e dytë, ai migroi në Medine.

Kur i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u nis për migrim, në Medine u themelua shteti islamik, u shtuan punët e shokëve të parë të Pejgamberit, u ndanë detyrat e tyre prej shtimit të betejave të shumta dhe sekreteve.

Pritja e delegacioneve dhe dërgimi i mesazheve e ngarkoi Osmanin me shkrimin e shpalljes bashkë me Aliun.

Kurse Ebu ibn Ka'bi, i cili është prej Ensarëve u bë mysliman në marrëveshjen e dytë të Akabesë, domethënë pak para hixhretit të Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* . Ai nuk e kishte praktikuar shkrimin e shpalljes vetëm se në Medinen e Ndritshme.

Zejd ibn Thabit ishte një tjetër që u bë mysliman, edhe ky ishte prej Ensarëve, pas hixhretit të Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Në atë kohë ai ishte njëmbëdhjetë vjeç dhe Pejgamberi e nënvlerësoi atë ditën e Bedrit. Por nga përgjigjja që ai i dha, u bë zëvendësi i tij në shkrimin e shpalljes hyjnore. Nga ana tjetër ka edhe lajme të pavërteta që thonë: "Me të vërtetë Abdullah ibn Sa'di ibn Ebu Serehi është i pari i shkruajtësve të shpalljes nga kurejshët dhe fjalë të tjera si këta që përftohen prej tyre se: Ebu ibn Serehi është i pari që ka shkruajtur shpalljen hyjnore". Por që të dyja këto thënie janë të refuzuara, sepse ibn Ebu Serehi u bë mysliman në vitin e tetë të hixhretit, pak para se të çlirohej Meka, pastaj ai hoqi dorë nga islami dhe u arratis nga Medineja në Mekë. Kur Pejgamberi (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të* dhe *mbi familjen e tij!)* shkoi në

Mekë si çlirues, Osman ibn Afani hyri ndërmjetës për të, sepse ai ishte vëllai i tij nga Medina dhe e pranoi Pejgamberin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* si ndërmjetësuesin e tij, e fali atë, kurse Ebu Serehi e rinovoi islamin e tij dhe u bë përsëri mysliman.

Ebu Ka'bi, siç përmendet edhe më parë u bë mysliman pak para hixhretit dhe nuk ka shkruajtur për të vetëm pas ardhjes së Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në Medine.

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka pasur shumë njerëz që shkruanin, një prej tyre është Khalid ibn Seidi ibn Asi dhe Muavije ibn Ebu Sufjani që shkruanin për nevojat e tij. Kurse Mugire ibn Shu'be dhe Hasijn ibn Nemiri shkruanin në mesin e njerëzve, zëvendësonin Khalidin dhe Muavijen nëse nuk ishin prezentë.

Abdullah ibn Erkami dhe Ala ibn Akabe kanë shkruar për popullin, fiset dhe ujërat e tyre në rradhët e Ensarëve, mes burrave e grave dhe mbase Abdullah ibn Erkami i shkruante mbretërve për Pejgamberin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Ndërsa Hudhejfe ibn Jemani shkruante jashtë hurmave të Hixhazit. Zejd ibn Thabiti i shkruante mbretërve atë që shkruante në shpallje. Kurse Muajkib ibn Ebu Fatime shkruante për triumfet e Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Kurse Handhale ibn Rebu 'i, djali i vëllait të Ekthemit ibn Sajfi ka qenë shkruajtës prej shkruajtësve të Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* i cili nëse dikush mungonte në punën e tij, ai kishte shumë emra për t'i zëvendësuar.

Në pjesën e katër "Aliu është nxënësi i parë i Pejgamberit" është përmendur se: Kur Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i zbriste shpallja natën, sapo agonte ai e lajmëronte Aliun për të dhe kur zbriste gjatë ditës, nuk ngryste derisa të lajmëronte Aliun.

Imam Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*ka thënë: Me të vërtetë se unë e di kopjuesin e Kur'anit dhe kopjen e tij, ekzaktësinë dhe të dyshimtat e tij. Nuk ka një shkronjë të vetme që ka zbritur, vetëm unë e di për cilin ka zbritur dhe për çfarë teme ka zbritur, për Zotin ky eshtë ajeti që Allahu ka zbritur: "**e kanë mësuar atë veshë që mbajnë mend**". Ne kemi qenë te i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe ai na lajmëronte për shpalljen dhe unë i mbaja mend shumë mirë, kurse të tjerët e humbisnin dhe kur ne dilnim ata thonin: Çfarë tha ai pak më parë?



AI ËSHTË I PARI QË JU KA LIDHUR ATIJ MBROJTJA NDAJ MYSLIAMNËVE[1]

Prijësi i besimtarëve, Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*ju ka dhënë mbrojtje në disa raste, e para e tyre ka qenë dita e shtëpisë kur ka zbritur ajeti i bekuar "**Paralajmëroje farefisin tënd më të afërm**"[2].

Në pjesën e pestë është përmendur se Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i ftoi bijtë Abdul Muttalibit, të cilin ishin dyzetë burra dhe kur u lexoi atyre ajetin, u tha: Cili prej jush më mbështet mua në këtë çështje e të bëhet vëllai, këshilltari dhe mëkëmbësi im në mesin tuaj dhe ua përsëriti fjalën atyre tre herë. Por askush nuk iu përgjigj, përveç Aliut të birit të Ebu Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)* duke thënë në çdo herë: Unë të mbështes ty o Pejgamber i Allahut me atë që ti ke ardhur, të ndihmoj dhe të jap besën. Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* duke e marrë për dore Aliun tha: "Ky është vëllai, këshilltari dhe mëkëmbësi im, pas meje".

---

1 Dijuanu Sejjid Humejri/111,112. Akhbar El Muafakijat /312. Dijuanu Sahib ibn Ubadi /261. El Irshadu /10,11. Esbabu Nuzul /192. Tefsirul Keshaf 1/468. Mexhmeul Bejan, komentimi i xhuzit të pestë/124-130. Tefsiri Fakhru Razij 12/26. Dhekhairul Ukba /88-102. Nurul Ebsar /77. El Muraxheatu /172-199. Delailu Sidki 2/44-63. El Gadiru 2/39, 58,330 dhe 3/354.

2 Sure Shuara, ajeti 214.

Myslimanët janë të një mendimi se ky ajet ka zbritur sapo imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* pranoi vulën e pejgamberëve në kohën kur ai ishte në ruku. Ebu Dheri *(Paqja qoftë mbi të!)*kanë thënë: Një ditë kam falur me të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* namazin e drekës, një lypës po lypte në xhami dhe askush nuk i dha atij gjë. Në këtë moment lypësi ngriti duart nga qielli dhe tha: O Allah, Ti je dëshmitar që unë kam lypur në xhaminë e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe askush nuk më dha gjë.

Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*ishte në ruku kur i bëri me shenjë lypsit të shkonte e ti merrte unazën e tij të vendosur në gishtin e tij të vogël, me nxitm ai shkoi dhe e mori atë. E gjithë kjo ndodhi në sy të të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).* Ai mbaroi namazin ngriti kokën nga qielli dhe tha: "O Zoti im, me të vërtetë se vëllai im Musai të është lutur Ty dhe ka thënë: "**Zoti im, ma zgjero gjoksin tim dhe më lehtëso në këtë punën time, më zgjidh nyjën e gjuhës time që ta kuptojnë fjalën time, më cakto një ndihmës nga familja ime, Harunin, vëllain tim, që me të, të ma forcosh fuqinë time, bëma shok atë në punën time".** Për këtë Allahu zbriti në Kur'an: **"O Zoti im, zgjeroma kraharorin tim, lehtësoma punën time, më jep një ndihmës nga familja ime, ma rrit fuqinë nëpërmjet atij"... "Ne do të të forcojmë ty me vëllanë tënd dhe që të dyve do t'ju japim fuqi. Kështu, ata nuk do të mund t'ju afrohen juve. ".**[1]

Ebu Dheri ka thënë: "Pasha Zotin, Pejgamberi nuk e plotësoi fjalën kur Xhebraili zbriti me urdhërin e Allahut të

1 Në lutjen e të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka përbërje të përkujtimit të të Mençurit që është fjala e Tij të Lartësuarit :" Zoti im më zgjero gjoksin tim... "sureja Ta-ha / ajeti 25". Ne do të forcojmë ty krahun...". sureja El-Kasas / ajeti 35.

Madhëruar dhe i tha: Lexo o Muhamed! "**Miqtë dhe mbrojtësit tuaj janë vetëm Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët që falin namazin dhe japin zeqatin, duke qenë të përulur (në adhurim) ndaj Allahut**".[1]

Hadithet profetike janë përsëritur në mbështetjen e miqësisë së afërt të Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*. Për shkak të numrit të madh të hadditheve, mjaftohemi me citimin e një pjese të tyre, por kush dëshiron më tepër duhet të përsërisë burimet e kësaj pjese. Për të qëndruar dhe mësuar më shumë në të dhe në pikat e saj nga librat e të vërtetave, virtyteve dhe tefsirit.

- Nga ibn Abbasi transmetohet: I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i ka thënë Aliut, të birit të Ebu Talibit: "Ti je miku më i mirë për çdo besimtar pas meje".

- Imran ibn Husajni transmeton: "Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dërgoi një shërbëtore dhe e vuri në shërbim të tyre. Aliu, i biri i Ebu Talibit zgjodhi për veten e tij një nga pesë robëreshat, kurse ata e kundërshtuan atë, ndërsa katër prej tyre ranë dakord të shkonin tek Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për ankesën e tij. Kur arritën, njëri prej iu ngrit të katërve dhe u tha: O i Dërguari i Allahut! Me të vërtetë Aliu ka bërë kështu e kështu, por ai e kundërshtoi atë. U ngrit i dyti dhe përsëriti të njëjtën gjë që tha edhe shoku i tij, por ai e kundërshtoi përsëri. I treti tha të njëjtat fjalë dhe përsëri e kundërshtoi, edhe i katërti tha të njëjtat fjalë që thanë të tjerët. Pasi i dëgjoi Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u kthye nga ata, hidhërimi dukej qartë në fytyrën e tij e u tha: Çfarë

1 Sureja Maide / ajeti 55.

doni prej Aliut? Me të vërtetë Aliu është prej meje dhe unë jam prej Aliut, ai është miku më i afërt i çdo besimtari pas meje."

- Burejde u ankua tek i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për ashpërsinë e Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe i tha atij: "O Burejde, a nuk jam unë miku më i afërt, më i dashuri i besimtarëve se sa vetet e tyre? Ai tha: Posi jo, o i Dërguari i Allahut: Atë që ti ke mik të afërt, Aliu është miku i tij i afërt". Ky hadith është përmendur nga burime të shumta, me ndryshime në të shprehur, por përmbajtja është e njëjtë.

- I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në një hadith që janë përmendur dhjetë cilësi të Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*ka thënë*:* "Ti je miku më i afërt i çdo besimtari pas meje."

- Nga Veheb ibn Hamza transmetohet: Kam udhëtuar me Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe kam parë tek ai ashpërsi, thashë me vete: Kur të kthehem do të ankohem për të, kur u ktheva i thashë të Dërguarit të Allahut për Aliun dhe mora prej tij këtë përgjigje duke thënë: Mos e thuaj këtë për Aliun, sepse pa dyshim ai është miku më i afërt i juaji, pas meje".

- Fjala e tij *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për Aliun: "Ky është imami i justifikuar i të mirëve, luftues i të këqijave, ndihmëtar i atij që e ndihmon dhe zhgënjyes për atë që e zhgënjen atë".

- Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "Më është shpallur mua se Aliu është i nderuari i të dërguarve dhe miku më i afërt i të devotshmëve dhe komandanti i naivitetit të të hutuarve".

- Ai *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* "Me të vërtetë Allahu i ka premtuar Aliut se ai është flamuri

i udhëzimit, imami i miqve të Mi dhe dritë e atij që më bindet Mua dhe ai është fjala që ia kam bërë obligim të devotshmëve".

Në fjalën e tij, i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "E këshilloj atë që ka besuar Allahun dhe më ka pranuar mua me ruajtjen e Aliut, të birin e Ebu Talibit. Sepse kush merr nën ruajtje atë, më ka marrë mua dhe kush kujdeset për të pas meje, ai ka marrë për mik të afërt Allahun. Kush e do atë, më ka dashur mua dhe kush më ka dashur mua, ka dashur Allahun e Madhërueshëm".

Në fund është hadithi të cilin e transmetojnë të gjithë myslimanët pa përjashtim duke rënë dakord se Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* zbriti në vendin e nisjes së tij. Në haxhin e lamtumirës, ai u foli dhe u tha njerëzve, duke kapur për dore Aliun: "Jam shoku dhe miku i tij më i afërt, atëherë ky është Aliu, shoku dhe miku i tij, o Allah, qëndroi afër. Atë që i qëndron afër, mbështete. Trajtoje si armik atë njeri që e trajton si armik Aliun, ndihmoje atë njeri që e ndihmon atë dhe hiq dorë prej atij njeriu që heq dorë prej tij".

Mirëpo myslimanët, jo nga radhët e shi'itëve, kanë thënë: "Me të vërtetë, për fjalën "meula" ka disa kuptime: Betim, komshi, bir, xhaxha, djali i xhaxhait, dashamirësi, ndihmës, posedues dhe bartësi i çështjes".

Përveç kuptimit të fundit (poseduesi i çështjes), e cila është një shprehje për përparësinë e miqësisë. Për të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* konteksti i imamatit, udhëheqjes së Aliut pas tij, është se askush prej atyre që erdhën në ditën e lamtumirës për kalifatin e Ebu Bekrit, nuk do të heshtë.

Kurse sa i përket shi'itëve, ata mendojnë se Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me fjalën "el-

meula" ka pasur si qëllim kuptimin (poseduesi i çështjes) në mënyrë strikte dhe kjo për shkak të mungesës së zbatimit të çdo kuptimi tjetër. Këtë fjalë e kanë argumentuar me shumë shembuj, disa prej tyre janë: Me të vërtetë Allahu i Madhërueshëm i shpalli Pejgamberit të Tij *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mesazhin që është fjala e Tij e madhërueshme: "**O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin eTij; Allahu të ruan ty prej njerëzve. Natyrisht që Allahu nuk i udhëzon njerëzit që nuk besojnë**".[1]

E para: Zbritja e Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në atë situatë e cila nuk i përshtatet zbritjes është afër rrugëve të përçara. Kjo është pozita më e mirë e përcjelljes së mesazhit para ndarjes, përçarjes së myslimanëve dhe shkuarjes në shtëpitë e tyre.

E dyta: Ishte koha e duasë, kohë që nuk kërkon zbritjen dhe ndalimin e rrugës së ecjes, përveçse për një çështje shumë të rëndësishme. Kështu Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i vendosi ata në një vend të hapur, në një ditë shumë të nxehtë, ku shumica e njerëzve kishin hedhur veshjet dhe rrobat poshtë këmbëve të tij. Ai urdhëroi që burrat të mblidheshin, i vendosi rrobat sipër njëra-tjetrës, pastaj urdhëroi thirrësit e tij për namazin. Ai u ngjit në minderin e improvizuar, derisa arriti në majë dhe ftoi Aliun të ngjitej tek ai. Aliu qëndroi në të djathtë të tij, pastaj u mbajti ligjëratë dhe i këshilloi, përcolli mesazhin e lajmëroi ymetin e tij: "Me të vërtetë, unë jam i ndjekur në mesin tuaj, në atë që nëse ju kapeni fort pas tij nuk do të humbisni kurrë, Librin e Allahut dhe linjën pasardhëse të

1 Suretu Maide /ajeti 67.

familjarëve të shtëpisë sime, sepse pa dyshim ato dy gjëra nuk do të përçahen kurrë edhe sikur të hidhen në det".

Pastaj me sa fuqi kishte, thirri: "A nuk jam më i dashuri për ju se sa vetet tuaja?" Ata thanë: Po për Zotin, për rregullin dhe harmoninë. Pa asnjë disfatë e mori krahun e prijësit të besimtarëve dhe i ngriti lart derisa iu duk e bardha e sqetullës së tij, nëse unë jam miku dhe mbrojtësi juaj atëherë ky është Aliu, miku dhe mbrojtësi tij... Hadith".

Pra nuk është e llogjikshme që të merren të gjitha këto zhvillime ngjarjesh me qëllim që Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* t'u thotë myslimanëve se: "Me të vërtetë Aliu është djali i xhaxhait tim, ndihmësi dhe komshiu im apo të ngjashme me këto sqarime tepër të qarta.



I PARI QË ËSHTË QUAJTUR SI TRASHËGIMTAR[1]

Hadithi profetik na tregon për ngjarjen e shtëpisë, e cila është përmendur në pjesët (5 dhe 7). Atë ditë kur Pejgamberi ua tërhoqi vërejtjen njerëzve të afërt të farefisnisë së tij dhe duke kapur për dore djalin e xhaxhait të tij tha: Ky është vëllai, këshilltari dhe trashëgimtari pas meje". Me të vërtetë me lindjen e islamit, këshilla iu bashkangjit Aliut, kurse Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e vazhdoi këtë mbështetje duke e përsëritur herë pas here dhe duke e konfirmuar me fjalë dhe vepra. Disa nga hadithet në trashëgiminë e Aliut janë:

- "Me të vërtetë, trashëgimtari dhe vendi i sekretit tim është më i miri që do të lë pas meje, ai që përmbush premtimin dhe kryen borxhin tim është Aliu, i biri i Ebu Talibit".

-Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* Enesit, të birit të Malikut, shërbëtorit të tij, i ka thënë: *"O Enes, i pari që do të hyjë nga kjo derë është imami i njerëzve të*

1 Dijuan Ebu Esuedit Ed dueli /72, El Hashimijat i Kemijt /29, Dijuan Sejjid Humejri /63. Akhbarul Muafakijat, /593. Belagatu Nisa, /38. El Kamilu i Muberridit 3/204,205. Dijuanul Mutenebij, sherhul Uahidij, /856. El Irshadu i El Mufid/31. Huljetul Uelija 1/63. El Menakib i ibn Shehri Ashubi 1/238. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebi Hadid 1/143-150 dhe 6/35. Lisanul Arab (madetu el uasij). El Iberu i Edh Dhehebij 5/289-290. Taxhul Arus, (madetu el uasij). El Muraxheat /240-332. Fadilu khamse fi Sihahi es Siteh, 2/32.

devotshëm, është më i nderuari i të dërguarve, është mbrojtësi i fesë, vula e trashëgimtarëve dhe komandanti i trimave dhe guximtarëve" Enesi tha: Kur erdhi Aliu, i biri i Ebu Talibit, i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u çua drejt tij, duke buzëqeshur e përqafoi dhe i tha: "*Ti (Ali) do të më përmbushësh mua dhe do të bësh të dëgjohet zëri im dhe do t'ua bësh atyre të qartë që të kontradiktohen në të kur unë të mos jem*".

- Në fjalën e tij i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* për copën e mishit të tij, lulen, Fatimenë *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "A e di ti se Allahu i Madhërueshëm i ka parë me imtësi banorët e tokës dhe zgjodhi prej tyre babain tënd, e dërgoi atë Pejgamber, pastaj pa përsëri dhe zgjodhi bashkëshortin tënd dhe ma shpalli mua, e unë e martova me ty dhe e bëra trashëgimtar".

- Në një tjetër transmetim Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i ka thënë Aliut *(Paqja qoftë mbi të!):* "Unë jam vula e pejgamberëve, kurse ti o Ali, je vula e trashëgimtarëve".

- Ai *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e këshilloi atë që të flinte në shtratin e tij kur të nisej për hixhret dhe të qëndronte pak në Mekë në vend të tij, që të kryente amanetet tek pronarët. Të përmbushte borxhet dhe premtimet, pastaj të mblidhte bijat dhe gratë e familjes së tij e të migronte bashkë me to në Medine.

Zubejdi, tek *Taxhul Arus* "lënda el uasij" ka thënë: El uesijju është si el-fennijju dhe është lagap i Aliut *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*. Ibn Mendhuri e ka thënë më parë në gjuhën arabe se lënda e trashëgimisë (testamenti) është ajo që të lihet trashëgimi dhe është quajtur kështu për shkak të lidhjes së saj me çështjen e vdekjes. Për këtë, Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*i është thënë: "vesijjun" trashëgimtar për lidhjen dhe prejardhjen e tij, motivit dhe atributit

të tij në lidhje me prejardhjen e të nderuarit tonë, të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Për shkak të atributit të tij, ibn Mend'hurit ka thënë: "Allahu e ndriçoftë fytyrën e prijësit të besimtarëve, Aliut dhe e begatoftë atë, këto janë ato cilësitë e tij tek selefët punëmirë".

Nipi i të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* Imam Hysejni, i biri i Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* në prezantimin e hytbes kur u vra babai i tij *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij)* ka thënë: "Unë jam djalë pejgamberi, unë jam djalë trashëgimtari...".

Për këtë ka folur edhe Ummul Khajri, e bija e Hurejshit, rrezja e shpresës në Sifin duke nxitur popullin e Kufes për luftë. Në fjalimin e saj ajo ka thënë: "Nxitoni ju mëshiroftë Allahu, drejt imamit të drejtë, trashëgimtarit besnik dhe të sinqertit më të madh" deri në fund të fjalës së saj. Shembuj të tillë ka shumë dhe kjo fjalë nuk mund t'i asimilojë të gjitha.



IMAMI I PARË NË ISLAM[1]

Në gjuhë, fjala imam ka shumë kuptime dhe ajo që synohet me të është imami, prijësi i myslimanëve me të cilin lidhen veprat dhe fjalët e tij, udhëzohen me diturinë dhe punën e tij. Imamati dhe udhëheqja është sinonim i kalifatit, kurse imam Ridha Ali ibn Musa e ka përkufizuar atë me fjalën e tij: Imami është bukuria e fesë, rregulli i çështjeve të myslimanëve, fuqia e besimtarëve dhe stanjacioni i jobesimtarëve. Është besniku i Allahut te krijesat e Tij dhe argument për krijesat e Tij.

Të parët e shi'itëve që e kanë parë Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*, janë të gjithë bijtë e Benu Hashimitë, Selman Farisij, Omar ibn Jasir, Ebu Dherr El Gifarij, Mikdad ibn Esvedi elkendi, Khazimetu ibn Thabit i dy dëshmive, Ebu Ejjub El Ensarij, Xhabir ibn Abdullah El Ensarij, Ebu Seid El Khudrij dhe të tjerë prej brezave të sahabeve prej muhaxhirinëve (atyre që migruan). Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e ka provuar udhëheqjen e Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe kalifatin e tij, sapo janë bashkuar tek ai veçoritë, tiparet dalluese të udhëheqjes,

1 Dijuan Sejjid Humejr /322. Huljetul Eulija 1/66 dhe 71. Tarikhu Bagdad 11/112, dhe 13/123. Menakib i ibn Shehri Ashubi 1/ 246 dhe 250, 2/ 70 dhe 320, dhe 3/19 dhe 28 dhe 103. Usdul Gabe 1/69 dhe 3/116. Jenabiul Meuedeh /98 (kapitulli i gjashtëmbëdhjetë). El Muraxheat /189,190. El Gadijr 2/67, 127,338 dhe 10/358,362. El Abkarijat /749,750.

cilësitë e mirësisë dhe të përsosjes të cilat nuk janë bashkuar tek askush tjetër veç tij.

Në këtë rrugë kanë ecur pasardhësit prej shi'itëve dhe të gjithë e shikojnë bindjen me literaturë për udhëheqjen e Aliut *(Paqja qoftë mbi të!).* Nga obligimet e bazave të fesë, ata kanë influencë dhe raunde që kanë mbushur me dhjetëra botime duke mos i lënë kundështarëve të tyre asnjë dyshim. Ata vetëm se i kanë larguar njollat e tyre me argumente të qarta, si qartësia e Diellit. Por, kush dëshiron që të mësojë më shumë për të, atëherë ai duhet të përsërisë librin Esh Shafij të Sherif Murteda, Nehxhul Hak të dijetarit el Hil'lij dhe Delailu Sidk, të eruditit Muhammed Hasan El Mudhaffar, El Muraxheatu të imam Sherefu Din dhe El Gadiru i dijetarit Emini.

- Në shumë hadithe të përmendura nga Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* ka një literaturë të qartë për imamatin e tij dhe prej tyre që kanë të qartë argumentin e fjalës së Tij *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).* Aliu është kalifi, trashëgimtari im, prijësi i besimtarëve, i pari i myslimanëve, i pari i arabëve dhe i pari i sahabeve, mbrojtësi i fesë dhe më i miri i punëmirëve. Për të ka edhe shumë epitete të tjera, prandaj mjaftohemi me citimin e disa haditheve profetike tek të cilat është përmendur qartë fjala "imam".

- Imam Aliu *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij)* ka thënë: "I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* më ka thënë mua: "Mirëseerdhe i pari i myslimanëve dhe imami i të devotshmëve". E më pas më kanë pyetur: Për çfarë gjëje ishte ky falënderimi yt? Ai tha: E kam falënderuar Allahun e Lartësuar për atë që më ka lënë trashëgim dhe që të më shtonte më shumë mua nga ajo që më kishte dhënë".

-Nga Enes ibn Malik transmetohet se ka thënë: "Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha Ebu Berze El Eslemijjut dhe unë po e dëgjoja: "O Ebu Berze: Me të vërtetë, Zoti i të gjitha botërave më ka premtuar mua një premtim për Aliun, të birin e Ebu Talibit dhe tha: Me të vërtetë ai është flamuri i udhëzimit dhe feneri i besimit, imami i miqve të mi të afërt dhe drita e të gjithëve atyre që më janë bindur mua".

- Nga Amar ibn Jasiri *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*transmetohet: "I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "O Ali, me të vërtetë Allahu i Lartësuar të ka zbukuruar ty me një bukuri që askush nga robërit nuk është zbukuruar, me një bukuri më të dashur tek Allahu, ajo është bukuria e punëmirëve tek Allahu *(xh.xh)*. Ajo është asketizmi në dynja, e të ka bërë ty që të mos privosh asgjë nga dynjaja dhe dynjaja të mos privojë asgjë prej teje. Të ka dhuruar ty dashurinë e të vobektëve dhe të ka bërë që të jesh i kënaqur me to si ndjekës dhe ata të jenë të kënaqur me ty si imam".

- Ebu Dherri *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*ka thënë: "Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) duke kapur dorën e Aliut tha: "Ky është imami i punëmirëve, luftëtari i njerëzve të çthururve, ndihmëtar i atij që e ndihmon atë dhe i braktisur është ai që e braktis atë" pastaj e zgjati zërin e tij në të".

- Fjala e tij *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "Më janë shpallur mua tre gjëra për Aliun, të birin e Ebu Talibit: Se ai është më i nderuari i të dërguarve, imami i njerëzve të devotshëm dhe komandanti i njerëzve të famshëm".

- Ibn Abbasi *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*ka thënë: I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi*

familjen e tij!) transmeton: "Ditën e kijametit nuk do të jetë askush i hipur mbi kafshë përveç, katër personave". Xhaxhai i tij Abbasi tha: Aman na e thuaj, ti dhe kush tjetër është? Ai tha: "Unë do të jem i hipur mbi kafshën e Allahut, Burakun, kurse vëllai im Salihu do të jetë mbi devenë e Allahut e cila u ther, ndërsa xhaxhai im Hamzai, luani i Allahut dhe luani i të Dërguarit të Tij do të jetë mbi devenë time, kurse vëllai im dhe djali i xhaxhait tim dhe dhëndrri im, Aliu, i biri i Ebu Talibit do të jetë mbi një deve prej deveve të Xhenetit. Në dorën e tij ka flamurin e falënderimit dhe kur kalon afër një grumbulli melekesh ata thonë: Ky është një melek i afërt i Allahut, një pejgamber i dërguar apo Bartësi i Arshit të Zotit të Botërave. Kur thërret një thirrës nga afër Arshit, nga brendësia e Arshit thotë se ky nuk është një melek i afërt, as lajmëtar i dërguar dhe as Bartës i Arshit të Zotit të Botërave. Ky është Ali ibn Ebu Talibi, prijësi i besimtarëve dhe imami i njerëzve të devotshëm, komandanti i njerëzve të famshëm në Xhenetet e Zotit të botërave. Ai që e pranoi atë si të vërtetë ka shpëtuar dhe ai që e përgënjeshtroi ka dështuar. Edhe sikur një rob ta ketë adhuruar Allahun për njëmijë vjet, nëse ai del para tij duke e urryer familjen e Muhamedit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, Allahu do ta kapë atë nga vrimat e hundës së tij e do ta fusë në zjarrin e Xhehenemit".

Profesori i madh Abbas Mahmud Ukadi ka thënë se Ali ibn Ebu Talibi e përdor epitetin imam në mesin e të gjithë kalifëve të udhëzuar, ai që e përdor si titull atëherë nuk i shkon askujt përveç tij në mesin e të gjithë imamëve të cilët janë përshkruar me këtë cilësi.

Po pse? Nuk është vetëm ai unik në imamatin me të gjitha kuptimet e saj.

A nuk ka qenë Ebu Bekri Es-Siddiku, imam si Aliu?

A nuk ka qenë Faruku imam si Aliu?
A nuk ka qenë Othmani imam si Aliu?
A nuk kanë qenë kalifë të udhëzuar, nëse supozon kalifatin e udhëhequr pas profetësisë?

Po, posi jo, ata kanë qenë imam njësoj si Aliu dhe kanë qenë para tij. Mirëpo imamati atë ditë ka qenë i vetëm në sheshin e gjykimit pa asnjë debat dhe ortak. Fatkeqësisht nuk është shkruajtur për asnjërin nga ata që mbajë flamurin e udhëheqjes që të përqafojë me të flamurin e shtetit të dynjasë. As nuk është përgatititur me një ushtri përballë një ushtrie dhe një cilësi që refuzon një cilësi tjetër, dhe as që të bëhet simbol i kalifatit që të krahasohet me të, edhe as të krahasohet me diçka tjetër.

Pra, që të gjithë ata janë imam, pa asnjë dyshim dhe konfuzion, mirëpo imami pa ndjekje, vazhdimësi dhe pa shënime të sqaruara është imami Ali ibn Ebu Talibi . *(Paqja qoftë mbi të!)* Ashtu siç e kanë etiketuar atë njerëzit dhe epiteti i tij thuhet nga të gjithë, pasi atë e ka njohur fëmija i vogël kur dëgjonte lavdërimet e tij kumbuese nëpër rrugë pa pasur nevojë për emërtim, përkufizim apo specifikim. Asnjë imam nuk është i ngjashëm me të dhe se ajo është lidhja e tij me çdo mez'heb dhe grupe islamike që kur është gjendur në ballë të islamit, pasi ai është katalizatori i këtyre dallimeve dhe aksi i cili sillet rrotull tij. Në islam është shumë e pazakontë një dallim që Aliu nuk ka qenë mësuesi i saj që kur ka lindur, apo se nuk ka qenë subjekt dhe dialog i komentimeve të saj, duke folur dhe duke iu përgjigjur folësve.

Ndër vite janë bërë lidhjet e episodeve mes tij, dijetarëve të jurispudencës, sheriatit, dijetarëve të etikës dhe retorikës, pasi ai është profesori i të gjithë këtyre me sende të mbështetur.
Sa i përket dallimit që e ka bërë atë subjekt të saj dialog të diskutimeve të saj, mjafton të përmendësh havarixhët, refuzuesit,

shi'itët, opozitarët dhe ndjekësit e traditës profetike. Tek ata do të shikosh që ke përmendur të gjitha dallimet islamike pa asnjë përjashtim apo me një përjashtim shumë të lehtë.

Këtu përplasen degët dhe përzihen teknikat, do të shikosh një grup të vetëm të përzierë me sufizëm dhe politikë. Si konflikt i brendshëm degët e saj mund të zgjatohen derisa të arrijnë tek ata që flasin për mez'hebun kryesor. Ata janë një taraf, ekstrem i ndarë apo të bashkangjitur me disa prej atyre bazave.



I PARI QË KA MARRË EPITETIN SI PRIJËSI I BESIMTARËVE[1]

I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ia ka ofruar titullin e prijësisë, princit të besimtarëve, vëllait dhe trashëgiminë e tyre, derën e diturisë në shumë hadithe Aliut, të birit të Ebu Talibit *(Paqja q Allahut qoftë mbi të!),* të cilat i ka shpërndarë në disa raste.

Kur Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu bashkua mëshiruesit më të lartë, Allahut dhe Ebu Bekrit, u bë kalif dhe myslimanët e thirrën atë kalifi i kalifit të të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kur u afrua koha e kalifatit të Omerit, të birit të Khattabit është etiketuar si kalifi i të Dërguarit të Allahut për një periudhë kohore, pastaj e thirrën atë (prijësi i besimtarëve) e të gjithë ata që erdhën pas tij në kalifat vazhduan me këtë epitet, derisa mbaroi kalifati i Beni Othmanëve (shteti Osmanllinj).

Për emërtimin e Omerit me epitetin si prijësi i besimtarëve ka mendime të ndryshme. Transmetohet nga Ebu Uebretu se ka

1 Dijuanu Sejjid Humejir /358. Dijuanu Sahib ibn Ubadi /301. Dijuanu Mihjar 23/113. Huljetul eulija 1/63. El Istiabu 4/1744. Tarikhu Bagdad i Khatib Bagdadi 13/123. Dijuanu Talajiu i ibn Reziki /127. Usdul Gabe 5/287. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebi Hadid 1/12. Keshful Gummeh 1/348-357. Meathirul Enakati 1/26. Tarikhul Khulefai 171. El Muraxheatu / 230. El Gadiru 2/115 dhe 4/158. Fadailu Khamseti fi Sihahi Siteh 2/88 dhe 101-105.

thënë: Me të vërtetë Ebu Bekri i jepte dyzetë goditje me kamzhik pijanecëve? Për këtë pyeta Omerin: O prijësi i besimtarëve, vërtetë Khalidi më dërgoi tek ti. Ai tha: Për çfarë? Unë thashë: Me të vërtetë, se njerëzit e kanë frikë, janë trembur nga dënimi dhe janë dhënë pas pijes, e çfarë mendon për këtë? Omeri iu drejtua atyre që kishte afër: Çfarë mendoni ju? Aliu tha: O prijësi i besimtarëve, ne mendojmë për tetëdhjetë kamzhikë dhe Omeri e pranoi atë.

Mendohet se origjina e asaj është kur me të vërtetë Omeri dërgoi tek vartësi i tij në Irak dy burra Lebu ibn Rebu, poeti i njohur dhe Adij ibn Hatemi Et-Taiu, duke qenë se i njohin mirë punët e atij vendi, ata mund ti pyesnin se çfarë duan? Sapo ata mbërritën në Medine, hynë në xhami, aty gjetën Amr ibn Asi dhe i thanë: Na jep leje që të hyjmë tek prijësi i besimtarëve dhe Amri u tha atyre: Për Zotin, ju të dy keni goditur në shenjë në emrin e tij, pastaj ai hyri te Omeri dhe tha: O prijësi i besimtarëve *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe Omeri i tha: Çfarë të solli o i biri i Asit? Ai i tregoi historinë dhe e mbështeti tek emërtimi i tij i parë me titullin "Prijësi i besimtarëve".

Sa i përket haditheve profetike në mbështetjen e tij të pozitës së princit të besimtarëve ndaj imam Aliut, janë shumta, por mjaftohemi me citimin e disave prej tyre duke u kujdesur shkurtimisht:

- Nga Enes ibn Malik transmetohet se ka thënë: Kam qenë shërbëtori i të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe më ka thënë mua: "O Enes, më hidh ujë që të marr abdes" pastaj u ngrit dhe fali dy rekatë namaz, e tha: "O Enes, i pari që do të hyjë në atë derë është prijësi i besimtarëve, i pari i myslimanëve, komandanti i njerëzve të famshëm dhe vula e trashëgimtarëve". Unë thashë: O Allah, uroj të jetë prej ensarëve dhe kur papritur erdhi Aliu dhe tha: "Kush

është ky o Enes?" Unë thashë: Aliu u ngrit i buzëqeshur dhe e përqafoi atë, pastaj nisi të fshijë djersën nga balli i tij, e Aliu tha: O i Dërguari i Allahut nuk të kam parë ty të bësh diçka të tillë me mua më parë? Ai tha: Çfarë më pengon mua kur ti do të kryesh detyrat e mia dhe do t'ua bësh atyre të qartë në atë që kanë kontradikta pas meje".

- Ibn Abbasi ka thënë: Pejgamberi (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* Ummi Selmes *(Allahu qoftë i kënaqur prej saj*) i ka thënë: "Dëgjo dhe dëshmo se ky është Aliu, prijësi i besimtarëve dhe i nderuari i trashëgimtarëve".

- Nga Ebu Dherr El Gifarij dhe Selman El Farisij *(Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!)* transmetohet: I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e mori për dore Aliun dhe tha: "Me të vërtetë, ky është i pari që më ka besuar mua dhe ky është i pari që do të më shoqërojë mua ditën e Kijametit. Ky është ai, besniku më i madh dhe faruku i këtij ymeti që e ndan të vërtetën nga e kota dhe ky është mbrojtësi i besimtarëve, kurse pasuria është mbrojtësja e zullumqarëve".

- Ibn Abbasi *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*ka thënë: i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "Ky është Aliu, i biri i Ebu Talibit, mishi i tij është mishi im, kurse gjaku i tij është gjaku im dhe ai është prej meje si grada e Harunit me Musanë vetëm se pas meje nuk ka më pejgamber".

- Ummu Selmasë *(Allahu qoftë i kënaqur prej saj!)* i ka thënë: "Dëgjo dhe dëshmo, ky është Ali ibn Ebu Talibi, prijësi i besimtarëve dhe i pari i myslimanëve, zëvendësi i diturisë sime dhe dera ime nga e cila mund të hysh, vëllai im në dynja, shoku im në Ahiret dhe ai është me mua në vendin më të lartë".

- Ebu Dheri El-Gafarijju ka thënë: Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* duke thënë: "Pas meje do të ketë fitne dhe kur ajo të ndodhë, atëherë mbështetuni tek Aliu, i biri i Ebu Talibit, sepse ai është i pari që më shikon dhe që më shoqëron mua ditën e Kijametit. Ai është i sinqerti më i madh dhe ai është faruku i këtij ymeti që e ndan të vërtetën dhe të kotën, ai është mbrojtësi i besimtarëve, kurse pasuria është mbrojtësja e hipokritëve".

- Ai *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në një hadith të gjatë, i cili është përmendur në pjesën e mëparshme dhe e përmbledhim atë këtu ka thënë: "Ditën e Kijametit nuk do të ketë njeri hipur mbi kafshë përveç nesh dhe ne jemi katër vetë: Unë do të qëndroj mbi burak, kurse pejgamberi i Allahut dhe Salihu do të qëndrojë mbi devenë të cilën e theri populli i tij, kurse xhaxhai im Hamzai do të qëndrojë mbi devenë time të bardhë, ndërsa vëllai im, Ali ibn Ebu Talibi do të qëndrojë mbi një deve, prej deveve të Xhenetit dhe në dorën e tij ka flamurin e falenderimit dhe do të kalojë afër një grupi melekësh dhe do të thonë: Ky është një melek shumë i afërt te Allahu, lajmëtar i dërguar apo Bartës i Arshit të Zotit të botërave. Kur një zë nga brenda Arshit thërret e thotë: Ky është Aliu, i biri i Ebu Talibit, prijësi i besimtarëve, imami i njerëzve të devotshëm dhe komandanti i njerëzve të famshëm.

- Imam Sadiku nga baballarët e tij transmeton: I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "Aliu është nga unë dhe unë jam prej Aliut, është krijuar nga virtyti i baltës time për t'ua bërë njerëzve të qartë për ata që ata kanë kundërshtime në traditën time dhe se ai është prijësi i besimtarëve, komandanti i njerëzve të famshëm dhe më i miri trashëgimtar".

- Në fjalën e tij *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: "Me të vërtetë se Aliu është prijësi i besimtarëve me kujdesje nga Allahu i Lartësuar, i cili e ka nënshkruar atë sipër Arshit të Tij dhe ia ka dëshmuar atë melekëve të Tij, se Aliu është mëkëmbësi i Allahut, justifikimi i Allahut dhe se ai është imami i myslimanëve".

- Nga ibn Abbasi *(Paqja qoftë mbi të!)* transmetohet se: I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "O Ali, ti je imami i myslimanëve, prijësi i besimtarëve, komandanti i njerëzve të famshëm, argumenti i Allahut pas meje dhe më i nderuari i trashëgimtarëve".

- Ebu Dherr El Gifarij *(Paqja qoftë mbi të!)*ka thënë: Një ditë kemi qenë tek i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në xhaminë e tij dhe ai na tha: "nga ajo derë do të vijë tani një njeri i cili është prijësi i besimtarëve dhe imami i myslimanëve". Kur Aliu, i biri i Ebu Talibit u shfaq tek dera, atë e mirëpriti i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* pastaj u kthye nga ne me fytyrën e tij fisnike dhe tha: "*Ky është imami juaj pas meje*".

- Mus'ari ka thënë: Hyra tek Aliu, i biri i Ebu Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)*, në derë mbante flori dhe tha: Unë jam mbrojtësi i besimtarëve kurse ky është mbrojtësi i hipokritëve".

- Ebu Dherr El Gifarij, kur vuante nga një sëmundje nga e cila vdiq, i është thënë: "Lër amanet. Ai tha: I lashë. Kujt ia le? Ai tha: Ia lashë prijësit të besimtarëve. Iu tha: Othmanit? Ai tha: Jo, ia lashë prijësit të besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)*.

- Nga ibn Abbasi *(Paqja qoftë mbi të!)*transmetohet: Nuk ka zbritur Allahu "**O ju që keni besuar**" vetëm se Aliu është prijësi

dhe fisniku i tij dhe se Allahu i ka qortuar dhe këshilluar sahabet e Muhamedit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në vende të ndryshme dhe nuk është përmendur Aliu vetëm se për mirë.

Prej numrit të madh të përsëritjeve të epitetit të pozitës së princit të besimtarëve në kohën e Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të shoqëruar me emrin e imam Aliut *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij),* ai u bë prej emrave më të njohur, saqë kur thuhej prijësi i besimtarëve, mendja të shkonte te ai *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe nëse dikush dëshironte tjetër veç tij që të fliste, atëherë duhej që ta shoqëronte me emrin e personit që synonte.



I PARI QË SAKRIFIKOI VETEN E TIJ PËR PEJGAMBERIN[1]

Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*e sakrifikonte veten e tij për Pejgamberin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në kohën kur babai i tij Ebu Talibi e vinte atë të flinte në krevatin e të Dërguarit të Allahut. Ebu Talibi kishte shumë frikë që Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të flinte në krevatin e tij, kështu që ai e çonte atë natën nga frika e vrasjes apo rrëmbimit dhe në vendin e tij shtrinte djalin Aliun, me këtë gjë e qetësonte veten e tij.

Edhe gjatë kohës së qëndrimit të bijëve të Ebu Talibit në mes të rrugës, kur kurejshët i prenë lidhjet me ta, ai sakrifikoi Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe veten e tij për Pejgamberin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kjo ndodhi kur kurejshët e shtrënguan shumë Pejgamberin dhe Ebu Xhehli u tregoi kurejshëve në sheshin e diskutimeve të tyre për mënyrën e çlirimit prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata duhet të merrnin nga secili

1 Dijuanu Sejjid Hamirit /94. Siretu ibn Hishamit 1/428. Dijuanu D'abel El Khuzaij /252. Tarikhu Tabari 2/372,373. El Akdul Ferijd 5/99. Et Tabekatu ibn Sa'dit 1/228. El Irshadu /30. Dijuanu Mihjar Dilejmi 4/201. Dijuanu Sherif Murteda 3/162. Mexhmeul Bejan komentimi i xhuzit të dytë /174. El Menakibu 2/60,62,64. Tefsiri i Rrazij 5/223. Usdul Gabe 4/18,19,25. Sherh Nehxhul Belaga ibn Ebi Hadid 14/64. Dijuan Haxh Hashim El Ka'bi/53. Jenabiul meveddeh /105 (kapitulli i njëzet e një). Delailu Sidk 2/80,82. A'janu shi-ia 3/k1/151,152.

fis nga një djalë të ri, të fortë, pastaj secilit prej tyre t'u jepet nga një shpatë e mprehtë, pastaj këta djem në mbrëmjen e ardhshme do të shkonin tek Muhamedi, kur ai të jetë i shtrirë në krevatin e tij dhe ta godasin atë me shpatat e tyre nga një goditje për secilin dhe ta vrasin atë. Nëse e bëjnë këtë, gjaku i tij do të ndahet tek të gjitha fiset, kështu që bijtë e Abdul Mutalibit nuk do kenë fuqi që të merren me të gjitha fiset kurejshe dhe ata e pranuan menjëherë këtë plan.

Kështu njerëzit u shpërndanë pasi ishin të grumbulluar për atë plan, kurse Allahu i Madhërueshëm e urdhëroi të Dërguarin që të mos flinte në shtëpinë e tij, por të urdhëronte Aliun që të flinte atje.

Kështu Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e thirri Aliun, e lajmëroi atë se çfarë kishin planifikuar kundër tij dhe e urdhëroi atë që flinte në shtratin e tij me qëllim që jobesimtarët të mendonin se ai ishte në vendin e tij. Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*qau dhe Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha: Pse po qan o Ali, a ke frikë nga vdekja? Ai tha: Jo, pasha Atë që të ka dërguar ty me të vërtetë o i Dërguari i Allahut, unë kam frikë për ty, a do të jesh mirë o i Dërguari i Allahut? Ai tha: Po! E dëgjova dhe u binda, hallall të qoftë sakrifica ime për ty, o i Dërguari i Allahut.

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* doli, ndërsa njerëzit e kishin rrethuar atë në shtëpi, mori një grusht dhe' dhe nisi t'ua hedhë mbi kokat e tyre duke lexuar: "**Ne kemi vënë pengesë para tyre dhe pas tyre e i kemi mbuluar, kështu që ata nuk shohin**"[1] pastaj u largua drejt vendit që dëshironte të shkonte.

1 Suretu Jasin / ajeti 9.

Aliu u shtri në shtratin e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe sapo u mbulua me mbulesën, e zuri gjumi, Allahu i Lartësuar urdhëroi Xhebrailin dhe Mikailin *(a.s):* "Me të vërtetë unë ju kam vëllazëruar ju të dyve dhe e kam bërë jetëgjatësinë e njërit më të gjatë se të tjetrit, pra cili prej jush do t'i japë rëndësi shokut të tij para jetës?" Secili prej atyre të dyve zgjodhi jetën dhe i frymëzoi ata të dy "A nuk jeni as sa shembulli i Ali ibn Ebu Talibit të cilin e vëllazërova mes tij dhe Pejgamberit Tim, Muhamedit. Ai fjeti në shtratin e tij duke sakrifikuar veten për të e duke i dhënë rëndësi atij me jetë, zbrisni që të dy në tokë dhe mbrojeni atë nga armiku i tij."

Ata zbritën të dy, Xhebraili ishte te koka, kurse Mikaili tek këmbët e tij. Xhebraili thërriti: bah, bah, kush është si ti i o i biri i Ebu Talibit që Allahu *(xh.xh)* e rivalizon me melekët. I bëri njerëzit të kuptojnë dhe të shikojnë një person tjetër duke fjetur mbi shtrat, duke u mbuluar me mbulesën e Pejgamberit dhe vazhduan kështu derisa zbardhi dhe sulmuan shtëpinë. Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*u çua nga shtrati dhe kur afruan afër tij, e njohën atë dhe i thanë: Ku është Muhamedi? Ai tha: Ku e di unë se ku është Muhamedi? Ata thanë: Ne mendojmë se ke qenë i hutuar vetë që prej natës tonë.

Allahu i zbriti Pejgamberit të Tij të madh kur ai ishte rrugës për në Medine ajetin në lidhje me Aliun *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij* "**Ka njerëz që e flijojnë veten, për të fituar pëlqimin e Allahut. Allahu është shumë i mëshirshëm me robtë e Vet.**"[1]

1 Suretu Bekare/207



I PARI QË KA SHLYER BORXHET E PEJGAMBERIT KA KRYER AMANETET E TIJ DHE KA KTHYER SENDET E BESUARA TEK PRONARËT E VET[1]

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka qenë para dhe pasi se t'i vinte shpallja, besniku i kurejshëve për amanetet e tyre, u surprizua nga idhujtarët që e detyruan atë të migronte nga Meka në mënyrë të papritur. Ai e urdhëroi Aliun *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*që të flinte në dyshekun e tij në atë natë dhe të qëndrojë pak më tepër në Mekë pasi të largohej ai, për të kryer çështjet e mëdha që askush veç tij nuk mund ta bënte. Kthimi i sendeve tek pronarët e tyre dhe kryerja e garancive të borxheve tek pronari ishin te Pejgamberi.

Ndrësa kryerja e premtimeve tek pronarët e tyre me qëllim që t'i kryente të gjitha këto hapur para syve të njerëzve dhe të blinte kafshë për udhëtim, fëmijët e dobët dhe për këdo që dëshironte migrimin për në Medine bashkë me të, prej fisit beni-hashimitë e të tjerë. Më pas i tha atij: Idhujtarët nuk do të arrijnë

1 Dijuanu Sejjid Humejri /297 dhe 382. Et Tabekatu e ibn Sa'dit 2/319. Tarikhu Tabarij 2/378 dhe 382. Muruxhu Dheheb 2/285. El Irshadu /31. Hiljetul Eulijai 10/211. El Menakibu 2/59,60 dhe 132. Usdul Gabe 4/25. Es Siretul Halebijjeh 2/204,205. El Alevijjatul Ishrune /49 dhe 104. A'janu Shi-ia 2/60,63,64. Fadailul Khamseh fi Sihahi es Siteti 3/46,47.

tek ti dhe të të bëjnë keq derisa të arrish në Medine. Pasi të kryesh ato që të kam lënë amanet, atëherë bëhu gati për hixhretin drejt Allahut dhe të Dërguarit të Tij, prit derisa të vijë letra ime tek ti dhe pas kësaj mos qëndro më.

Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* gjatë qëndrimit në Mekë u vonua tre ditë dhe gjatë atyre ditëve çdo mëngjes dhe mbrëmje thërriste në një vend të sheshtë: "Kushdo që ka për të marrë tek Muhamedi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ndonjë amanet, borxh apo send, atëherë le të vijë e ta marrë atë. "
Kur Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* shpëtoi prej përndjekjes së idhujtarëve, doli prej guvës nën shoqërinë e Ebu Bekrit, i shkruajti Aliut me Ebu Vakidin El Lejthijjin duke e urdhëruar të vazhdonte rrugën drejt tij.

Babai i Hasanit i kishte kryer tashmë të gjitha detyrat me të cilat ishte obliguar. Ai i dha urdhër të gjithë njerëzve të dobët që ishin me të prej besimtarëve, që natën të shkonin fshehurazi aty ku priten rrugët. Në mbrëmje shkoi te xhaxhai i tij Abas ibn Abdul Mutalib dhe e lajmëroi se ai do të migronte me ata që ishin me të, dhe në mëngjes herët i tha Aliut: "Me të vërtetë, Muhamedi migroi fshehurazi dhe kurejshët e kërkuan atë kudo, kurse ti del haptazi me pasuri, burra dhe gra dhe i rrezikon ata të kapen rob në rrugët e malit në mesin e fiseve kurejshite? Nuk mendoj se do të kalosh ndryshe vetëm se duke u ruajtur mirë çalë–çalë. Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*iu përgjigj: I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* më ka premtuar se ata nuk do të arrijnë të më bëjnë keq mua.

Në mëngjes Ebu Hasani (Aliu) doli bashkë me nënën e tij, Fatimen e bija e Esedit, Fatimen e bija e xhaxhait të tij, Zubejrit të birit të Abdul Mutalibit dhe vajzat e të Dërguarit të Allahut *(Paqja*

dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) janë: Fatime Zazhra dhe Ummu Kulthumi, kurse Rukeja ishte emigrante në Abisini bashkë me bashkëshortin e saj Othman ibn Afani, kurse Zejnebja kishte mbetur në Mekë bashkë me burrin e saj Ebu Asi ibn Rebu'u. Me të doli Ejmen ibn Ummi Ejmeni, mbrojtësi i të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe Ebu Uakidi El Lejethij.

Sapo iu afrua Daxhnanit, mal afër Mekës, ata që e kërkonin e arritën. Ishin tetë kalorës të mbuluar e bashkë me ta ishte mbrojtësi i Harbit ibn Umejje që quhej Xhenah, ai i tha Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*Ejmenit dhe Ebu Vekadit: "Ndaleni devenë dhe vëreni në pengore". Ai u afrua, i zbriti gratë dhe iu afrua burrave duke nxjerrë shpatën e tij, njëri prej tyre i tha atij: "A mendon ti, o i pabesë se je i sigurtë me gratë? Kthehu se ti nuk ke baba". Ai tha: E nëse nuk e bëj? Ai tha: "Do të kthehesh me dëshirë ose do të kthejmë ty me më shumë flokë dhe është më e mirë për ty se sa i vdekur".

Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* u afrua afër sendeve dhe Xhenahu u përkul. Kur hipi mbi shpinën e kalit të tij, e drejtoi shpatën drejt imamit, por ai e shmangu goditjen e tij dhe i dha Xhenahut një goditje të shpejtë e të fuqishme mbi shpatulla. E ndau atë në dy pjesë, pastaj u kthye nga shokët e Xhenahut me forcë dhe ata u larguan prej tij.

Pastaj iu drejtua Ejmenit dhe Ebu Vakidit dhe u tha: Merrini sendet tuaja, pastaj vazhdoi ecjen si triumfues derisa takoi Pejgamberin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ku po i priste atje.

Ai *(Paqja qoftë mbi të!)*nga kujdesi i tepërt për favorizimin e grave për të larguar gjendjet e tyre të vështira, e linte kafshën dhe ecte në këmbë. I shoqëronte ato duke nxituar, duke iu kryer

nevojat dhe qetësonte gjendjet e tyre, derisa iu çanë dhe iu enjtën këmbët. Kur Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e pa në atë gjendje e përqafoi dhe qau si mëshirë për të.

Këto janë një grup hadithesh profetike që përfshijnë këshillën e tij *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* për Aliun *(Paqja qoftë mbi të!),* që të paguante borxhin, të kryente amanetin dhe të kthente sendet te pronarët e tyre.

- Nga Aliu *(Paqja qoftë mbi të!),* transmetohet: "I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: Kush do të kryejë detyrat dhe të çojë amanetet e mia që të jetë me mua në Xhenet? Unë thashë: Unë, o i Dërguari i Allahut".

- Selman El Farisij ka thënë: "I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë se Aliu i biri i Ebu Talibit do të kryejë premtimet e mia dhe do paguajë borxhin tim".

-Në mirësitë e Ahmedit thuhet se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "Aliu është prej meje dhe unë jam prej Aliut dhe borxhin tim nuk e paguan kush përveç meje dhe Aliut".

- Ibn Omer ka thënë: "Kur unë isha me të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në hijen e Medines po kërkonim Aliun. Duke kërkuar, përfunduam tek një mur, aty pamë Aliun që po flinte në tokë dhe ishte bërë me pluhur. Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha: A të të gëzoj ty o Ali? Ai tha: Posi jo, o i Dërguari i Allahut. Ai tha: "Ti je vëllai dhe ministri

im që më kryen borxhin, zbaton premtimin dhe largon shqetësimin tim".

- Nga Ebu Refiu transmetohet se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* Aliut, para se të ndërronte jetë ka thënë: "Më largo shqetësimin tim (borxhin) dhe prano traditën time".

- Aishe e bija e Sa'dit ka thënë: Kam dëgjuar babin tim të thotë se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* ditën e vështirësisë të thotë: "O ju njerëz, me të vërtetë se unë jam miku dhe mbrojtësi juaj", ata thanë: Të vërtetën the o i Dërguari i Allahut, pastaj e kapi për dore Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*e ngriti atë dhe tha: Ky është miku dhe mbrojtësi im që më paguan borxhin dhe unë jam mbrojtës i atij që e ndjek atë dhe kundërshtar i atij që e kundërshton atë".

- Habesh ibn Xhenade ka thënë: Borxhet e Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe amanetet që ka paguar Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*kanë qenë tetëdhjetëmijë derhem.



I PARI QË E KA VËLLAZËRUAR ATË PEJGAMBERI

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) [1]

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vëllazëroi mes shokëve të tij të së drejtës dhe i barazoi ata dy herë: Herën e parë, pak para hixhretit, ku vëllazëroi mes Hamza ibn Abdul Mutalibit dhe Zejdit ibn Harithit, mes Ebu Bekrit dhe Omer ibn Khatabit, mes Othman ibn Affanit dhe Abdurrahman ibn Aufit, mes Zubeir ibn Avamit dhe Abdullah ibn Mes'udit, mes Ubejde ibn Harithit ibn Mutalibit dhe Bilal Habeshijut, mes Mas'ab ibn Umejrit dhe Sa'd ibn Ebu Vekasit, mes Ebu Ubejdes ibn Xherahit dhe Salim Meula Ebu Hudhejfe dhe mes Seid ibn Zejdit dhe Talhasë ibn Ubejdullah.

Kur përfundoi me shokët e tij, Ai *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e ktheu kokën nga Ali ibn Ebu Talibi duke thënë: "A je i kënaqur ti që unë të jem vëllai yt?" Ai

1 Dijvanu Imam Ali /91. El Mihberu /70,71. Dijuanu Sahib ibn Ubad. El Istiabu 3/1098. El Menakibu 2/185. Usdul Gabe 3/318 dhe 4/16. Dhekhairul Ukba /66. ujunul etheri 1/200,201. Nihajetul Ed Derbu i Neuijrit 16/348 dhe 20/30. Dijuanu Safijju Din El Hil'lji /88. El Bidaje Uen Nihaje i ibn Kethirit 7/336. Es Siretul Halbijjeh 2/181 dhe 292. Jenabiul Meveddeh /63,64 (kapitulli i nëntë). El Muraxheatu /164. Delailu Sidk 2/267-271. El Gadiru 3/66 dhe 112-124 dhe 4/150-152.

tha: Posi jo, o i Dërguari i Allahut, jam i kënaqur. Ai tha pastaj: "Por, ti je vëllai im në dynja dhe në Ahiret".

Kurse në senedin e Ahmedit thuhet: Kur Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vëllazëroi mes muhaxhirinëve në Mekë, Aliu nuk e vëllazëroi me njeri dhe ai tha: O i Dërguari i Allahut, mu pre shpirti dhe mu copëtua shpina kur të pashë ty të bëje atë që bëre me shokët e tu, përveç meje. Nëse e ke bërë se je i inatosur me mua, atëherë ke respektin dhe bujarinë time. I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha: "Pasha Atë që më ka dërguar me të vërtetën, nuk të kam lënë jashtë vetëm se për veten time, ti je prej meje në gradën e Harunit me Musain, vetëm se pas meje nuk ka më pejgamber dhe ti je vëllai dhe trashëgimtari im" dhe Aliu tha: Po çfarë trashëgoj unë prej teje o i Dërguari i Allahut? Ai tha :" Atë që kanë trashëguar pejgamberët që kanë qenë para meje: Librin e Allahut dhe traditën profetike të profetit të tyre dhe ti je me mua në kështjellën time në Xhenet, bashkë me Fatimenë, vajzën time dhe ti je vëllai dhe shoqëruesi im" pastaj lexoi: "...**ata do të rrinë ulur si vëllezër përballë njëri-tjetrit në divane**."[1]

Kishin kaluar pesë muaj kur Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* erdhi në Medine, i bashkoi shokët e tij muhaxhirë dhe ensarë në shtëpinë e Enes ibn Malik dhe u tha: "Vëllazërohuni për hir të Allahut të Lartësuar, dy e nga dy në të drejtë dhe në barazi". Ai vëllazëroi mes Ebu Bekrit dhe Zejdit prej havarixhëve që ishte dhëndri i Ebu Bekrit, mes Omer ibn Khatabit dhe Utban ibn Malikit, mes Ebu Ruvejm El Khuth'amij dhe Bilal Habeshijut, mes Usejd ibn Khadiri dhe Zejd

1 Suretu El Hixhr / ajeti 47.

Ibn Haritheti, mes Ebu Ubejde ibn Xherrahu dhe Sa'd ibn Muadhit, mes Abdurrahman ibn Aufit dhe Sa'd ibn Rebu as deri kur erdhi tek i fundit prej tyre. E mori për dore Ali ibn Ebu Talibit dhe tha: "Ky është vëllai im". Kështu i Dërguari i Allahut dhe Aliu ishin dy vëllezër duke konfirmuar vëllazërimin e parë në Mekë.

Kurse në një transmetim nga ibn Omeri thuhet: Kur Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i vëllazëroi shokët e tij, erdhi Aliu (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)me lot në sy dhe tha: O i Dërguari i Allahut, ti vëllazërove shokët e tu dhe nuk më vëllazërove mua me askënd. Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "Ti je vëllai im në dynja dhe në Ahiret".

Kurse në një transmetim tjetër nga ibn Abbasi transmetohet: I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "A u zemërove o Ali kur vëllazërova mes muhaxhirëve dhe ensarëve dhe nuk vëllazërova askënd me ty? A nuk je i kënaqur që të jesh prej meje në gradën e Harunit me Musanë vetëm se pas meje nuk ka më pejgamber?"

Kjo është ajo që kanë transmetuar shumica e historianëve dhe autorët, e historive dhe transmetuesit e virtyteve, po kështu janë përmendur edhe shumë transmetime të tjera që janë:

- Mohimi i ibn Tejmijes për vëllazërimin e parë mes muhaxhirëve e sidomos vëllazërimin e Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me Aliun *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*ka thënë: Sepse vëllazërimi mes muhaxhirëve dhe ensarëve është bërë vetëm që të përfitonin nga njëri-tjetri dhe të lidheshin zemrat e tyre. Kështu që nuk ka asnjë kuptim vëllazërmi mes muhaxhirëve.

Kurse ibn Haxheri e kundërshtoi atë duke thënë: "Ky është një refuzim i literaturës dhe mendimit të shumicës. Një pjesë e pronarëve ishin më të fuqishëm se disa të tjerë në pasuri dhe tribu, kështu që ai vëllazëroi mes atij që ishte më lart dhe më poshtë që të përfitonte. Këtë e bëri për arsye se ai që ishte më lart të ndihmonte atë që ishte më poshtë".

- Ibn Habibi në një shkrim ka thënë: Me të vërtetë se Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, herën e dytë ka vëllazëruar në Medine mes Ali ibn Ebu Talibit dhe Sehli ibn Hanifit.

Neviri në fund të propozimit ka thënë: Me të vërtetë vëllazërimi në të dyja rastet është bërë në Medine pas hixhretit të parë mes muhaxhirëve me njëri-tjetrin, kurse e dyta mes muhaxhirëve dhe ensarëve dhe në secilën herë i thotë Aliut (*Allahu qoftë i kënaqur prej tij)*: "Ti je vëllai im në dynja dhe në Ahiret". Rreth vëllazërimit janë përmendur shumë hadithe, prej tyre janë:

Nga Makhduxh ibn Zejdi El-Hudhejli transmetohet: Me të vërtetë i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vëllazëroi mes shokëve të tij, pastaj tha: "O Ali, ti je vëllai im, dhe ti je për mua në gradë si Haruni me Musain, vetëm se pas meje nuk ka më pejgamber dhe të jepet ty flamuri im, që është flamuri i falënderimit. Gëzohu o Ali, unë dhe ti jemi të parët që do të thirremi, vërtetë ti do të mbulohesh nëse mbulon, do të thërritesh nëse thërret dhe do të duhesh nëse do. Hasani dhe Hysejni janë bashkë me ty derisa të qëndrosh mes meje dhe mikut Ibrahimit nën hijen e Arshit, pastaj një thirrës që thërret: Po, babai është babai yt Ibrahim Khalili (miku i Allahut) dhe po, vëllai është vëllai yt Aliu".

Xhabir ibn Abdullah El-Ensarijju ka thënë: Me të vërtetë Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e pa Aliun dhe tha: "Ky është vëllai dhe shoku im, është prej atyre që janë rivalizues të melekëve për Allahun dhe ai që do të hyjë me paqe në Xhenet".

Nga imam Sadiku transmetohet: "Kur Pejgamberi i vëllazëroi shokët e tij, e la Aliun, ai e pyeti Pejgamberin për këtë gjë dhe Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha atij: Unë të kam lënë ty në fund për veten time, ti je vëllai im dhe unë jam vëllai yt në dynja dhe në Ahiret". Për këtë Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, qau.



I PARI QË KA ZBATUAR AJETIN E BISEDËS KONFIDENCIALE[1]

Pasanikët dhe shtresa e lartë e popullit vinin te Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i jepnin atij muhabet shumë më tepër se sa fukarenjtë dhe të gjithë njerëzit e tjerë të kuvendit, derisa i Dërguari i Allahut filloi ta urrente të ndenjurën e zgjatur dhe bisedën e tyre, kështu Allahu i Madhërueshëm zbriti: "**O ju që keni besuar, kur të doni të këshilloheni me të Dërguarin, para këshillimit, jepni lëmoshë, kjo është më mirë dhe më pastër për ju. Po, nëse nuk keni, Allahu me të vërtetë, është Falës dhe Mëshirëplotë**".[2]

Kur atyre iu ndalua biseda derisa të jepnin një sadaka, u frenuan e u zbrapsën dhe askush nuk bëri bisedë konfidenciale me të përveç Aliut, të birit të Ebu Talibit. Ymeti i tij ra dakord me atë, që në librin e Allahut është një ajet që askush nuk ka vepruar sipas tij përveç Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe askush nuk do të veprojë me të pas tij deri në kijamet. Transmetohet prej tij *(Paqja*

1 Dijvanu Sejjid Humejri /284 dhe 299,300. El Euailu i Ebu Hilal El Askerij /166. El Irshadu /80. Esbabu Nuzul /438. Tefsir El Keshaf i Zamkhashirij 4/393,394. Mexhmaul Bejani i Et Tabarsij 6/v 28/14,15. Tefsir Fakhru Razij 29/273. Usdul Gabe 4/27. Dhekhairul Ukba/85,109. Jenabiul Meveddah /66 (kapitulli i dhjetë) dhe 116 (kapitulli i njëzet e shtatë). El Muraxheatu /247, 265. Delailu Sidk 2/104-107. A'janu Shi'ia vëll. 3. k 1/74-76. El Aleuijat El Ishrun /56. Fadailul Khamseh fi Sihahi Es Siteti 1/292-295. Fi dhilalil Kur'ani 8/21.

2 Suretul Muxhadele/ ajeti 12.

qoftë mbi të!) se: Me të vërtetë në librin e Allahut ka një ajet që askush nuk ka vepruar me të para meje dhe askush nuk do të veprojë me të pas meje: ”**O ju që keni besuar, kur të doni të këshilloheni me të Dërguarin, para këshillimit, jepni lëmoshë, kjo është më mirë dhe më pastër për ju. Po, nëse nuk keni, Allahu me të vërtetë, është Falës dhe Mëshirëplotë**”.

Fjala e tij: “Kisha një dinar dhe e shita atë për dhjetë derhem. Kur dëshiroja të bisedoja me të Dërguarin e Allahut, jepja sadaka’ një derhem derisa i mbarova dhe zura vendin e ajetit”.

Në thënien e tij *(Paqja qoftë mbi të!)*në kohën kur zbriti ajeti i nexhvasë (bisedimit), i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* më ka thënë mua: Jepu urdhër që të japin sadaka’. Unë thashë: Po sa o i Dërguari i Allahut? Ai tha: Si mendon për një dinar? Unë thashë: Ata nuk kanë mundësi për kaq, ai tha: Atëherë po gjysëm dinari? Unë thashë: Nuk kanë mundësi. Ai tha: Po sa atëherë? Unë thashë: Pesha në flori e një fije floku. Ai *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: Me të vërtetë ti je asketik (domethënë, jo i pasur dhe e vlerësove në bazë të situatës tënde). Pastaj e la urdhërin e përcaktimit të sadakasë në dorë të atij që jep sadakanë.

Megjithëkëtë, myslimanët u ngushtuan pak me sadakanë, e sa i përket të varfërit për shkak të vështirësisë së tij, kurse sa i përket të pasurit kjo për shkak të kopracisë së tij. Kështu zbriti ajeti i autorizimit dhe në të kishte pak qortim të ashpër, që është fjala e Tij *(xh.sh):* **“A mos po frikësoheni që para këshillimit tuaj të jepni lëmoshë?! E nëse nuk jepni, e Allahu jua ka falur..**”[1]
Imam Aliu ka thënë: “Allahu mua më ka lehtësuar në këtë ymet”.

1 Suretul Muxhadele / ajeti 13.

Ibn Omeri ka thënë: "Aliu ka pasur tre gjëra, e sikur unë të kisha vetëm njërën prej tyre do të ishte më e dashur për mua se sa mirësitë më të mira, që është martesa e tij me Fatimenë, dhënia e flamurit ditën e Hajberit dhe ajeti i nexhvasë".

Fakhru Razi në tefsirin e tij ka thënë se pasi janë transmetuar shkaqet e zbritjes së dy ajeteve të bisedimit, Kadiu në përmbledhjen e tij, ka thënë: "Me të vërtetë se kjo nuk tregon për avantazhin e Aliut *(Zoti qoftë i kënaqur prej tij!)* ndaj sahabeve të mëdhenj, sepse koha mes zbritjes së ajetit të bisedës dhe ajetit të autorizimit mbase nuk shtrohet për veprim me këtë qëllim".

Fakhru Razi e nënvizoi veten e tij me fjalën e Kadiut duke thënë se edhe nëse përfshihet kurajo për këtë vepër, është në atë që e ngushton zemrën e fukarait, kurse sadakaja' tek biseda është obligim, detyrë. Kurse sa i përket bisedës, ajo nuk është obligim dhe as e legjitimuar, madje më e mira është lënia, braktisja e saj sepse ajo ishte shkaktare e mërzitjes së Pejgamberit.

Në përfundim Sejjid Muhsin El Emini i përgjigjet Fakhru Razit me fjalën e tij: Nëse çështja është e tillë, atëherë çfarë kuptimi ka fjala e Tij e Madhërueshme. "**A mos po frikësoheni që para këshillimit tuaj të jepni lëmoshë?! E nëse nuk jepni, e Allahu jua ka falur...".** Kurse biseda, e cila më e mira ishte lënia e saj, është ajo që imponon mërzitjen, rivalitetin e të pasurve ndaj të varfërve, jo shpëtimi në mënyrë absolute. Në bazë të kësaj filozofie imagjinare, obligohet që më parësore të jetë lënia e veprimit, e veprave të mira nga të pasurit me qëllim që të mos thyheshin zemrat e të varfërve.

Biseda konfidenciale mes Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe vëllait të tij vazhdoi sa herë që kishte diçka të re dhe mjaftohemi me përmendjen e dy haditheve.

- Kur Allahu i copëtoi të gjithë idhujtarët në Hanin, arabët dhe ndjekësit e tyre shkuan në Eutas, ndërsa një njeri me përvojë dhe bashkë me ndjekësit e tyre morën rrugën për në Taif. Në këtë mënyrë Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dërgoi Ebu Omer El Esharijjun në Eutas dhe Ebu Sufjanin ibn Harbin në Taif.

Sa i përket Ebu Amirit, pa dyshim ai përparoi me flamur, derisa ra dëshmor pa e marrë atë. Kështu atë e mori djali i xhaxhait të tij, Ebu Musa El Esharijju dhe ai luftoi bashkë me myslimanët që ishin me të derisa Allahu e çliroi atë.

Ebu Sufjanin e takoi një njeri me përvojë, ndërsa ata e goditën në fytyrë, ai u mund dhe u kthye te Pejgamberi e tha: "Më dërgove mua tek një popull që nuk ngrihet flamuri me ta". Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* heshti! Pastaj shkoi vetë në Taif, atë e rrethuan disa ditë dhe imam Aliu iu përgjigj me kalorësi, e urdhëroi atë që të shtypë kë të gjejë dhe të thyejë çdo statujë që të gjejë.

Prijësi i besimtarëve doli derisa e takoi kalorësin e Khath'amit në një numër të madh, kur prej atij populli doli një burrë që quhej Shehab ibn Gabeshi dhe imami tha: "Kush do t'i dalë atij? Askush nuk u çua. Menjëherë pas tij u çua Ebu Asi ibn Rebu, i shoqi i Zejnebes, vajzës së të Dërguarit të Allahut dhe tha: Rri ti, o prijës, ndërsa ai tha: Jo, por nëse unë vritem, ti je në krye të njerëzve, pastaj doli duke thënë: "Me të vërtetë çdo kryetar ka të drejtën të ngjitet lart ose të zhytet në tokë".

Pastaj e goditi dhe e vrau atë, kalorësi qëndroi derisa i theu statujat dhe u kthye te i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kur ai ishte në rrethimin e Taifit dhe kur Pejgamberi e pa atë, ra në tekbir. Njëri prej muhaxhirinëve tha: A po bisedon vetëm me të përveç nesh?

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "Nuk e zgjodha unë për të biseduar, por Allahu e zgjodhi atë".

Kurse ngjarja e dytë është: Ishte dita e ndërrimit të jetës së Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* kur nëna e besimtarëve Ummul Selme *(Allahu qoftë i kënaqur prej saj!)* tha se ai i cili i kërkoi Atij t'i jepte betimin ishte Ali ibn Ebu Talibi, njeriu më i afërt në besë për të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* . I Dërguari i Allahut na kërkoi që në mëngjes herët disa herë duke thënë: A erdhi Aliu? A erdhi Aliu? Fatimeja vajza e tij tha: Duket sikur po e kërkon atë për ndonjë nevojë? Ajo tha: Kur erdhi më pas mendova sikur ai kishte nevojë për të dhe ne dolëm nga shtëpia, u ulëm tek dera. Unë isha më afër se të tjerët tek dera, e i Dërguari i Allahut iu dedikua atij, e uli në të majtë dhe bisedonte me të, pastaj e mbërtheu atë dhe familjen e tij që prej asaj dite.

Abdullah ibn Omeri ka thënë: "I Dërguari i Allahut ka thënë se kur ishte i sëmurë në shtratin e tij, ka thirrur vëllain e tij dhe erdhi Ebu Bekri, atë se pranoi, pastaj tha më thërrisni vëllain tim dhe erdhi Othmani, e edhe atë nuk e pranoi. Pastaj i thërritën Aliut, të birit të Ebu Talibit dhe e mbuloi atë me rrobën e tij, iu dedikua dhe kur doli prej andej i tha: Çfarë të tha ty? Ai tha: Më mësoi njëmijë dyer, secilës derë i hapej një derë tjetër".



I PARI QË ËSHTË QUAJTUR I PLUHUROSURI (EBU TURAB)[1]

Historianët kanë rënë dakord me unanimitet se i Dërguari i Allahut është ai i cili e quajti Aliun i pluhurosuri *(ebu turabi)* që ishte prej epiteteve më të bukur të tij.

Kurse sa i përket shkakut të emërtimit në të janë përmendur shumë thënie:

Ibn Is'haku ka thënë: "Disa dijetarë më kanë thënë se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e ka quajtur Aliun (njeriu me pluhur) sepse ai kur e qortonte Fatimenë nuk i ka folur dhe nuk i ka thënë asaj diçka që ajo e urrente, por ai vetëm merrte dhe e hidhte mbi kokën e tij. I Dërguari i Allahut shikonte në kokën e tij, e kuptonte se ai kishte qortuar Fatimenë dhe thoshte: Çfarë ke o njeriu i pluhurit?"

El-Haxhidhu ka thënë se Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* transmeton: "Nëse ndonjëri prej jush shkruan, atëherë le të pluhurosi librin e tij, sepse dheu është i bekuar dhe ai është më i suksesshmi në rast nevoje".

Allahu për Ademin që është esenca e njerëzimit dhe ka thënë: "**Rasti i Isait për Allahun është si rasti i Ademit që e**

1 Siretu ibn Hisham 1/599,600. El Bejanu ue Tibjinu 3/204. Mekatilu Talibine /25. Themarul kulubi fil Mudafi uel Mensub i Thealibij /80. El Istiabu 3/1118. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebi Hadid 1/11 dhe 17. Tarikhul Khulefai /168. A'janu shi'ia 3/k1/9. Men jesmeu i El Humanijj /159. Fadailul Khamseh fi Sihahi Es Siteti 3/151-156.

krijoi prej baltës e pastaj i tha: "Bëhu!" - dhe ai u bë."[1], dhe për këtë, Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e etiketoi Aliun me emrin 'ebu turab'.

Kanë thënë: "Një herë e ka parë atë të fërkojë fytrën e tij në dhe', kur ishte në sexhde, apo ka qenë duke fërkuar faqet e tij e i ka thënë atij: O njeriu i dheut".

Mirëpo e vërteta e vazhdueshme, nga ajo që përmendet nga Omar ibn Jesari është se ai ka thënë: "Unë dhe Aliu ishim dy shokë në betejën e tribuve dhe kur i Dërguari Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* zbriti, ne pamë disa njerëz me kova që po punonin në pusin dhe tek palmat. Për këtë u tha Aliu *(Paqja qoftë mbi të!):* O ju vigjilentë, si thoni a shkojmë tek ata njerëz që të shikojmë se si punojnë? Ai tha, nëse ti dëshiron, po. Ai tha: Shkuam tek ata dhe e pamë punën e tyre për një orë, por pastaj po na kapte gjumi. Unë dhe Aliu shkuam dhe u shtrimë nën hijen e një palme dhe një grumbull dheje dhe fjetëm. Po për Zotin nuk na zgjoi askush tjetër veç të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* duke na lëvizur ne me këmbën e tij. Por, ne ishim pluhurosur nga dheu ku kishim fjetur. Atë ditë i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha Aliut: "Çfarë ke o aba turab?".

Nga Sehli ibn Sa'di Saidi transmetohet se ka thënë: Një ditë, Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* erdhi te vajza e tij Fatimeja dhe tha: Ku është djali i xhaxhait tënd? Ajo tha, është atje i shtrirë në xhami. Kur Pejgamberi shkoi e gjeti atë të shtrirë me shpinë, i pastroi pluhurin nga shpina e tij dhe nisi t'i fshijë dheun prej tij duke thënë: "Ulu o njeriu i dheut (aba turab)".

1 Suretu Al-Imran / ajeti 59

Mes këtyre dy transmetimeve të Amar ibn Jasirit dhe Sehl ibn Sa'dit dhe numrit të madh të ngjarjeve të ndodhura nuk ka asgjë kondradiktore. Pasi emërtimi i parë me këtë epitet ka ndodhur për herë të parë, siç e kemi bërë të qartë më parë, në betejën e tribuve, do me thënë në fillim të vitit të dytë të hixhretit. Prej asaj dite, imami u bë i njohur me atë emër dhe nuk mund të lihet mënjanë pa përmendur se Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* sa herë e kërkonte Aliun e gjente atë të shtrirë mbi dhe' e i thërriste atij: "O njeriu i dheut, kurse babai i Hasanit nxitonte për ta dëgjuar atë".

Armiqtë e prijësit të besimtarëve prej beni Umejjeve dhe ndjekësve të tyre kanë dashur ta përdornin këtë emër për interes të tyre dhe të shanin imamin *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe kështu e falsifikuan hadithin e Sehl ibn Sa'dit dhe e bënë shkakun e emërtimit se një ditë Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*e mërziti Fatimenë dhe doli e u mbështet tek muri i xhamisë. Pejgamberi shkoi tek ai dhe pa që shpina e tij ishte mbushur me dhe'. Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nisi t'ia pastrojë dheun nga shpina e tij dhe i tha (ulu, o njeriu i dheut).

Përsa i përket qëllimit të cilin armiqtë e supozuan pas këtij falsifikimi, ajo është që të fusnin në mendjet e të gjithëve se Aliu e ka mërzitur Fatimenë, kështu e ka merituar inatosjen e Allahut dhe inatosjen e të Dërguarit të Tij. Por, nga fjala e Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tregohet se: "Fatimeja është pjesë e trupit tim dhe kush e mërzit atë më ka mërzitur mua" ndërsa Fatimeja ka thënë: "Me të vërtetë Allahu inatoset kur inatosesh ti dhe kënaqet kur kënaqesh ti".

Ibn Ebu Hadidi ka thënë: "I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i vuri epitetin si njeriu i dheut dhe kur e gjeti atë duke fjetur mbi dhe', mbulesa i

kishte rënë dhe trupi i ishte mbuluar me dhe'. Ai erdhi dhe iu ul te koka, e zgjoi atë dhe nisi t'i fshijë dheun nga shpina, duke i thënë: Ulu se ti je njeriu i dheut dhe kjo ishte nga epitetet më të dashura. Ai gëzohej kur thirrej me këtë emër, kurse Benu Umejjet i nxisnin folësit e tyre që ta ofendonin atë nga minderet, e bënë të duket si defekt dhe turp për të, njësoj si mbulesa e xhevahirit dhe hallalleve. Ashtu siç ka thënë Besarijju se Benu Umejjet u preukopuan ndaj sulltanit të islamit nga lindja e tokës në perëndim të saj dhe u përpoqën me çdo lloj marifeti që të shuajnë dritën e tij.

Duke i nxitur kundër tij, i kërcënuan ata që e lavdëronin, madje i burgosën, i vranë dhe e ndaluan transmetimin e një hadithi që përmbante ndonjë mirësi të tij apo që i ngrinte lart përkujtimin e tij. Madje gjërat shkuan deri aty sa paralajmëruan çdokënd që e përdorte emrin e tij për të emërtuar dikë, mirëpo kjo vetëm e ngriti lart gradën dhe emrin. Ishte njësoj si aroma e mirë e trëndafilit, sa herë që mbulohej, përhapej jehona e tij dhe sa herë që fshihej, përhapej lajmi i tij. Ashtu si Dielli që nuk mbulohet me pëllëmbën e dorës dhe si drita e ditës, që nëse fshihet nga një sy i vetëm e shohin sy të tjerë.



LUFTËTARI I PARË NË RRUGË TË ALLAHUT[1]

Dihet se më të spikaturit në xhihad prej sahabeve të të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* janë: imam Aliu, luani i Allahut Hamza ibn Abdul Muttalib, Xha'ferri fluturuesi i biri i Ebu Talibit, Ubejde ibn Harithi ibn Muttalib, Zubejr ibn Auami, Talha ibn Ubedjullah, Ebu Duxhaneh, Sa'd ibn Ebi Uekasi, Berae ibn Azib, Sa'd ibn Muadh dhe Muhamed ibn Musel-leme *(Zoti qoftë i kënaqur me ta!).*

Ymeti ka rënë dakord në mënyrë unanime, se në mesin e këtyre heronjve nuk ka asnjë që të krahasohet me luftëtarin e parë dhe çliruesin e të këqijave, shqetësimeve nga i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* . I pari në pararojë në të gjitha betejat dhe ndihmësi në të gjitha kasaphanat, prijësi i besimtarëve Aliu *(Paqja qoftë mbi të!),* i cili nuk e ka shmangur kurrë dhe nuk ka pasur nevojë për një goditje të dytë, pas goditjes së parë. Në hadith thuhet se goditjet e tij kanë qenë të fuqishme, vdekjeprurëse.

---

1 El Mugazi i El Uakidij /49 dhe 181. Siretu ibn Hisham 1/625. El Akdul Feridu 5/95,96. El Bed'u uet Tarikhu 4/198. El Irshadu /39-42. El Menakibu 2/65-70. Usdul Gabe 4/20. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebi Hadid 1/20,24 dhe 14/130. Keshful Gummeh 1/180-184. Dijuanu Ka'bij /54-55. A'janu Shi'ia 3/k 1/143 dhe 175. El Aleuvijjatul Ishrune /6.

Lufta e tij *(Paqja qoftë mbi të!),* ka nisur që kur ai ka qenë fëmijë, ditën kur kurejshët i kishin ngjitur ngjarjet e tyre me Pejgamberin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe kur ai dilte nga shtëpia e tij, ata e ndiqnin, e godisnin me gurë derisa e bënin t'i dilte gjak nga këmbët e tij. Kjo gjë i shkaktonte dhembje Ebu Talibit dhe nuk mundej që të vendoste veten e tij në vend të fëmijës dhe ta mbronte djalin e vëllait të tij. Por Pejgamberi e gjeti zgjidhjen e përshtatshme dhe filloi të merrte Aliun kur dilte që ta mbronte atë, filloi të merrej me fëmijët, i brejte ata në fytyrat dhe hundët e tyre, kurse ata, fëmijët ktheheshin tek baballarët e tyre duke qarë dhe thonin: "Na ka brejtur Ali ibn Ebu Talibi dhe për këtë është quajtur brejtësi".

Pastaj lufta e tij kundër idhujve u lavdërua, pasi i bllokuan rrugën kur donte hixhretin nga Meka dhe bashkë me të kishte edhe fëmijë në gji. Pasi i zbatoi të gjitha ato që e urdhëroi Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të bënte, i frikësuar vrau djalin e Handhales ibn Ebu Sufjani, i cili ishte fshehur në rrugë kur ai po dilte nga shtëpia e xhaxhait të tij Abbas ibn Abdul Mutalibit. Pastaj vrau Xhenahun mbrojtësin e Harb ibn Umejje, i cili i zuri rrugën kur ai po dilte nga Meka. Pastaj shokët e tij iu shmangën shtatë kalorësve duke u kthyer në Mekë (komentimi i kësaj është përmendur në pjesën e dymbëdhjetë).

Nuk ka asnjë kontradiktë se duelistët e parë, në impaktin e Bedrit (i cili është impakti i parë në islam) ata janë: Ali ibn Ebu Talib, Hamza ibn Abdul Mutalib, Ubejde ibn Harithi ibn Muttalib. Kur doli për duel Ataba ibn Rebu, vëllai i tij Shejbe dhe djali i tij Velidi thirrën fort: O Muhamed na i nxirr neve më të mirët e kurejshëve dhe Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: Çohu o Ali, çohu o Hamza, çohu o

Ubejde, luftoni për të drejtën tuaj me të cilën Allahu ka dërguar Pejgamberin tuaj, nëse kanë ardhur me të pavërtetën e tyre për të shuar dritën e Allahut.

Babai i Hasanit doli në duel me Velidin ibn Ataba pasi ishin më të rinjtë në moshë dhe pasi shkëmbyen nga dy gjuajtje, Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*e vrau atë. Pastaj u ngrit Atabe dhe atij i doli në duel Hamzai, shkëmbyen nja dy goditje dhe Hamzai e vrau atë.

Pastaj u ngrit Shejbe, atij i doli në duel Ubejde dhe ai në atë kohë ishte më i moshuari i shokëve të të Dërguarit të Allahut. Shejbe e goditi këmbën e Ubejdes me tehun e shpatës dhe e preu atë, kurse Hamzai dhe Aliu iu vërsulën Shejbes duke e vrarë atë, e mbajtën në krahë Ubejden, por më pas ai vdiq prej plagëve të rënda.

Beteja e Bedrit ishte një vijë ndarëse mes mosbesimit dhe besimit, me këtë u stabilizua rruga e secilit prej atyre të dyjave, ku u vendosen shtyllat e islamit të forta e të qëndrueshme, shkatërroi forcat e idhujtarisë, i hodhi në tokë tiranët kurejshitë në Bedër dhe pastaj i hodhi në Xhehenem, e ç'vend i keq është ai. Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*ka qenë heroi i asaj beteje të përgjakshme dhe boshti që sillej rrotull tij, sepse ai pasi e fitoi betejën në përgjakjen e parë dhe kur doli në duel me Asin ibn Seidin ibn Asi e vrau atë. Pastaj doli ne duel me Hand'hale ibn Ebu Sufjanin dhe e vrau atë.
Pas tij doli në duel me Ta'me ibn Addi dhe e vrau atë.

Pastaj si kundërshtar i doli Nuvel ibn Khuvejlidi i cili ishte prej shejtanëve të kurejshëve, e vrau edhe atë. Kur imami *(Paqja qoftë mbi të!)*u kthye te Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e dëgjoi atë duke thënë: "Kush ka dijeni për Novel ibn Khuvejlidin, ai tha: Unë e vrava atë o i Dërguari i Allahut dhe Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e lartësoi Allahun me tekbire

dhe tha: "Falënderimi i takon Allahut i cili m'u përgjigj mua në lutjen time".

Prijësi i besimtarëve vazhdonte t'i vriste njëri pas tjetrit derisa erdhi në pjesën e të vrarëve të idhujtarëve që ishin shtatëdhjetë. Në një transmetim thuhet se kanë qenë dyzetë e nëntë të vrarë. Myslimanët u angazhuan me të gjithë të vrarët e pjesës së parë, kurse prijësi i besimtarëve u mor me të vrarët e pjesës tjetër më vete, me ndihmën e Allahut ndaj tij dhe suksesin e Tij për të.

Beteja u mbyll me një grumbull gurësh. I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* i hodhi në anën e idhujtarëve dhe tha: "Fytyrat u gëzuan dhe shumica u mundën, Allahu ua bëri të mjaftueshme luftën besimtarëve".

Is'hak ibn Ibrahimi ka thënë: "Ai është njëri nga dijetarët me të cilët ka debatuar kalifi i sinqertë për Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja qoftë mbi të!)*. Në asnjë prej raporteve të gjykatësit të gjykatësve Jahja ibn Ekthem, i sinqerti më tha mua: O Is'hak, cila nga punët ka qenë më e mira pas islamit? Unë thashë: Lufta në rrugë të Allahut, ai tha: të vërtetën the, por a gjen tek ndonjëri prej shokëve të të Dërguarit të Allahut, atë që e gjen tek Aliu në luftë? Unë thashë: Në cilën kohë? Ai tha: Në çdo kohë që dëshiron ti, unë thashë: Bedri, ai tha: Nuk dua asgjë veç saj, por a gjen te ndonjëri diçka që nuk e ka Aliu ditën e Bedrit? Më thuaj mua sa është numri i të vrarëve të Bedrit? Janë vrarë: Më shumë se gjashtëdhejtë burra prej idhujtarëve, ai tha: Sa ka vrarë vetëm Aliu? Unë thashë: Nuk e di, ai tha: Njëzet e tre ose njëzet e dy dhe dyzetë për pjesën tjetër të njerëzve.

Ibn Ebu Hadidi ka thënë se sa i përket luftës në rrugë të Allahut është e ditur tek shoku i imamit dhe armiku i tij se ai është

i pari i luftëtarëve. A është për njeri tjetër xhihadi përveç tij dhe ti e di se një nga betejat më të mëdha që ka luftuar i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe shpartallimi më i madh i idhujtarëve është Bedri i madh ku janë vrarë shtatëdhjetë idhujtarë. Gjysmat e tyre i vrau Aliu, kurse myslimanët e melekët vranë gjysmën tjetër dhe nëse kthehesh tek luftëtari Muhamed ibn Omer El Uakidij dhe historisë fisnike të Jahja ibn Xhabiri Beladhirijju dhe të tjerave veç tyre, do të mësoje të vërtetën e saj. Të vërtetën, deri kur kjo pjesë nuk ka kuptim perifrazimi, sepse është e ditur nga informacionet e domosdoshme si dituria për ekzistencën e Mekës, Egjiptit e të tjera.



I PARI QË KA MBAJTUR FLAMURIN E ISLAMIT PARA TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) [1]

Ibn Sa'di tek libri "*Et Tabekatu*" ka thënë se Ali ibn Ebi Talibi ka qenë bartësi i flamurit të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ditën e Bedrit dhe në çdo skenë.

Ibn Kutejbe në librin tij "*El mearif*" ka thënë: Ka qenë flamuri i Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në Bedër bashkë me Mus'ab ibn Umejri dhe unë e kam parë atë bashkë me Ali ibn Ebu Talibin".

Në historinë e tij Tibrijju ka thënë se ka qenë bartësi i flamurit të të Dërguarit të Allahut në Bedër, Ali ibn Ebu Talibi, kurse bartësi i flamurit të ensarëve ka qenë Sa'd ibn Ubade.

Dijetari Muhamed ibn Nu'mani në udhërrëfimin e tij ka thënë se flamuri dhe simboli i kurejshëve kanë qenë të gjitha në dorë të Kasi ibn Kilabi. Pastaj flamuri ka vazhduar të jetë në dorë

1 Tabekatu i ibn Sa'd 3/23. El mearifu i ibn Kutejbe /153. Tarikhu Tabari 2/431. El Irshadu /43. El Istiabu (Asimilimi) 3/1090 dhe 1097. Usdul Gabe 4/20. Keshful Gummeh 1/190. Es Siretul Halebijeh 2/382. A'janu Shi'ia 3/k1/170-172. El Aleuijatul Ishrune /51 dhe 104. Idul Gadir /58.

të djalit të Abdul Mutalibit duke e mbajtur atë kush shkonte në luftë, derisa Allahu dërgoi të Dërguarin e Tij dhe ju dha flamuri i kurejshëve dhe i të tjerëve. Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e vendosi atë te beni Hashimijët dhe ia dha atë Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)*në betejën e (vedanit).

Kjo është beteja e parë që është bartur me atë flamur në islam bashkë me Pejgamberin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* më pas ka vazhduar të jetë në dorë të Aliut në çdo skenë. Në Bedër është goditja më e madhe, flamuri në Uhud atë ditë ka qenë te beni Abdu Dar dhe i Dërguari i Allahut ia dha atë Mus'ab ibn Amirit. Por ai ra dëshmor dhe flamuri ra nga dora e tij, fiset e panë atë, ndërsa Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e mori dhe ia dha Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*. Flamuri dhe simboli u bashkuan atë ditë dhe se ato të dyja deri në ditën e sotme janë tek beni Hashimijtë.

Bashkimi i atyre të dyjave në dorën e Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*nuk do të thotë se ai i mban ato të dyja bashkë. Përkundrazi nënkuptimi i saj është se çështja e atyre të dyjave është për të dhe ndonjërën prej tyre ia jep kujt të dojë ai.

Ibn Abdul Berri tek Asimilimi ka thënë se ibn Abbasi *(Paqja qoftë mbi të!):* Aliu ka pasur katër virtyte që askush tjetër nuk i ka pasur veç tij, pasi ai është arabi dhe i joarabi i parë që është falur me të Dërguarin e Allahut. Ai ishte flamuri i tij, i cili ka qenë bashkë me të në çdo tubim dhe ai ka bërë durim bashkë me të, ditën kur njerëzit e braktisën atë. Ai e lau dhe e futi atë në varrin e tij".

Nga ibn Abbasi është transmetuar gjithashtu se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e*

tij!) ia afroi flamurin Ali ibn Ebu Talibit ditën e Bedrit kur ai ishte në moshën njëzet vjeçare".

Ibn Ethiri tek 'Usdul Gabe' ka thënë: "Sa'd ibn Ubade ka qenë mbajtësi i flamurit të të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në të gjitha vendet, por kur ishte koha e luftës, atë e merrte Ali ibn Ebu Talibi".

Ali ibn Burhanidin në "*Es sijretul Halebijeh"* ka thënë: Në Bedër, para të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishin dy flamuj të zinj. Njërin e kishte Ali ibn Ebu Talibi, *Allahu ia ndriçoftë fytyrën*, që i thuhej me emrin, "Ukab" dhe ka qenë prej mbulesave të Aishesë, *Zoti qoftë i kënaqur prej saj*".

Pastaj lajmi paraprirës është transmetuar që dhe atë e ka përmendur ibn Abbasi se Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ia ka dhënë Aliut flamurin ditën e Bedrit, kur ai ishte në moshën njëzet vjeçare. Gjithashtu nga libri i udhëzimit është transmetuar se flamuri i muhaxhirëve ka qenë me Mus'ab ibn Amiri, kurse flamuri i Khazrexhit me Habbab ibn Mundhiri dhe flamuri i Eusit me Sa'd ibn Muadhin, por në të nuk janë përmendur dy flamujt e zinj, pastaj nga libri i gëzimit është transmetuar se Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka lënë tre veta që të ngrejnë flamurin: Një flamur që e mbante Mus'ab ibn Amiri dhe dy flamuj të zinj, njëra prej tyre me Aliun, kurse tjetrin njeri prej ensarëve. Pastaj tha: Në të ka një specifikim të fjalës "liaun" (flamur, parrullë) dhe ndaj fjalës "alemun" (flamur) është prezantuar më parë, se një grup nga profesorët e gjuhës e kanë bërë të qartë sinonimin e fjalës "levaun dhe "alemun" (flamur).

Sejjid Muhsin El-Emini në sytë e shiitëve ka thënë se ka qenë beteja e (Vedanit) dhe quhet (el-ebvaru). Në zinë e dymbëdhjetë netëve që kaluan prej saj në fillim të muajt të dymbëdhjetë të ardhjes së Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në Medine, kjo është beteja e parë e Pejgamberit në të cilën është mbajtur flamuri me Pejgamberin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe flamurin e kishte Aliu *(Paqja qoftë mbi të!).* Kurse parrullat e tij ishin bashkë me Hamza ibn Abdul Muttalib, siç është përmendur tek libri shtresat e ibn Sa'dit dhe udhërrëfimi i Mufidit, nuk ka kontradiktë se "er-rajetu" flamuri është më i madh, kurse "el-levau" jo.

Ajo që supozohet nga fjalët e disave prej ithtarëve të gjuhës prej bashkimit të atyre të dyjave, është i refuzuar dhe i dyshimtë me sqarimin e të tjerëve.

Po, mund të specifikohet nga njëri nga tjetri apo në përgjithësi duke e konsideruar se "rajetun", emërtohet gjithashtu edhe "levaun" (flamur). Secila prej tyre mund të komentohet me njëra-tjetrën në gjuhën e ithtarëve, të cilën shumë prej tyre e komentojmë në përgjithësi.

Siç tregohet nga ibn Sa'di dhe ibn Is'haku, flamujt që kanë ngjarë ditën e hajberit janë të refuzuara, këto transmetime kanë paraprirë në betejën e "Vedanit" dhe (Bedrin e parë). Në betejën e tribuve u bë e ditur se flamuri i muhaxhirëve në betejën e Bedrit ishte në dorën e Aliut *(Paqja q Allahut qoftë mbi të!),* kurse parrullat e tyre ishin në dorë të Mus'ab ibn Amiri dhe se parrullat e hazrexhit prej ensarëve ka qenë me Habbab ibn Mundhiri. Ndërsa parrulla e Eusit ishin me Sa'd ibn Muadhi dhe në atë kohë bëhet një flamur i vetëm dhe tre valëvitje, ai është i dakordësuar sipas vlerësimit.

Kjo është përmbajtja e teksteve të përmendura në burimet e kësaj pjese dhe prej tyre është bërë e qartë se imami *(Paqja qoftë mbi të!)*është i pari që ka mbajtur flamurin e islamit përballë të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kjo ka ndodhur në betejën e "Vedanit", betejë në të cilën nuk është bërë luftim. Pastaj e ka mbajtur atë në betejën e madhe të Bedrit, në të ishte shkatërrimi më i madh e cila tronditi themelet e idhujtarisë në vendet e arabisë përgjithmonë. Në to u ngritën shtyllat e islamit të fortifikuara, përgjithmonë dhe prej tyre u përhapën rrezet e udhëzimit nga lindja në perëndim. Me lejen e Allahut të Lartësuar, vendet arabe do të vazhdojnë të jenë vendet e mesazheve qiellore, që ndriçojnë rrugën për atë që dëshirojnë udhëzimin dhe lumturimin në të dyja shtëpitë.

Pastaj, flamuri mbeti në dorë të prijësit të besimtarëve, Aliut në të gjitha vendet, përveç betejës së Tebukut, në të cilën nuk është zhvilluar luftë në atë betejë dhe imami, nuk ka qenë dëshimtar i saj, se Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e la atë në vendin e tij në Medine dhe për këtë i ka thënë atij: "Ti prej meje je në gradë ashtu si Haruni prej Musait, vetëm se pas meje nuk ka më pejgamber".



I PARI NË DUEL NË LUFTËN E UHUDIT DHE I PARI QË KA QËNDRUAR I PALËKUNSHËM BASHKË ME PEJGAMBERIN

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) [1]

Pasi myslimanët dhe idhujtarët i organizuan mirë radhët e tyre ditën e Uhudit, Talha ibn Ebu Talha doli përpara si kryetari i Beni Abdu Darit dhe si mbajtësi i flamurit të idhujtarëve në betejën e turbullirës, me zë të lartë thërriti: O ju shokët e Muhamedit, vërtetë ju pohoni se Allahu do të na fusë neve në zjarr nëpërmjet shpatave tuaja, kurse juve ju nxiton me shpata tona për në Xhenet. A ka ndonjë prej jush që Allahu ta fusë me nxitim në Xhenet me shpatën time apo të më çojë mua në zjarr me shpatën e tij.

---

1 Dijuanu mensubun lil emriril mu'minin Ali /105, 106. El Mugazi i El Uakidij /176,200,217, 220. Es Siretu i ibn Hishamit 2/73 dhe 151. Tabekatu i ibn Sa'dit. Tarikhu Tabarij 2/509, 513, 514,533. El Agani i ibn Ferxhit 15/145-149. Mu'xhemu shuara /130. El Irshadu /37,44 dhe 46-49. El Menakibu i ibn Shehri Ashubit 1/192. Usdul Gabe 2/137. El Kamilu i ibn Ethir 2/106,107. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebi Hadid 10/179-182 dhe 14/235,236,,250,251,255,257 dhe 15/20. Ujunul Ether 2 dhe 12. Es Siretul Halebijeh 2/497-499. A'janu Shi-ia 3/k 1/184-189. Hajatul Muhamed i El Hejkel /298. El Gadiru 2/59 dhe Idul Gadir /68.

Babai i dy Hasanëve *(Paqja qoftë mbi të!)*u afrua afër tij dhe tha: Pasha Atë që ka në dorë shpirtin tim, nuk do të të ndahem ty derisa të të çoj me këtë shpatën time për në zjarr. Ose të më çosh me shpatën tënde për në Xhenet dhe prijësi i besimtarëve *(Paqja qoftë mbi të!)*e goditi dhe ia preu këmbën. Për këtë është thënë se e ka goditur në kokë dhe ai ka rënë në tokë bashkë me të edhe flamuri nga dora e tij dhe iu zbuluan lakuriqësia e tij, për këtë ka thënë: Kërkoj Allahun dhe mëshirë o djalë i xhaxhait, imami e la atë dhe u terhoq prej tij, kurse i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u gëzua dhe shfaqi madhërime për Allahun, edhe myslimanët e madhëruan Allahun.

Pas Talhasë flamurin e idhujtarëve e mbajti vëllai i tij, Othmani dhe ai u vra, pas tij e mbajti vëllai i tij Ebu Seidi, pastaj pas tij e mbajti vëllai i tij Harithi, më pas vëllai i tij Kilabie pastaj pas tij e mbajti vëllai i tij, Xhelai por edhe ai u vra.

Kur nuk mbeti më asnjë prej bijve të Ebu Talhasë, flamurin e mori një person prej beni Abdudarit që quhej Artaet ibn Sherhabili i cili u vra, pastaj atë e mbajti një skllav i beni Abdudarit që quhej Sava, por edhe ai u vra.

Historianët kanë rënë dakord unanimisht se ai i cili e ka vrarë Talhanë ibn Ebu Talha është imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*por nuk kanë rënë dakord në përcaktimin e emrave se kush i vrau të gjashtë ata që mbetën prej fisit të beni Abdudarëve.

Shumë prej historianëve kanë transmetuar, në historinë e tij, se është Taberijju, në këngët e tij Ebul Ferexhi El'asfahanijju, dhe në librin "I përsosuri" ibn Ethiri. Me të vërtetë se ai që i ka vrarë shtatë mbajtësit e flamurit të idhujtarëve është Ali ibn Ebu Talibit *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij),* kurse një pakicë e atyre që

kanë transmetuar pjesa e mbetur e historianëve dhe autorët e historive në këtë kapitull është se ai ka vrarë tre prej tyre.

Është transmetuar nga Ebu Rafiu, se mbrojtësi i të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të)* kur Ali ibn Ebu Talibi, i vrau ata që mbanin flamurin, pa me shikimin e tij një grup prej idhujtarëve kurejshë dhe i tha Aliut: Sulmoi ata dhe ai i sulmoi. E copëtoi grupin e tyre dhe e vrau Amru ibn Abdullah el-xhemhin, i cili tha se Pejgamberi me shikimin e tij pa një grup tjetër prej idhujtarëve kurejshë dhe Shejbe ibn Maliki vrau një nga djemtë e Amir ibn Le'iji.

Njerëzit u vranë derisa lufta ndaloi, kurse Hamza ibn Abdul Mutalib, Ali ibn Ebu Talibi dhe Ebu Dexhane, *(Zoti qoftë i kënaqur prej tyre!)* luftuan derisa shkuan të palodhur në mesin e njerëzve. Për këtë Aliu ka thënë: Unë veçova prej tyre një grup të vogël të ashpër, në të ishte Akreme ibn Ebu Xhehli, hyra në mesin e tyre me shpatë dhe i godita. Ata u hodhën sipër meje furishëm derisa i dhashë fund edhe të fundit të tyre. Pastaj e përsërita këtë në mesin e tyre për herë të dytë derisa u ktheva andej nga erdha mirëpo exheli, afati i vdekjes nuk kishte ardhur akoma që Allahu të përfundojë një çështje që është e bërë.

Imam Aliu ka thënë se kur ishte dita e Uhudit, njerëzit bënë atë raund ku erdhi Umejje ibn Ebu Hudhejfe ibn Mugire i cili kishte veshur një armaturë prej hekuri që vetëm sytë e tij e kishin parë duke thënë: Gjatë luftës së Bedrit Umejjes i del përpara një burë prej myslimanëve të cilën ai e vrau. Unë i dola atij përpara dhe e godita me shpatën time në kokë. Në të kishte vënë një helmetë, kurse poshtë helemetës një tjetër mbulesë që vishet poshtë saj. Ai më godet me shpatën e tij, kurse unë mbrohem me mburojë. Shpata e tij u ngatarurra (do me thënë ngeci në mburojë dhe nuk po dilte), kurse unë kur e godisja atë, mburoja i ishte

palosur me buzë dhe unë i preva atij këmbët. Ai ra në tokë dhe filloi të rregullojë shpatën derisa e nxorri nga mburoja. Filloi të përleshët me mua me gëzim derisa pashë një të çarë poshtë sqetullës së tij, në këtë moment i futa shpatën në të dhe vdiq e unë u largova.

I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* atë ditë ka thënë: "Kush ka dijeni për Dhekvan ibn Abdu Kajsin? Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*tha: Unë o i Dërguari i Allahut pashë një kalorës që po i shkonte nga pas, shkova pas tij dhe i thashë: Nuk ke shpëtuar akoma, për këtë e sulmoi me kalin e tij, kurse Dhekvani ishte në këmbë dhe ai e goditi atë duke i thënë: Merre pra, se unë jam i biri i Ulaxhit dhe e vrau atë. Unë nxitova për tek kalorësi dhe e godita në këmbë me shpatë derisa ia preva nga gjysma e kofshës. Pastaj e rrëzova nga kali i tij dhe i dhashë fund atij (do me thënë e vrara), ai kishte qenë Ebu Hakemi ibn Akhanes ibn Sheriki.

Mposhtja e fortë e myslimanëve, pas triumfit e cila finalizua me vrasjen e mbajtësve të flamurit nga bijtë e Abdu Darit, ndodhi kur harkëtarët e kundërshtuan urdhrin e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe i lanë pozicionet e tyre për t'iu bashkuar vëllezërve të tyre në plaçkat e luftës. Në atë kohë askush përveç Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja qoftë mbi të!)* nuk qëndroi me të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* . Kjo bëri që historianët të kishin kontradikta në përcaktimin e emrave dhe numrit të atyre myslimanëve të tjerë që qëndruan me Të. Për këtë mendimet janë të shumta, dikush ka thënë se kanë qenë tetëdhjetë me në krye imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*, ndërsa dikush tjetër ka thënë se kanë qenë dymbëdhjetë, apo katërmbëdhjetë e në krye të tyre ishte Ali ibn Ebu Talibi.

Ebu Omer, Muhamed ibn Abdul Uahid, mjeshtri i gjuhës djali i Tha'lebiut dhe Muhamed ibn Habibi kanë transmetuar se me të vërtetë se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kur tij shumica e shokëve të tij u larguan prej ditën e Uhudit, atij shtuan batalionet e idhujtarëve dhe një batalion i beni Kenane të cilët e shënjestruan atë. Aty ishin beni Abdumenatëve ibn Kenane, benu Sufjani ibn Avifi, Khalidi, Ebu Sha'thau, Ebu Hamrau dhe Gurabi

I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u tha: "O Ali, sulmoje këtë batalion dhe ai e sulmoi. Aty ishin rreth pesëdhjetë kalorës, ndërsa ai (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)i godiste ata me shpatë derisa largoheshin prej tij. Pastaj e sulmonin atë në këtë formë disa herë derisa i vrau të katër bijtë e Sufjan ibn Avifit dhe plot dhjetë prej tyre.

Xhebraili *(a.s)* i tha të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* , o Muhamed me të vërtetë melekët janë habitur nga ngushëllimi i këtij djali dhe tha i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* : "dhe çfarë e pengon atë kur ai është prej meje dhe unë prej atij. Xhebraili *(a.s)* tha: Edhe unë jam prej ju të dyve, tha ai: Atë ditë u dëgjua një zë nga qielli që askush nuk e ka parë atë që bërtiti duke thërritur shpesh: Nuk ka shpatë vetëm për atë që ka vertebra dhe nuk ka djalë si Aliu.

Doktor Muhamed Husejn Hejkeli në librin Jeta e Muhamedit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* duke përshkruar situatën e ushtrisë myslimane atë orë të tmerrshme të arratisjes, me zë të lartë bërtiti se Muhamedi është vrarë. Zhurma, rrëmuja u shtua, shqetësimi u rrit dhe myslimanët u konfliktuan. Ata nisën të luftonin dhe të vrisnin njëri-tjetrin, duke mos e ndjerë fare se në çfarë hutimi dhe gjendje

ishin. Shqetësimi më i madh i çdo myslimani ishte të shpëtonte veten e tij, përveç atij që mbrojti, ruajti Allahu si shembulli i Ali ibn Ebu Talibit *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij).*

Nëse vendoset e drejta e Hejkelit që Allahu e faltë, synohet e vërteta që të plotësojë fjalën e tij dhe ka thënë: A ka shembull si Ali ibn Ebu Talibi në atë ditë? Kur beteja mbaroi, i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u kthye në shtëpi bashkë me Aliun *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij),* ia dha shpatën e tij vajzës së tij Fatimes dhe i tha laje gjakun e kësaj o bija ime.



SFIDUESI I PARË NË LUFTËN E HENDEKUT[1]

Shkaku i luftës së hendekut ishte se i Dërguari i Alahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* donte të largonte çifutët e fisit benu Nedir nga shtëpitë e tyre afër Medinës. Pasi iu bë e qartë tradhtia ndaj myslimanëve në betejën e Uhudit, ku idhujtarët kurejshë shkuan të bashkojnë forcat kundër pejgamberit, duke i premtuar atyre armë dhe burra, ia konfirmuar se feja e tyre është më e mirë se feja e Muhamedit. Kjo gjë i gëzoi ata duke i dhënë shtysë që të përgatitën për luftë, me synim plotësimin e triumfit të tyre, e cila nuk u realizua në Uhud.

Kur morën garanci për përgjigjen e kurejshëve, shkuan te fisi Gatfan tek Kajsi Ajlani, beni Fezareh, Eshxhea dhe Selim e të tjerë. I lajmëruan ata për atë që u arrit mes tyre dhe kurejshëve, se ata janë të vendosur në luftimin e Muhamedit dhe nisën t'i bashkohen duke i premtuar triumfin dhe shkatërrimin e kësaj feje, e cila i kërcënon interesat e tyre.

---

1 Siretu ibn Hisham, 2/225, 226, 268. Tabakat ibn Sa'd, 2/68. Tarijkh Tabarij, 2/ 573. El Irshad, 50. Zehrul Edeb, 1/45-47. Tarikhu Bagdad, 13/19. Tefsir Fakhru Razij, 6/ 211 dhe 32/31.. El KAmil i ibn El Ethijr, 2/124. Sherh Nehxhul Belaga, i ibn ibi Hadijd, 19/60. Keshful Gumeh, 1/196-206. Nihajetul Erb i En Nuejrij, 17/166 dhe 174. Tarijkh ibn El Uerdij, 1/162. El Bidajetu ue En Nihajetu, i ibn Kethijr, 4/105-180. Es sijretu Halebijeh, 2/641-648. A'janu Shi'iah, 2/135-148.

Kurejshët marshuan nën komandën e Ebu Sufjanit ibn Harbit kurse grupacionet, aleatët dolën nën komandën e kryetarëve të tyre duke synuar Medinën. Numri i tyre i kalonte dhjetëmijë luftëtarë.

Lajmi i mbërriti menjëherë në vesh të Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ku bashkë me shokët me tij tubuan për këshillim. Selman Farisijju këshilloi që të hapnin një kanal, që do ishte hendek rreth Medinës, ideja u pranua nga të gjithë. Të gjithë myslimanët morën pjesë në hapjen e hendekut, burra e gra dhe Pejgamberi që ishte në krye të tyre duke e bartur dhenë vetë derisa e gjithë kjo punë gjigante përfitoi për gjashtë ditë.

Kur kurejshët dhe aleatët e tyre mbërritën, e kishin mbushur të gjithë hapësirën me pajisje luftarake dhe njerëz. Ata qëndruan tek hendeku dhe kjo mënyrë mbrojtjeje i tmerroi, pasi nuk ishte bërë më parë. I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* doli bashkë me tremijë myslimanë, pasi i vendosi gratë dhe njerëzit e dobët në vendet e mbrojtura të Medinës. E pozicionoi ushtrinë e tij para luftëtarëve dhe i vuri me shpinë nga mali i Sal'a, kurse hendeku i ndante mes tyre dhe kurejshëve.

Kur myslimanët e panë numrin e madh të tyre morën vesh edhe për prishjen e marrëveshjes së benu Kurejdhave me Pejgamberin dhe se ata e kishin prerë mbështetjen e tyre për Medinën. Të gjithë i zuri paniku, përveç atij që e kishte mbështetur Allahu. Ata kishin përgatitur gjithçka me qëllim për të nxjerrë helimin e tyre mes njerëzve duke i futur në dyshim për profetësinë e Muhamedit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* . Ai i kishte premtuar për triumfin ndaj Kisrasë dhe Cezarit, madje kishte prej tyre që nxisnin për t'u

arratisur sepse ata nuk kishin fuqi kundër këtij kundërshtari të fortë të fiseve kurejshe dhe aleatëve të tyre. Kishte edhe prej atyre që abuzonin me Pejgamberin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* duke kërkuar që të ktheheshin në Medine, sepse shtëpitë e tyre ishin të zbuluara ndaj armiqve.
Myslimanët vazhduan të qëndrojnë në këtë pozitë të vështirë prapa hendekut për afër një muaj edhe pse i ftohti ishte i acartë, kurse bllokada rritej ditë pas dite. Shqetësimet e brengat shtoheshin, kurse frika rritej kur dy grupe myslimanësh u vranë një natë pa e ndjerë fare njëri-tjetrin. Nuk menduan vetëm se ajo ishte vepër e armikut pasi në mesin e tyre kishte të plagosur dhe të vrarë, pastaj thërritën me sloganet islame "Ato nuk ndihmojnë".

Gjatë kohës kur myslimanët ishin në këtë atmosferë të ndezur, Amru ibn Abdu Vud El Amirij, i cili kishte qenë dëshmitar i Bedrit, doli që kishte mbajtur në kurriz një të plagosur kur ishte në çastet e fundit të jetës, por ai nuk kishte qenë dëshmitar i Uhudit. Ai doli duke treguar shpatën e tij, duke bërë me shenjë dhe treguar guximin dhe forcën e tij. Bashkë me të doli edhe Dirrar ibn Khatab El Fehri, Akreme ibn Ebu Xhehl, Hubejre ibn Ebi Uehebu dhe Neufel ibn Abdullah ibn Mugire të cilët u sollën rrotull me kuajt e tyre mbi hendek sa lart poshtë duke kërkuar një vend të ngushtë për të kaluar, derisa qëndruan te vendi më i ngushtë në të, në vendin e njohur me emrin si vend i shenjtë (Mezarun). Kuajt e tyre nuk donin të hynin në të, kështu që e kapërcyen dhe mbetën bashkë me myslimanët në një tokë të vetme. I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte i ulur, kurse shokët e tij ishin në këmbë rreth tij.

Amru ibn Abdu Vuddi doli përpara dhe i ftoi për duel disa herë, por askush nuk i pranoi. Kur e teproi Ali ibn Ebu Talibi

*(Paqja qoftë mbi të!)*u ngrit dhe tha: Unë e sfidoj atë, o i Dërguari i Allahut! Por ai e urdhëroi atë që të ulej. Amri filloi të thërriste përsëri kurse njerëzit ishin të heshtur, sikur të kishin ndonjë zog mbi kokë dhe ai thotë: O ju myslimanë, vërtetë ju thoni se të vrarët tuaj shkojnë në Xhenet kurse të vrarët tanë shkojnë në zjarr, a nuk dëshiron ndonjëri prej jush që të shkojë më parë në Xhenet, apo të çojë një armik të tij në zjarr? Përsëri askush nuk i doli në duel, pas kësaj u çua babai i Hasanit për herë të dytë dhe tha: Dal unë, o i Dërguari i Allahut, por ai e urdhëroi përsëri të ulej, kurse Amri po vinte rrotull me kalin e tij duke bërë karshillk. Të mëdhenjtë e aleatëve qëndronin nga parapa hendekut dhe kishin zgjatur qafat e tyre për të parë kur Amri pa se askush nuk po i përgjigjej atij tha:

Mu ngjir zëri duke thirrur në mesin tuaj se a ka ndonjë sfidat,
Dhe qëndrova duke ndjekur me shikim, pozitën moshën e luftëtarit,
Por unë kështu vazhdoj të jem i ngutur para tronditjeve
Me të vërtetë se guximi në rini dhe bujari është prej trofeve më të mirë.

Aliu (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)u ngrit për herë të tretë dhe tha: Më lejo o i Dërguari i Allahut në sfidën e tij dhe Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: Afrohu afër meje dhe ai u afrua, i dha shpatën dhe i veshi çallmën e tij dhe tha: Shko tani në çështjen tënde dhe kur ai u largua pak tha (o Allah, ndihmoje atë).

Në një hadith të pejgamberit shtuar me fjalë dhe vepra thuhet: Me të vërtetë i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kur Aliu e sfidoi në duel Amrin, nuk i uli duart e tij. Duke kthyer kokën nga qielli e duke lutur Zotin e tij tha: O Allah, vërtetë Ti largove prej meje

Ubejden dhe Hamzanë ditën e Uhudit, ruaje o Allah, Aliun sot në këtë ditë. O Zoti im, mos më lër vetëm, se Ti je trashëguesi më i mirë), kurse në një hadith gjithashtu është transmetuar se ai *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* atë ditë ka thënë: "I gjithë besimi e ka eklipsuar totalisht idhujtarinë". Kur Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*iu afrua Amrit iu përgjigj atij me poezinë e tij:

Mos u nxito se të erdhi ty, ai që i përgjigjet zërit të dobët,
Me trimëri dhe shikim të mprehtë që shpreson me to shpëtimin e fituesit,
Vërtetë unë shpresoj që të çoj ty në anën e të vdekurve,
Nga goditja e të turpëruarve mbetet përkujtimi i saj tek tronditjet,

Kurse Amri thotë: Kush je ti? Imami u afrua dhe tha se unë jam Ali ibn Ebu Talibi, ai (Amri) tha: Babai yt ka qenë shoku dhe miku im, kështu që ktheu ore djalosh sepse unë nuk dua të të vras ty.

Ebul Khajri Misdek ibn Shejbi Nahvijj ka thënë: "Për Zotin nuk e urdhëroi atë që të largohej për t'i kursyer jetën, por prej frikës, sepse i kishte njohur të vrarët e tij në Bedër dhe Uhud. E dinte nëse do ta sfidonte atë, ai do ta vriste, por u turpërua që t'ia shfaqte këtë avantazh, kështu që bëri të dukej sikur po i kursente jetën dhe u kujdes për të, por vërtetë se ai ishte mashtrues në të dyja këto".

Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*i tha atij: Por unë kam dëshirë të të luftoj ty, kurse ai tha: O djali i vëllait tim, vërtetë se unë e urrej që të vras një burrë të nderuar si ti, kështu që kthehu, se është më mirë për ty. Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*tha se me të vërtetë kurejshët flasin për ty se ti je vrarë: Nuk më fton mua askush në tre herë, vetëm se i përgjigjem atij qoftë edhe në herën e parë, ai tha: Është e vërtetë tha ai *(Paqja qoftë mbi të!)*sepse vërtetë

unë të ftoj ty në islam, ai thotë: Lëri këto, ai tha: Vërtetë unë të bëj thirrje të kthehesh bashkë me kurejshët që të kanë ndjekur ty për në Mekë, ai tha: Atëherë, gratë kurejshite do të thonë për mua, se një djalë më mashtroi mua dhe tha: Atëherë unë të ftoj ty në dyluftim, Amri u mbrojt dhe tha: Nuk e kam menduar ndonjëherë se ndonjëri prej arabëve do ta dëshironte këtë prej meje, pastaj zbriti, theri kalin e tij dhe pas pak goditi fytyrën dhe u largua me vrap.

Xhabir ibn Abdulla El-Ensarijjui cili ishte dëshmitar i duelit nga afër ka thënë: "U rrotulluan dhe u bë një pluhur i madh, humbën nga sytë deri kur njerëzit dëgjuan tekbiret e Aliut nga poshtë pluhurit. Aty e kuptuan që Aliu e kishte vrarë atë dhe kur u largua pluhuri, Aliu kishte hipur mbi gjoksin dhe e tundte kokën e tij".

Shokët e Amrit u larguan për të kaluar hendekun dhe kuajt kapërcyen hendekun, përveç Nufel ibn Abdallah, sepse kali i tij rrëshqiti dhe ra në hendek. Myslimanët e goditën atë me gurë dhe ai tha: O ju njerëz, vrasja është më e nderuar se sa kjo dhe prijësi i besimtarëve zbriti tek ai dhe e vrau. Ebu Sufjani ofroi njëqind deve haraç për kufomën e tij, por Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e refuzoi ofertën e tij dhe tha: Ne nuk kemi nevojë për haraç, merreni ju atë se vërtetë ai është i papastër, pagesë e pisët. Zubejri ibn Avami e zuri Hejberen ibn VehEbu dhe e goditi atë, ia preu frerët e kalit të tij, kurse mburoja që e mbante nga prapa i ra në tokë dhe atë ia mori Zubejri. Është thënë se prijësi i besimtarëve e vrau Haselin ibn Amri ibn Abdu Vuddin, pasi vrau babain e tij.

Omer ibn Abidi nga Hasan Elbasrijju transmeton se Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*kur e vrau Amrin ia preu kokën e barti, e hodhi para Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi*

familjen e tij!) . Ebu Bekri dhe Omeri u çuan dhe e puthën në kokë dhe në fytyrë, kurse i Dërguari i Allahut buzëqeshte nga gëzimi dhe thoshte "ky është triumfi i parë".

Nga Muhamed ibn Is'haku transmetohet se kur Ali ibn Ebu Talibi e vrau Amrin u drejtua drejt të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe fytyra e tij buzëqeshte nga gëzimi, për këtë Omer ibn Khatabi tha: A nuk e mbrojti atë mburoja e tij, o babai i Hasanit, sepse arabët nuk kanë një mburojë të tillë si ai, kurse imam Aliu tha: Me të vërtetë mua më vinte turp që të zbuloja turpërimin e djalit të xhaxhait tim.

Pas vrasjes së Amrit Allahu *(xh.sh)* dërgoi erën kundër kurejshëve dhe aleatëve të tyre. I pakësoi fuqitë, i shkatërroi pajisjet, ata u shqetësuan dhe u kontradiktuan me aleatët e tyre çifutë. Allahu iu kundërpërgjigj me atë që kishin kultivuar dhe që nuk bënë asnjë të mirë. Ky çlirim ishte i shoqëruar me guximin e Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*qëndrimin, vrasjen nga ana e Amrit dhe djalit të tij, një nga shokët e tij të cilët kaluan hendekun bashkë me të derisa u mposht unioni dhe u idhujtarët u përçanë pas bashkimit të tyre.

Në këtë kohë Allahu i Madhërueshëm zbriti disa ajete të qarta në suren Ah'zabu mbi të Dërguarin e Tij të nderuar. Për shqetësimin e myslimanëve që i kaploi dhe frikën nga numri i madh i armikut, pajisjeve të tyre luftarake dhe parullave të cilat i përhapën hipokritët të indoktrinuar në mesin e myslimanëve ka një përshkrim të shkëlqyer të ngjarjes.

"O ju që keni besuar, përkujtojeni të mirën e Allahut, kur juve ju erdhi një ushtri e Ne kundër tyre lëshuam një furtunë dhe ushtri që ju nuk i shihnit, e Allahu e shihte atë që ju vepronit.

Kur ata u erdhën juve edhe prej së larti edhe prej së poshti dhe kur shikimet u shtangën, e zemrat arritën në fyt, e ju sajonit mendime të llojllojshme për Allahun.
Atje, në atë vend qenë sprovuar besimtarët dhe qenë tronditur me një dridhje të fortë.

Hipokritët dhe ata që në zemrat e tyre kishin sëmundje, thonin: "Allahu dhe i Dërguari i Tij, nuk na premtuan tjetër vetëm se mashtrim! ".

Pejgamberi (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kur Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*u kthye triumfues goditja e Aliut ndaj Amrit ibn Abdu Vuddit tha se është drejtësia e adhurimit të dy rëndesave "apo ka thënë "gjëja më e mirë që ka vepruar ymeti im deri në ditën e kijametit".

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i ka thënë Aliut: Si e ndjeve veten tënde o Ali? Ai tha: E pashë atë, sikur edhe populli i Medinës të ishte në njërën anë, do t'i kisha bërë ballë.

Xhabir ibn Abdullah elensarijju *(Paqja qoftë mbi të!)* transmeton: Vrasja e Ali ibn Ebu Talibit, Amrin ibn Abdu Vuddit el-amirijju nuk i ka ngjasuar vetëm se asaj që ka treguar Allahu i Lartësuar nga tregimi i Davudit a. s dhe Xhalutit, ku thotë i Madhërueshmi: "Me ndihmën e Allahut i thyen ata, e Davudi e mbyti Xhalutin ".

Bekër ibn Ajashi ka thënë: Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë se nuk ka pasur goditje më të fortë se goditja e atij. Ndërsa goditja që Amrit ibn Abdu Vuddit i ka dhënë nuk ka qenë më poshtëruese, që do me thënë se goditja e ibn Mulxhimit, Allahu e mallkoftë.



I PARI QË KA SHKRUAR NJË MARRËVESHJE MES PEJGAMBERIT

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)

DHE IDHUJTARËVE KUREJSHË E CILA KA NDODHUR NË MARRËVESHJEN E PAQES SË HUDEJBIJES[1]

Myslimanët qëndruan gjashtë vite duke u ankuar për dhembjet e ndalimit ndaj vatanit të tyre, duke gëlltitur idhtësinë e ndalimit të shikimit të familjeve të tyre në Mekë. Ndërsa Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i premtonte atyre triumfin dhe se një ditë është e padiskutueshme që Allahu do t'u hapi atyre dyert e Mekës dhe të bëjnë tavafin rreth shtëpisë (Qabesë) që të kryejnë obligimin e haxhit.

Kurejshët edhe pse kanë pasur mbrojtjen e shtëpisë, nuk kanë të drejtë që të ndalojnë askënd nga arabët që të bëjnë tavafin rreth shtëpisë. Por ata u kapën pas ndjenjave dhe zilise të tyre ndaj myslimanëve, të cilët mobilizuan heronjtë e tyre dhe morën

1 Es sijretu nebeuijeh I ibn Hisham, 2/317 dhe 319. Tabakat ibn Sa'ad, 2/95-105. El Akhbar et Tiual, 194. El KAmilu i El Mubered, 3/182. Tarijkh Tabarij, 3/ 634-636. El Irshad, 63. Keshful Gummeh, 1/209. Es sijretu Halebijeh, 2/706-709. A'janu Shi'iah, 2/153 dhe 158 dhe 32/85. Fadailu Khamseh fi Sihahi Siteh, 2/333-336.

mposhtjen e padëshiruar në Bedër, Uhud dhe Hendek. U betuan që nuk do ta lejojnë Muhamedin të hyjë në Mekë ose do të shkatërrojnë edhe njeriun e fundit të tyre.

Myslimanët po digjeshin nga malli teksa shikonin Mekën dhe shpresonin në kryerjen e obligimit të haxhit dhe umres. Kur u erdhi lajmi se Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka parë në ëndërr dhe ëndrra e pejgambereve është e vërtetë se ata do të hyjnë në xhaminë e shenjtë ata ishin në xhami. Këtë ngjarje e pasoi zbritja e ajetit të bekuar: "Allahu ëndrrën e të Dërguarit të Vet e vërtetoi me realitet; se me vullnetin e Allahut do të hyni në xhaminë e shenjtë (në Qabe) të siguruar, të rruani flokët e kokave tuaja, t'i shkurtoni e nuk do të keni frikë! Pra Ai ka ditur atë që ju nuk e dinit, andaj para kësaj ju dha një fitore të shpejtë (Hajberin)"

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i mobilizoi shokët e tij për kryerjen e umres, nuk dëshironte luftë, kurse arabët dhe ata që ishin rrotull tij prej beduinëve u mobilizuan që të dilnin bashkë me të. Ai i frikësohej kurejshëve se mund ta pengonin atë të shkonte në Qabe dhe ta luftonin atë. Kështu pak nga arabët iu përgjigjën me ato që ishin prej muhaxhirëve dhe ensarëve, kurse flamuri ishte me Ali ibn Ebu Talibin *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe bashkë me të nxituan shtatëdhjetë njerëz, u vesh me veshjen e ihramit dhe iu përgjigj thirrjes së Allahut.

Idhujtarëve u erdhi lajmi për ardhjen e Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nga Medineja duke synuar Mekën, kështu që ranë në një mendim për ta bllokuar atë. Në kohën që myslimanët ishin në rrugë, panë nga larg ushtrinë e kurejshëve dhe aleatëve të tyre, kurse Pejgamberi i

urdhëroi shokët e tij që të merrnin rrugën djathtas dhe të zgjidhnin rrugën që do t'i çonte ata në Hudejbije, që ishte rreth nëntë milje nga Meka në krah të Xhiddes. Kur idhujtarët e panë pluhurin e ushtrisë së Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që devijoi rrugën, shkuan me nxitim te kurejshët duke i paralajmëruar ata, pastaj të gjithë dolën derisa arritën në ujërat e Hudejbijes. Bedil ibn Verka Elkhazaijju erdhi me një grup nga populli i tij tek Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe çalimi i myslimanit dhe i jobesimtarit ishte çliruese për të Dërguarin e Allahut dhe këshillë për të. Asgjë nuk i fshihej atij nga çështja e kurejshëvedhe për këtë tha se ne të kemi ardhur nga ana e kurejshëve dhe ty të janë mobilizuar Abisinët. Ata i janë bindur atyre bashkë me ata, mbrojtja me fëmijët e vegjël dhe janë betuar se nuk do të lënë ty dhe Mekën të bashkoheni derisa të shuash të gjallët e tyre. I Dërguari i Allahut tha: Me të vërtetë ne nuk kemi ardhur për të luftuar askënd, por kemi ardhur që të bëjmë tavafin në këtë shtëpi të shenjtëdhe kush tenton të na e ndalojë, do ta luftojmë atë. Bedili u kthye bashkë me ata që ishin tek kurejshët dhe u tha atyre: Me të vërtetë, ju nxitoheni me Muhamedin, me të vërtetë se ai nuk kishte ardhur për luftë, por kishte ardhur të vizitonte këtë shtëpi, por ata e akuzuan dhe e ofenduan me fjalë të rënda.

Ambasadorët u frekuentuan mes të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe kurejshëve, prej të cilëve ishte Othman ibn Afani dhe kur ai arriti tek kurejshët e mbajtën për tre ditë. I Dërguari i Allahut e mori lajmin se ata e kishin vrarë dhe tha: Nuk do të largohemi derisa të luftojmë popullin dhe i ftoi shokët e tij në marrëveshjen e luftës dhe mosdezertimin. Kjo marrëveshje e kënaqësisë, pranimit u mor

nën pemë ku Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mori besën dhe bën durim nga shokët e tij.

Othmani u kthye, por atë ndoqën përsëri lajmëtarët. Për paqe dhe pajtim në fund kurejshët dërguan Sehil ibn Amri me disa burra tek Pejgamberi dhe u bë marrëveshja në kushtet e paqes. Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thirri Ali ibn Ebu Talibin *(Paqja qoftë mbi të!)*që të shkruante marrëveshjen mes tij dhe kurejshëve dhe i tha atij: Shkruaj Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit dhe Suhejli tha: Allahun ne e njohim, kurse të Gjithëmëshirshmin dhe Mëshirëbërësin, ne nuk e njohim, prandaj hape atë libër me atë që ne e njohim dhe shkruaj: Me emrin tënd O Allah dhe Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* urdhëroi që të shkruhej ashtu. Kur shkroi se kjo është ajo që padit Muhamedi, i Dërguari i Allahut kërkoi Suhejl ibn Amrin dhe Suhejli tha: Po të përgjigjem ty për këtë, do të deklaroja profetësinë tënde, por shkruaj: Kjo është ajo që kanë rënë dakord Muhamed ibn Abdullahu dhe Suhejlin ibn Amrin. Pejgamberi i tha Aliut: Fshije atë që shkruante dhe shkruaj atë që ai dëshiron, Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*u vonua pastaj tha: Shpirti im nuk është aq bujar o i Dërguari i Allahut që të fshijë emrin tënd nga profecia, kurse Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: S'ka gjë, ma lër mua dhe ai e fshiu me dorën e tij dhe e urdhëroi atë që të shkruajë, Muhamedun ibn Abdullah, pastaj buzëqeshi dhe tha "Ti, o Ali do të helmohesh njësoj si ajo dhe do ta japësh" dhe është ai ka thënë "shkruaje atë sepse pa dyshim edhe ti do të kesh të njëjtën gjë do ta japësh kur ti të jesh tiran, persekutor".

Në fjalën e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kjo është një shenjë treguese e tij mes asaj që do të ndodhë me Aliun dhe Muavijen në dy grupe, pasi pa dyshim ata të dy kur bënë marrëveshjen e paqes mes tyre për lënien e luftës deri në fillim të vitit kanë shkruan: Kjo është ajo që prijësi i besimtarëve Ali ibn Ebu Talibi ra dakord me Muavijen ibn Ebu Sufjanin, kurse Muavija e kundërshtoi dhe Amru ibn Asi i tha shkruajtësit: Shkruaj emrin e tij dhe të babait të tij, kurse Ahnef ibn Kajsi tha: O prijësi i besimtarëve, mos e fshi emrin e prijësisë së besimtarëve, se me të vërtetë unë kam frikë se nëse e fshin atë, nuk do të kthehet kurrë më tek ti, prandaj mos iu përgjigj atyre në këtë.

Prijësi i besimtarëve tha: Allahu është më i Madhi vit pas viti, pasha Allahun kam kaluar nëpër duart e mia të njëjtën gjë si kjo ditën e hudejbijes, kur kurejshët u frenuan dhe e refuzuan që të shkruaj: Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* më tha: Shkruaj Muhamedi i biri Abdullahut, kurse ti do të kalosh të njëjtën situatë.

Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* shkroi kjo se kjo është marrëveshja që Muhamedi i biri i Abdullahut bëri me Suhejlin ibn Amrin, në të cilën ranë dakord për ndalimin e luftës për dhjetë vite. Në këtë mënyrë njerëzit do të jenë të sigurt dhe do ta linin të qetë njëri-tjetrin, pa vjedhje dhe pa mashtrime. Kush dëshiron të hyjë nën mbrojtjen e Muhamedit dhe marrëveshjes së tij le të hyjë dhe kush dëshiron të hyjë nën mbrojtjen e kurjeshëve dhe marrëveshjes së tyre le të hyjë. Kush vjen tek Muhamedi pa lejen e pronarit të tij, i kthehet mbrapa dhe cili prej shokëve të Muhamedit shkon te kurejshët nuk kthehet prapa. Muhamedi i tërheq bashkë me shokët e tij të gjithë dhe na mësyn duke pranuar shokët e tij,

zbaton tre gjëra, nuk futet me armë tjetër, përveç armës së udhëtarit dhe as shpata në afërsi.

Marrëveshjen e paqes e dëshmuan burra nga myslimanët dhe burra nga idhujtarët, Ebu Bekër ibn Kahafe, Omer ibn Khatabi, Abdurrahman ibn Aufi, Abdullah ibn Suhejli ibn Amri, Sa'd ibn Ebi Vakasi, Mahmud ibn Musel'leme, Muker'rez ibn Hafsi ibn Ahnefi dhe Ali ibn Ebu Talibi.



I PARI QË SHKULI PORTËN E NJË KALAJE DHE U MBROJT ME TË[1]

I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i mobilizoi ata që kishte rreth tij të cilët kishin qenë dëshmitarë të hudejbijes, për të luftuar khajberin dhe në këtë betejë. Ishin njëmijë e katërqind luftëtarë, kurse kalorësia kishte dyqind kalorës që erdhën, ata që mbetën prapa në marrëveshjen e hudejbijes dilnin bashkë me të në luftë por ai tha: Mos ejani me mua në luftë vetëm se me dëshirë, e sa i përket plaçkës së luftës, ju nuk do të merrni asgjë prej saj.

Kur Pejgamberi (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu afrua Khajberit, i urdhëroi njerëzit që të qëndronin, pastaj ngriti duart e tij nga qielli dhe tha: "O Allah, Zoti i shtatë qiejve dhe atyre qe ke nën hije, Zoti i shtatë tokave dhe çfarë ka në to dhe Zoti i shejtanëve dhe i atyre që i ke humbur. Unë të lutem Ty për të mirën e këtij vendi dhe të mirën

1 Dijuan Sejid El Humejri, 100-105. Es Sijretu Nebeuijeh i ibn Hisham, 2/334. Tabakat ibn Sa'ad, 2/ 110-112. Tarikh Tabarij, 3/10. El Irshad, 65-68. Hiljetul Eulija, 1/62. Tefsi Fakhri Razij, 21/91 El Kamilu i ibn El Ethijr, 2/139. Er Reudatul Mukhtarah, 84-98. Keshful Gummeh, 1/211. Dijuan El Busajrij, 21. Nihajetul Erb, i Nuejrij, 17/252-253. Ujunul Ethijr, 2/135. Tarikhul Khulefa i Sujutit, 176. Es Sijretul Halebijeh, 2/726-746. A'janu Shi'iah, 2/159-164. Hajatu Muhamed, 388. El Gadijr, 2/40-41. Fadailu Khamseh fi Sihahi Es Siteteh, 2/161-179.

që ka në të dhe mbrohem me Ty prej së keqes së saj dhe të keqes që ka në të: Pastaj tha: "Bëni përpara me emrin e Allahut dhe me begatinë e Allahut".

Në darkë zbriti në sheshin e Khajberit, por çifutët nuk lëvizën deri në lindje të diellit, hapën kështjellat dhe u nisën për në punët e tyre. Sapo e panë të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* , u kthyen me nxitim për në kështjellat e tyre duke thënë: "Muhamedi dhe ushtria".

Pejgamberi e rrethoi hajberin për njëzet e ca net dhe në të ishte flamuri i Aliut *(Paqja qoftë mbi të!).* Ai pati një lëndim të syrit që e pengoi për luftën, kurse myslimanët po përlesheshin me çifutët mes kështjellave dhe vendeve të tyre. Atë ditë hapën portën, kurse ata (çifutët) kishin hapur një hendek për veten e tyre sikur e kishin mësuar prej myslimanëve në kohën e luftës së aleatëve. Hendeku ishte i panjohur më parë tek arabët dhe burrat çifutë dolën që të përballeshin në luftë.

Të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e kishte kapur dhembje e kokës dhe dali para njerëzve, kështu që dërgoi Ebu Bekrin *(Paqja qoftë mbi të!)*me flamurin e tij. Ai shkoi, luftoi pastaj u kthye, por nuk e kishte çliruar. Pastaj dërgoi Omerin ibn Khatabin me flamurin, luftoi dhe u kthye, por edhe ai nuk e çliroi, pejgamberi u shqetësua dhe tha: "Nesër do t'ia jap flamurin një njeriu që e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij edhe Allahu dhe i Dërguari i Tij e duan atë, i vendosur e që nuk kthehet mbrapa e Allahu me dorën e tij do ta çlirojë".

Atë natë njerëzit fjetën duke menduar se cilit prej tyre do t'ia japë flamurin dhe kur u ngritën në sabah, shkuan tek i Dërguari i Allahut që të shikojnë se cili është ai njeri me fat dhe

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: Ku është Ali ibn Ebu Talibi? Ata thanë: Ai, o i Dërguari i Allahut po ankohet prej syrit dhe ai dërgoi te Aliu, Selleme ibn Akvea dhe erdhi Aliu hipur mbi një kafshë derisa u ul afër me kofshët e të Dërguarit të Allahut kur një skuqje kishte acaruar sytë e tij. Sel-leme tha: e solla atë duke e drejtuar nga Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i tha: Nga se ankohesh? Më djegin sytë e nuk mund të shikoj, kam edhe dhembje koke, ai i tha ulu dhe vëre kokën tënde mbi kofshën time. Pasi e bëri atë pejgamberi u lut për të dhe fryu në dorën e tij dhe i fshiu me to sytë dhe kokën e tij, në këtë moment sytë iu hapën dhe dhimbja e kokës i pushoi. Për këtë Hassan ibn Thabiti thotë:

Aliu kishte djegie sysh, po kërkonte një ilaç, por nuk nuk gjeti kurues. Atë e shëroi i Dërguari i Allahut me një fryrje të bekuar, ai u shërua duke qenë i shtrirë dhe u bekua në shkallë të lartë.

Flamurin do t'ia jap sot një guximtari që e do të Dërguarin dhe e mbron. Zoti e do atë që i çliron me të kështjellat e mëdha. Aliu bën drejtësi me ta pa përdorur ashpërsinë me të gjithë ata që e ka emërtuar si ministri vëllazërues.

Pastaj i dha atij flamurin dhe i tha: Shko me të, sepse Xhebraili është me ty, kurse fitorja është përpara teje dhe frika është futur në gjokset e atij populli. Dije mirë o Ali, se ata e gjejnë në librat e tyre, se ai që do t'i shkatërrojë ata e ka emrin (Ilija), prandaj kur t'i takosh ata, thuaju se unë jam Aliu dhe se ata në dashtë Allahu do të tradhtojnë. Prandaj shko në punën tënde derisa Allahu të hapë rrugët. Ai tha: Për çfarë t'i luftoj ata o i Dërguari i Allahut? Ai tha: Ftoi në islam dhe lajmëroi ata për detyrat që kanë ndaj Allahut, sepse Pasha Allahun, nëse Ai

drejton me ty një njeri të vetëm në rrugën e drejtë, është më e mirë për ty sesa begatitë prej floriri".

Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* u ngrit me flamurin dhe doli duke nxituar derisa fiksoi një grumbull gurësh poshtë kështjellës. Ndrësa çifutët e shikonin atë nga maja e kështjellës dhe thanë: Kush je ti? Ai tha: Unë jam Aliu. Çifutët thanë: Keni ngritur krye edhe në atë që i ka zbritur Musait.

I pari prej çifutëve që zbriti ishte Harith ibn Murhibi, i njohur për trimëri. Myslimanët u hapën dhe para qëndroi vetëm Aliut *(Paqja qoftë mbi të!).* Ata u përleshën dhe babai i Hasanit e vrau atë, të gjithë çifutët që ishin me të u mundën. Pastaj doli Murhib, drejtoi armën duke thënë një vjershë:

"Hajberi e ka ditur se unë jam Murhibu, specialisti i shpatës dhe heroi me eksperiencë. Ndonjëherë të shpoj e herë të godas fort dhe kur i afrohem luanëve ata marrin flakë".

Prijësi i besimtarëve i afrohet atij duke thënë:

Unë jam ai që nëna ime më ka quajtur 'luan'. Luan, luan dhe luan të fortë e mezi pres që me shpatën time t'ju shqyej e t'u bëj copash.

Kur u takuan babai i Hasanit menjëherë i dha një goditje prej luani, duke ia prerë për së gjati mburojën dhe zbriti në kokën e tij. helmetën ia çau me gurin që kishte poshtë çallmës duke ia ndarë kokën në dysh.

Kur Murhibi u vra, ata që ishin bashkë me të u kthyen në kështjellë dhe i mbyllën dyert, kurse Aliu shkoi tek dera dhe e godiste derisa e shkuli nga vendi. Kur e hapi myslimanët që nuk kishin kaluar bashkë me të ishin në anën tjetër të hendekut. Ai e mori portën e kështjellës që ta bënte si urë që të kalonin, të mësynin kështjellën dhe të merrnin plaçkën e luftës. Fakhru Razi në komentimin e tefsirit të ajetit ka thënë: "A mos mendove ti se

ata, të vendosurit e shpellës dhe Rekimit ishin nga mrekullitë Tona të çuditshme?"

Me të vërtetë ai i cili kishte më tepër njohuri për botën e së panjohurës, ishte me zemër më të fortë dhe më pak i dobët. Për këtë Ali ibn Ebu Talibi *(Allahu ia ndriçoftë fytyrën!)* ka thënë: "Pasha Allahun, unë nuk e shkula portën e khajberit me forcë trupore, por me forcë hyjnore". Kjo sepse Aliu *(Allahu ia ndriçoftë fytyrën)* në atë moment shikimi i tij u largua nga bota e trupave dhe erdhën meleket me dritat e botës së madhështisë që të forcojnë shpirtin e tij. Ajo iu përngjas me xhevahiret e shpirtrave prej meleku dhe shndritën në të dritat e botës së shenjtë, të madhështisë dhe nuk ka asnjë diskutim se mori një fuqi që Aliu nuk e kishte dhe askush veç tij nuk e kishte.

Xhabir ibn Abdullah Elensarijju ka thënë: Aliu e barti portën mbi shpinën e tij ditën e haberit, derisa myslimanët u ngjitën mbi të dhe e çliruan kështjellën, më pas ata e tërhoqën dhe nuk e bartën vetëm se dyzet burra.

Nga Ebu Rafiu transmetohet se ka thënë: Me të vërtetë Aliu e mori portën e kështjellës së haberit dhe e bëri si mburojë për veten e tij. Ai vazhdonte ta mbante në dorën e tij duke luftuar, derisa Allahu na dha suksesin. Ne tetë burrav u përpoqëm që ta rrokim atë derë, por nuk e rrokëm dot.



I PARI QË KA HIPUR MBI SUPET E PEJGAMBERIT

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)

DHE QË KA THYER STATUJAT[1]

Ngjitja e Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)* mbi supet e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte me qëllim thyerjen e statujave, dy herë në dy kohë të ndryshme:

Ngjitja e parë ishte pak para shpërnguljes së Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* më saktë natën kur imam Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*fjeti në shtratin e Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata që e kanë nxjerrë hadithin janë imam Ahmed ibn Hanbeli në senedin e tij, Nisaijju në dallimet e tij, Ebu Ja'la në senedin e tij, Hakimi në perceptimin e tij, Mutteki Elhindi në thesarin e punëtorëve dhe Khatib Elbagdadi në historia e Bagdadit, e të tjerë.

Në përmbledhjen e tregimit për imam Aliun *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*thuhet: Atë natë që i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe*

1 Dijuan Sejjid El Humejrij, 77. Tarikhu Bagdad, i Khatijb El Bagdadij, 13/302. Tefsir El Keshaf i Zamakhsherij, 2/688. El Menakib i ibn Shehr Ashub, 2/135-142. Keshful Gumeh 1/79. Dhekhairul Ukba, 85.Es Sijretul Halebijeh, 3/29-30. Jenabiul Meudeh, 164, kap. 48. A'janu Shiah, 3/149. Delailu Sidk, 2/294. El Gadijru, 3/353. Er Reudatul Mukhtarah, 105.

bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) më urdhëroi mua që të flija në shtratin e tij, i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* bashkë me mua shkoi tek statujat dhe tha: Ulu, dhe unë u ula në anë të Qabesë, pastaj u ngjit mbi supet e mia dhe tha: Çohu dhe unë u çova dhe kur ai e vuri re dobësinë time, tha: Ulu dhe unë u ula, zbriti nga unë dhe u ul afër meje, pastaj tha: Ngjitu dhe unë u ngjita mbi supet e tij, pastaj ai më ngriti mua dhe mu bë sikur po të doja do ta kisha prekur qiellin dhe unë u ngjita në Qabe, mbi të ishte një statujë prej tunxhi ose bakri dhe nisa ta lëviz atë sa majtas djathtas dhe para-mbrapa. I Dërguari i Allahut thotë: "Oh oh, derisa unë nuk mundesha dot më dhe më tha mua: Hidhe atë dhe unë e hodha. Kur ajo u thye ashtu siç thyhen enët e qelqit zbrita dhe u larguam bashkë me të Dërguarin e Allahut duke garuar shpejt derisa u fshehëm nëpër shtëpitë nga frika se mos na shihte ndokush.

Ngjitja e dytë ishte në çlirimin e Mekës dhe në transmetimin e këtij hadithi ka disa ndryshime në mënyrën e të shprehurit, emrat e statujës dhe kontributet. Një herë është statuja, kurse herë tjetër është një shpend që quhet hebel, prandaj mjaftohemi me dy transmetime që i përfaqësojnë të gjitha të tjerat:

Zamkhasherijju në librin Zbulesat ka thënë: Rreth shtëpisë (Qabesë) ka pasur treqind e gjashtëdhjetë statuja, puta, një statujë për çdo popull, sipas imagjinatës së tyre. Ibn Abbasi *(Paqja qoftë mbi të!)*ka thënë: Për ato statuja, fiset arabe bënin haxhin dhe thernin kurban, për to dhe shtëpia iu ankua Allahut *(xh.sh)* dhe tha: O Zot, deri kur do të adhurohen këto statuja në vendin Tënd? Allahu e frymëzoi shtëpinë: Me të vërtetë, Unë do të bëj që të ndodhin ty ndryshime të reja dhe do të mbush me njerëz që bëjnë sexhde dhe që vijnë tek ti me një ecje të lehtë si skifteri, që sillen

rrotull teje si shpendi rrotull vezëve të saj. Do të kenë një zhurmë, gumëzhitje rreth teje me telbije, pastaj Zamkhasherijju ka thënë: "ankimi i shtëpisë dhe frymëzimi i saj është një shëmbëllim dhe një imagjinatë:.

Kur zbriti ajeti: "Dhe thuaj: "Erdhi e vërteta dhe u zhduk e kota". Vërtet, e kota gjithnjë ka qenë e zhdukur" ditën e çlirimit, Xhebraili *(a.s)* i tha të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, merre shkopin tënd dhe rrëzoi putat. Ai filloi ti afrohej putave njëri pas tjetrit dhe sikur ai i fliste shkopit të tij e çonte duke thënë "erdhi e vërteta dhe u zhduk e kota". I përmbysi statujat derisa i rrëzoi të gjitha, por mbeti vetëm statuja e huzasë sipër Qabesë dhe në të ishte një enë prej tunxhi dhe tha: "O Ali, rrëzoje atë dhe i Dërguari i Allahut e barti derisa u ngjit dhe e hodhi e ajo u thye. Populli i Mekës u habit duke thënë: Nuk kemi parë njeri më magjistar se sa Muhamedi".

Ka transmetuar ibn Shehri Ashubi tek libri Virtytet nga Ebu Hurejre atë që përmblidhet në të duke thënë: Më ka thënë mua Xhabir ibn Abdullah el-Ensarijju: "Hymë në Meke bashkë me Pejgamberin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kurse në Qabe dhe rrotull saj kishte treqind e gjashtëdhjetë puta dhe Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dha urdhër që të hiqeshin dhe të përmbyseshin të gjitha, kurse sipër Qabes ishte një statujë e gjatë që quhej: hebel, Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e pa Aliun dhe i tha atij: o Ali, a do hipësh ti sipër meje apo të hipi unë mbi ty që të rrëzojmë hebelin nga shpina e Qabes?

Aliu tha: Hip ti mbi shpinën time, o i Dërguari i Allahut dhe sapo u ngrit mbi shpinën e tij, Aliu nuk mundi që ta mbante

atë prej peshës së mesazhit dhe tha: Po hipi unë mbi shpinën tënde, o i Dërguari i Allahut. Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* buzëqeshi dhe barti atë derisa u ngjit në majë të Qabes, e rrëzoi në tokë hebelin, kurse Allahu *(xh.sh)* zbriti ajetin: "Erdhi e vërteta dhe u zhduk e kota. Vërtet, e kota ka qenë e zhdukur".

Mes dy haditheve ka pasur shumë konfuzion dhe përputhje, mirëpo rezultati është vetëm një, i cili është se Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*është ngjitur në të dyja herët mbi shpinën e Pejgamberit dhe ka thyer putat.



NGA TË VENDOSURIT E PARË BASHKË ME PEJGAMBERIN

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)

DITËN E HUNEJNIT[1]

Kur Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e çliroi Mekën e bekuar dhe myslimanët ishin në mes të gëzimeve për triumfin, lajmet e vazhdueshme për bashkimin e fiseve Hevazin dhe Thekif në luginën e Hunejnit vazhdonin të vinin. Ata pritën për të sulmuar myslimanët para se ata të zgjoheshin nga dehja e triumfit, kjo për shkak të indinjatës së tyre për putat e tyre të cilat myslimanët i thyen në Mekë, të cilat i thyen me qëllim që ata të mos surprizohen, ashtu siç i surprizuan kurejshët në shtëpitë e tyre.

Pesëmbëdhjetë ditë pas çlirimit të Mekës, i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përgatiti çdo gjë që duhej për luftimin e Hevazinit dhe Thekifit në vendin e grumbullimit të tyre. Nga Safvan ibn Umejje mori një hua të garantuar e të kthyeshme njëqind mburoja dhe

1 Siretu ibn Hisham, 2/442-445. Tabakat ibn Sa'ad, 2/150-151. El Mearif i ibn Kutejbeh, 164. El Akdul Ferijd, 5/98. El Irshad, 74. El Istiab, 3/1090. Mexhamul Bejan fi tefsiril Kur'an, vëll. 3, xhuzi 10, f. 38-39. El Menakib i in Shehr Ashub, 2/84. Sherh Nehxhul Belaga, i ibn Ebi Hadijd, 10/179 dhe 182. Es sijretul Halebijeh, 3/67. A'janu Shiah, 2/186-190. Ijdul Gadijr, 97-100. Fadailu Khamseh fi Sihahi Siteh, 2/326.

doli nga Meka me dymbëdhjetë mijë luftëtarë. Dymijë prej tyre ishin nga ata që u bënë myslimanë në ditën e çlirimit, kurse pjesa tjetër prej dhjetëmijë vetash ishin shokët me të cilët Allahu çliroi Qaben e shenjtë.

Flamurin e tij më të madh ia dha Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe urdhëroi të gjithë ata që hynë në Mekë që të mbanin nga një flamur. Kurse dy kryetarët e fiseve Hevazinët dhe Thekifët u mblodhën tek Malik ibn Aufi dhe morën bashkë me ta pasuritë e tyre. Gratë dhe fëmijët e tyre zbritën në Eutas, kurse Derid ibn Samme poeti i shquar persian ishe në popull. Ai ishte i moshuar dhe i kishte ikur shikimi prej pleqërisë. Atë e sollën për t'i marrë mendimin e tij dhe për të përfituar nga eksperiencat e tij, ai u tha atyre: Në cilën luginë jeni ju? Ata thanë: Në luginën e Eutasit, ai tha: Vendi më i mirë për kuajt, nuk është i vështirë për dhëmballët por as i lehtë për t'u kaluar. Po pse po dëgjoj hungërimën e devesë, pëllitjen e gomarëve, palljen e lopëve, blegërimën e dhenve edhe qarjen e fëmijëve? Ata thanë: Me të vërtetë Malik ibn Aufi ka marrë bashkë me njerëzit, fëmijët dhe pasuritë, gratë dhe fëmijët që gjithsecili prej tyre të luftojë me familjen dhe pasurinë e tij, Deridi tha: Bari dhensh, pasha Zotin e Qabesë, më sillni Malikun këtu dhe kur ai erdhi tha: O Malik, ti je kryetari i popullit tënd dhe kjo është një ditë që nuk ka kthim pas, ktheje mbrapa popullin tënd në vendet e tyre më të larta, nxirri burrat hipur mbi shpinat e kuajve sepse me të vërtetë ty nuk do të bëjë dobi, Vetëm një burrë me shpatën dhe kalin e tij, nëse janë me ty do të të vijnë pas e nëse janë kundër teje, do të poshtërosh veten para popullit dhe familjes tënde. Kurse Maliku i tha: "Me të vërtetë se ti je plakur shumë, të ka ikur dituria dhe logjika".

I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* pasi fali namazin e sabahut, zbriti në një

sulm të befasishëm me ata njerëz që kishte në një luginë të gjerë dhe shumë të pjerrët. Mirëpo idhujtarët kishin shkuar para tyre në luginë dhe ishin fshehur në shtigjet dhe ngushticat e luginës. Ata ishin përgatitur që t'u bënin pritë dhe i frikësuan shokët e Pejgamberit *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)*, pasi ata ishin në përgjumjen e sabahut, batalione duke i sulmuar nga çdo anë dhe mundën benu Sulejmet të cilët ishin në pararojë të ushtrisë së Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Njerëzit u bënë gati të ktheheshin prapa duke mos e pritur njëri-tjetrin, kurse Allahu *(xh.sh)* i ndau mes myslimanëve dhe armikut të tyre që t'i bëjë ata (myslimanët) të kënaqen me numrin e tyre të madh. Thënia e tyre "me të vërtetë ne fitojmë prej numrit të madh në njerëz".

Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja qoftë mbi të!)* po luftonte kur Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u anua nga krahu i djathtë. Afër tij kaluan të mundurit duke mos iu bindur asgjëje, kurse Abbasi ibn Abdul Muttalib kishte kapur frerët e mushkës së të Dërguarit të Allahut dhe bashkë me të ishin disa burra prej beni-Hashimëve. Kur Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha xhaxhait të tij, Abbasiti cili ishte esencial dhe me reputacion të lartë: Ngjitu, o xhaxha në këtë vend të lartë dhe thërrit: O ju muhaxhirunë dhe ensarë, o njerëzit e sures El Bekare, o popull i marrjes së premtimit te pema, për ku po largoheni? Kujtoni premtimin të cilin ia keni dhënë të Dërguarit të Allahut.

Sapo myslimanët e dëgjuan zërin e Abbasit, u penduan dhe u rikthyen njëri pas tjetrit derisa erdhën të gjithë, pastaj i vunë përpara idhujtarët. Një njeri i hipur mbi një deve të kuqe prej Havazinëve kur erdhi mbante në dorën e tij një flamur të zi i vendosur në kokën e një heshte të gjatë. Nëse fitoren e merrnin

myslimanët do të bashkohej me ta dhe nëse njerëzit nuk e shihnin, ngrinte flamurin e atyre që kishte prapa tij prej idhujtarëve që e ndiqnin. Këtë ai e përshkroi me një poezi:

"Unë jam Ebu Xhedveli që ndëshkoj rëndë derisa të pëlqejë populli apo të pëlqehemi
Populli e ka mësuar që herët se unë jam në luftë dhe ai që e kulloj gjakun
Por atij i doli përballë prijësi i besimtarëve dhe e goditi me lakun e devesë së tij, e rrëzoi përtokë, pastaj e goditi përsëri, e bën të pikojë gjak, duke thënë një vjershë:
Populli e mësoi që herët se unë jam ai që në luftë e kulloj gjakun".

Idhujtarët u shkatërruan me vrasjen e Ebu Xhedvelit, ndërsa myslimanët u mblodhën grumbull dhe ngritën supet e tyre. I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "o Zoti im, unë e bëra të parin e kurejshëve të shijojë ndëshkim, Ti o Allah, shijoja të fundit të tyre drejtësinë, mirësinë". Dy grupet u përleshën kur shumë shpejt idhujtarët ikën nga sytë këmbët, ata i sollën të Dërguarit të Allahut robërit e luftës të lidhur dhe Allahu i Madhërueshëm zbriti mbi Pejgamberin e Tij të nderuar: "Nuk ka dyshim se Allahu ju ka ndihmuar juve në shumë beteja, e edhe në ditën e Hunejnit, kur juve ju mahnit numri juaj i madh, i cili nuk ju vlejti asgjë dhe me gjerësinë e saj që e kishte toka u ngushtua për ju, pastaj ju u zmbrapsët. Pastaj Allahu zbriti qetësinë e Vet në të Dërguarin e Tij dhe në besimtarë, zbriti një ushtri që ju nuk e patë, i dënoi ata që mohuan, e ai ishte ndëshkim ndaj jobesimtarëve. Allahu pastaj i fal atij që do. Allahu fal shumë dhe mëshiron shumë".

Transmetimet për numrin e atyre që qëndruan bashkë me të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe*

mbi familjen e tij!) në ditën e Hunejnit kanë qenë të ndryshme. Shumica e atyre që është janë se ata kanë qenë katërqind vetë dhe numri më i vogël që është thënë për ta është katër vetë. Ajo që mbështesin më shumë historianët është se ata kanë qenë mes shtatë dhe katërmbëdhjetë burrave. Pjesa më e madhe apo të gjithë prej Beni-hashimitëve i ndiqte Ejmen ibn Ummu Ejmeni dhe është thënë: Bashkë me ta ishte Ebu Bekr Siddiku dhe Omer ibn Khatabi, kurse në një transmetim tjetër Usame ibn Zejdi ibn Harithe ka qenë bashkë me ta. Sado të shumta të jenë transmetimet për këtë dhe të ndryshojnë në përcaktimin e numrit dhe përcaktimit të emrave. Pa dyshim ato janë dakord se imam Aliu ka qenë në krye të atyre që qëndruan të vendosur, ai ishte luftëtari veç të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Disa historianë kanë thënë se të mundurit nuk janë kthyer vetëm se pasi erdhi triumfi i Allahut, ata i sollën të lidhur robërit e luftës së Hauazit dhe Thekifit.

Me'mun ibn Haruni Rreshidi gjatë debatit me dijetarët lidhur me pararojën e Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*duke e drejtuar bisedën e tij te Is'hak ibn Ibrahimi, në prezencë të gjykatësit të gjykatësve Jahja ibn Ekther ka thënë: Më fol mua për fjalën e Tij *(xh.sh)*: "e edhe në ditën e Hunejnit, kur juve ju mahnit numri juaj i madh "deri te fjala e Tij *(xh.sh)*"pastaj Allahu zbriti qetësinë e Vet në të Dërguarin e Tij dhe te besimtarët". A e din ti se cilët janë besimtarët për të cilët Allahu flet në këtë pikë? Ai tha: Nuk e di, tha: Të gjithë njerëzit në ditën e Hunejnit u mposhtën dhe askush nuk mbeti me të Dërguarin e Allahut përveç shtatë personave që ishin prej benu hashimitëve, Aliu që godet me shpatën e tij para të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe Abbasi i cili kishte kapur për frerësh mushkën e të Dërguarit të Allahut. Pesë të tjerë ishin rrotull tij nga

frika se mos merrte ndonjë plagë prej atyre, derisa Allahu i dha të Dërguarit të Tij triumfin e besimtarëve, në këtë pikë: Në mënyrë të veçantë Aliu, pastaj ata që ishin me të prej benu-hashimitëve.

Ibn Ebu Hadidi duke komentuar fjalën e prijësit të besimtarëve *(Paqja qoftë mbi të!)*ka thënë: Shokët që ruanin Muhamedin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e dinë shumë mirë se vërtetë unë nuk e kam kundërshtuar Allahun dhe të Dërguarin e tij, kurrë asnjë moment. E kam mbështetur atë me veten time kudo, në vendet ku heronjtë e tjerë tërhiqen dhe këmbët nuk shkojnë dot, në mënyrë befasuese Allahu më ka nderuar.

Pasi tregoi për pozicionet e imamit në Bedër, Uhud dhe Hajber, tha se sa i përket ditës së Hunejnit me të kanë qëndruar vetëm një numër i vogël prej beni-hashimitëve, pasi myslimanët e tjerë u kthyen prapa. Aliu e mbrojti dhe vrau shumë prej Havazinëve para tij (Pejgamberit) derisa ensarët erdhën dhe e mbështetën dhe kështu u mposhtën Havazinët dhe ata përfituan pasuritë e tyre.

Abbasi ibn Abdul Muttalib kanë argumente se ata që qëndruan në atë ditë janë tetë, shtatë prej beni-hashimitëve, kurse i teti ishte Ejmen ibn Ummu Ejmeni i cili ra dëshmor duke mbrojtur të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*:

Të Dërguarin e Allahut në luftë e mbrojtën shtatë veta dhe ai që iku prej tyre dhe u copëtua

Kurse i teti prej nesh e takoi vetë pëllumbin sapo ai e preku, për Allahun dhembje nuk gjeti.



I PARI DJALË I RI NË ISLAM[1]

(Elfeta) në gjuhë do të thotë djali i ri, zemërgjeri bujar, kurse (elfutuve) rrjedh nga fjala (feta), njësoj si fjala burrëri nga fjala burrë dhe ajo do të thotë: bujari, zemërgjerësi, burrëri, njeri i përsosur, liri dhe virtyte të larta.

(Elfutuve) në traditën, praktikën islamike, mbi të cilën është ndërtuar themeli i rregullit të djalërisë, janë një grup cilësish të larta me të cilat duhet të karakterizohet djali, si trimëria, zemërgjerësia, altruizmi, sinqeriteti, mbajtja e fjalës, turpi, ndjekja e të vërtetës, të ndihmuarit e familjes së tij, të ndihmuarit e atij në nevojë, mbrojtja e grave dhe jetimëve, adhurimi i sinqertë i Allahut *(xh.sh)*. Por ajo ka edhe shumë përkufizime të tjera, sipas ndryshimit dhe animimit të përkufizuesve.

Kështu për shembull sufitët e kanë parë atë me lupën e asketizmit dhe mirësjelljes dhe moralit shpirtëror, kurse të tjerë e kanë parë atë me lupën e jetës shoqërore dhe kanë thënë: (elfutuv-vetu) (gjeneroziteti, adoleshenti) është që t'i japësh vëllait tënd nga pasuria e shpirtit tënd dhe të mos lakmosh në pasurinë e tij.

1 Es Sijretu en Nebeuijetu i ibn Hisham, 2/100. Tarijkh Tabarij, 2/514. Fehrest i ibn En Nedijm, 98. Muhaderatu Ragib, 1/301. Sherh Nehxhul Blaga, i ibn Ebi Hadijd, 1/59 dhe 14/250. Xhamiu Esrar ue Menbeul Enuar, 231. Rihletu ibn Batutah, 293. Keshful Istilahatul Funun i Et Tehanunj, 2/1156. El Aleuijattul Ishrun, 81. El Gadijr, 2/59-61 dhe 4/315. Fi Turathil Arabij i doktor Mustafa Xheuad, 26-28 dhe 219-226. Mexheletul Mexhmaul Alemij el Irakij, 5/46-81.

Të ndash në mënyrë të barabartë dhe të mos kërkosh prej tij barazi, të jesh i përmbajtur dhe të mos e braktisësh atë.

Kurse në traditën profetike, në të janë përmendur lajme, një pjesë të tyre e ka transmetuar imam Ebu Abdullah Xha'ferr Essadiku nga të parët e tij nga i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: Djemtë, adoleshentët e ymetit tim do të kenë dhjetë shenja, që janë fjala e sinqertë, mbajtja e premtimit, kryerja e amanetit, lënia e gënjeshtrës, mëshira me jetimin, dhënia ndaj lypësit, të shpenzuarit e mirësisë, përfitimit, shtimi i veprave të mira, respektimi i mikut dhe në krye të tyre është turpi.

Imam Xha'ferr Es Sadiku ka thënë: Elfutuv-vetu është burrëria, një ushqim i shtruar, një mirësi e shpenzuar, një njeri i pranuar, një i virtytshëm i njohur dhe e keqe e verbër.
Shejkh Muhamed ibn Ebu Mekarimi, i njohur si ibn Ma'rufi i ibn Mi'marit el-Hanbelij el Bagdadi ka thënë: (elfutuv-vetu) në traditën e praktikës janë cilësi të lavdërueshme që përshkruhet një person për një specifikë dhe është dalluar me to prej bijve të nacionalitetit të tij, kështu që emri "feta"(djalë, adoleshent) i takon atij dhe këtë e dëshmon fjala e Allahut të Lartësuar për shokët e shpellës: **Kur disa djelmosha u strehuan në shpellë dhe thanë: "O Zotiynë, na jep mëshirë nga ana Jote dhe përgatitna për sjellje të drejtë!"**[1]

Tehanivijju tek "*Keshful Istilahatul Funun*" ka thënë se adoleshenca tek praktikuesit është ndalimi ndaj lëndimit, të keqes, të shpenzuarit për atë që ka nevojë dhe lënia e ankimit mënjanë dhe ato tek njerëzit e tefsirit është kundërshtimi i pasionit.

1 Sure Kehf, ajeti 13.

Amali tek sekretet universale ka thënë se atributi i sekretit të ruajtjes ndaj pjesës së grisur është si atributi i petkut të devotshmërisë për devotshmërinë, sipas fjalës së Tij: **"...si edhe për zbukurim; por, petku i devotshmërisë është më i miri..."**[1]

Është e ditur se devotshmëria nuk ka rroba, petk dhe po kështu edhe gjendja e adoleshencës lidhur me prijësin e besimtarëve Aliun *(Paqja qoftë mbi të!),* sepse ato janë gjithashtu çështje abstrakte, jo konkrete.

Mjaftohemi me kaq për sa u tha në përkufizimin e adoleshencës që është një numër i vogël shtese dhe adoleshencës. Sipas ndryshimit të përkufizimeve të tyre ato janë rryma islamike fetare dhe shoqërore ku janë zhvilluar mposhtjet e rrymave të tjera dhe përçarja e anëtarëve në parti dhe grupe, prej tyre janë: profetike, miqësore, sipas vendit të lindjes, çështjes së jashtëzakonshme, ngjarjeve. Secili grup pohon se rinia, adoleshenca e saj është e vërteta dhe që të gjithë e mbështesin atë zinxhirin transmetues tek prijësi i besimtarëve Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja qoftë mbi të!).*

Djemtë, kështu nisën të vishnin rroba që i dallonin nga të tjerët dhe veshjet më të famshme të tyre ishin pantallona që njiheshin si pantallonat e adoleshencës, një rrip që shtrëngonte mesin e djalit kur ai arrinte moshën e adoleshencës.

Adoleshenca, në fundet e shekullit të pestë të hixhretit është përballur me një përmbysje të frikshme, ku anëtarët e tyre janë dëbuar dhe çështja është refuzuar nga kalifati Abbasij dhe sulltan Selxhukij për shfarosjen dhe detyrimin e tyre. Për t'u kthyer nga rryma e tyre në adoleshencë, mirëpo ata u çuan dhe nuk i dhanë rëndësi burgosjes, dëbimit dhe vrasjes. Qëndruan derisa furtuna u qetësua dhe rinia përgatiti fuqinë e saj dhe u

1 Sure A'raf, ajeti 26.

aktivizua në vitin 563 të hixhretit. Ajo lëvizje nisi të rritet derisa kalifati përfundoi tek imami mbrojtës i fesë së Allahut në vitin 575 të hixhretit dhe pa se në ç'gjendje të dobët dhe sa e përçarë ishte bota islame. Me grindje dhe forcim të forcës së kryqtarëve mendoi se bota islame ka nevojë për një rregull, sistem që ta unifikojë atë dhe përdori instrumentin gjithëpërfshirës dhe shërues. E përdori në mënyrën më të mirë dhe nëpërmjet tyre arriti që të përgatisë një brez të fortë e guximtar, i armatosur me forcën e besimit dhe me shembullin më të lartë, luftëtar në rrugë të Allahut i cili dashuron martirizimin, për të ngritur lart fjalën e vërtetë.

Fillimi i zhvillimit të Nasiru Dinil-lahit në rregullin e adoleshencës u bë në vitin pesëqind e shtatëdhjetë e tetë kur në atë kohë i vjen shehu i rinisë, i cili quhej Abdul Xhebbar ibn Jusufi ibn Salihi dhe bashkë me të ishte edhe djali i tij Shemsudini dhe dhëndëri i tij Jusuf Ikabi. Kalifi veshi pantallonat e rinisë me ardhjen e shokëve të tij dhe shehu e lajmëroi atë se ai i ka veshur ato me kohë pastaj u plotësua nga prijësi i besimtarëve Ali ibn Ebu Talibi *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij).*

Në vitin 602 të hixhretit, kalifi Nasirudinil-lah, urdhëroi me prishjen e të gjitha dallimeve të vjetra rinore dhe formimin e rinisë së tij të vetme. Kështu që i fshiu të gjitha armiqësitë që ndodhnin mes grupeve kohë pas kohe dhe kalifët Abisinitë e ndoqën gjurmën e tij, të cilët erdhën pas imamit Nasirudinil-lah në kujdesin e rinisë dhe projektimin e saj.

Ndihmëtari i Allahut, nipi i Nasirudinil-lahit donte që të ngrihej lart mbi një mbështetje të lartë në rini, adoleshencë dhe kryetari Xhelalud-din Abdullah ibn Mukhtari, aleviti nga Kufeja, ia zbukuroi atij që të vishte menjëherë pantallonat e rinisë së prijësit të besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibit. Pa ndërmjetës i dha atij fetvanë, mendimin se lejohet, kurse kalifi iu drejtua Nexhefit të

bekuar dhe veshi pantallonat në brendësi të vendit të shenjtë, tek varri.

Mirëpo rënia e shtetit Abbasit pas kësaj shkaktoi një stanjacion në çështjen e rinisë në Irak, pastaj u shfaq kafshimi i ndaluar nën hijen e shtetit Abbasit në Egjipt dhe çështja e saj shkoi në periudhën e mbretërive në Egjipt dhe Sham, por çështja në Irak është e kundërta e saj.

(Elfutuv-vetu), (rryma që zhvillon moralin e guximit tek rinia), u përhap në vendet romake dhe në Azinë e vogël që në ditët e kalifatit të Nasirudinil-lah dhe vazhdoi të fuqizohej. Ibn Betuta ka thënë se nomadi i njohur kur ka përmendur qytetin (Kunija) zbritëm në cep të kadiut të sajibn Kasimi Shahiti cili ishte prej adoleshentëve, e që kishte një grup të madh nxënësish. Ata për adoleshencën kishin një sened të lidhur me prijësin e besimtarëve Ali ibn Ebu Talibin *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe rrobat e tyre që mbuloheshin, ishin pantallonat ashtu siç mbulohet arna.

Në mbështetjen e adoleshencës tek prijësi i besimtarëve Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*për të qenit e tij, themeluesi i saj, ka disa shkaqe, ku vetëm tre prej tyre janë më të rëndësishme:

- Përmbajtja e tij e të gjitha cilësive shembullore që njerëzit e mendonin për njeriun e përsosur pas Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe aftësia e tij me përshkrimin e atyre cilësive të larta në fjalimet, mesazhet e tij, fjalët e urta, lutjet e tij dhe dialogu i tij në mënyrën më shkëlqyer pastaj shpalosja e tyre e mishëruar në të gjitha veprimet e tij.
- Veçimi me hadithet e shumta profetike të shqiptuara me mirësine e tij, derisa ka transmetuar ibn Nedimi nga Vakidijju, ky nga Sehmu ibn Eslemi se Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*ishte prej mrekullive të Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*

dhe mbi familjen e tij!), ashtu siç ishte shkopi për Musanë *(a.s)* dhe ringjallja e të vdekurve për Isanë, të birin e Merjemes.

- Ajo që kanë transmetuar historianët si Taberijju, ibn Hishami dhe ibn Ebu Hadidi e të tjerë se ai *(Paqja qoftë mbi të!),* ka qenë autori i rolit të kryetarit në ruajtjen e bardhësisë së islamit ditën e Uhudit. Pasi ai vrau shtatë mbajtësit e flamurit të idhujtarëve prej fisit beni-abdu dari dhe kur erdhi mposhtja e padëshiruar e myslimanëve për shkak të kundërshtimit të urdhrave të Pejgamberit nga harkëtarët, Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*ishte në krye të asaj pakice që qëndruan me të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kur njësitë e idhujtarëve e lakmuan të Dërguarin e Allahut u orvatën që ta vrasin atë. Ai ishte i vetmi mbrojtës i Pejgamberit, që e largoi rrezikun para tij duke iu përgjigjur atyre njësive njëra pas tjetrës, e ata duke u tërhequr kur shikonin të vrarët prej shokëve të tyre.

Xhebraili *(a.s)* ka thënë: O i Dërguari i Allahut: Me të vërtetë kjo është ngushëlluese, kurse Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: Me të vërtetë ai është prej meje dhe unë jam prej atij, kurse Xhebraili tha: Edhe unë jam prej ju të dyve.



KADIU (GJYKATËSI) I PARË NË ISLAM[1]

I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* caktoi tre gjykatës dhe asnjë tjetër veç tyre. Caktimi i tyre në mënyrë të veçantë ishte në Jemen në periudha të ndryshme.

I pari prej i tyre ka qenë Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja qoftë mbi të!),* i cili kur ka folur për veten e tij ka thënë: I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* më caktoi mua kadi në Jemen dhe unë thashë: O i Dërguari i Allahut, ti po më dërgon mua atje, por unë jam i ri në moshë, nuk kam asnjë njohuri në gjykim, por ai tha: Shko se Allahu do ta udhëzojë zemrën dhe do ta forcojë gjuhën tënde. Nëse ulesh me dy njerëzit që kanë konflikt, ti dëgjo prej tij të dytit, ashtu siç dëgjove nga i pari, kështu që vendos, nuk ke më dyshim në gjykim më pas.

1 Deijvanu Sejjid Humejir /76. Ujunul Akhbari i ibn Kutjebe 2/69. Akhbarul Kada i Uekiut 1/84-91 dhe 100-101. Tarikhu Tabari 2/131,132. El Besairu ue Dhakhairu 3/79. El Irshadu 105-120. El Istiabu 3/1100-1102. Dijvanu hajsi ue bejsi 3/416. El Menakibu i ibn Shehri Ashub 3/ 352-388. El Kamilu i ibn Ethir 2/205. En Nihajetu i ibn Ethir 4/40. Usdul Gabe 4/376,377. Dhekhairul Ukba /83,84. Mukhteseru Tarikh i ibn Kazerunij /56. El Mukhtesiru fi Akhbaril Besher 1/182. A'janu Shi-ia 3/k1/256-260 dhe 276-279. El Abkarijjatu /740,741. Fadailu Khamseh fi Sihahi Es Siteh, 2/260-308. En Nudhumul islamijjeh /319.

Për këtë është konsensusi i transmetuesve, përveç njërit që është përmendur nga Ebu Refiu dhe ka thënë: Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e dërgoi Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)* në Jemen që të punonte atje ose të bëhej kadi. I fërkoi gjoksin e tij dhe tha: O Allah, udhëzoje zemrën dhe bëje të mprehtë gjuhën e tij, jepi atij kuptimin e asaj çështjeje që vijnë tek ai si konflikt.

Por, askush nga historianët nuk na ka lajmëruar për periudhën e aktivizimit të tij si kadi në Jemen. Çështjet e shumta që ai ka gjykuar atje na tregojnë se ai ka ndenjur atje për një kohë të gjatë.

Kur Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e kuptoi se detyra e Aliut përfundoi dhe se prezenca e tij në Jemen për xhihad (luftën në rrugë të Allahut) është më e mirë për islamin, e thirri atë dhe në vend të tij caktoi kadiun e dytë Muadh ibn Xhebel. Pas një periudhe kohe caktoi kadiun e tretë, Ebu Musa Elesh'arijju edhe pse aty ishte prezent Muadh ibn Xhebel. Secilit prej tyre u caktoi zona të ndryshme që të bëjë punën e tyre. I këshilloi ata që t'i lehtësojnë dhe të mos i vështirësojnë çështjet, të jenë bashkëpunues dhe të mos të kënë konflikte, të vizitonin njëri-tjetrin dhe mos të ndërhynin në punën e njëri-tjerit.

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e ka dërguar Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*tre herë në Jemen: Herën e parë e dërgoi atë si kadi, kjo ka ndodhur pas ngjarjes së Hunejnit, mes viteve tetë dhe nëntë të hixhretit.

Herën e dytë e dërgoi në fillimet e vitit të dhjetë të hixhretit dhe në atë kohë kishte dërguar tek populli i Jemenit Khalid ibn Velidin që t'i ftonte ata në islam. Ai qëndroi në mesin e tyre

gjashtë muaj, e askush nuk iu përgjigj atij në asgjë. Pas tij, dërgoi Aliun e urdhëroi që të kthente Khalidin dhe ata që ishin me të.

Berrau ibn Azibi ka thënë: Kam qenë nga ata që ka ndenjur bashkë me prijësin e besimtarëve, Aliun kur arritëm në fillim të Jemenit. Njerëzve u shkoi lajmi dhe ata iu bashkuan atij, Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*fali me ne namazin e sabahut dhe kur e përfundoi pa që ishin grumbulluar safe-safe. Ai doli para nesh, falënderoi dhe e lavdëroi Allahun, e pastaj u lexoi atyre fjalë të të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kështu të gjithë Hemdanët u bënë myslimanë në një ditë të vetme.

Për këtë gjë, Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*i shkroi të Dërguarit të Allahut . Kur, Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e lexoi letrën e tij, ra në sexhde duke falënderuar Allahun, pastaj u ul dhe tha: "Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi Hemdanin. E tha atë tre herë, pastaj populli i Jemenit vazhdoi të ndiqte islamin.

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e dërgoi atë për herë të tretë në Jemen gjatë Ramazanit po në muajin e dhjetë të hixhretit që të mblidhte pesë minerale: Ar dhe argjend, të marrë atë që ka rënë në marrëveshjen e paqes bashkë me delegacionin e Nexhranit, armët dhe spiunët e të tjera dhe të ftojë Mudhhixhin dhe Zubejdin në islam. Khalid ibn Velidin shkoi në Xha'fa dhe u takua me prijësin e besimtarëve Ali ibn Ebu Talibi. Nën urdhrat e Aliut bashkuan dy ushtritë dhe pasi e kreu misionin e tij, u takua me Pejgamberin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në Mekën e bekuar, në haxhin e lamtumirës.

Hadithet profetike që flasin për superioritetin e Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*në gjykim është fjala e tij *(Paqja dhe bekimet e Allahut*

qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!): "Më gjykues ndër ymetin tim është Aliu". Për shokët e tij: "Më gjykuesi ndër ju është Aliu". Kur është pyetur nga shokët e tij Pejgamberi ka thënë: "Më gjykuesi ndër ju është Aliu". Fjala e tij *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* edhe një herë tjetër: "Aliu është më gjykuesi në ymetin tim".

Këtë e kanë dëshmuar edhe sahabet e mëdhenj *(Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!).* Ata e pyesnin atë për çdo gjë që u interesonte ose i vinin rrotull atij për ta pyetur që të merrnin prej tij përgjigjen.

Sherih ibn Hani'i El Harithi ka pyetur Aishenë, nënën e besimtarëve për mes'hin mbi meste dhe ajo ka thënë: Shko te Aliu dhe pyet atë. Udhejne ibn Musel-leme ka thënë: Shkova te Omer ibn Khatabi dhe e pyeta atë: Nga ku ta filloj umren? Ai më tha: Shko te Aliu dhe pyet atë.

Omer ibn Khatabi ka thënë se më i drejti në gjykim ndër ne, është Aliu. Omeri i ka thënë një njeri, se nëse mes meje dhe teje ka një çështje, nëse zihemi në diçka do të marrim gjykimin e Aliut.

Ibn Abbasi ka thënë*:* Nëse kishin diçka, Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja qoftë mbi të!)*fliste për të duke gjykuar ose jepte opinionin e tij e ne nuk e kërkonim nga dikush tjetër atë. Abdullah ibn Mes'udi ka thënë: "Njeriu më i drejtë në gjykim nga njerëzit e Medines është Ali ibn Ebu Talibi".

Mugire u betua në Zot: Ali ibn Ebu Talibi nuk ka gabuar kurrë në një gjykim. Prijësi i besimtarëve ka pasur shumë çështje që i ka gjykuar dhe përgjigje për gjëra të çuditshme. Njëra prej tyre është ajo që ka ndodhur në jetën e Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe një në kohën e tre kalifëve të udhëzuar. Në ditët e kalifatit të tij, për të cilën janë shkruar shumë libra, si lajmet e kadive, thesari i punëtorëve, kopshtet e zbukuruara, udhërrëfimi, virtytet të ibn

Shehri Ashubit e të tjera. Ashtu siç janë botuar me gjykime shumë libra, prej tyre libri i Muhamed ibn Kajsi el Baxhalijju dhe libri i Muali ibn Muhamed el-Basarijju, libri i Timidhijjut autor i sahihut dhe libri mrekullitë e prijësit të besimtarëve, tregimi i Muhamed ibn Ali ibn Ibrahimi ibn Hashimi e të tjera.

Prej gjykimeve të tij në Jemen në kohën e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është se ai mori përsipër lajmin e tre fqinjave që po loznin duke hipur sipër njëra-tjetrës. Kur ishte poshtë e pickon atë të mesit dhe ajo u egërsua, kurse ajo që ishte lart u rrëzua dhe theu qafën e saj. Një të tretën e pagesës së gjakut e ndau për të dyja dhe e hodhi poshtë një të tretën e të sipërmes sepse ajo ndihmoi vetën e saj. Ky lajm i shkon të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i cili dha aprovimin dhe dëshmoi për drejtësinë e tij. Ibn Ethiri, tek libri "*En Nihajeh*" ka thënë: Zamkhasherijju (në të jashtëzakonshmen) e ka bërë këtë hadith merfuun (shtesë e hadithit të Pejgamberit) kur ai është nga fjala e Ali ibn Ebu Talibit.

Nga gjykimet e tij kur ka qenë kalif Ebu Bekri flitet për një njeri të dehur dhe kur po zbatonin dënimin ndaj tij, ai pohoi se nuk e dinte se ishte haram, kalifi e rekomandoi çështjen e tij tek imam Aliu. Ai vendosi që të sillen rrotull me dy burra myslimanë në kuvendet e muhaxhirëve dhe ensarëve dhe të kërkonin tek ata: A ka në mesin e tyre ndonjë njeri që i ka lexuar ajetin e ndalimit dhe ta lajmërojë atë për të Dërguarin e Allahut. Nëse dy burra dëshmojnë për këtë, obligohet zbatimi i dënimit, në të kundërt do t'i kërkohet që të bëjë pendesë dhe të lihet i lirë, ai njeri ishte i sinqertë në fjalën e tij dhe u la i lirë.

Prej gjykimeve të tij të shumta *(Paqja qoftë mbi të!)* në kalifatin e Omer ibn Khatabit janë: Sillet një grua që kishte bërë

zina (imoralitet) dhe dyshohej për shtatzëninë e saj. Imami e ndaloi dënimin e saj dhe dha mendimin që të lihej në pritje derisa të sillte në jetë fëmijën dhe i tha Omerit: Nëse ti mund të kesh autoritet ndaj asaj, atëherë ti nuk mund të kesh autoritet mbi atë që ajo ka në barkun e saj.

Pasi ia hoqën gruan nga duart e atyre që do të zbatonin dënimin ndaj saj, Omeri e pyeti atë dhe tha: A nuk e ke dëgjuar të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të thotë: Është ngritur kalemi nga tre persona, nga ai që është duke fjetur derisa të zgjohet, nga i vogli derisa të rritet dhe nga i sprovuari derisa të ndërgjegjësohet? Ai tha: Posi jo, tha ai: Kjo pra është e sprovuar e birit të filanit dhe mbase dikush i ka ardhur asaj kur ajo ka qenë në gjendje të vështirë. Omeri hoqi dorë nga dënimi me kamxhik i saj prej dyshimit në mendjen e saj.

Në disa prej këtyre gjykimeve faruku fjalën e tij të njohur ka thënë: "sikur të mos ishte Aliu, Omeri do të shkatërrohej" dhe "Allahu nuk më ka lënë mua ndonjë dilemë që nuk e ka ditur babai i Hasanit".

Gjykimet e tij *(Paqja qoftë mbi të!)*në kalifatin e Osmanit *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*janë përmendur nga Ibn Shehri Ashubi, transmetuar nga Keshafi Etha'l Ebujju dhe dyzet teologë. Meutau Maliku ka thënë se u soll një grua që kishte lindur në muajin e gjashtë dhe kalifi e kuptoi se duhej rrahur me kamxhik, kurse imam Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*tha: "Nëse të kundërshtoj ty me librin e Allahut do të mund ty, me të vërtetë se Allahu i Madhërueshëm thotë: "**Ai mbartet dhe ushqehet me gji për tridhjetë muaj**"[1] pastaj thotë: "**Nënat, ato që duan të plotësojnë gji-dhënien, janë të obliguara t'u japin gji fëmijëve të vet dy vjet**

1 Suretu Ahkaf, ajeti 15.

të plota"[1] kështu që (haulejni) (dy vite): Është periudha e gjidhënies kurse gjashtë muaj është periudha e shtatzënisë dhe Othmani tha: "Kthejeni atë".

Përsa i përket gjykimeve të tij në kohën e kalifatit, ato janë shumta, të cilat janë tubuar në libra specifikë ku shumica e tyre janë botime të vazhdueshme, të përhapura. Disa prej atyre gjykimeve janë: Disa njerëz kishin pirë alkool dhe u prenë më njëri tjetrin me thika, disa u plagosën, dy prej tyre vdiqën kurse dy të tjerët mbijetuan. Njerëzit e atyre që u vranë erdhën tek prijësi i besimtarëve dhe thanë: O prijësi i besimtarëve, na çliro neve prej këtyre të dyve, kurse ai u tha atyre: Çfarë dini ju për këtë ngjarje? Se mbase secili prej atyre të dyve ka vrarë shokun e tij dhe ata thanë: Ne nuk dimë gjë, por ti gjyko ashtu siç të ka mësuar Allahu *(xh.sh)* dhe ai tha: Pagesa e gjakut të të vrarëve është obligim për të katër fiset pas kompensimit të dy të gjallëve me pagesën e gjakut të plagës së atyre të dyve.

Në Eufrat zbritën gjashtë njerëz dhe nisën të loznin në lumë, njëri prej tyre u mbyt, kurse dy prej tyre dëshmuan kundër dy të tjerëve se ata e mbytën atë, kurse tre të tjerët dëshmuan kundër atyre të dyve që ata e mbytën atë. Prijësi i besimtarëve gjykoi se pagesa e gjakut duhet te ndahet në pesë pjesë. Tre të pestat për dy vetë sipas dëshmisë së atyre të dyve dhe dy të pestat për ata të tre, sipas dëshmisë gjithashtu.

Ai *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*ka gjykuar për një njeri trashëgimtar dhe ka thënë: Ka dalë nga skllavëria çdo skllav i vjetër në pasurinë time dhe kur vdiq, nuk dihej se çfarë të bëhej me trashëgiminë dhe e pyetën imamin *(Paqja qoftë mbi të!).* Ai tha: Çdo skllavi i ndahet si pronë e tij vlera e gjashtë muajve dhe lexoi

1 Suretu El-bekare / ajeti 233.

fjalën e Tij *(xh.sh)* **"Hënës i kemi caktuar faza; ajo përditë hahet e bëhet si rremi i përkulur i hurmës."**[1], është vërtetuar se trajta përfundon në gjysmë hënë në harkimin e saj gjashtë muaj, pasi është marrë hurma prej tij, por do të përmendim disa nga çështjet e saj në pjesët e ardhshme.

1 Suretu Jasin / ajeti 39.



I PARI QË I ËSHTË PËRCJELLË MESAZHI NGA I DËRGUARI I ALLAHUT

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) [1]

Çlirimi i Mekës u bë në vitin e tetë të hixhretit dhe Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* shkatërroi të gjitha statujat që ishin në shtëpinë e shenjtë edhe mbi Qabe. Por idhujtarët e Mekës dhe arabë të tjerë veç tyre i dhanë besën të Dërguarit të Allahut dhe vazhduan të praktikojnë traditat e tyre të injorancës së lirë. Hynin në shtëpi (Qabe) si zakonisht dhe silleshin rrotull Qabesë natën duke qenë lakuriq e askush prej tyre nuk kishte hedhur një rrobë që të mbulohej. Pa pasur turp dhe pa u zverdhur bërtisnin me zë të lartë me thirrjet e idhujtarisë "Të përgjigjemi ty që nuk ke shok

1 Dijvanu Sejjid Humejir /58,59. Siretu ibn Hisham 2/543-546. Tabekat i ibn Sa'dit 2/168. Tarikhu Tabarij 3/122. El Bed'u ue Tarikhu 4/240. Dijvanu Sahib ibn Ubad /245. El Irshadu /37. El Keshafu i Zamkhasherijj 2/243. Mexhmeul Bejani 3/vol 10/fq 9,10. El Menakibu e Khavarizmij /101,102. El Menakibu i ibn Shehri Ashubit 2/126-129. El Kamilu i ibn Ethirit 2/198. Dhekhairul Ukba 69. Ujunul Ether 2/231,232. El Bidaje ue Nihaje i ibn Kethir 5/36. Jenabiul Meveddeh /101 (kapitulli i shtatëmbëdhjetë). A'janu Shi-ia 3/k 1/271. Aleuijatul Ishrun/54. Delailu Sidki 2/245-248. Hajatu Muhammed/469-473. Fadailu Khamseh fi Sihahi Es Siteh 2/342-347. El Gadiru 4/149.

tjetër, përveç një ortaku që është i yti që e mbretëron atë dhe atë që ai ka" dhe lutjet dhe thirrjet e tyre bënin zhurmuesin e myslimanëve.

Pastaj filluan t'i prishin betimet e tyre njëri pas tjetrit, përveç një pakice prej tyre si beni damre dhe beni-kenane. Marrëveshja e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me idhujtarët ishte e përgjithshme dhe specifike. E përgjithshmja ishte që askush të mos e bllokonte shtëpinë (Qabenë) dhe askush të mos frikësohej në muajt e ndaluar. Ndërsa marrëveshja specifike ishte mes të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mes fiseve dhe arabëve deri në brezat e njohur.
Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* edhe myslimanët u prekën shumë me idhujtarët, por në fillim të muajit të ndaluar të Muharremit, vitin e nëntë të hixhretit, zbritën ajetet e para të sures Teube:
"**Lirim** (i deklaruar) **nga ana e Allahut dhe të Dërguarit të Tij prej çdo detyrimi ndaj idhujtarëve me të cilët kishit bërë marrëveshje. "Udhëtoni nëpër botë ju** (idhujtarë) **edhe katër muaj** (të sigurt)**, por ta dini se nuk do të mund t'i shpëtoni Allahut dhe se Allahu do t'i poshtërojë mohuesit"; Ja shpallja e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij drejtuar njerëzve në ditën e haxhit të madh: "Allahu dhe i Dërguari i Tij shkëpusin çdo detyrim ndaj idhujtarëve". Nëse ju (idhujtarë) pendoheni, është më mirë për ju; por, nëse largoheni** (nga pendimi)**, ta dini se nuk do të mund t'i shpëtoni Allahut!**
Njoftoji mohuesit për dënimin e dhembshëm (që i pret)**. Përjashtim bëjnë ata idhujtarë, me të cilët keni lidhur marrëveshje e që nuk ju kanë shkelur asgjë prej saj dhe që nuk kanë ndihmuar askënd kundër jush. Respektojeni marrëveshjen me ta deri në fund. Me të vërtetë, Allahu i do ata që** (i)

frikësohen (Atij)**. Kur të kalojnë muajt e shenjtë** (në të cilët ndalohet lufta)**, atëherë i vritni idhujtarët kudo që t'i ndeshni, i zini robër, i rrethoni dhe u bëni pusi kudo! Por, nëse pendohen, falin namazin dhe japin zeqatin, atëherë i lini të qetë! Vërtet, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë. Nëse ndonjë nga idhujtarët kërkon mbrojtje nga ti** (Muhamed)**, mbroje, në mënyrë që të dëgjojë fjalën e Allahut, e pastaj përcille në vendin e tij të sigurt. Kështu duhet, sepse ata janë njerëz që nuk dinë. Si mund të kenë idhujtarët besëlidhje me Allahun dhe të Dërguarin e Tij, me përjashtim të atyre me të cilët keni lidhur ju marrëveshje te Xhamia e Shenjtë?! Sa kohë që ata t'i përmbahen marrëveshjes - përmbajuni edhe ju, sepse Allahu i do ata që** (i) **frikësohen** (Atij)**. Si** (mund t'u besoni**) kur, nëse ju mundin, ata nuk e respektojnë as farefisninë, as marrëveshjen? Ata ju kënaqin me fjalë, ndërsa zemrat e tyre ju kundërshtojnë; shumica e tyre janë të ligj. Ata i shesin fjalët e Allahut për një vlerë të vogël dhe i pengojnë njerëzit nga Rruga e Tij. Vërtet të shëmtuara janë veprat e tyre! Ndaj besimtarëve, ata nuk respektojnë as farefisni, as besëlidhje; këta janë tejkaluesit e kufirit (në të këqija). Megjithatë, nëse ata pendohen, falin namazin dhe japin zeqatin, atëherë janë vëllezërit tuaj në fe. Kështu ua shpjegojmë shpalljet njerëzve që dinë. Por, nëse ata e prishin betimin pas lidhjes së marrëveshjes dhe sulmojnë fenë tuaj, atëherë luftoni kundër krerëve të mosbesimit - sepse ata nuk kanë besë - që të mund të frenohen** (nga të këqijat)**."**[1]

Për numrin e ajeteve që kanë zbritur në lidhje me këtë, ka kontradikta, pasi më e pakta që është thënë për to është se kanë

1 Suretu Teube / ajeti 1-12.

qenë nëntë ajete, shumica e asaj që është thënë për numrin e tyre është se janë dyzetë ajete.

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e dërgoi Ebu Bekrin *(Paqja qoftë mbi të!)*me këto ajete në Mekë dhe e urdhëroi atë që t'ua lexojë ato atyre që kanë qenë prezent në festën e ditës së kurbani. Të prishë marrëveshjen me të gjithë ata që i kanë dhënë besën dhe t'u përcjellë atyre që asnjë idhujtar të mos i afrohet shtëpisë së shenjtë pas këtij viti. Askush të mos hyjë në Qabe, përveç atij që është mysliman dhe të mos bëjnë tavaf rrotull Qabes lakuriq. Ai që ka marrëveshje mes tij dhe të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* besa e tij është deri në kohën e caktuar dhe ai që nuk ka besë është i afatizuar deri në katër muaj që të ketë garancinë e tij.

Ebu Bekri iu afrua pemës në të cilën ishte bërë besa. Aty i vjen imam Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja qoftë mbi të!).* Me vete kishte një letër nga i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për Ebu Bekrin, për heqjen e tij nga detyra. E urdhëronte atë që ajetet t'ia jepte Aliut që të përcillte mesazhin.

Aliu shkoi në Mekë dhe qëndroi deri ditën e kurbanit tek guralecët e Akabesë dhe tha: O ju njerëz, unë jam i dërguari i të Dërguarit të Allahut tek ju, ata thanë: Për çfarë? Pastaj u lexoi atyre ajetet dhe tha: Jam urdhëruar për katër gjëra: Që të mos i afrohet shtëpisë së shenjtë asnjë idhujtar pas këtij viti, e as të mos bëjnë tavaf lakuriq në Qabe. Të mos hyjë në mburojë vetëm se çdo njeri besimtar. Mes tij dhe të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka një premtim, deri në afatin e tij, kurse ai që nuk ka premtim është i afatizuar deri në fund të katër muajve që të ketë garancinë e tij.

Disa idhujtarë thanë se tani, nuk e duam atë afat, çlirohemi prej teje dhe prej djalit të xhaxhait tënd. Përveç goditjes dhe përfoljes, njerëzit e bënë haxhin atë vit dhe kur u kthyen në shtëpitë e tyre u shanë mes tyre dhe hynë në islam me hir e me pahir.

Kjo është ajo që kanë bashkuar në mendime komentuesit dhe transmetuesit e lajmeve. Mirëpo ka kontradikta të shumta dhe të rëndësishme në shkaqet, komentimet dhe analizat që do t'i përmbledhim më poshtë.

Ibn Sa'di tek libri Shtresat ka transmetuar: Se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e urdhëroi Ebu Bekrin për haxhin në vitin e nëntë të hixhretit. Pasi ai doli nga Medineja zbritën ajetet e sures Teube. Pejgamberi dërgoi me to Aliun *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij)*, i dha devenë e tij që këto ajete, t'ua lexojë njerëzve në tubim; Aliu Ebu e arriti Bekrin në rrugë dhe i tha atij: Të ka urdhëruar ty i Dërguari i Allahut për haxhin? Ai tha: Jo, por më ka dërguar mua t'u lexoj njerëzve suren e pendimit dhe të prish marrëveshjen e me të gjithë ata që kanë besën. Ebu Bekri shkoi dhe bëri haxhin me njerëzit, ndërsa Aliu shkoi dhe u lexoi njerëzve ajetet ditën e kurbanit. Prishi marrëveshjen e idhujtarëve, pastaj u kthyen të dy në Medine.

Një grup tjetër, prej tyre është Taberijju në historinë e tij ka thënë: Kur zbritën ajetet e para nga sureja Teube, ato ajete i Dërguari i Allahut i dërgoi bashkë me Ebu Bekrin dhe e urdhëroi atë për haxhin. Kur ai iu afrua pemës ku ishte bërë betimi, atë e ndoqi Ali ibn Ebu Talibi dhe i mori ato ajetet prej tij. Ebu Bekri u kthye te Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe tha: O i Dërguari i Allahut, të kam si babain dhe nënën time, a ka zbritur ndonjë gjë për mua? Ai tha: Jo, por

askush nuk përcjell për mua përveç meje, apo ai që është prej meje. A nuk je i kënaqur o Ebu Bekër që ke qenë me mua në shpellë dhe se ti je shoku im në tubim? Ai tha: Posi jo, o i Dërguari i Allahut, pastaj Ebu Bekri shkoi në haxh kurse Aliu të lajmërojë për Teuben, shfajësimin.

Një grup tjetër, prej tyre është imam Ahmedi në përmbledhjet e tij dhe Tirmidhijju në Sahihun e tij dhe Nisaijju në të posaçmet e tij dhe Khavarizimij në virtytet e tij duke e përmbledhur kanë transmetuar:

Kur Ebu Bekri u nis bashkë me ajetet, Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)*: Shko arrije Ebu Bekrin dhe ktheje tek unë, shko me ajetet dhe përcillua ti ato. Kur Ebu Bekri ishte rrugës, dëgjoi trokullitjen e devesë me veshë të prerë të të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe doli i frikësuar. Mendoi se ishte i Dërguari i Allahut, kur pa që ishte Ali ibn Ebu Talibi, i cili i dha atij letrën e të Dërguarit të Allahut dhe mori prej tij ajetet. Ai shkoi me to në Mekë, kurse Ebu Bekri u kthye në Medine dhe kur iu afrua Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nisi të qajë dhe tha:

"O i Dërguari i Allahut, a ndodhur ndonjë gjë në lidhje me mua? Ai tha: Jo, por Xhebraili *(a.s)* më erdhi dhe më tha: Nuk e bën punën tënde askush tjetër veç teje ose një njeri që është prej teje dhe ka prej tyre që kanë thënë "Por jam urdhëruar që ta përcjellë atë vetëm unë ose një njeri prej meje".

Këtu ka disa kontradikta të tjera në shprehje dhe komentime, edhe pse gjëja e vetme në të cilën nuk ka kontradiktë është se Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e veçoi Aliun për të përcjellë mesazhin, lajmëroi

se nuk lejohet që të përcjellë askush veç tij ose një njeri që është prej tij, i cili është Aliu.

Nuk ka ndonjë dallim që ky specifikim të jetë me shpallje nga Allahu i Madhërueshëm ose me mendimin e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i cili nuk flet kot, sepse ajo është një shpallje që i shpallet atij.



I PARI QË PEJGAMBERI

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)

E KA BËRË ORTAK NË KURBANIN E TIJ[1]

I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e dërgoi Ali ibn Ebu Talibin në Jemen në muajin Ramazan të vitit të dhjetë të hixhretit që të tubojë pesë materiet e saj. Të mbërthejë atë që ka ndodhur në paqen me delegacionin e Nexhranit, shpatat dhe spiunët e të ftojë në islam Mudhhaxhin dhe Zubejdin. Atij i dha një flamur dhe i vuri çallmën me dorën e tij dhe i tha: Shko dhe mos e kthe kokën pas dhe kur të arrish në vendin e tyre, mos i lufto ata derisa ata të luftojnë ty.

U nis bashkë me treqind kalorës, takoi bashkësinë e tyre dhe i ftoi ata në islam, por ata refuzuan dhe e goditën me shigjetë. Imami i sulmoi dhe vrau njëzet burra prej tyre, ata u përçanë dhe ndaluan së përndjekuri ata. Pastaj i ftoi në islam dhe ja, ata nxituan dhe iu përgjigjën. Disa prej kryetarëve të tyre i dhanë

1 Dijvanu Sejjid Humejri/286-288. Siretu ibn Hishamit 2/602. El Irshadu /92. El Menakibu i ibn Shehri Ashub 2/130,131. El Kamilu i ibn Ethir 2/205,206. Dhekhairul Ukba/70,71. Nihajetul erb i Nuvejri 17/368,369. El Bidaje ue Nihaje i ibn Kethir 5/187-189. A'janu Shi-ia 2/215-219. Hajatu Muhamed/488,489,491.

besën atij për islamin dhe thanë: Ne jemi me atë që është pas nesh prej popullit tonë dhe këto janë sadakatë tona, prandaj merr prej atyre të drejtën e Allahut. Prijësi i besimtarëve i grumbulloi plaçkat e luftës dhe mori një të pestat e saj dhe pjesën tjetër të plaçkës ia ndau shokëve të tij.

Në fillim të muajit Dhulka'de të atij viti, i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vendosi për të bërë Haxhin (haxhin e lamtumirës) dhe sapo myslimanët e dëgjuan atë, u përgatitën për haxh bashkë me Pejgamberin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).* Në Medine u grumbulluan aq shumë njerëz, saqë numri i tyre i kaloi të njëqind e njëzetmijë personave dhe Pejgamberi doli bashkë me ata. Në pesë ditët e mbetura të Dhulka'des, bashkë me të ishin gratë dhe vajza e tij Fatimeja *(Allahu qoftë i kënaqur prej tyre).*

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i shkroi Aliut që të drejtohej nga Jemeni për në haxh, por nuk ia përmendi atij llojin e haxhit për të cilin kishte vendosur të bënte.

Haxhi, ashtu siç është e ditur është tre llojesh: Haxhi ifrad (ku bëhet nijet për kryerjen vetëm të haxhit), haxhi Kiran (i cili në mikat bëhet nijet për kryerjen e umres dhe haxhit bashkarisht) dhe haxhi temetu' (në muajin e haxhit bëhet nijet se do kryejë së pari umren). Ifradi dhe Kirani janë obligim të bëhet afër Mekës, kurse Temet'eu është obligim të bëhet larg Mekës. Haxhiu 'mufrid' dhe 'karin' bëjnë haxhin në fillim pastaj bëjnë umren më vete. Vetëm në këtë mënyrë lirohet nga ihrami dhe obligimet e tij, kurse el-mutemeteu' vendos të kryejë umren së pari, pastaj vendos të bëjë haxhin.

Haxhi i Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në atë vit ishte haxh kiran, sepse ai e veshi ihramin e tij sipas kontekstit të udhëzimit, ndërsa ihramin e veshën aleatët edhe njerëzit që ishin me të. Ai u lexoi telbijen në anë të Bejdaut dhe u lidh midis dy haremejneve me telbijate derisa përfundoi trokun e kuajve me pluhur, kurse njerëzit që ishin me të kishin hipur mbi kafshë.

Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*doli nga Jemeni bashkë me ushtrinë dhe me vete kishte materialet që kishte marrë nga populli i Nexheranit. Kur i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu afrua Mekës, prej rrugës së Medines, Aliu iu afrua asaj nga rrugët e Jemenit. Imami nxitoi në takimin e Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe njëri prej tyre mbeti prapa ushtrisë që ishte me të. Pejgamberi zuri vendet e bekuara të Mekës, i dha atij selam dhe e lajmëroi atë për atë që kishte bërë dhe marrë. I Dërguari i Allahut u gëzua për atë, buzëqeshi që u takua dhe i tha atij: Me kë ke bërë tehlilate o Ali? Ai tha: Vërtetë, ti o i Dërguari i Allahut nuk ke shkruar gjë për këtë dhe unë nuk e dija, kështu që unë e lidha nijetin tim me nijetin tënd dhe thashë: O Allah, unë jam i mirëpritur me atë që vjen Pejgamberi Yt, robi Yt dhe i Dërguari Yt *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* , ai tha: Po a ke ndonjë kurban me vete? Ai tha: Jo! Atëherë, ti je ortaku në kurbanin tim, prandaj vishe ihramin dhe kthehu te ushtria jote, nxito me ta drejt meje derisa të tubohemi në Mekë, në dashtë Allahu.

Prijësi i besimtarëve e përshëndeti dhe u kthye te ushtria e tij, i gjeti ata që e kishin veshur ihramin dhe e i tha atij që kishte mbetur pas: Mjerë ti, kush të tha ty që të veshësh ihramin para se t'ia japim të Dërguarit të Allahut, kur unë nuk të kam dhënë leje

ty për këtë, e ai tha: Më kërkuan mua që të zbukurohen me to dhe të vishnim ihramin pastaj të m'i kthenin mua. Prijësi i besimtarëve ua hoqi e ua mori, ua ndau shpërblimet dhe ata e urryen atë për këtë që bëri. Kur arritën në Mekë, u shtuan ankesat e tyre rreth tij; Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* urdhëroi një thirrës që të thërriste njerëzit "pushoni, mos flisni më për Ali ibn Ebu Talibin sepse ai është i sertë në lidhje me Unin e Allahut *(xh.sh)* nuk është lajkatar në fenë e Tij. Njerëzit pushuan së përmenduri dhe e mësuan pozitën e tij te Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* .

Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*e veshi ihramin duke ndjekur shembullin e të Dërguarit të Allahut. Shumë prej myslimanëve kishin dalë bashkë me Pejgamberin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* pa pasur kurban dhe Allahu i Lartësuar zbriti ajetin "**Kryeni haxhin dhe umren për hir të Allahut!**"[1] Kurse i Dërguari i Allahut tha: "E kam futur umren në haxh deri në ditën e kijametit" dhe gërshetoi gishtat e tij me njëra-tjetrën, pastaj tha: Nëse i kthehem urdhrit tim nuk do të ktheja mbrapsht në dhënien e kurbanit", pastaj urdhëroi thirrësit e tij që të thërrasin "Cili nga ju nuk ka bërë kurban le të veshë ihramin dhe le të bëjë umren. Ai i cili ka bërë kurban le të rrijë në ihramin e tij". Një pjesë e njerëzve iu bindën, kurse një pjesë e kundërshtuan dhe nisën të flisnin mes tyre, e disa thanë: I Dërguari i Allahut është i shpupuritur i pluhurosur, kurse ne kemi veshur rrobat, i afrohemi grave dhe binjakëve të tyre?

1 Suretu el-Bekare / ajeti 196.

Disa të tjerë thanë: A nuk keni turp që dilni kur kokat tuaja pikojnë ujë nga larja, kurse i Dërguari i Allahut është me ihram. I Dërguari i Allahut e refuzoi atë që e kundërshtoi në këtë gjë dhe tha: "Sikur unë të mos kisha bërë kurban do ta zëvendësoja dhe do të bëja umren, prandaj kush nuk ka bërë një kurban le ta zëvendësojë".

Nga nëna e besimtarëve, Aisheja *(Allahu qoftë i kënaqur prej saj!)* transmetohet se i Dërguari i Allahut erdhi pasi kishin kaluar katër apo pesë nga muaji i Dhulhixhes. Hyri te Aliu, i cili ishte i mërzitur dhe i tha: Çfarë të ka mërzitur ty o i Dërguari i Allahut, Allahu e dërgoftë atë në zjarr, ai tha: A e di se unë i urdhërova njerëzit me një urdhër dhe ata e refuzuan, sikur unë ta marr urdhrin tim nuk kthehem prapa. Nëse nuk kam marrë kurban me vete derisa ta blej atë, pastaj çlirohem nga ky urdhër ashtu siç u çliruan.

Kur i Dërguari i Allahut e kreu sakrificën e tij, e bëri Aliun pjesëmarrës në kurbanin e tij që ishin njëqind krerë dhe Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* bëri vetë me dorën e tij të bekuar gjashtëdhjetë e tre krerë për të cilën është thënë: Gjashtëdhjetë e gjashtë me dorën e tij, kurse prijësi i besimtarëve bëri kurban pjesën e mbetur nga njëqind, pastaj Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e urdhëroi Aliun që të merrte nga secili kurban një pjesë, e gatuan, e hëngrën dhe e shijuan që të dy mishin.



I PARI I MË TË AFËRMVE TË PEJGAMBERIT[1]

Prijësi i besimtarëve, Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*është nga njerëzit më të afërt të të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Dëshmitë për këtë janë të shumta, saqë nuk mund të numërohen, prandaj do të mjaftohem me një citim të thjeshtë e cila harmonizohet me planin tonë shkurtimisht. Në të ka argumenta të mjaftueshëm se Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka një gradë që askush nuk i afrohet asaj shkalle veç tij.

1 Dijvanu Sejjid Humejri /57,281,282,370. Tabekatu ibn Sa'd 2/278. El Akdul Feridu 4/312 dhe 5/97. Muruxhu Dhehebu 3/53. Dijvanu Sahib ibn Ibad 186,187. El Istiabu /1098,1099. El Menakibu i Khavarizemijut /81. El Menakibu i ibn Shehri Ashub 2/189-216-288 dhe 282,283 dhe 3/222, 354-356. Mealimul Ulema i ibn Shehri Ashub /151. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Hadid 10/ 179. Keshful Gummeh 1/62,79. Dhekhairul Ukba /62,64. Nihajetul erb i En Nuejrij 18/389. Tarikhul Khuleha/172. Es Siretul Halebijeh 1/432. Jenabiul Meueddeh /58-67 dhe 102,206 (kapitujt 7-11 dhe 19, 55). A'janu Shi-ia 3/k1/159 dhe 30/4,6. El Aleuijatul Ishrune /43. Delailu Sidk 2/326. El Muraxheatu /152,153,156,157,222. Fadailul Khamseh fi Sihahi Siteteh 3/29,33. Ehlul Bejti i Teufik Ebu Ilm /144-150.

Pejgamberi mori përsipër edukimin e tij pasi ai lindi

Kur lindi imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!),* i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha nënës së tij Fatimesë e bija e Esedit: Vëre djepin e tij afër krevatit tim dhe shumicën e çështjeve të edukimit të tij e lidhte me veten e vet. Ai e pastronte kur ishte koha për t'u larë, i jepte qumështin për të pirë dhe e lëvizte djepin e tij kur donte të flinte. I fliste ëmbël kur ishte zgjuar dhe e mbante atë në krahë, kurse atij që e shikonte duke u sjellë kështu me të, u thoshte: Ky është vëllai dhe mbrojtësi, ndihmësi, trashëgimtari dhe kalifi im. E mbante atë në krahë dhe vinte rrotull maleve të Mekës dhe luginave të saj.

Tek libri "*Khasaisul Ashrati*" i Zamkhasherijut thuhet Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mori përsipër emërtimin e Ali ibn Ebu Talibit dhe ushqyerjen e tij me djersën e tij të bekuar. Duke përthithur gjuhën, nëna e tij Fatime thotë: Kur unë e linda atë, Pejgamberi e quajti me emrin Ali dhe pështyu në gojën e tij, pastaj e gëlltiti me gjuhën e tij dhe vazhdoi ta përthithte atë derisa ai fjeti, ajo tha: Të nesërmen ne i kërkuam atij një nënë mëndeshë, por ai nuk pranonte gjirin e asnjërës prej tyre dhe thërritëm Pejgamberin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, e ai e lëpiu atë me gjuhën e tij, dhe fjeti më pas dhe kështu ka ndodhur në dashtë Allahu *(xh.sh)*.

Sapo nisi të ecte në tokë, Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e mori nga prindërit e tij dhe e adoptoi atë. Nisi ta përgatisë me edukatë dhe kulturë, nuk e ndante atë përveç në ato raste të detyrueshme, shqetësuese derisa

e bëri atë një njeri si shembulli i tij që nuk ndryshonte as sa fija e flokut.

Pas kësaj, ai hynte tek i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dy herë: Një hyrje natën dhe një hyrje ditën për të marrë dituri, imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*ka thënë: Kur unë hyja dhe e gjeja atë duke u falur, ai më përgjigjej mua me zë nga brenda tij.

Enes ibn Maliku, shërbëtori i të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kur është pyetur për Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*ka thënë: Nuk kam parë njeri në gradën e Aliut tek i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* , saqë kur ai vinte në mes të natës tek ai, u veçonte e rrinte bashkë me të derisa të agonte.

Pejgamberi e vëllazëroi atë dy herë

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vëllazëroi ndërmjet muhaxhirëve në Mekën e bekuar dhe vëllazëroi ndërmjet ensarëve dhe muhaxhirëve në Medine. Në secilën prej tyre nuk e vëllazëroi Aliun me askënd tjetër duke i thënë: "Ti je vëllai im në dynja dhe në Ahiret". Me këtë i shtoi vëllazërisë së lidhjes farefisnore, vëllazërinë e islamit dhe që prej asaj dite imam Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*u bë i njohur në mesin e myslimanëve si vëllai i të Dërguarit të Allahut.

Këtë lidhje të fortë me Pejgamberin e shoqëroi lidhja edukative, nxënësie dhe shoqërore dhe vëllazërore që të ngrihet lart njeriu më i nderuar dhe vëllai i tij në shkallët më të larta. Kur hidhërohej Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* , askush nuk shkonte t'i fliste atij veç tij.

Martesa e tij me Fatime Zahranë

Kur Fatime Zahra e arriti moshën e pjekurisë dhe u bë grua, shpirtrat e pastër të shokëve e dëshiruan atë për grua, por edhe shtresat e larta të kurejshëve. Për fejesë e kërkoi Ebu Bekri dhe Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha atij: Akoma nuk ka zbritur ndonjë caktim, pastaj e kërkoi për fejesë Omer ibn Khatabi, pas tij erdhën disa njerëz të mëdhenj prej kurejshëve dhe Pejgamberi i refuzoi ata ashtu siç i ktheu përgjigje Ebu Bekrit.

Ebu Bekri u takua me Aliun dhe i tha: Nuk ka cilësi të mirë që ti nuk e ke dhe që ia kalon të tjerëve, ti ke pozitën që e di dhe vetë tek i Dërguari i Allahut, por fisnikët kanë kërkuar tek i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, dorën e bijës së tij Fatimesë. Ai i ka kthyer ata dhe u ka thënë: Me të vërtetë çështja e saj është tek Allahu *(xh.sh)*, e çfarë të pengon ty ta përmendësh dhe ta fejosh për veten tënde atë? Aliu tha: Për Zotin, unë e pëlqej shumë Fatimenë dhe nuk më pengon gjë mua, vetëm se nuk kam shumë pasuri në dorë.

Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*shkoi tek i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në shtëpinë e Ummi Selmasë dhe Pejgamberi i tha asaj të çohej dhe të hapte derën. Ky është një njeri që Allahu dhe i Dërguari i Tij e duan atë dhe ai i do shumë ata të dy.

Ummu Selma ka thënë: U çova, hapa derën dhe pashë Ali ibn Ebu Talibin, ai hyri dhe u ul para Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe Ai i tha atij: Mendoj se ti ke ardhur për t'u fejuar me Fatimenë? Ai tha: Po, o i Dërguari i Allahut, ai tha: Po a ke ti ndonjë gjë që e vlerëson të lejuar (hallall) që ta japësh? Ai tha: Kam kafshën, shpatën dhe mburojën time. Kafsha të duhet ty për nevojat e tua, ti nuk ke

ndonjë pasuri në shpatën tënde, atëherë shite mburojën tënde dhe më sill vlerën e saj.

Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*thotë se unë e shita atë për katërqind derhem dhe erdha dhe i vendosa derhemat në dhomën e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kurse ai mori një grusht prej tyre dhe i tha Bilalit. Na bli neve diçka të mirë me to.

Pastaj ftoi Ebu Bekrin, Omerin, Othmanin, Zubejrin, Talhanë dhe një grup ensarësh dhe i fejoi para tyre me vlerën e martesës dhe në fund tha: Me të vërtetë Allahu më urdhëroi mua, që ta martoj Fatimenë, të bijën e Hatixhesë me Aliun, të birin e Ebu Talibit. Prandaj dëshmoni se unë e kam martuar atë për katërqind derhem, nëse e pranon edhe Aliu thotë: Jam i kënaqur me këtë o i Dërguari i Allahut dhe ra në sexhde duke falënderuar Allahun; i Dërguari i Allahut thërriti që të sillnin një tabaka me hurma të papjekur në të dhe tha: Kini kujdes.

Natën e dasmës së saj, i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, e dërgoi vetë me dorën e tij në shtëpinë e Aliut dhe u lut për ata të dy: "*O Allah, kjo është bija ime, krijesa më e dashur për mua dhe ky është vëllai im, krijesa më e dashur për mua. O Allah, bëje atë mbrojtësin tënd dhe të mirëpritur tek Ti dhe begatoje atë në familjen e tij. O Allah, unë kërkoj mbrojtjen Tënde për ata të dy dhe për pasardhësit e tyre nga shejtani i mallkuar*", pastaj doli dhe ua mbylli derën me dorën e tij të bekuar.

Ngjarja e zogut të pjekur

Enes ibn Maliku u nervozua, kur u pyet për këtë tha: Kjo është duaja e Ali ibn Ebu Talibit ndaj meje: Po si kështu, ai ka thënë: të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu bë dhuratë një zog i pjekur dhe ai

tha: O Allah, më sill këtu robin më të dashur Tëndin që të hajë me mua këtë zog. Kur erdhi Aliu, Enesi i tha atij: I Dërguari i Allahut është i zënë, sepse doja që të ishte një njeri prej popullit tim dhe i Dërguari i Allahut u lut përsëri. Aliu erdhi dhe unë i thashë: I Dërguari është i zënë; i Dërguari i Allahut u lut për herë të tretë dhe Aliu erdhi përsëri dhe unë i thashë: I Dërguari është i zënë, kurse ai ngriti zërin dhe tha: E çfarë e preukopon të Dërguarin prej meje? Atë Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e dëgjoi dhe tha: O Enes kush është? Unë thashë: Ali ibn Ebu Talibi, ai tha: Lëre të vijë dhe kur hyri brenda i tha atij: Me të vërtetë se unë iu luta Allahut tre herë që të më sillte njeriun më të dashur të tij që të hante bashkë me mua këtë zog dhe po të mos më vije edhe në herën e tretë do t'i lutesha Allahut për emrin tënd, që të të sillte këtu, e ai tha: O i Dërguari i Allahut, unë vërtetë kam ardhur tre herë, por Enesi më ka kthyer pas dhe më thoshte: Se i Dërguari i Allahut është i zënë dhe i Dërguari i Allahut më tha mua: Pse e bëre ti këtë gjë? Unë i thashë: Doja që të ishte një njeri prej popullit tim, kurse Aliu ngriti lart dorën e tij dhe tha: O Allah, jepi sqarim Enesit që të mos fshehë më gjë nën çallmë. Pastaj zbuloi nervozizmin, fanatizmin e tij nga koka e tij dhe tha: Kjo është lutja e Ali ibn Ebu Talibit.

Kalifi abasit Me'mun ibn Haruni Rrashid gjatë debatit të tij me dijetarët në lidhje me Ali ibn Ebu Talibin *(Paqja qoftë mbi të!)*ka thënë*:* O Is'hak, a e din ti historinë e zogut? Unë thashë: Po, ai tha: Atëherë ma trego mua, tha Is'haku dhe i tregova atij ngjarjen e ai tha: o Is'hak, vërtetë, unë të kam folur ty dhe kam menduar se ti nuk je kokëfortë ndaj të vërtetës, por tani më është bërë e qartë kokëfortësia jote, që ti e beson se kjo ngjarje është e vërtetë? Unë thashë: Po, atë e ka transmetuar ai që nuk mund të kundërshtohet, ai tha: A mendon ti se ai që beson se kjo ngjarje është e vërtetë,

pastaj pohon se dikush tjetër është më i mirë se Aliu, të anulohet nga një prej të trejave: Që lutja e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të jetë kundër tij ose të thotë: Me të vërtetë Allahu *(xh.sh)* njeh të përsosurin e krijesave të tij, kurse i preferuari ka qenë më i dashur tek Ai, apo që të thotë: Me të vërtetë Allahu *(xh.sh)* nuk e njihte të përsosurin nga i preferuari, pra cila nga këto të tre është më e dashur për ty që të thuash? Heshti, pastaj tha: o Is'hak, mos thuaj asgjë prej tyre sepse nëse ti thuan diçka ajo të qetëson ty dhe nëse për hadithin ke ndonjë komentim përveç këtyre të triave, thuaje.

Mbyllja e dyerve dhe dritareve që të çonin në xhaminë e të Dërguarit të Allahut, përveç derës së Aliut

Kur muhaxhirunët erdhën në Medine, ndërtuan rreth xhamisë së të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* shtëpi dhe dyert i bënë që të çonin drejt xhamisë. Allahu *(xh.sh)* i shpalli Pejgamberit që të bllokonte të gjitha dyert, përveç derës së tij (Aliut) dhe ia ndaloi çdokujt që të kalonte afër xhamisë, përveç atyre të dyve. Kështu Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që dërgoi Muadhi ibn Xhebelin dhe ai thirri: Pejgamberi ju urdhëron juve të bllokoni dyert tuaja, përveç derës së Aliut dhe njerëzit filluan të flasin për këtë. Kurse Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u ngrit e falënderoi Allahun, e lavdëroi Atë dhe tha:

Si më poshtë, pa dyshim unë urdhërova të mbylleshin dyert përveç derës së Aliut dhe është folur për këtë. Por pa

dyshim unë nuk kam bllokuar gjë dhe as e kam hapur atë, por unë jam urdhëruar në diçka dhe e kam zbatuar atë.

Amaneti që i la i Dërguari i Allahut që të marrë përsipër larjen, qefinosjen dhe varrosjen e tij

Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë se Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* la amanet që të mos e lajë kush veç meje dhe tha: Askush të mos i shikojë vendet e mia të turpshme, sepse në të kundërt do t'i verbohen sytë. Kurse Fadil ibn Abbasi dhe Usame ibn Zejdi e hidhnin ujin nga pas perdes dhe nuk shikonin fare me sy, kur e mbaroja një pjesë më dukej sikur e kthenin bashkë me mua edhe tridhjetë vetë të tjerë, derisa e mbarova larjen e tij.

Abdullah ibn Abbasi ka thënë: "Aliu ka katër cilësi që askush veç tij nuk i ka: Ai është arabi i parë dhe i huaji i parë që është falur bashkë me të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai ka pasur flamurin në çdo tubim dhe ai është bëri durim bashkë me të, ditën kur u larguan prej tij të tjerët dhe ai është i cili e lau dhe e futi atë në varrin e tij".

Prijësi i besimtarëve në një fjalim të tij ka thënë: "I Dërguari i Allahut e dha shpirtin kur koka e tij ishte mbi gjoksin tim dhe iu kërkua shpirti, e lejova të kalojë para fytyrës time, mora përsipër larjen e tij dhe meleket ishin ndihmësit e mi. Shtëpia u mbush me zhurmë, një turmë hynte kurse një turmë dilte, veshi nuk e humbi për asnjë çast dashurinë e madhe të tyre duke rënë në salavate për

të derisa e futëm në varrin e tij. Pra kush është ai njeri që e meriton më shumë se sa unë, për së gjalli apo vdekur".

Disa hadithe profetike të përmendura për të

"Kush e do Aliun më ka dashur edhe mua dhe kush e urren Aliun më ka urryer edhe mua. Kush e dëmton Aliun më ka lënduar mua dhe kush më lëndon mua, ai e ka lënduar Allahun".

"Kush e ofendon Aliun, më ka ofenduar mua dhe kush më ofendon mua, e ka ofenduar Allahun. Kush e ofendon Allahun, Allahu do ta kthejë përmbys atë ditën e kijametit e do ta fusë në zjarr".

Abdullah ibn Abbasi *(Paqja qoftë mbi të!)*thotë se disa njerëz po shanin Ali ibn Ebu Talibin dhe ai i tha djalit të tij: Më kap për dore dhe më ço mua tek ata. Ai e mori dhe kur arriti tha: Cili prej po e shan Allahun? Ata thanë: I Madhëruar është Allahu, ai që e shan Allahun ka bërë kufër dhe ai tha: Cili prej jush e shan të Dërguarin e Tij? Ata thanë: I Madhëruar është Allahu, ai që e shan të Dërguarin e Allahut ka mohuar, ai tha: Cili prej jush e shan Ali ibn Ebu Talibin? Ata thanë: Ishte ai atje, ai tha: Unë dëshmoj se e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të thotë: "Ai që e shan Aliun, më ka sharë mua dhe kush më shan mua, ka sharë Allahun. Kush e shan Allahun, Allahu ditën e kiametit do ta kthejë atë përmbys në zjarr" pastaj u largua prej tyre dhe i tha djalit të tij Aliut: Si tu dukën ty o biri im? Ai tha:

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i ka thënë Aliut *(Paqja qoftë mbi të!):* "ti je për mua ashtu siç është shpirti im në trupin tim".

Gjithashtu ai *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është pyetur për disa shokë të tij dhe ka folur për ta, kurse dikush pyeti: Po Ali ibn Ebu Talibi? Ai tha: Ti më pyete mua për njerëzit dhe nuk më pyete për veten time.

Ai *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* se ditën e hendekut kur Aliu i doli në duel Amru ibn Abdu Vuddi elamirijjut ka thënë: "O Allah, ti i more prej meje Ubejden ditën e Bedrit dhe Hamzanë ditën e Uhudit, ky është Aliu, prandaj mos më lër mua vetëm, se Ti je Trashëguesi më i mirë".

Nga Muadh ibn Gafarijju transmetohet se ka thënë: Hyra tek Pejgamberi në shtëpinë e nënës së besimtarëve, Aishesë, kurse Aliu po dilte prej andej dhe e dëgjova atë të thotë: "O Aishe, me të vërtetë se ky është nga njerëzit më të dashur për mua dhe më i nderuari, prandaj ta dish mirë hakun e tij dhe nderoje pozitën e tij".

Aliu është përmendur tek Aisheja, e cila ka thënë: Nuk kam parë njeri më të dashur tek i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* se sa ai dhe nuk kam parë grua më të dashur për të se sa gruaja e tij.[1]

Aisheja është pyetur: Cili prej njerëzve është më i dashur tek i Dërguari i Allahut: Ajo ka thënë: Fatimeja! Po nga burrat? Ajo ka thënë: Bashkëshorti i saj, nëse nuk e di fjalëpaku e i drejti.

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* Aliut në betejën e tebukut ka thënë: "Ti je prej meje në shkallën e Harunit me Musanë, vetëm se pas meje nuk ka më pejgamber".

1 Ka për qëllim Fatimenë (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), gruan e Aliut (Allahu qoftë i kënaqur prej tij).

Ajo që ka i thënë Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* delegacionit të thekifit: "Do të dorëzoheni ose do ju dërgoj një njeri prej meje ose ka thënë: Si vetja ime që do të godasë qafat tuaja dhe do ju presë krahët dhe do ju marrë pasuritë tuaja".

Ngjarja e berides dhe shprehja e saj është ashtu si në përmbledhjen e Ahmedit ka thënë: i Dërguari i Allahut dërgoi në Jemen dikë dhe më dërgoi edhe mua, në krye të një grupi ishte Ali ibn Ebu Talibi, kurse tek tjetri ishte Khalid ibn Velidi dhe tha: Nëse ju takoheni, atëherë Aliu është në krye të njerëzve dhe kur të ndaheni, atëherë secili prej jush në krye të ushtrisë së tij, ai tha: Ne takuam Zubejdnin nga populli i Jemenit dhe e vramë atë. Myslimanët iu shfaqën idhujtarëve e i zumë rob pasardhësit dhe Ali ibn Ebu Talibi zgjodhi një grua nga robërit e luftës për veten e tij. Khalid ibn Velidi i shkruajti të Dërguarit të Allahut duke e lajmëruar për atë dhe kur unë erdha te Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij! ,* i dhashë letrën dhe ai e lexoi. E pashë zemërimin në fytyrën e tij dhe thashë: Ky është vend i mbrojtjes tënde, o i Dërguar i Allahut, ti më dërgove mua me një njeri dhe më urdhërove që t'i bindem atij dhe unë bëra atë që u urdhërova, kurse i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "Mos e përgojo Aliun se ai është prej meje dhe unë jam prej tij dhe ai është mbrojtësi juaj pas meje".

Ai *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë*: "Hasani dhe Hysejni janë prijësit e rinisë së banorëve të Xhenetit dhe babai i tyre është më i mirë se ata të dy*".

Sahabët e mëdhenj nuk e patën zili imam Aliun *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)* për gradën e lartë që kishte ai tek i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe

vazhdonin ta përmendnin mirësinë e tij dhe shpresonin që të arrinin shkallën e tij.

Ibn Ebu Nexhihu ka treguar se: Kur Muavija e bëri haxhin, bëri një tavaf rreth Qabesë dhe bashkë me të ishte edhe Sa'd ibn Ebu Uakasi, kur e përfundoi, Muavija shkoi në shtëpinë e kështillit dhe e uli atë mbi minderin e tij, kurse Muavija filloi të përgojojë dhe ta shante Aliun. Sa'di bëri përpara dhe tha: Më ule afër teje në minderin tënd pastaj nise të shaje Aliun; Për Zotin që të isha dhëndëri i të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe se unë kam aq fëmijë sa ka edhe Aliu, është gjëja më e dashur për mua se sa Dielli që ka lindur mbi të. Për Zotin që të më thotë i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* atë që tha ditën e khajberit "se do t'ia jap flamurin nesër një njeriu që e do Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe ai e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij e që Allahu do ta çlirojë me dorën e tij" është më e dashur për mua se çdo gjë që të kisha se sa të lindë Dielli mbi kokë. Për Zotin, sikur i Dërguari i Allahut të më thoshte mua atë që tha në betejën e tebukut "a nuk je i kënaqur që ti të jesh prej meje në gradën e Harunit me Musain, vetëm se pas meje nuk ka më pejgamber" është më e dashur për mua se sa Dielli që lind mbi koka. Pasha Allahun nuk do të kisha hyrë në shtëpinë tënde dhe nuk do të qëndroja, pastaj ai u çua dhe doli.

Abdullah ibn Abbasi ka thënë se Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka pasur tetëmbëdhjetë virtyte që askush tjetër veç tij nuk i kishte nga ky ymet.

Omer ibn Khatabi ka thënë: Aliut i janë dhënë tre cilësi, sikur mua të më jepej edhe njëra prej tyre, do të ishte më e dashur për mua se të gjitha begatitë. Kur është pyetur cilat janë ato, ai ka thënë: Martesa me Fatimenë, banimi në xhami që nuk më lejohej mua në të ajo që i lejohej atij dhe flamuri ditën e Khajberit.



I PARI QË HERONJTË KRENOHEN ME DUELET E TIJ DHE TË VRARËT ME SHPATËN E TIJ[1]

Askush nuk ndryshon mendim për Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*se ai ka një guxim të mahnitshëm, gati sa afrohet me mrekullitë. Që asnjeri nuk është përshkruar me të më parë, as nuk do t'i afrohet më pas atij dhe do të mbetet e tij deri në ditën e kiametit. Ai *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)* fshiu të gjithë emrat e të parëve dhe atyre që vijnë më pas.

Kurrë nuk është larguar me arrati dhe goditja e tij e parë nuk ka pasur nevojë për të dytën. Sa herë është takuar me një të barabartë e ka vrarë atë dhe çdo ushtri që ka sulmuar e ka shkatërruar atë dhe kur ka shkuar si luftëtar është kthyer si çlirues.

I është thënë atij: Si fillove që të vrasësh heronjtë? Ka thënë: Sepse kur unë e takoja atë (heroin) e bëja atë të besonte se unë do ta vrisja dhe ai mendonte se unë do ta vrisja atë. Kështu që isha

1 Dijvanu Hasan ibn Thabit /107,108. Uakiatu Sifini /417. Siretu ibn Hishamit 1/636. El Besairu ue Dhekhairu i ibn Ebi Hajan 1/135. El Irshadu /41,56. Thimarul Kulubi fil Medafil Mensubi /496. Zehrul Adabi 1/46,47. El Menakibu i ibn Shehri Ashub 3/119. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebu Hadidit 1/20,21,28,29. Keshfuk Gummeh 1/185,186. Dijvanu Ebu Mehasin Kerbelai /172,173. A'janu Shi-ia 3/ k1/176. El Abkarijjatul Islamijjeh /663,664,665.

unë dhe shpirti i tij kundër tij. Mbretëritë e huaja dhe të Romës e përshkruanin fotografinë e tyre në vendet e adhurimit të tyre[1] dhe tempujt e tyre, duke mbajtur shpatën të gatshëm për luftimin e tij kurse mbretërit e Turqisë e përshkruan foton e tij mbi shpatat e tyre.

Fotografia e tij ka qenë e vendosur në krye të shtetit të ibn Bevihit, kurse shpata e babait të tij është element (simbol) i shtetit dhe një shpatë bashkoi ursalanët. Shpata e babait të tij është pronë e shahut, perandorit të Persisë e duket sikur ata janë optimistë për fitore dhe triumf.

Nuk është forca apo kurajo e tij vendi i mrekullisë në guximin e tij, përkundrazi mrekullia më e madhe se ato të dyja janë kultura e mjeshtërisë së kalorësisë së tij të cilën e kishte të lindur që në moshë të re.

Ukadi ka thënë: "*Trimëria e Aliut ka qenë prej trimërive të rralla me të cilën fisnikërohej me të atë që godiste, atë që goditej dhe shtohej fisnikëria e saj se ajo shtohej me cilësitë më të bukura me të cilat zbukuron trimëria. Trimërinë e të fortëve dhe njerëzit nuk kishin njohur xhevahirin e trimërisë më të bukur se ato cilësi të cilat ishin vulosur mbi të pa asnjë detyrim. Luftim mendimi që është përmbajtja nga padrejtësia, agresioni dhe bujaria me armikun, qoftë i fortë apo i dobët, pa dallim, dhe ruajtja e gjoksit nga mërzia, zemërimi ndaj armikut pas mbarimit të luftës.*

Nga përmbajtja e tij ndaj agresionit me fuqinë e tij të madhe dhe trimërinë e rrallë është se ai nuk e ka luftuar kurrë një njeri nëse nuk kishte alternativë, ndaj i thoshte djalit të tij Hasanit (Paqja qoftë mbi të!):

1 El bej'u: janë vendet e adhurimit.

"*Mos fto askënd në duel, sepse nëse e bën duhet t'i përgjigjesh, pa dyshim ai që fton është agresor dhe agresori është epileptik*".

Për këtë famë të tij *(Paqja qoftë mbi të!)*me këtë formë unike të trimërisë, guximit, bujarisë dhe tolerancës, arabët filluan të mburreshin për qëndrimin e tyre në luftë përballë tij dhe i krenohej vrasësit epileptik me shpatën e tij.

Sa'd ibn Asi bashkë me Othman ibn Afani hynë në kuvendin e Omer ibn Khatabit dhe kur u ulën aty, Omeri e shikon Seidin që i kishte ngulur një shikim të zgjatur atij dhe (Omeri) tha: Çfarë ke që më shikon aq gjatë sikur të kesh ndonjë gjë me mua, a mos mendon se unë kam vrarë babain tënd? Për Zotin do kisha dashur shumë të isha vrasësi i tij, por edhe sikur ta kem vrarë atë, unë nuk kërkoj falje për vrasjen e jobesimtarit. Unë kam vrarë dajën tim, Asin ibn Hishamin ibn Mugiren, kurse babain tënd, unë kalova pranë tij ditën e Bedrit, e pashë atë duke kërkuar të ndeshej ashtu siç bën demi me brirë, ndërsa anët e gojës i shkumëzonin dhe kur më pa mua nxitoi të afrohej. U inatosa dhe ai tha: Ku po shkon o i biri i Khatabit? Kur Ali ibn Ebu Talibi i doli përballë, e mori atë, po për Zotin as nuk luajta nga vendi kur ai e vrau dhe Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*i cili po vinte në kuvend tha: O Allah, lus faljen Tënde, sepse iku idhujtaria me çfarë ka në të dhe islami i fshiu të gjitha ato të mëparshmet. Përse ashpërsohen zemrat dhe shkaktohen zilia? Omeri ndaloi dhe Seidi tha: Kurse për mua nuk do të ishte e lehtë dhe nuk do të më gëzonte që vrasësi i babait tim të ishte dikush tjetër veç djalit të xhaxhait të tij, Aliu.

Amru ibn Abdu Vudd El Amirij kur u takuan me Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*në luftën e hendekut i ka thënë: O djali i vëllait tim, unë nuk dua të të vras ty, ndërsa Aliu i tha: Por unë dëshiroj shumë të të vras ty dhe Amri u mbrojt, zbriti nga kali i tij, ia

gjymtoi këmbët kalit dhe iu drejtua Aliut. Sipër tyre u ngrit një pluhur i madh që i mbuloi të dy ata dhe myslimanët nuk panë gjë përveç tekbirateve dhe e kuptuan se Aliu e vrau atë. Motra e tij Umejre erdhi dhe e pa atë që nuk ishte turpëruar, e pyeti për atë që e vrau dhe i tha asaj: është Ali ibn Ebu Talibi dhe ajo tha: është një kopetent bujar.

Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* e ftoi Muavijen ditën e Sifinit për dyluftim që edhe njerëzit të qetësoheshin nga lufta duke vrarë njëri-tjetrin, Amr ibn Asi tha: Ai të ka trajtuar me drejtësi, kurse Muavija i tha: Nuk më ke manipuluar kurrë që kur më ke këshilluar, deri më sot, a po më urdhëron mua të dal ne duel me babain e Hasanit kur ti e di mirë se ai është guximtari i pashembullt. Po mendoj se ti po synon pozitën e princit të Shamit pas meje.

Një ditë Muavija u zgjua dhe pa Abdullah ibn Zubejrin të ulur te këmbët e krevatit të tij dhe Abdullahu duke u tallur me të i tha: Po të doja, o prijësi i besimtarëve të të vrisja ty, do ta kisha bërë, kurse Muavija i tha atij: U bëre trim pas nesh o Ebu Bekër? Ai tha: Çfarë ke që e mohon trimërinë time kur unë kam qëndruar në rresht kundër Ali ibn Ebu Talibit, ai tha: Pa dyshim se ai të vrau ty dhe babain tënd me dorën e tij të majtë, kurse dora e tij e djathtë mbeti e lirë duke kërkuar se kë do vriste me të.

Ata tubuan në ditët e Sifinit tek Muavija, Amru ibn Asi, Atabe ibn Ebu Sufjani, Velid ibn Akabe, Mirvan ibn Hakemi, Abdallah ibn Amiri, Talhatu Talhaate dhe Atabe tha: Me të vërtetë çështja jonë dhe e Aliut është e çuditshme, ne nuk kemi, veçse të vrarë të justifikuar, mua më ka vrarë gjyshin tim dhe ka marrë pjesë në gjakun e xhaxhallarëve të mi ditën e Bedrit, kurse ty Velid të ka vrarë babain ditën e Bedrit dhe la jetim vëllezërit e tu.

Muavija tha: Ky është vendimi, po ku janë të tjerët? Mirvani tha: Cilët të tjerë dëshiron ti? Ai tha: Dua që të shkatërrohet me heshtarë, ai tha: Për Zotin, ti je vërtetë shakaxhi, por edhe ne të rënduam pak.

Amr ibn Asi tha: Për Zotin askush nuk turpërohet duke ikur me vrap nga Aliu.



I PARI QË TUBOI KUR'ANIN, E MËSOI ATË PËRMENDËSH DHE THEMELOI SHKENCAT E TIJ[1]

A. Tubimi i Kur'anit

Disa shokë të Pejgamberit u kujdesën për tubimin e Kur'anit dhe në krye të tij ishte Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, Ebu Derdai, Muadh ibn Xhebeli dhe Ebi ibn Ka'bi, është e qartë se ai nuk ishte një tubim i plotë apo se nuk ka qenë i radhitur me suret ashtu siç është tani. Imam Aliu ishte i pari që tuboi Kur'anin pas vdekjes së Pejgamberit *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* sipas radhës së zbritjes së tij. Transmetimet për këtë nëpërmjet familjarëve të

1 Dijuanu Sahib ibn Ibad /107,108. El Euailu i Ebi Hilal Askerij /166. Sheuahidu Tenzil li kauaidi tefsil 1/26. El Irshadu/23. Mukaddimetani fi ulumil Kur'ani /13-15 dhe 263,264. Hiljetul Eulijai 1/67,68. El Fehresu i ibn Nedim /27,28. El Istiabu 3/1107. El Menakibu i ibn Shehri Ashub 2/39-43. Sherh Nehxhul Belaga 1/19,27. Gajetu nihaje fi tabekatul kurrai 1/546. Tarikhul Khulefai /166. Miftahu seade le tashe kubrete Zadeh 2/62-64 dhe 370 dhe 3/112. Esh Shia ue fununil Islam/13. A'janu Shi-ia 1/ k2/230. Delailu Sidki 23/336. El Gadiru 3/388. Menahilul Irfani fi ulumil Kur'ani 1/247, 482,483. Fadailu Khamse fi Sihahi Siteh 2/237,238.

shtëpisë janë të vazhdueshme, kurse nëpërmjet njerëzve të hadithit janë të detajuara.

Ibn Nedimi në librin "El Fehrest" me senedin nga Aliu ibn Ebi Talib *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë se ai ka parë një shenjë të keqe tek vdekja e Pejgamberit *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* dhe është betuar se nuk do të gjejë rehatinë derisa të tubojë Kur'anin. Ai ndenji në shtëpinë e tij tre ditë, derisa të tubonte Kur'anin dhe ajo është kopja e parë e tubuar nga zemra e tij, ky Kur'an ka qenë në familjen e Xha'ferrit.

Në kohën tonë tek Ebi Ja'la Hamzetu Husnij, *Allahu e mëshiroftë* kam parë një kopje të Kur'anit që i ishin hequr fletët me shkrimin e Aliut ibn Ebi Talibi, të cilin e kishin trashëguar bijtë e Hasanit me kalimin e kohës. Kjo është radhitja e sureve në këtë kopje të Kur'anit. këtu është përmendur në shtojcë dhe shfaqet se Khaberi kishte një pjesë që kishte rënë nga kopja e botuar".

Lajmi i ibn Nedimit plotëson një lajm tjetër që e transmeton ibn Seidi ibn Musibi nga Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*ka thënë: E kam pyetur të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* për mirësinë e Kur'anit, ai më lajmëroi mua për mirësinë e çdo sureje, sipas përmbajtjes që ka zbritur nga qielli, se e para që ka zbritur në Mekë është: Sureja El-fatiha, hapësja e librit pastaj: ikre' bismi rabbike, pastaj nun ue lkalem, pastaj ja ejjuhel muddethir, pastaj ja ejjuhel muzemmil, pastaj idhesh-shemsu, pastaj: sebbihisme, pastaj: vel-lejli, pastaj: vel-fexhri, pastaj: vedduha, pastaj: elem neshrah, pastaj: vel-asri, pastaj: vel adijati, pastaj: elkeuther, pastaj: elhakumut-tekathur, pastaj: ere'ejte, pastaj: elkafirune, pastaj: elif, lam, mimë, pastaj: el-felek, pastaj: en-nas, pastaj: el-ikhlas, pastaj: abese, pastaj: inna enzelnahu, pastaj: vesh-shemsi, pastaj: el-buruxh, pastaj: vet-tini, pastaj: li-ilafi, pastaj: el-karia, pastaj: el-kijame, pastaj: hemeze, pastaj: el-murselatu, pastaj:

kaaf, pastaj: el-beled, pastaj: et-tarik, pastaj: es-sa'a, pastaj: sad, pastaj: elif, lam, mimë, sad, pastaj: kul uhije, pastaj: jasini, pastaj: el-furkan, pastaj: el-melaike, pastaj: kef, he, je ajn, sad, pastaj: ta-ha, pastaj: el-vakia, pastaj: pastaj esh-shuara, pastaj: en-neml, pastaj: el-kasas, pastaj: subhane, pastaj: junuz, pastaj: hud, pastaj: jusuf, pastaj: el-hixhr, pastaj: el-en'amu, pastaj: es-safatu, pastaj: lukman, pastaj: sebe'e, pastaj: ez-zumer, pastaj: shtatë havamimët që ndjekin njëra-tjetrën, pastaj: edh-dharijatu, pastaj: El-Gashije, pastaj: El-Kehf, pastaj: En-Nahl, pastaj: Inna Erselna, pastaj: Ibrahim, pastaj: El-Enbija, pastaj: Elmu'minune. Pastaj: Elif, Lam, Mimë Essexhde, pastaj: Vet-Turi, pastaj: El-Mulk, pastaj: el-hakkah, pastaj: Seele Sailun, pastaj Amme Jetesaelune, pastaj: en-naziatë, pastaj: Infetaret, pastaj: Er-Rum, pastaj: El-Ankebutë, pastaj: El-Mutaf-Fifine, Pastaj: Inshekkat.

Kurse ato që kanë zbritur në Medine, sureja e parë është: El-Bekare, pastaj: El-enfalu, pastaj: Al imran, pastaj: El-Ahzabu, pastaj: el-Mumtehine, pastaj: En-Nisa, pastaj: Idha Zulzilet, pastaj: El-Hadidu, pastaj: sureja Muhammed, pastaj: Er-Ra'du, pastaj: Er-Rahmanu, pastaj: hel eta, pastaj: et-talaku, pastaj: lem jekun, pastaj: el-hashr, pastaj: Idha Xhae, pastaj: En-Nur, pastaj: El-Haxh, pastaj: El-Munafikune, pastaj: El-Muxhadele, pastaj: El-Huxhuratu, pastaj: Et-Tahrimu, pastaj: El-Xhumua, pastaj: Et-Tegabunu, pastaj: El-Fethu, pastaj: El-Maide, pastaj: Et-Teube, pastaj: En-Nexhmu.

Meriton të përmendet se ky kalendar ka lënë jashtë dy sure, e para është: Surja 111 El-leheb e cila është Mekase, kurse e dyta është: surja 61 Es-saf, e cila është Medinase. Sipas këtij transmetimi ato të dyja janë ndërthurur me një pjesë të sureve të përmendura dhe ka kontradikta në transmetimet e radhitjes së

sureve ku një pjesë e tyre janë përmendur në librin e prezantimeve në shkencat e Kur'anit.

Hafiz Hakim Ennisabevijju ka thënë: Kur Ebu Bekri u bë kalif, Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*ndenji në shtëpinë e vet, atij i vjen një njeri dhe i thotë: Me të vërtetë Aliu të urren ty dhe ai shkoi tek Aliu dhe i tha: A më urren ti mua? Ai tha: Për Zotin jo, unë nuk të urrej ty, vetëm se kur ndërroi jetë i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* dhe Kur'ani nuk ishte tubuar, pata frikë se mos shtojnë ndonjë gjë dhe vendosa të mos dal nga shtëpia vetëm se për të falur namazin, derisa e tubova atë.

Tek burimet e dijes nga Akreme përmendet lajmi se Ebu Bekri i tha atij: Po, nuk e kam parë dhe ibn Sirini ka thënë se ai ka shkruar në kopjen e Kur'anit të tij, kopja dhe e kopjuara. Ebu Hilal Elaskerijju ka thënë se kemi transmetuar një hadith që ka folur për Aliun, i cili është i pari që ka tubuar Kur'anin pas vdekjes së Pejgamberit.

Kurse në një transmetim nga Nafiu, thuhet se Pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* i ka thënë Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*ka i sëmurë kur tha se "ky është libri i Allahut, merre me vete". Aliu e mblodhi atë me një rrobë dhe shkoi në shtëpinë e tij. Kur Dërguari i Allahut ndërroi jetë Aliu ndenji dhe e bashkoi atë ashtu siç e zbriti Allahu, ai ishte i ditur për atë punë.

Ibn Ebi Hadidi ka thënë: Vërtetë Aliu nuk erdhi, kur u bë Ebu Bekri kalif jo se ai e kundërshton atë, por për shkak se ai ishte i zënë me tubimin e Kur'anit. Kjo tregon se ai është i pari që ka tubuar Kur'anin, sepse sikur Kur'ani të ishte i tubuar në kohën e të Dërguarit të Allahut, ai nuk do kishte nevojë të preokupohej me tubimin e tij pas vdekjes së Pejgamberit (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).*

B. Nxënia përmendësh e Kur'anit dhe leximi i tij

Ibn Ebi Hadid ka thënë: Sa i përket leximit të Kur'anit dhe preokupimi me të, premtimi i tij është në këtë kapitull. Të gjithë kanë rënë dakord se ai e mësonte përmendësh Kur'anin në kohën e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* dhe askush veç tij nuk e mësonte. Nëse i kthehej librave të leximeve, imamët e lexuesve që t'i referoheshin atij, njësoj si Ebi Amri ibn Alai, Asim ibn Ebi Nexhudi dhe të tjerë. Veç tyre sepse ata i referoheshin lexuesit të Kur'anit Ebi Abdurrahman Esselmit dhe Ebu Abdurrahman ka qenë nxënësi i tij, prej tij e ka marrë leximin.

Ibn Shehri Ashubi ka thënë: Shtatë lexuesit i referoheshin leximit të tij, kurse Hamzai dhe Keshaiu mbështeten në leximin e Aliut dhe ibn Mes'udit. Kopja e tyre e Kur'anit nuk është kopja e ibn Mes'udit, sepse pa dyshim se ata të dy i referohen Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe mbështesin ibn Mes'udin në lidhje me çfarë kalonte në rrugët e arabëve. Ibn Mes'udi ka thënë: Nuk kam parë njeri më të lexueshëm se Aliu ibn Ebi Talibi për Kur'anin. Kurse Nafiu dhe ibn Kethiri dhe Ebu Amri në shumicën e leximeve të tyre i referohen ibn Mes'udit. Ibn Abbasi i ka lexuar Ubejjes të birit të Ka'bit, kurse Aliu ibn Ebi Talibi dhe ata që e lexuan këta lexues, e kundërshton leximin e Ubejjes, sepse ajo është një leje e marrë nga Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*. Asimi i ka lexuar Ebi Abdurrahman Esselmi dhe Abdurrahmani ka thënë: Ia kam lexuar të gjithë Kur'anin Aliut ibn Ebi Talibit dhe kanë thënë: Leximi më qartë dhe i mirë është leximi i Asimit, sepse ai ka sjellë origjinën, sepse ai tregon se akush nuk e ka asimiluar veç tij dhe i jep hakun shkronjës aq sa duhet edhe zanoret janë të qarta saqë nuk anojnë askund.

Ajo që lidhet me leximin dhe që konsiderohet prej shkencave të rëndësishme të Kur'anit janë: Shkenca e ndalimit, e cila është një shprehje e ndërprerjes së zërit nga fjala aq kohë sa i duhet lexuesit të marrë frymë për të vazhduar leximin. Për të qenë në fillim të ajetit, në mes të tyre dhe është thënë: Njohja e ndalesës së Kur'anit është obligim siç ka thënë Allahu (xh.sh): "**dhe Kur'anin lexoje me vëmendje**"[1] dhe Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: Leximi me vëmendje e Kur'anit është shqiptimi i pastër i shkronjave dhe njohja e ndalesës.

C. Shkenca e komentimit

Dhjetë janë sahabet e pejgamberit që janë të njohur për komentimin e Kur'anit, prej tyre katër janë kalifët e udhëzuar. Por, transmetimet rreth Aliut të birit të Ebi Talibit janë më të shumta, kurse transmetimet për tre të parët janë më pak. Sujutijju e ka justifikuar numrin e vogël të transmetimit për shkak të vdekjeve të tyre të hershme dhe të jetuarit më vonë të imamit ndaj tyre.

Ajo që nuk ka dyshim në të është se shkenca e komentimit, siç ka thënë dhe ibn Ebi Hadidi është marrë prej tij, është degëzuar dhe nëse kthehemi tek librat e komentimit do mësojmë vërtetësinë e kësaj. Shumica e tyre janë prej tij (Aliut) dhe nga Abdullah ibn Abbasi. Njerëzit e kanë mësuar situatën e ibn Abbasit në shoqërimin e tij në të. Aderimit të tij se ai është nxënësi dhe ish-studenti i tij dhe atë e kanë ndjekur dijetarët e tjerë si Muxhahi dhe Seid ibn Xhubejri e të tjerë.

1 Suretu El Muzemmil, ajeti 4.

ibn Abbasi *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: Shumicën e asaj që kam mësuar në komentim e kam marrë nga Aliu i biri i Ebu Talibit dhe i është thënë atij: si është dituria jote në krahasim me diturinë e djalit të xhaxhait tënd, Aliut? Ai tha: është njësoj si pika e ujit në mesin e oqeanit.

Është transmetuar nga Abdullah ibn Mes'udi se ai ka thënë: Kur'ani ka zbritur mbi shtatë shkronja dhe nuk ka një shkronjë që të mos ketë të dukshmen dhe të padukshmen e saj, Aliu e njihte dukshmen dhe të padukshmen e saj. Esh Sha'bij ka thënë: Nuk ka njeri më të ditur për librin e Allahut pas vdekjes së pejgamberit të Allahut, se sa Aliu ibn Ebi Talibi.

Ibn Atije Abdulhak ibn Ebi Bekr Elgarnatij në komentimin e tij ka thënë: Një numër i madh i shumë selefëve e kanë komentuar Kur'anin, kurse i pari i komentuesve dhe komandanti në mesin e tyre ishte Ali ibn Ebi Talibi. Pas tij vinte Abdullah ibn Abbasi që ishte dedikim i çështjes dhe kompletimit të saj, atë e kanë ndjekur dijetarë si Muxhahid dhe Seid ibn Xhubejri e të tjerë.

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: Më pyesni për librin e Allahut, se për Zotin nuk ka ajet që unë të mos e di, në ka zbritur natën apo ditën në lehtësi apo vështirësi. Është transmetuar prej tij se ka thënë: Për Zotin nuk ka zbritur ndonjë ajet që të mos e dijë se për çfarë ka zbritur dhe ku ka zbritur, me të vërtetë Zoti im më ka dhuruar mua një zemër të mençur dhe gjuhë që pyet shumë. Ai *(Paqja qoftë mbi të!)*ka thënë: Po të doja do të kisha mbushur shtatëdhjetë deve me komentimin e sures El-fatiha.

Nga Esbegu ibn Nebate transmetohet se kur imam Aliu u bë kalif, mbajti një hytbe njerëzve, e ajo çka tha në hytben e tij është: Për Zotin, nuk ka dyshim se unë jam më i dituri për Kur'anin dhe komentimin e tij. Çdo pretendues për diturinë e tij,

se pasha Atë që e ka ndarë në dy pjesë farën dhe ka krijuar shpirtin. Nëse më pyesni mua për çdo ajet, do t'u lajmëroja juve për kohën e zbritjes së tij dhe përse ka zbritur. Do tu lajmëroja për anuluesin dhe kopjen e tyre, specifiket dhe të përgjithshmet, precizet dhe të dyshimtat, Mekaset dhe Medinaset.



I PARI MYSLIMAN PËR TË CILIN PEJGAMBERI NUK KA VENDOSUR URDHËRUES PËR ATË[1]

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* e ka përshkruar Aliun me shumë cilësi për të ngritur lart pozitën dhe për të shfaqur mirësinë e tij. Nga cilësitë më të shumta që ai e përshkruante ishin ato që kishin në të kuptimin e të qënit kryetar dhe komandant, parësia dhe të qenit princ, udhëheqja dhe imamati. Ai *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* i ka thënë Enesit ibn Malikit, shërbëtorit të tij: "O Enes, i pari që do të hyjë në atë derë është prijësi i besimtarëve dhe i nderuari i të dërguarve dhe komandanti i teheve të këmbësorisë së bardhë dhe vula e tarshëgimtarëve".

Enesi ka thënë: O Allah, bëje të mundur që të jetë njëri prej ensarëve dhe e mbajta të fshehtë brenda meje, kur erdhi Aliu dhe Pejgamberi tha: Kush është ky o Enes? Unë thashë: Është Aliu ibn Ebi Talibi, u ngrit i buzëqeshur duke e përqafuar filloi të fshinte djersën e faqes së tij me të Aliut, kurse Aliu thotë: O i Dërguari i

1 Dijvanu Sejjid Humejr /350. Es Siretu Nebeuijjeh i ibn Hisham 2/623. Tabekat i ibn Sa'd 2/131, 189. Hiljetul Eulijai 1/63,66. Ujunul Ether 2/157. Es Siretul Halbijeh 3/198,227. A'janu Shi-ia 3/k1/261,265. El Gadiru 3/60.

Allahut, ke bërë diçka që se ke bërë kurrë më parë me mua? Ai tha: E çfarë më pengon mua, kur ti do të paguash borxhin tim dhe do t'i bësh ata të dëgjojnë zërin tim dhe do t'ua bësh të qartë atë që kanë dyshim në të pas meje".

Ai *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* një ditë ka thënë: "Më thërrisni këtu të parin e arabëve" do me thënë Aliun ibn Ebi Talibin dhe Aisheja që thotë: A nuk je ti i pari i arabëve o i Dërguari i Allahut? Ai tha: Unë jam i pari i djemve të Ademit, kurse Aliu është i pari i arabëve". I dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!),* nuk ka zbritur Allahu një ajet që është në të" **o ju që keni besuar**" vetëm se Aliu është principali dhe prijësi i tyre.

Një ditë imam Aliu shkoi tek Pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* dhe i tha: Mirëserdhe o më i nderuari i të dërguarve dhe o prijësi i njerëzve të devotshëm". Pejgamberi i tha Ebi Berzes: Me të vërtetë se Zoti i botërave më ka premtuar mua për Aliun ibn Ebi Talibin, me të vërtetë se ai është flamuri i udhëzimit, pishtari i besimit, imami i eulijave të Mi, drita e të gjithë atyre që më binden Mua, o Ebu Berze, Aliu ibn Ebi Talibi, nesër në kiamet është besniku im për çelësat e magazinave të mëshirës së Zotit tim dhe mbajtësi i flamurit tim në kiamet".

Me të vërtetë Allahu i Madhërishëm më ka shpallur mua natën e Isras tre gjëra për Aliun, se ai është i pari i besimtarëve, imami i njerëzve të devotshëm dhe komandanti i teheve të këmbësorisë së bardhë. Ai *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* ka thënë*:* Ti je i nderuar, i pari në dynja dhe në Ahiret". Duke kapur kofshën e tij i ka thënë Imam Aliut: Ky është princi i punëmirëve, vrasësi i njerëzve të shthurur, ndihmës i atij që e ndihmon atë, është i mbrojtur për atë që e zhgënjen atë e shumë hadithe të tjera me të cilat ngushtohet përmbledhja.

Po si të mos e dallojë atë me këto cilësi të larta të cilat e bëjnë atë meritor për çdo lidership. Ai është vëllai dhe edukuesi i tij, i cili u lind dhe u rrit në dhomën e tij. Nxënësi i tij shoqërues ditë e natë dhe ndjekësi i tij që si ndahej kurrë njësoj si hija e tij. Pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* u kujdes që ta bëjë shembullin e vetes së tij dhe e bëri me dëshirën dhe vullnetin e Allahut të Lartësuar. Pasi ai ishte unik në përsosje, ishte unik në dituri dhe mirësi, burrëri, sinqeritet, besim, përkushtim, adhurim, durim dhe tolerancë, në falje kur mundej, drejtësi, forcë, guxim dhe në natyrë të karakterit të tij.

Prandaj pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* ngulmoi që ta bënte atë prijës në çdo betejë, sekret apo detyrë tjetër. Veç luftës që ishte pjesëmarrës nuk e ka prirë kurrë askush edhe pse Pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* i dërgoi ushtarët, shokët e tij më të afërt, më të vjetër në moshë në disa plane sekrete, duke marrë urdhër prej komandantit të tyre.

Përmendim dy hadithe

E para: Pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* dërgoi një kompani ushtrie me disa hirearki. Në vitin e tetë të hixhretit nën komandën e Amër ibn Asit për të luftuar një vend të quajtur Kada'a. Bashkë me të dërgoi treqind muhaxhirë dhe ensarë, kur ai iu afrua atij populli i erdhi lajmi se ata janë të shumtë në numër, por ai u frikësua që të përleshej me ta. Kështu i dërgoi një lajm Pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* që të tërhiqej, por ai i dërgoi atij Ebu Ubejden ibn Xherrahun me dyqind forca të tjera prej muhaxhirëve dhe ensarëve. Në mesin e tyre ishte Ebu Bekër Siddiku dhe Omer ibn Khatabi, e urdhëroi Ebu Ubejden që të shkojë e të bashkohet me ibn Asin, që të jenë të bashkuar e të mos konfliktohen bashkë. Kur u bë xhemati për t'u

falur, Ebu Ubejde dëshiroi që të ishte ai imami i njerëzve për namazin, por Omeri e refuzoi dhe i tha atij: Prijësia jote ndaj meje qe shumë e gjatë, mirëpo Ebu Ubejdeja e la kundërshtimin dhe u bind.

E dyta: Në vitin e njëmbëdhjetë të hixhretit, i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* ka urdhëruar myslimanët që të bëjnë përgatitje për luftimin e romakëve. Usame ibn Zejdi ibn Harithe thërriti: Atë e ngarkoi për komandimin e ushtrisë dhe i tha: Tregoje vendin e vrasjes së babit tënd dhe shtype kalorësinë e tyre, pastaj me dorën e tij i dha atij flamurin të bekuar dhe i tha: Lufto me emrin e Allahut dhe në rrugën e Allahut.

Zejdi ngriti kampin në Xheref dhe nuk mbeti asnjë muhaxhir dhe ensar që pejagmberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* nuk e çoi përfaqësues në atë betejë. Aliun e mbajti me vete. Në ushtri ishte Ebu Bekr, Omer ibn Khatabi, Ebu Ubejde ibn Xherrahu dhe Sa'd ibn Ebi Vekasi, Seid ibn Zejdi e shumë të tjerë.

Një pjesë e njerëzve folën, thanë: E ka vënë përpara këtë djalë ndaj muhaxirëve të parë, pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* u zemërua dhe doli para njerëzve duke qenë me temperaturë të lartë, kishte një dhimbje të fortë të kokës, u ngjit në minber dhe pasi e falënderoi dhe lavdëroi Allahun tha: Më ka ardhur një fjalë nga një pjesë e saj për caktimin tim të Usames dhe nëse e kontestoni caktimin tim si prijës Usamen, atëherë keni kontestuar në caktimin tim si prijës, babain e tij më parë. Pasha Allahun që ai ishte meritor për prijësi dhe se djali i tij pas tij, ai e meriton titullin prijës, pastaj zbriti nga minberi dhe hyri në shtëpinë e tij.

I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* u rëndua më shumë dhe filloi të përsëriste: Zbatoni dërgimin e Usames, pastaj iu shtua edhe më shumë dhimbja, por ushtria u vonua derisa e zbatoi atë Ebu Bekri pasi u bë kalif.

Kalifët e udhëzuar u kujdesën për respektimin e imam Aliut pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* dhe nuk i dhanë asnjë urdhër. Ai mbeti të jetë me ata si tregues dhe ministër, duke punuar sa mundej për të mirën që kishte për të gjithë myslimanët. U angazhua me tubimin e Kur'anit, komentimin dhe leximin e tij, përhapjen e shkencave të fesë dhe marrjen e vendimeve. Qartësimin e çështjeve të panjohura për të cilat ishin problem për të tjerët dhe nxjerrjen e ujit nga brendësia e tokës. Mbjelljen e palmave dhe gjallërimin e kopshteve dhe arave rreth Medines, përballimin e njerëzve të varfër të myslimanëve dhe punëve të tjera të cilat i atribuohen islamit për interesin e përgjithshëm.



I PARI QË KA VESHUR NJË MBUROJË PA PJESËN E PASME TË SAJ[1]

Në historinë e prijësit të besimtarëve përmendet se Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* kishte vetëm pjesën e përparme të të mburojës, për këtë i është thënë. Nëse armiku im vjen nga pas nuk mbetet i gjallë.

Historia na ka treguar për heronj që kanë neglizhuar, e kanë marrë lehtë në disa beteja luftarake duke e hequr mburojën dhe kanë shkuar në luftë pa mburoja. Mirëpo ne nuk kemi parë para dhe pas tij prijësit të besimtarëve që të ketë një mburojë vetëm nga njëra anë, pa pjesën e pasme të mburojës, duke marrë garancinë nga ai se ai nuk i lë kohë armikut që t'i vijë atij nga pas. Fjala mburojë, parzmore ka shumë emra në gjuhën arabe dhe shumica e tyre janë cilësi që përshkruajnë përmasat dhe format e tyre, prej tyre janë:

El Xhunnetu: Parzmore dhe është çdo gjë që të mbron

1 Ujunul Akhbar i ibn Kutejbe 1/131. El Akdul Feridu 1/179. Fikhul Lugah i Thualebij/235,236. El Mukhasses i ibn Sejid 2/6/69. Dijvanu Ka'bij /52,53. En Nudhumul islamijjeh /501.

Es Sirbalu: Parzmore në Kur'anin Famëlartë thuhet: "Parzmore që ju mbrojnë juve nga e keqja"
El Besire: Mburojë diçka që nuk është armë
Es Senuru: Çdo gjë që vishet në luftë veç mburojës
Es sirdu: Çdo gjë që është i ngjashëm me mburojën deri në gurmaz
Es Sulukijje: Një parzmore që ka lidhje me Sulukun, një vend në Jemen
Ed Davudijje: Një parzmore që ka lidhje me pejgamberin e Allahut, Davudin (a.s)
El Muhelhele: Mburojat më të dobëta
Nëse mburoja, parzmorja është e gjerë, atëherë ajo quhet za'fe, nethre, nethle, fefadah (pompoze), mufada, fejudun, sabigatun dhe rebudun
Nëse ajo është e plotë: është parzmore
Nëse është e butë, atëherë është e gjatë, e gjerë.
Nëse është e bardhë: Atëherë është e dobët (madhijeh), prej saj rrjedh edhe mjalti i i bardhë, i lehtë (madhij).
Nëse është e shpuar atëherë është e arnuar.
Nëse është e fortë e sigurtë ajo është kada'u (e fortë dhe e padepërtueshme).
E nëse është e thurur është (xhedlaun) e nëse është thurur rrathë–rrathë ajo është meduneh.
Nëse është e gjatë atëherë ajo është neutralizuese.

E nëse është pa gjunjëza dhe pa supet, atëherë ajo është e cunguar. E nëse është me grykë të ngushtë atëherë është dekhas, perfekt deri në grykë. Nga sa thamë më sipër përfitohet se arabët nuk kanë mburojë si mburoja e imam Aliut pa mburojën e pasme, sepse sikur të kishte do të përmendej në fjalorët e gjuhës. Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*kur e bleu mburojën e tij të gjatë e të kompletuar për katëqind derhem apo më shumë dhe çmimin e saj,

e dha si sadaka për gruan e tij, virgjëreshën Fatime të bijën e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi famijen e tij!)*. Këtë parzmore ka parë jo të plotë, sepse ishte e thyer deri poshtë tek këmbët dhe ai e riparoi atë. Prej saj nxorri disa pjesë si rrathë dhe e bëri vetëm me gjoksore dhe pa pjesë të pasme.

Ajo që e përforcon këtë supozim është ajo që përmendet nga Vakidijju se Abdullah ibn Fadili i cili transmeton se babai i tij Muhamed ibn Hanihe ka thënë: Kur zbritën në Basra dhe vendosëm atje, rradhët tona u mobilizuam, babai im më dha flamurin dhe tha: Mos shkaktoni asgjë derisa diçka të ndodhi tek ju, pastaj fjeti dhe ne pamë shigjetat e popullit dhe kjo e trembi atë. Nisi të fërkojë sytë nga gjumi kur Aliu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*u shfaq, nuk kishte veshur asgjë veç këmishës së tij. Pastaj tha: Vazhdo përpara me flamurin, unë bëra përpara dhe i thashë: Në këtë ditë shfaqesh vetëm me një këmishë? Ai tha: Mjaft jam ruajtur nga vdekja, pasha Allahun, unë kam luftuar bashkë me Pejgamberin *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* pa mburojë, më shumë se sa kur kam pasur mburojë në trup.

Pastaj u afruan që të dy Zubejri dhe Talhaja e ai foli me ata të dy dhe u kthye duke thënë: Populli refuzon çdo gjë veç luftës, atëherë luftojini ata se kanë bërë mizori. I sollën mburojën e tij të cunguar, të cilën nuk e kishte veshur pas Pejgamberit, vetëm se atë ditë pasi ishte e prishur midis dy supeve. Kur erdhi prijësi i besimtarëve kishte në dorë rripa sandallesh, kurse ibn Abbasi i tha atij: Për çfarë i do këto rripa o prijësi i besimtarëve? Ai tha: Ti lidh ato që janë prishur nga kjo mburojë nga pas, kurse ibn Abbasi i thotë: Po këtë ditë po i vesh këto? Ai *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)* tha: Po pse jo? Ai tha: Kam frikë për ty, tha: Mos ki frikë se nuk më vijnë nga pas, për Zotin o ibn Abbasi nuk jam zvarritur kurrë në luftë.



I PARI QË ËSHTË SHMANGUR PËR TË QENË I PARI QË TË LUFTONTE DIKË[1]

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*i ka thënë djalit të tij Hasanit: "Mos fto askënd në duel dhe nëse e fton, atëherë përgjigju, sepse ai që fton në të është mizor dhe mizori është epileptik". Ibn Ebi Hadidi duke komentuar këtë fjalë ka thënë se imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*me mençurinë e tij e ka përmendur shkakun dhe askush prej historianëve nuk ka përmendur se ai ka ftuar dikë në duel. Por ishte ai vetë që ftohej e dikush tjetër i dilte në duel me atë që e ftonte dhe e vriste.

Djemtë e Rebias ibn Abdushemsi, Atabe dhe Shejbe dhe Velid ibn Atabe i ftuan në duel ditën e Bedrit. Në duel i dolën tre prej ensarëve, por ata e refuzuan duelin e tyre dhe kërkuan që t'u dilnin ndonjë prej kurejshëve. Pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* dërgoi Aliun, Hamzanë dhe Ubejden për të

1 Uak'atu Sifini /80,154,272,315,316,458. Ujunul Akhbar i ibn Kutejbe 1/128. El Akdul Feridu 1/102. Muruxhu Dhehebi 2/370. Behxhetul Mexhalisi ue unsul Mexhalisi 1/466. Dijvanu Talaja ibn Zerik /88. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebi Hadid 19/60. El Abkarijatu i Abbas Mahmud Ukad/664.

luftuar me ta. Aliu e vrau Velidin, kurse Hamzai e vrau Atabanë dhe të dy morën pjesë në vrasjen e Shejbes.

Talha ibn Ebi Talha, ditën e Uhdit që e ftoi në duel, atij i doli Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe e vrau atë. Murhibu e ftoi në duel ditën e hendekut, ai i doli dhe e vrau atë, e ftoi Amru ibn Abduvuddi në duel po ditën e hendekut dhe ai doli në atë mënyrë që e meriton t'i thuash glorioze, më e madhe se të thuhet madhështore. Madhështia e saj shfaqet nga fjala e Pejgamberit kur ai iu përgjigj Amrit: "I gjithë besimi doli para idhujtarisë". Në fjalën e tij pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* kur Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*u kthye duke mbajtur në dorë kokën e Amrit tha: "Vrasja e Amrit nga Aliu vuri drejtësinë e adhurimit të dy rëndesave".

Duelet në kohën e Pejgamberit *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* janë përmendur me pak komentim në pjesët e mëparshme, por meritojnë që të përsërisim një pjesë të dueleve të tij në ditët e kalifatit të tij. Shkurtimisht do përmendim disa që kanë ndodhur në luftën e Safejnit. Harithi, shoku i Muavijes i cili ishte shumë i fuqishëm doli dhe thirri: O Ali, a po del në duel? Babai i Hasanit doli dhe shkoi drejt tij, u përleshën por nuk zgjati shumë kur i dha një goditje të fuqishme dhe e ndau në dy pjesë.

Një njeri prej hamirëve që quhej Kerib ibn Sabahi ishte më i famshmi në Sham për fuqinë e madhe që kishte, pastaj thirri: Kush del në duel? Në duel i doli Murtefiu ibn Vedahi Ezzebidi dhe e vrau atë. Murtefiun qëndroi sipër tij dhe thirri përsëri: Kush do dalë tani? Harithi ibn Xhelahu doli dhe e vrau edhe atë, e hodhi sipër të parit, pastaj thirri: Kush do dalë tani? Atij i doli Aid ibn Mesruki el-hemdanijju, por edhe pati të njëjtin fat si të parët, pastaj thirri për herë të katërt: Kush do dalë tani? Njerëzit u

trembën prej tij dhe ata që ishin përpara në rreshtin e parë filluan të dalin prapa.

Ishte imami që i doli këtij njeriu, i cili njihej për guximin dhe forcën e tij duke thënë: O Kerib, të paralajmëroj me Allahun, forcën dhe hakmarrjen e Tij, të ftoj ty në rrugën e Allahut dhe rrugën e të Dërguarit të Tij, mjerë ti, nuk do të fusë ty në zjarr i biri i asaj që han mushkëritë. Përgjigjja e tij për këtë këshillë ishte, sa shumë e kemi dëgjuar këtë fjalë prej teje, por ne nuk kemi nevojë për to, eja para nëse do.

Ai *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*tha se nuk ka forcë dhe fuqi më të madhe veç Allahut, eci drejt tij dhe nuk zgjati shumë kur i dha një goditje të fortë që e shtriu në tokë të vrarë, pastaj thërriti që ta dëgjonin radhët: O ju njerëz, pa dyshim Allahu (xh.sh) thotë: "**Muaji i shenjtë** (i këtij viti) **është për muajin e shenjtë** (të vitit) **e shënjtëritë** (shkelja e tyre) **janë masë ndëshkuese**", e nëse ju nuk do të fillonit të parët, ne nuk do të fillonim pastaj u kthye në vendin e tij.

Ebu Davudi Arvete ibn Davudi eddemaskij i foli prijësit të besimtarëve duke i thënë, se nëse Muavija nuk e do dyluftimin me ty atëherë eja tek unë o babai i Hasanit. Ai shkoi përballë tij, kurse disa shokë i thanë: Lëre këtë qen se ai nuk është në lartësinë tënde, ai tha: Lërmëni mua, pastaj e sulmoi atë dhe e ndau në dy pjesë, njëra ra nga ana e djathtë kurse tjetra ra nga e majta. Të dyja ushtritë u drodhën nga tmerri i goditjes, pastaj tha ai *(Paqja qoftë mbi të!)*duke i folur të vrarit tha: Shko o Arvete dhe lajmëroje popullin tënd, se pasha Atë që ka dërguar me të drejtën Muhamedin, se sapo e pe me sytë e ty zjarrin dhe u bëre prej të penduarve.

Djali i xhaxhit Arvetes i tha se është mëngjesi i tij më i keq, Allahu e ka shëmtuar qëndrimin pas Ebu Davudit, e sulmoi

prijësin e besimtarëve dhe sfidoi atë. Por, babai i Hasanit e kapi shigjetën me shpatën e tij, pastaj i dha një goditje më shpatën e tij dhe e çoi te djali i xhaxhait të vet. Nga ana e tij *(Paqja qoftë mbi të!)* është e njohur se ai nuk është përplasur me armiqtë e tij jobesimtarë dhe rebelë në luftërat e tij, të cilat i ka bërë në Basra, Safejn dhe Nehrevan, vetëm pasi i ka paralajmëruar dhe u ka dhënë arsye, justifikim dhe argumentet e mëdha.

Kur Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* zbriti në Basra, fali katër rekate namaz dhe e afroi faqen e tij me tokën ku lotët iu përzien me dheun, pastaj ngriti duart e tij lart duke u lutur dhe tha: O Allah, Zoti i qiejve, atyre që u bën hije dhe i tokave Zoti i Arshit të Madhërishëm, o Allah, kjo është Basra dhe unë kërkoj nga Ti të mirën e saj dhe mbrohem me Ty nga e keqja e saj. O Allah na zbrit neve në të në një vend të mirë se t'i je frymëzuesi më i mirë. O Allah vërtet ky popull ka thyer bindjen time, kanë bërë padrejtësi ndaj meje dhe e kanë mohuar besën time. O Allah kurseje gjakun e myslimanëve. Tek ata dërgoi një njerin prej shokëve që kishte me vete dhe një Kur'an që t'i ftojë ata tek Allahu, por ata e goditën me shigjeta dhe e vranë.

I urdhëroi shokët e tij që të jenë të drejtë me ata dhe të mos nisin të parët luftën, mos të qëllojnë me shigjeta, shpata apo heshta, derisa Abdullah ibn Bedili el-khazaijju erdhi nga ana e djathtë e ushtrisë me vëllain e tij të vrarë, kurse disa të tjerë nga ana e majtë me një njeri që ishte goditur me shigjetë dhe ishte vrarë, imam Aliu tha: o Allah, ji dëshmitar se e kemi justifikuar popullin.

Kur lufta e Basrës përfundoi prijësi i besimtarëve shkoi në Kufe dhe qëndroi atje shtatëmbëdhjetë muaj, duke shkëmbyer letra me Muavijes dhe Amru ibn Asit. Kur ata njerëz ngulnin këmbë në të kotën, ai *(Paqja qoftë mbi të!)*u mërzit nga kthimi i tyre

në rrugën e drejtë, i tha Malik Eshteriut: Vërtetë Zijadi dhe Sherih ibn Hani'i erdhën tek unë duke më thënë se ata të dy kishin takuar Eba A'meri Esselmij në një ushtri të banorëve të Shamit në rrethinat e romakëve dhe i Dërguari më pati lajmëruar mua se ai i ka lënë ata në një linjë. Shpëto shokët e tu, e nëse i shkon atyre, atëherë ti je i pari i tyre, ki kujdes, mos e fillo i pari luftën vetëm nëse ata e fillojnë të parët dhe derisa t'i takosh e ti dëgjosh ata dhe të mos inkriminojë ty urrejtja e tyre për t'i luftuar. Para se t'i thërrasësh ata dhe ti japësh arsye herë pas here, mbaj në të djathtën tënde Zijadin kurse në të majtë Sherih ibn Hani'in dhe qëndro midis shokëve të tu dhe mos iu afro atyre njësoj si ai që do të shpërthejë luftën.

Dije se ushtritë e havarixhëve do ta përçajnë ushtrinë e tij që të favorizojnë atë, e atij i është thënë: Ata vërtetë dalin kundër teje, prandaj bëje ti hapin e parë para se ta bëjnë ata, ai tha: Unë nuk i luftoj ata derisa të më luftojnë ata mua dhe ata do ta bëjnë.



I PARI QË E MORI NË PRONËSI UJIN NGA ARMIQTË E TIJ PASTAJ I LEJOI QË TË PIJNË PREJ TIJ[1]

Ushtria e imam Aliut iu afrua Safejnit një fshati me ndërtesa romake i shkatërruar deri në Eufrat, distanca ishte sa hedhja e një shigjete dhe ushtria e Shamit kishte shkuar para tyre atje. Kishin zbritur në një vend të zgjedhur në një rrugë më të lehtë se ajo në Eufrat për të arritur tek uji. Pjesa tjetër ishte e thepisur e rrethuar me pyll e pemë dhe kodra të larta, gjatësia e të cilave i kalonte dy legat saqë nuk kishte të çarë ndonjë rrugë deri në Eufrat e gjithë xhungla ishte me baltë, përveç asaj rruge që mori nën kontroll ushtria e Shamit. Aty ngriti kampin e saj dhe numri i kësaj ushtrie ishte dyzet mijë luftëtarë nën komandën e Ebi A'verit es-selmijju, të cilët ishin bashkuar për të penguar popullin e Irakut që të arrinte tek uji.

Prijësi i besimtarëve erdhi me ushtrinë e tij dhe befasoi popullin e Shamit, të cilët kishin marrë nën ruajtje rrugën, fshatin

1 Uak'atu Sifejni /160,162,163,166,167,193. El Imame us Sijase /109,110. El Akhbaru Tiual / 168. Muruxhu Dhehebi 2/384-386. Dijvanu Hejsi Bejsi 3/404. El Kamilu i ibn Ethir 3/145. Sherh Nehxhul Belaga 1/23 dhe 3/244 dhe 312-331. El Abkarijatu i Ukad /672. Idul Gadiri 161,162.

dhe urdhëroi njerëzit që të zbrisnin afër ushtrisë së Muavijes. Atje shkuan bartësit e ujit, ndërsa fëmijët në rrugën e ujit. Kur Ebu A'veri ndërhyri mes tyre dhe tij, prijësi i besimtarëve e thirri Sa'sanë ibn Suhanin dhe i tha: Shko tek Muavija dhe thuaji: Se ne kemi ecur në rrugën tonë dhe unë nuk e duam luftimin tuaj para se t'ju lirojmë nga falja dhe se vërtet ti erdhe me kalin tënd dhe na luftove para se të të luftojmë ne, kurse ne nuk e kemi parë të arsyeshme që të heqim dorë nga ti derisa të ftojmë ty dhe të të sfidojmë. Kjo që bëtë kur ndërhytë mes njerëzve dhe ujit ishte një çarje mes tyre dhe atij, sa të shikojmë edhe ne atë që kemi mes nesh dhe jush dhe për çfarë kemi ardhur ne e për çfarë keni ardhur ju. E nëse do ishte më e mira për ty që të largoheshim nuk do të kishim ardhur për të pyetur dhe ti linim njerëzit të vriten për ujin derisa të jetë triumfuesi ai që e pi ujin.

Muavija pyeti shokëve të tij se çfarë mendonin: Velid ibn Akabe thotë: Prejua ujin ashtu siç ia preu prijësi i besimtarëve Osmanit dhe vriti ashtu të etur, që Zoti i vraftë. Amru ibn Asi thotë: Bëj një çarje mes popullit dhe ujit sepse ata nuk të kenë etje kur ti të jesh plot me ujë. Kurse Abdullah ibn Ebi Serehi thotë: Ndalojua atyre ujin deri në mbrëmje e nëse nuk e përballojnë dot do të kthehen andej nga kanë ardhur kthimi i tyre pas është mposhtja e tyre. Sa'sa'a i thotë Muavijes: Çfarë mendon ti? Ai thotë: Kthehu se do të vijë mendimi im. Sa'sa'a u largua dhe lajmëroi prijësin e besimtarëve se për çfarë u fol në mesin e tyre, kurse populli i Irakut mbeti atë ditë dhe natë, pa ujë, përveç atyre që dërgonin fëmijët në krahun e xhunglës dhe ecte në atë terren të vështirë për të marrë ujë.

Populli i Shamit u gëzua për kontrollin e Eufratit, kurse Muavija thotë: O populli i Shamit, për Zotin ky është triumfi i parë, mua nuk më dha të pijë ujë Allahu dhe as Ebu Sufjanit edhe

nëse kanë pirë prej tij, derisa t'ju vrasin të gjithëve për të. një njeri nga Shami prej Hemdanit që quhej Mu'reb ibn Akbeli i cili ishte eremit u ngrit dhe tha: O Muavije, i madhëruar është Allahu, meqë ju shkuat para njerëzve në Eufrat dhe e morët nën kontroll atë, i pengoni ata që të shkojnë tek uji? Për Zotin sikur ata të shkonin para nesh atje, ata do të na jepnin neve ujë? A nuk është gjëja më e madhe që po merrni prej tyre, t'i pengoni për në Eufrat dhe ata të zbresin në një hapësirë tjetër dhe ju tejkalojnë juve me atë që bëtë? A nuk e dini se në mesin e tyre është skllavi dhe robëresha, i sëmuri dhe i dobëti dhe ata që s'kanë asnjë gjynah? Kjo për Zotin është e para mizori sepse je bërë trim me frikacakun, ke parë të dyshimtin dhe ke sulmuar atë që nuk mund të bartë mbi supe luftimin tënd. Por, Muavija i foli shumë ashpër dhe e dëboi nga kuvendi.

Kur popullit të Irakut iu bë i qartë vendimi i Muavijes për mos lejimin e ujit ndaj tyre, u shtua presioni ndaj prijësit të besimtarëve, mbi Malik Eleshteriu dhe Esh'athi ibn Kajsin. Me marrjen e rrugës nga populli i Shamit, prijësi i besimtarëve i mblodhi shokët e tij dhe u çua në mesin e tyre duke folur: Ata ju ushqyen juve luftën, kurse ata e morën vendimin e ulët, të turpshëm dhe lanë pas vendin, zonën, apo i kanë ngopur shpatat me gjak, u morën me ujin, sepse vdekja në jetën tuaj është e mposhtur, kurse jeta në vdekjen tuaj është triumfuese. A nuk është Muavija komandanti i një grupi të humburish dhe ua fshehu atyre lajmin derisa i bënë kurbanet e tyre objektiva të vdekjes?

Esh'athi u ngrit dhe tha: O prijësi i besimtarëve, a do të na e ndalojnë ata njerëz ujin, kur ti je në mesin tonë dhe kemi shpatat? Na lër neve dhe popullin se për Zotin nuk do të kthehemi derisa ta marrim atë ose të vdesim. Esh'athi iku të hipte mbi kalin e tij

por qëndron dhe imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*thotë: Kjo varet nga ju.

Esh'athi thirri mes njerëzve: Kush është ai që dëshiron ujin apo vdekjen, ta dijë se caktimi është në sabah, sepse unë do të shkoj tek uji. Atë natë i erdhën atij dymbëdhjetë mijë burra dhe sapo zbardhi njerëzit u vërsulën me shpatat mbi qafat e tyre dhe nisi të hedhë shtizën duke thënë: Ecni përpara shtizës time dhe vazhdoi në atë mënyrë derisa u përzije me popullin e Shamit, zbuloi kokën e tij dhe thirri: Unë jam Esh'athu ibn Kajsi, largohuni nga uji.

Eshteri kishte ardhur me kalorësinë e tij aty ku e kishte urdhëruar prijësi i besimtarëve dhe dërgoi dikë tek Esh'athi që të rrinin mbi kuaj, i nganë ato derisa vunë patkonjtë mbi Eufrat dhe ia morën shpatat e banorëve të Shamit, ata u kthyen pas pa e kthyer kokën prapa për ndonjë gjë.

Ndërsa Amru ibn Asi i tha Muavijes: Çfarë mendimi ke ti sot për popullin, nëse ata të pengojnë ty ujin ashtu siç ua pengove dje? Ai thotë: Lëre atë që ndodhi dje, por çfarë mendon ti për Aliun? Ai tha: Unë mendoj se ai nuk do të pengojë prej teje atë që ti i ndalove dje, sepse nuk të ka ardhur ty për ujin. Pas pak për Muavijen vjen një letër nga prijësi i besimtarëve në të cilën thuhej: Ne nuk të përgjigjemi ty në të njëjtën mënyrë, ejani tek uji, sepse ne dhe ju jemi njësoj të barabartë.

Secili prej tyre mori rrugën që donte dhe njerëzit u përshëndetën në paqe, hoqën dorë nga njëri-tjetri, të gjithë pinë ujë dhe filluan të përziheshin me njëri-tjetrin. Një pjesë e tyre hyn në kampin e njëri–tjetrit dhe askush prej të dyja grupeve nuk e pengonte shokun e tij, por shpresonin që të vihej paqja mes tyre, sikur Muavija dhe Zemre të mos ngulnin këmbë për luftë dhe të

mos i linin hapësirë paqes për qëllime që vazhdonin të ishin të fshehta për çdokënd.

Ky akt bujar i prijësit të besimtarëve më kujton se pas gjithçkaje që bëri Muavija ditën kur hyri në Mekë si çlirues, se si iu përgjigj Ebu Sufjanit (babait të Muavijes) dhe si ngriti lart pozitën e tij pas poshtërimit të mposhtjes që mori mosbesimi para islamit dhe urdhëroi thirrësit që të thërrisnin me zë të lartë në Mekë. Ai që hyn në shtëpi është i sigurt, ai që e mbyll derën e tij është i sigurt dhe kush futet në shtëpinë e Ebu Sufjanit është i sigurt.



I PARI QË KA BËRË TRADITË KËRKIMIN E FALJES NDAJ ARMIKUT TË TIJ QË E SFIDONTE KUR IU KA ZBULUAR KUNDËRSHTARIT PJESA E TURPSHME E TIJ[1]

Prej burrërisë së prijësit të besimtarëve Aliut, zemërgjerësisë së tij është se ai nuk luftuar as të dobët e as frikacak, as ka ndjekur dikë që është larguar me vrap, e as nuk e ka vrarë ndonjë të plagosur, as nuk e ka filluar i pari luftën dhe të gjitha këto. Historia nuk na ka treguar se këto cilësi iu janë bashkuar tek ndonjëri prej njerëzve të tjerë.

Luftëtari duelit mund të dobësohet nëse bie në tokë dhe shfaqet vendi i tij i turpshëm, sepse ai e humbet kontrollin ndaj vetes së tij dhe fuqitë mund t'i dobësohen, ashtu siç i ndodhi Talhasë ibn Ebi Talha, mbajtësi i flamurit të idhujtarëve në betejën e Uhudit, i cili është përmendur në pjesët e mëparshme se ai

1 Uak'atu Sifejni /406, 407, 423, 424, dhe 459-462. Es Siretu Nebevijeh i ibn Hisham 2/73, 74. Ujunul Akhbar1/169. Tarikhu Tabirij 2/509. Dijvanu Ebi Ferras El Hamdanij/160. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebi Hadid 6/ 312-317. El Bidaje ue Nihaje i ibn Kethir 4/20. Es Siretul Halbijjeh 2/ 497, 498. Envaru Rrabi'i 3/227. Dijvanu Abdulbakij El Amrij /72. A'janu Shi-ia 3/k1/167-170.

qëndroi mes dy grupeve dhe thirri me zë të lartë: O shokët e Muhamedit, vërtetë ju thoni se Allahu, me shpatat tona ju çon juve në Xhenet, kurse ju me shpatat tuaja na çoni neve në zjarr, a ka ndonjë në mesin tuaj që ta çoj me shpatën time në Xhenet apo të më çojë mua me shpatën e tij për në zjarr? Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*u ngrit dhe i tha atij: Pasha Atë që ka në dorë shpirtin e Muhamedit nuk do të lë derisa të çoj ty me shpatën time për në zjarr, apo të më çosh mua me shpatën tënde për në Xhenet. Pastaj atë e goditi babai i Hasanit dhe ia preu këmbën, ai ra në tokë e iu zbuluan pjesët e turpshme dhe tha: Pasha Allahun mbulohu o djali i xhaxhait dhe e la atë, kurse i Dërguari i Allahut bëri tekbirate dhe i tha Aliut: Çfarë të pengoi ty që ta vrisje atë? Ai tha: Vërtetë djali i xhaxhait tim mu përgjërua kur iu zbuluan pjesët e turpshme të tij dhe unë pata turp prej tij. Mes njerëzve u përhap fjala se Aliu e largoi shikimin nga Talhaja kur iu zbuluan pjesët e turpshme të tij dhe nuk e vrau atë.

Pasi kishin kaluar tridhjetë vite nga kjo ngjarje, Amru ibn Asi vendosi që në betejën e Sifijnit të qëndrojë në rreshtin e parë para imam Aliut *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij)*, ballë për ballë dhe e ftoi atë në duel me gjakftohtësi, sepse ai siç duket i kishte shtrënguar mirë rripat dhe kishte vendosur që të mbrohej me lakuriqësinë e tij, e bëri atë dhe shpëtoi nga vrasja e paevitueshme. Nasir ibn Muhazimi ka thënë se në ditët e Sifijnit, sa herë që Amru ibn Asi ulej në kuvendim nuk rrinte pa e përmendur luftën.

U bënë shumë poezi në lidhje me këtë ngjarje të cilat u përhapën me shpejtësi derisa arritën në veshin e Amrit. Ai u betua se do ta flakë dhe brengosë Aliun edhe sikur të vdesë njëmijë herë. Kur grupet u përplasen Aliun takoi dhe e sulmoi atë me heshtë, kurse prijësi i besimtarëve përparoi duke treguar shpatën e tij. Kur e kapi atë, ngacmoi kalin e tij që të ngrihej lart dhe Amri e rrëzoi

veten e tij nga kali në tokë duke rënë me këmbët hapur e duke zbuluar vendet e turpshme të tij, imami u largua prej tij pa e kthyer kokën prapa.

Amri u kthye tek Muavija dhe ai e pyeti: Çfarë bëre? Ai tha: Aliu më takoi dhe më sulmoi mua, falëndero Zotin dhe vendin e turpshëm tëndin, se për Zotin sikur ti ta njihje mirë atë nuk do ta sulmoje. Amri u zemërua dhe tha: Sa shumë e urren ti Aliun në këtë çështjen time, a nuk është ai një njeri që e ka takuar djali i xhaxhait të tij dhe ndeshet me të? A mos mendon se qielli do të pikojë gjak? Ai tha: Ato të përndjekin ty me turp, përçmim.

Një ditë Muavija pas marrjes së mbretërisë i ka thënë Amrit ibn Asit: O babai i Abdullahit, sa herë të shikoj ty më vjen për të qeshur, ai tha: Për çfarë? Ai tha: më kujtohet dita kur të sulmoi ty njeriu i dheut në Safejn dhe ti hodhe veten tënde poshtë për tu larguar nga maja e heshtës së tij dhe ia zbulove vendin e turpshëm tëndin atij, dhe Amri thotë: Mua më vjen më shumë për të qeshur, se vërtetë unë e kujtoj ditën kur të ftoi ty në duel dhe t'u ngritën lart mushkëritë, gjuha në gojën tënde u lidh, u mbushe me jargë dhe u drodhe nga frika, prej teje u shfaqën gjëra që urrej ti përmend ato.

Muavija tha se kjo nuk ishte e gjitha, e si të jetë kur përveç meje u bë i zymtë edhe esh'arijunët? "Një grup që rrjedh nga Ebu Hasan El'esh'arij, kundërshtojnë ideologjinë e mutezilitëve". Ai tha: Vërtetë ti e di se ajo që ti përshkrove, nuk është ajo që të goditi ty, sepse ajo zbriti për ty dhe përveç teje u bënë të zymtë edhe Esh'arijunët, e si do të ishte gjendja jote sikur të bashkoheshin të dyja në vendin e luftës? Kurse ai tha: O babai i Abdullahut, lëri shakatë e bëhu më serioz, vërtetë frika dhe arratisja nga Aliu nuk është turp për asnjërin prej atyre të dyve.

Lufta u nxeh ditën e Sifijnit, kurse populli i Shamit humbi nga dora e prijësit të besimtarëve një numër të madh kalorësish të njohur për trimërinë dhe guximin. Ebu Davudi doli para Arvetes ibn Davudi Ed Demashkij dhe ai është prej atyre me fuqi të madhe, kërkoi të dilte në duel me prijësin e besimtarëve, e sulmoi dhe e ndau në dy pjesë, e të dyja ushtritë u drodhën nga goditja e tmerrshme.

Pastaj djali i xhaxhait të Ebi Davudit sulmoi prijësin e besimtarëve dhe atë e ndoqi djali i xhaxhait të tij, kurse Muavija qëndronte mbi kodër duke parë dhe tha: Qofshin të shkatërruar këta njerëz dhe turp për ta, a nuk ka në mesin e tyre ndonjë që të vrasë Aliun në duel apo ta vrasë kur të përplasen trupat ushtarake e kur të bëhet vendi pluhur? Pastaj e ktheu kokën nga Jasir ibn Ertae dhe i tha atij: A po del në duel me të? Nuk ka njeri që e meriton më shumë se ti për këtë e nëse ju e refuzoni atë, atëherë do dal unë.

Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* kishte zbritur nga kali i tij dhe po ecte bashkë me Eshteri kur i doli para një njeri që ishte i mbuluar me hekur që nuk e njihte dhe i thirri atij: dil në duel, o babai i Hasanit. Prijësi i besimtarëve i zbriti atij pa nxitim, indiferent, aq sa kur iu afrua atij, e sulmoi me parzmore dhe e rrëzoi në tokë, por mburoja e ndaloi heshtën që ta arrinte atë, kurse Jasiri u mbrojt me pjesën e turpshme të tij, që e zbuloi me qëllim që të largojë të keqen prej vetes. Prijësi i besimtarëve u largua prej tij pa e kthyer kokën, por atë e njohu Eshteri kur ra në tokë dhe tha: O prijësi i besimtarëve, ky është Bisr ibn Ertae, armiku i Allahut dhe armiku yt, por tha: Lëre atë, mallkimi i Allahut është mbi të, por është edhe më i madh se ajo që bëri.



MYSLIMANI I PARË QË KA FOLUR PËR ARTET USHTARAKE[1]

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*kishte një marrëdhënie të mirë me teknikat ushtarake dhe luftarake, të cilat i kishte përfituar nga eksperienca e gjatë në duelin e heronjve dhe luftimin e atyre që ishin stërvitur me këtë art. Zhytja në përplasjen e luftërave të ashpra, duke filluar nga beteja e Bedrit që kur ishte në lule të rinisë së tij dhe kur doli prej asaj lufte kishte vrarë gjysmën e idhujtarëve, kurse gjysmën tjetër i kishin vrarë të gjithë myslimanët, deri kur u nderua në moshën gjashtëdhjetë vjeçare ku mori pjesë në luftërat e tmerrshme, natën e oshtimës në Sifijn.

Ndonjë tjetër mund t'i ketë aftësitë e tij teknike luftarake apo edhe më tepër, por ai *(Paqja qoftë mbi të!)*shquhej nga të tjerët për forcën e realizimit dhe shpejtësinë e përftimit dhe përfitimit prej eksperiencave. Çështja e tij në këtë është pozita e tij në kulturat e tjera shkencore të cilat shfaqeshin tek ai si tek askush tjetër, sepse siç thuhet për të posedonte një zemër të logjikshme, të mençur dhe një gjuhë që lutej shumë dhe veshë që dëgjonin

1 Uak'atu Sifijni /235,307,308. Ujunul Akhbari i ibn Kutejbe 2/110. El Irshadu /112. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebi Hadid 1/241; 5/168; 8/3,9,95,99; 17/ 17/48,51,106. Dijvanu Abdubaki El Amri /72-74. El Abkarijatu /759. Err Rraai ue Rraijeh /91-107. Ejamul arab fil Islam /311.

shumë. Ukadi thotë se fjala nuk plotësohet për kulturën e imam Aliut, aq sa plotësohet me fjalë pesha e tij në kulturën ushtarake apo në teknikën e luftës, e cila është fusha e parë e tij. Përgjegjësia e famës së tij, në të cilën shfaqet cilësia e guximit dhe trimërisë para çdo cilësie dhe kualifikimi, aftësia e luftëtarit para çdo kualifikimi tjetër.

Nga kurthet e tij të njohura në dobësimin e forcës së armikut të tij është kur urdhëroi therjen e një deveje në betejën e njohur me emrin e tij, sepse ai ishte flamuri i kombit. E gjitha kjo ishte teknika e heroit kurajoz, luftarak i cili i ndan ushtarakët mes tij dhe mes planeve të komandimit teknikave të mobilizimit, nxitjes së ushtrisë. Në këtë kapitull nuk është përmendur asnjë nga lajmet e imamit që të gjykojmë komandimin e tij ushtarak me këtë vlerësim.

Po, me të vërtetë ai e ndante ushtrinë e tij në të djathtë dhe të majtë, qendër dhe pararojë dhe në fund, ndarje të tjera si ato të cilat i bëri në mënyrë të veçantë në luftën e Sifiinit. Ai kishte këshilla të rezervuara në marshimin e ushtarëve, edukimin dhe trajtimin e tyre me banorët e vendeve, njëra prej tyre është thënia e tij, nëse sulmoni një armik, apo sulmoheni prej tij, kampi juaj të jetë në anë të fisnikëve dhe rrëzat e maleve. Sulmoni gjatë ditës që të mos jetë shkatërruese për ju, kurse të tjerët janë të shkatërruar. Luftimi juaj të jetë vetëm në një drejtim, ose dy, mbani nën kontroll majat e maleve apo anët e kodrave që armiku të mos ju vijë nga frika ose siguria, dijeni se parësia e popullit janë sytë e tyre. Kini kujdes dhe ruhuni nga përçarja, nëse zbrisni, bëjni të gjithë e nëse largoheni, ikni të gjithë. Nëse ju zë nata, heshtat bëjini mbulesat tuaja do me thënë t'ju rrethojnë juve e mos e shijoni gjumin vetëm se me nxitim si në majë të shpatës ose sikur po lani gojën. Përmbledhja e të gjithë kësaj është se kultura e

imamit është kultura e diturisë individuale dhe vlera e lartë mes masave në çdo vend.

Për teknikat luftarake imam Aliu ka edhe shumë thënie të tjera të cilat i ka përfshirë në hytbet, periudhat, ndjekësit,këshilla për ushtritë dhe komandantët. Por këtu nuk është vendi për të argumentuar zhvillimin e tij në teknikat ushtarake, të cilat ishin të përhapura në atë kohë, prej tyre rrjedh thënia e tij Omerit ibn Khatabit kur e këshilloi vetë individët për luftimin e persëve. Me të vërtetë vendi i ngritur me autoritet është vendi i metodës me rruazat që i bashkon dhe i lidh. Nëse prishet rregulli, shpërndahen rruazat dhe ikin, pastaj nuk bashkohen kurrë më të gjitha bashkë. Prandaj bëhu lider i ftohtë dhe ndizi ndjenjat e arabëve, çoi ata në zjarrin e luftës, kurse ti jo, sepse nëse ti ikën nga këto toka, arabët do të rebelohen kundër teje nga të gjitha skajet e saj, sa do të duken mangësitë që ke lënë pas vetes më të rëndësishme për ty se sa ajo që ke në duar.

Me të vërtetë, nëse të huajt të shikojnë ty nesër, do të thonë kjo është origjina e arabëve, e nëse ju i prisni ata, kërkon mëshirë dhe kjo gjë do jetë lakmia më e madhe e tyre për ty. Prej tyre ka ardhur edhe fjala që i ka thënë djalit të tij Muhamed ibn Hanife, kur i dha atij flamurin: Zër malet dhe mos i lësho, bëj durim për çdo vështirësi, Allahu do të turpërojë kokën tënde nëse rri e ngroh tokën e këmbëve të tua, hidhi një shikim të gjatë njerëzve dhe dije se triumfi është prej Allahut të madhërishëm.

Këshillat e tij për ushtrinë para fillimit të luftës:

Ta ndjeni frikën dhe vishuni me petkun e qetësisë shpirtërore, bëni durim për vështirësitë, sepse nuk ka gjë më të urryer për shpatat se momenti, rëndësia, përsosni ymetin, mbroni kafshët dhe jepuni marshimin shpatave. Përpara të jenë ata me

parzmore, kurse prapa ata që nuk kanë parzmore, shtrëngoni dhëmbët sepse është më e urryer për shpatat për nga rëndësia. Bëhuni hark në skajet e harkëtarëve, sepse janë punë për të moshuarit. Largoni shikimet, sepse është i lidhur me shpirtin dhe rri në zemër. Mbytini zërat, sepse ajo e largon dështimin. Mos e lini flamurin të anojë në njërën anë dhe as mos e lëshoni. Mos e lini atë, vetëm se në dorë të guximtarëve dhe atyre që nuk e duan poshtërimin tuaj, sepse pa dyshim se durimtarët për përmbushjen e të vërtetave janë ata të cilët ecin këmbëzbathur me simbolet e tyre duke e rrethuar atë. Ecin këmbëzbathur me të, pas dhe para saj dhe nuk rrinë larg shumë saj që të jetë i sigurt dhe as nuk ecin shumë përpara që ta lënë vetëm atë.

Një nga planet e tij më të mrekullueshme është çarja e bllokadës nga një pjesë e ushtrisë së tij në Safein, për këtë Nasir ibn Muzahimi ka thënë: Kalorësia e popullit të Shamit sulmoi kalorësinë e popullit të Irakut, kur u shkuptën njëmijë burra apo më shumë prej shokëve të Aliut i rrethuan ata dhe ndërhynë, i ndanë mes tyre dhe shokëve të tyre dhe nuk i shikonin më. Imami çoi si delegat një njeri nga ushtria e tij që quhej Abdulaziz ibn Harithi Elxha'ferijju dhe i tha atij: O babai i Harithit, Allahu të dhëntë forcë, sulmo popullin e Shamit derisa të vijnë shokët e tu dhe thuaji atyre: Prijësi i besimtarëve ju bën selam dhe ju thotë: Bëni tehlilate (la ilahe il-lallah) dhe tekbirate (Allahu Ekber) nga krahu juaj, kurse ne po bëjmë tehlilate dhe tekbirate nga krahu jonë, sulmoni nga ana juaj, kurse ne po sulmojmë nga ana jonë ndaj popullit të Shamit.

Xha'fijju e goditi kalin e tij, i cili u zhduk si të ishte pluhur derisa u çua në majë të thundrave, sulmoi popullin e Shamit që ishin të rrethuar nga shokët e Aliut, kur ata e panë atë u gëzuan shumë dhe thanë: Çfarë bëri prijësi i besimtarëve? Ai tha: Ai ju

bën selam dhe ju thotë: Thoni sa më shumë Allahu Ekber dhe sulmoni si një grusht i vetëm nga ajo anë. Ata e sulmuan popullin e Shamit prej andej, kurse prijësi i besimtarëve i sulmoi prej këtej me shokët e tij dhe në fund u hapën Populli i Shamit dhe ikën e asnjë njeri nuk u lëndua prej tyre, kurse prijësi i besimtarëve tha: Jo, kurrë, mirëpo ai është shoku juaj, Xha'fijju.



KALIFI I PARË QË E KA EMRIN ALI[1]

Askush nuk e ka marrë në dorë kalifatin përveç imam Aliut ibn Ebi Talibit. Pas dyqind e pesëdhjetë vitesh i erdhi radha, atij që e kishte kënaqur me Allahun, ibn Ahmed El Mu'tedid El Abasiju, i cili e mori kalifatin pas vdekjes së babait të tij në vitin 289 të hixhretit. Para islamit, emri Ali nuk ka qenë i njohur tek arabët dhe librat e historisë na kanë informuar se nuk e ka paraprirë imam Aliun me këtë përveç një numri të vogël, që janë:

1. Ali ibn Mes'ud ibn Mazin ibn Dhi'bi El Gasaniju, i cili është vëllai i Abdumenatit i biri i Kenane nga nëna e tij.
2. Ali ibn Bekiri ibn Vaibi ibn Kasiti, i cili është babai i disa prej fiseve të Bekir ibn Vaili, njësoj si beni Lexhimët, beni Hanifet, beni Eddeuli, beni Murre dhe të tjerë.
3. Ali ibn Shejbani ibn Dhehli ibn Tha'lebe ibn Ikabe ibn Sa'bi ibn Aliu ibn Bekiri ibn Vaili për të cilin folëm më lart.
4. Ali ibn Esedi ibn Sarideti ibn Zejdi ibn Xhashmi ibn Khazrexhi ibn Harithe.
5. Ali ibn Hadka ibn Mudha (emri i tij është Sufjan) ibn Selhemi ibn Hakemi ibn Sa'de Elashire.

1 Dijvanu Sejjid Humejri /399. Murxhu Dhehebi 2/359. Zehrul Adab 2/1065. Xhemhuretu ensabil arabi i ibn Hazm/180,309, 317, 357, 408, 409. El A'lamu i Zerkalij 5/56. El Mehrexhanul A'lemijj bi dhikra meulidil imami Ali /83.

Mirëpo pasi Pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* u dërgua me misionin e profetit, emri i djalit të xhaxhait dhe kujdestarit të tij u shoqërua me emrin e tij. Gjuhët e përsëritnin sa herë që ndodhte një ngjarje e rëndësishme prej ngjarjeve të thirrjes profetike.

Çelësi i famës së tij ishte ajo çfarë ndodhi ditën e Bedrit, ditën kur i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* mblodhi njerëzit e tij të afërt dhe u lexoi atyre ajetin e bekuar: "**dhe ti tërhiqu vërejtjen njerëzve të tu të afërt**" dhe u tha atyre: Ju kam sjellë juve gjënë më të mirë të dynjasë dhe të Ahiretit, cili prej jush do të më mbështesë mua dhe të bëhet vëllai im, trashëgimtari im dhe mëkëmbësi im pas meje? E përsëriti fjalën tre herë, por njerëzit heshtën së përgjigjuri, kurse Aliu ngrihej në çdo herë dhe thoshte: Unë të ndihmoj ty, o i Dërguari i Allahut me atë që ke ardhur, të mbështes dhe të jap fjalën ty, kurse ai u thotë atyre kur e pa zhgënjimin e tyre dhe mbështetjen e Aliut: Ky është vëllai, trashëgimtari dhe mëkëmbësi im pas meje, kurse ata u ngritën dhe ikën duke qeshur dhe tallur dhe i thoshin Ebi Talibit: Bindju djalit tënd, sepse e ka caktuar princin tënd.

Të gjithë kurejshët filluan të flasin për kurajën dhe përballimin e çështjeve të mëdha pastaj e pasoi atë fjetja e tij në shtratin e Pejgamberit, natën që ai *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)* migroi në Medine. Si i përballoi ky djalë mizorët kurejshë dhe ndenji në Mekë edhe tre ditë pas daljes së Pejgamberit, për të kryer amanetet, sendet e lëna tek Pejgamberi për t'i ruajtur dhe borxhet e tij *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!),* më pas doli nga Meka në mes të ditës, bashkë me të kishte katër Fatime të dhe të moshuar.

Kur myslimanët i çliruan punët e tyre pas hixhretit në betejën e Bedrit, e cila e tronditi ekzistencën e idhujtarisë, imam Aliu kishte në të rolin ku vrau me shpatën e tij gjysmën e idhujtarëve.

Atë e ndoqën ngjarjet e mëdha bashkë me shtrirjen e historisë profetike, në Uhud, të aleatëve, në hajber, në çlirimin e Mekës dhe Huneinit e të tjera. Në të gjitha këto ngjarje ka qenë lideri, pas të cilit sillej rrotull shpërthimi i luftës dhe emri i tij ishte në gojën e të gjithë vendeve arabe.

Pastaj erdhi radha e kalifave të udhëzuar. Kjo ndodhi në atë periudhë kur këshilltari i cili jepte mendimin e tij dhe mësuesi i parë i përhapjes së shkencave islame dhe arabe ishte jeta e tij e mbushur me vepra të mëdha, afektuese e habisë së të gjithë njerëzve pa bërë dallim mes shoqëruesit të mirë dhe kundërshtarit. Për të gjithë këtë, emri i Aliut u përhap dhe u bë prej emrave më të dashur për baballarët dhe nënat.

Pavarësisht se kaluan nëntëdhjetë vite, ku gjatë atyre viteve njerëzve iu ndalua që të emërtojnë fëmijët e tyre me këtë emër koha e ligjit emerit mbeti emri i Aliut, më i famshmi ndër emrat në të gjitha vendet islamike.



KALIFI I PARË NGA FISI I HASHIMIJËVE[1]

Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* është kalifi i parë hashimit, pasi tek ai ishin bashkuar siç ka thënë Ukadi cilësitë e sinqerta me të cilat kjo familje bujare ishte e njohur. Cilësitë dhe tiparet e tyre ishin shumë të përafërta me shenjat e të parëve të tyre të cilat ishin: Bujaria, forca, trimëria, burrëria, zgjuarsia përveç cilësive trupore që hasëm apo u përafruan me disa prej atyre shenjave".

Ai është i biri njeriut më të nderuar të stepave dhe më i moshuari i kurejshëve, Ebi Talib ibn Abdulmuttalib ibn Hashimi i cili mori nën kujdesin e tij pejgamberin pas vdekjes së gjyshit të tij Ebi Talibit. Ai shpenzoi veten dhe pasurinë e tij në rrugën e edukimit dhe mbrojtjes dhe mbrojtjes së thirrjes së tij. Pasi ishte një nga ata të tre që mbajtën mbi supet e tyre peshën e fesë islame dhe është thënë: Islami u ngrit mbi tre shtylla: Mbrojtja e Ebu Talibit, pasuritë e nënës së besimtarëve Hadixhesë e bija e Huvejlidit dhe shpata e Aliut ibn Ebi Talibi.

Nëna e tij Fatimeja e bija e Esedit i biri i Hashimit, ishte ajo që e priti Pejgamberin *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* krahëhapur pas vdekjes së nënës së tij Eminesë e

1 Muruxhu Dhehebi 2/359. El Egani 18/156. Usdul Gabe 4/16. Mukhtesiru Tarikhi i ibn Kazerun /75. Ed Derexhatu Refiah iRefiut /60. El abkarijjatu/661.

bija e Vehebit, kur ai ishte vetëm gjashtë vjeç. Ajo ishte për të një nënë shumë e dashur dhe e dhimbshme për të, ai ishte dritë e syve të saj, u bë myslimane bashkë me të parët që hynë në islam dhe kur ajo vdiq pejgamberi e qefinosi atë me rrobën e tij me qëllim që të mbulohet me mirësitë e Xhenetit dhe u shtri në varrin e saj para se ajo të futej në të, me qëllim që ta mbrojë atë nga ngushtimi i varrit dhe Pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha dikujt, që ishte habitur nga veprimi i tij: Pas Ebu Talibit, nuk ka pasur njeri më të dashur e të sjellshëm për mua se sa ajo, me të vërtetë ajo është nëna ime që më rriti dhe edukoi dhe më kishte si djemtë e saj.

Pas imam Aliut asnjë nuk e pasoi të qenit kalif, përveç djalit të tij Hasanit dhe nënës së tij lulja Fatime, e bija e të Dërguarit të Allahut dhe Muhamed Emini i biri i Haruni Rreshidit dhe nënës së tij, Zubejde e bija Xha'ferrit i biri i Ebi Xha'ferrit El Mensurit. Eshxheu ibn Amri Es Selmiju, poeti ka thënë: Hyra te Muhamed Emini kur ai merrte pjesë në kuvendin e edukimit për të mësuar kur ai ishte në moshën katër vjeçare, ai rrinte aty një orë pastaj çohej.



I PARI QË VURI NJË KUSHTETUTË TË PLOTË PËR SHTETIN ISLAMIK[1]

Në librin e imam Aliut, "*Nehxhl Belaga*" ka marrëveshje, obligime, këshilla dhe hytbe, letra dhe tërheqje vërejtjeje, e në to ka shumë rregulla dhe ligje të cilat nëse tubohen, merren si vendime dhe qartësohen, do të përfitohet prej tyre një kushtetutë e përsosur. Një kushtetutë që përmbush nevojat e popujve të kulturuar, bashkë me një seri të plotë të ligjeve për të cilat ato popuj kanë nevojë për funksionimin e çështjeve të tyre dhe sistemimit të shoqërive të tyre.

Një numër i madh dijetarësh nga lindja dhe perëndimi e kanë sfiduar shpjegimin, komentimin e marrëveshjes së imamit *(Paqja qoftë mbi të!)*për nëpunësin e tij Maliku El'eshteru, kur e emëroi atë në tokat e Egjiptit, me komentime shkencore të shoqëruar me kushtetutat e vendeve të përparuara dhe i kanë përkthyer një pjesë të tyre në disa gjuhë të gjalla, sepse ajo është marrëveshja më e vërtetë që ka nxjerrë islami.

---

1 Behxhetul Mexhalisi ue unsul mexhalisi 1/223. Sherh Nehxhul Belaga 1/10/30 e më tej. El Aleuijatul Ishrun /30. Er Rraai ue Rraijjetu i El Fekikij. El Abkarijatu /738. Ali, Seutul adaletil insanijjeh 5/265. Nidhamul hukmi uel idareti fil islam/299 e më tej.

Prej komentimeve arabe është libri "Err Rraai ue Err Rraijeh" të juristit të shkëlqyer profesor i ndjerw Teufik El Fekiki. Sa i përket fjalës së prijësit të besimtarëve të cilën e përmban shtegu i elokuencës në këtë përmbajtje, ka mbetur në komentimet e tij gjuhësore dhe kulturore dhe historike, e cila i ka kaluar të pesëdhjetë komentet, deri kur e sfidoi shkrimtari profesor Xhorxh Xhordak me leksion dhe përmes testimit për disa tema të asaj metode të drejtë dhe e përfundoi atë studim me librin e tij unik "Aliu është zëri i drejtësisë njerëzore" me pesë volume që përmbante titujt e mëposhtëm:

I pari është: Aliu dhe të drejtat e njeriut

I dyti: Ndërmjet Aliut dhe revolucionit Francez

I treti: Aliu dhe Sokrati

I katërti: Aliu dhe periudha e tij

I pesti: Aliu dhe nacionaliteti arab

Me këto tema arriti qëllimin të cilën nuk mund ta arrijë atë vetëm se ata që janë të aftë në dituri dhe dijetarin Muhamed Xhevad e goditi në brendësi me thënien e tij në shkrimin e librit (kush i lexon të dy librat e Ukadit dhe doktor Taha Hysejnit për Aliun të birin e Ebi Talibit, pastaj e lexon këtë libër do ta zërë vetëkënaqësia me çdo mënyrë, se si shkoi reputacioni i atyre të dyve më larg se sa reputacioni i Xhorxh Xhordakut? Nuk largohet vetëkënaqësia vetëm kur njohim se Xhorxh Xhordak vazhdon të jetë i ri dhe është në fillim të rrugës së tij.

Ukadi ka shkruar duke besuar në origjinat e aristokratëve kurse Taha Husejni ka shkruar duke prezantuar rrugën si një listë e mirëorganizuar me mënyrën e tij të njohur, kurse sa i përket Xhorxhit, ai ecte në zbulimin e të vërtetave, në analizën dhe ekspozimin e tyre, ai ecte bashkë me raketat e drejtuara dhe zhvendosej me satelitët dhe i linte Ukadin dhe Taha Husejnin në

një makinë që rrotullohej në rrethin e rrugës dhe që u paloste në fund të luginës duke korrigjuar dhe evapuruar.
Për të justifikuar mishërimin e kësaj përmbajtjeje, qoftë edhe një pjesë të qartësimeve të ligjeve superiore në shtegun e elokuencës dhe krahasimin e tyre me ligjet moderne në administrim, në gjykim dhe politikë, në ekonomi dhe teknikat ushtarake dhe fenomenet shoqërore në garantimin e të drejtave të punëtorëve dhe shtresave të tjera, do të mjaftohem me nocionin e fragmenteve nga periudha e imamit për Malik Eshteriun të klasifikuara, sipas përmbajtjeve të tyre. Ia lë lexuesit përsëritjen e burimeve të kësaj pjese për të marrë një qëndrim ndaj shpjegimit të periudhës së përmendur dhe krahasimin e saj me ligjet dhe teoritë moderne.

Paraqitja e marrëveshjes

Kjo është ajo që robi i Allahut, Aliu, prijësi i besimtarëve e urdhëron Malikun ibn Harithi El Eshteriut në qarkoren që i drejton, me të cilën e bën guvernator të Egjiptit, për administrimin e të ardhurave, luftimin e armiqve, mirëqënien e popullit, ndërtimin dhe lulëzimin e qyteteve të saj.

E urdhëroi atë të ketë frikë Allahun dhe të pëlqejë bindjen ndaj Tij dhe të përmbushë atë që ka urdhëruar Ai në librin e Tij përmes porosive të Tij të detyrueshme e të këshillueshme, prijëset e vetme në virtyt pa u bërë i ashpër kurrë, përveçse kur luftohet e padrejta dhe shpërfillet e drejta dhe pa i kursyer Zotit të Lavdishëm mbështetjen me anë të zemrës, dorës e gjuhës, sepse Zoti ka marrë përsipër me Emrin e Tij të Madh që të ndihmojë këdo që e mbështet dhe të mbrojë këdo që e përkrah. Pa dyshim se Ai i Lartësuari ka garantuar për triumfin me ndihmën e Tij dhe për zgjidhjen për atë që e mbështet Atë dhe imami e urdhëroi atë që ta thyejë veten e tij tek pasionet dhe ta shpërndajë atë tek

parregullsitë, sepse pa dyshim se nefsi, egoja urdhëron në të keqe, përveç atij që ka mëshiruar Allahu.

Dije mirë, o Malik, se unë të kam caktuar ty në një vend ku ka patur qeverisje dhe përpara teje, si të mira edhe të këqija. Tani njerëzit do shikojnë çfarë bën ti, njësoj siç i ke parë ti sundimtarët para teje dhe do të të qortojnë ty ashtu si ti ata. E dihet se të virtytshmit njihen nga fama që Zoti ua ka përhapur gojë më gojë në popull. S'ka dyshim se kamjen e vërtetë mund ta sjellë vetëm bollëku i punëve të mira. Prandaj mbaji pasionet nën kontroll dhe mos e lër zemrën të bëjë atë që s'të lejohet ta bësh. Se zemrën do mund ta mbash në zap, vetëm kur t'i qëndrosh së mesmes mes asaj që ajo do dhe asaj që ajo nuk do.

A. Detyrat e administratorit

1. Sjellja e mirë me ata që ke nën kujdes:

Mësoje zemrën tënde me mëshirë për shtetasit dhe dhembshuri e mirësi kundrejt tyre. Mos u sill me ta si ata bishat gjakësore që ndihen të nginjuara vetëm pasi shqyejnë; se njerëzit janë dyllojësh: ose vëllezërit e tu në fe', ose të ngjashëm të tu në krijim. Ata edhe do shkasin e do futen në udhë të gabuar dhe mund të bëjnë të këqija sepse s'bëjnë kujdes, apo edhe me qëllim. Pra, jepu faljen dhe ndjesi me po atë arsye që të shtyn t'i kërkosh falje dhe ndjesë Zotit për vete, sepse ti je mbi ta siç është imami yt mbi ty, ndërkohë që Zoti është mbi ty dhe mbi atë që të ka caktuar ty. Ai të ka besuar mbarëvajtjen e punëve të tyre dhe të ka vënë në provë përmes tyre.

2. **Lidhja e administratorit me ata që ka nën kujdes**

Mos u jep të njëjtin pozicion e trajtim njerëzve të virtytit e vesit, ndryshe i virtytshmi zverdhet prej virtytit, ndërkohë që

perversi gjen mbështetje për vesin e tij. Jepi secilit vendin që i takon. Ajo që i jep më shumë nam të mirë sundimtarit midis shtetasve të tij është sjellja e mirë ndaj tyre, lehtësimi i vuajtjeve të tyre dhe shmangia e sakrificave të mëdha prej tyre. Prandaj, ec rrugëve që lënë përshtypje të mirë tek njerëzit, sepse kjo t'i lehtëson problemet e mëdha dhe ta dish mirë, se opinioni më i besueshëm është i atij, ndaj të cilit nuk ke qenë dhe aq i ëmbël.

Mos i prish traditat e mira që kanë krijuar njerëzit e hershëm të komunitetit, në sajë të të cilave ata lulëzuan dhe ndërtuan bashkim të fortë. Mos fut në jetën e tyre praktika që mund të cenonin, përndryshe mirënjohja do t'u shkonte vetëm krijuesve të tyre, kurse ty do të mbetej vetëm barra e zhdukjes së tyre. Mbaj përherë kontakte me dijetarët e të urtët dhe diskuto me ta, si të lulëzohet vendi e të pasurohet përvoja që i dha jetë veprës së brezave të shkuar.

3. Dedikimi ndaj nevojtarëve

Cakto një kohë për ata që duan të ankohen. Gjatë saj të merresh vetëm me ta, të ulesh pranë tyre e ta ndiesh veten të përvuajtur për hir të Zotit dhe kujdesu që t'i largosh ushtarët, rojet dhe policët, që ai që do të flasë, të flasë pa ndrojtje, sepse kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të përsëriste shpesh: "Nuk mund të jetë kurrë i pastër një popull, që nuk e siguron të drejtën e të dobëtit përmes frikësimit të më të fortit". Duroje ngathtësinë dhe paaftësinë e tyre në të shprehur, shmange ngushtësinë dhe fudullëkun dhe kështu do të fitosh mëshirën e Zotit dhe shpërblimin e bindjes ndaj Tij. Çfarëdo lloj gjëje që t'u japësh, jepua me gëzim dhe kur t'i kundërshtosh, bëje me mirësjellje e duke u kërkuar ndjesë.

4. Domosdoshmëria e të bërit vetë të disa punëve nga ana e administratorit

Ka edhe disa punë, të cilave nuk mund t'u shmangesh e duhet t'i bësh vetë. Midis tyre janë përgjigjet për letrat e nëpunësve dhe të besuarve të tu, kur kjo është jashtë aftësive dhe kompetencave të sekretarëve të tu. E nëse mëson se njerëzit e tu nuk kujdesen sa duhet për hallet e shtetasve, merri ti vetë në dorë problemet e tyre. Mbaroje çdo ditë punën e caktuar për atë ditë, sepse çdo ditë ka punën e saj. Ruaj për vete pjesën më të mirë e më të madhe të kohës për t'ia kushtuar adhurimit të Zotit, përderisa bëhen me qëllimin e mirë për t'u ndihmuar krijesave të Tij.

5. Zbatimi i obligimeve

Ajo që jep dorë më shumë në mbajtjen pastër të besimit, është përmbushja e detyrimeve që lidhen vetëm me Zotin. Prandaj kushtoi kësaj pune një pjesë të energjive të tua, ditën apo natën dhe kujto që adhurimi që të jep afërsinë e Zotit është i plotë e pa të meta e mungesa, sado mundim që të kërkojë. E kur drejton lutjen (namazin) në publik, kujdesu të mos jenë tepër të gjata, sa të ngjallin mërzi por jo dhe shumë të shkurta e sa për sy e faqe, sepse në popull mund të ketë të sëmurë dhe njerëz që s'u pret puna. Kur më nisi për në Jemen i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* e pyeta si t'i bëja lutjet me njerëzit? Ai më tha: Falu me ta si i pafuqishmi midis tyre dhe si përjetues i problemeve të tyre.

6. Moszgjatja e shfaqjes përpara ndaj shtetasve

Mos u ndaj për shumë kohë nga shtetasit, sepse kur pushtetari shkëputet prej tyre, ngushton këndvështrimin e tij, e nuk i kupton më problemet e tyre. Veçimi prej tyre bën që këta të mos i dinë gjërat që duhet t'i dinë, kështu që problemet e mëdha nisin të shikohen si të vogla dhe të voglat si të mëdha, punët e mira

gjykohen si të këqija dhe të këqijat si të mira, kurse e vërteta ngatërrohet e nuk ndahet dot më nga e pavërteta. Tek e fundit, edhe guvernatori njeri është e s'mund t'i dijë gjërat që njerëzit në shërbim të tij ia fshehin. E vërteta nuk ka yll në ballë, që t'i dallojë nga e pavërteta shprehjet e ndryshme të saj. Për pasojë, ti mund të jesh veç dy llojesh: Ose prijës i zellshëm, i përkushtuar, i sinqertë dhe bujar në përmbushjen e të drejtave të tyre ; po pse, atëherë duhet të ndahesh nga njerëzit, përderisa i ke kryer detyrimet e Zotit ndaj tyre? Ose shpirtngushtë e dorështrënguar, armik i çdo forme të bujarisë, i ndryshuar nga frika e përhershme se mos njerëzit ta kuptojnë tipin dhe nuk kërkojnë më prej teje, ngaqë nuk kanë besim se mund t'i ndihmosh, harron që shumica e kërkesave të njerëzve nuk kanë të bëjnë fare me kuletën tënde, por vetëm me detyrimin tënd për të mos u hapur rrugë padrejtësive dhe për t'i bërë vend drejtësisë dhe barazisë.

7. Kontrolli specifik dhe rutinë

Çdo guvernator ka miq e njerëz që kanë lehtësi marrëdhëniesh me të. Shpesh këto lloje lidhjesh shpërdorohen e këta lloj njerëzish bëhen arrogantë e nuk pyesin fare për drejtësinë, nëse ke të tillë njerëzish rreth e qark, mos e zgjat, por shkulja rrënjën së keqes së tyre para popullit dhe përvëloi farat e tyre. Mos u dhuro toka miqve e përkrahësve e mos u ngjall kurrë shpresa se mund t'u japësh prona, që pastaj do mund t'i përdorin për t'u bërë dëm fqinjëve në periudhat e ujitjes e të shërbimeve të tjera. Këta njerëz e kanë zakon t'ua lënë të tjerëve në shpinë barrën e këtyre punëve. Pra, janë ata që përfitojnë, por faji të mbetet ty, si në këtë botë ashtu edhe në Ahiret.

Jepja të drejtën kujtdo që i takon, qoftë ky i afërm me ty a krejt i panjohur. Në këtë çështje duhet të jesh i vendosur e i kujdesshëm edhe sikur të kesh punë me farefisin dhe të dashurit e tu. Kujto

shpërblimin e asaj që është vërtetë e rëndë në të mbajtur. Vetëm ky lloj shpërblimi është i madh vërtet. E nëse shtetasit të fajësojnë ty për arrogancë dhe tirani, shpjegojua qëndrimin tënd dhe hiqua dyshimin me durim. Kështu do ta ruash fytyrën tënde e do t'i respektosh edhe ata e kështu do të ndihmohen dhe planet e tua për t'i mbajtur njerëzit në udhën e së drejtës.

8. **Leksione në moral, politikë dhe fe'**

Shmange vetëkënaqësinë, besimin e verbër në vete dhe etjen për lëvdata të tepruara, sepse këto rrugë pëlqen më shumë shejtani për zhvlerësimin e virtytit. Vrite dëshirën që shtetasit të ta quajnë borxh të mirën që u ke bërë, e mos ua hidh në sy se ia heq çdo vlerë; mos kërko prej tyre të ngrenë në qiell për punët që ke bërë, sepse lavdet hedhin terr mbi dritën e vërtetë; shmangi premtimet që pasojnë me shkelje, sepse premtimet që shkelen ndezin zemëratën e Allahut. Sepse Allahu i Lavdishëm thotë: "**Zoti urren mbi çdo gjë të thoni gjëra që s'i bëni**".

Mos u ngut në gjërat që s'u ka ardhur koha ende, mos ngurro në punët që janë tamam në kohë, mos ngulmo në çështjet që nuk dihet si do shkojnë, tregohu i palëkundur kur bëhet e qartë çdo gjë, jepi vendin që meriton çdo problemi dhe zgjidhe çdo problem në kohën që i takon.

Mëso e përvetëso gjënë që duhet gëzuar njësoj nga të gjithë, mos shpërfill problemet që dalin nga harrimi pas problemeve të tjera. Shpejt, nga sytë e tu do të bien të gjitha perdet, e ti do duhesh të ndreqësh me dëmshpërblim. Mbaje nën kontroll masën e prestigjit, shpërthimin e inatit, fuqinë e krahut dhe mprehtësinë e gjuhës. Bëj kujdes në këto gjëra, shmange nxitimin dhe vonoje veprimin, deri sa inati të fashitet e të rifitosh vetëkontroll. Por ti nuk do mund ta mbrosh veten nga këto të meta, në mos u kujtofsh që tek Zoti është rikthimi. Mëso nga përvoja e mirë e prijësve të

shkuar, qofshin qeveri, tradita me vlerë, pasardhës të Pejgamberit *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* apo urdhra Kur'anore. Mbaji parasysh e vepro mbi bazën e tyre, ashtu si na ke parë edhe ne të veprojmë. Përpiqu për zbatimin e udhëzimeve të kësaj letre dhe përmbushi deri në një shpresat që kam vënë tek ti, e kështu s'do mund të kesh arsye pse t'i shkosh zemrës pas, nëse ta tundon pasioni.

B. Shërbimi burokratik (ministrat)

1. Zgjedhja dhe testimi i tyre në emërim

Pastaj kujdesu për bashkëpunëtorët dhe sekretarët e tu. Cakto njerëz të zgjedhur për t'u marrë me punët e tua. Besoja dokumentet e tua një njeriu me karakter të lartë, sidomos ato që kanë sekrete e lidhen me politikën, një njeriu që nuk ekzaltohet nga besimi që i jepet dhe që nuk thotë fjalë që do mund të prishin punë në mjediset publike. Atij nuk i lejohen parregullsitë në paraqitjen e raporteve të zyrtarëve e në përcjelljen korrekte të vendimeve që janë marrë për probleme të ardhurash dhe pagesash. Atij nuk i lejohet të bëjë në emrin tënd ujdia që janë në dëmin tënd. Atij nuk i lejohet ngurrimi në mospranimin e marrëveshjeve që janë në dëmin tënd. Atij nuk i lejohet të mos njohë kompetencat që kanë lidhje me çështje të ndryshme, sepse ai që nuk e di se çfarë i lejohet, është shumë më i paditur kur bëhet fjalë për të tjerët.

Prandaj mos zgjidh me hamendje apo për hir të afërsisë e përshtypjes tënde të mirë. Shpesh njerëzit gjykohen me sjellje të shtira dhe shërbime personale, por kjo nuk ka të bëjë me qëllimet e mira dhe besimin. Është më mirë t'i gjykosh nga ç'kanë bërë nën drejtimin e njerëzve të virtytshëm, që punuan me ta para teje.

Vendos pro atyre me emër të mirë mes njerëzve të thjeshtë dhe me nam për ndershmëri. Kështu do dëshmosh nderimin tënd për Zotin dhe atë, në emër të cilit je në atë post. Cakto në krye të çdo seksioni njerëz me dije e përvojë të madhe, që nuk hutohen nga punët e mëdha e nuk shastisen nga moria e madhe. Nëse nëpunësit e tu bëjnë gabime që ti nuk kujdesesh për t'i shmangur e ndrequr, përgjegjësia e tyre bie mbi ty.

2. Zhvendosja e atyre që kanë sekrete të këqija

Më i keqi ministër për ty do të ishte ai që u ka shërbyer atyre që drejtuan keq përpara teje e që u bashkuan me ta ne mëkat, prandaj mos e bëj një të tillë njeriun tënd të rëndësishëm, sepse do t'u bëhet njerëzve të ligj krah dhe tiranëve vëlla. Gjej në vend të tij një që ka zellin dhe autoritetin e tij, por jo dhe mëkatet dhe veset e tij. Gjej atë që nuk i ka ndihmuar kurrë tiranët në tiraninë e tyre, e as mëkatarët në mëkatin e tyre. Atë që do t'i kursejë shqetësimet dhe do të bëhet mbështetësja jote më e mirë. Atë që do të ketë respektin më të lartë ndaj teje e s'do ta mbajë mendjen tek të tjerët. Pra, të tillë t'i zgjedhësh bashkëpunëtorët e tu më të ngushtë, si në jetën private dhe në atë publike. Më të mirët për ty midis tyre do jenë ata që ta thonë hapur të vërtetën e që nuk të përkrahin në ato punë që Zoti ua ndalon njerëzve të Tij dhe jo ata që të vijnë pas qejfit e që pajtohen me çdo gjë që bën e thua. Mbaj pranë ata që i druhen Zotit e që e duan të vërtetën. E, më në fund, mos mëso njeri të lëvdojë e lajkatojë për veprime që nuk i ke bërë, sepse teprimi në lavde shpie në krenari dhe krenaria shpie në arrogancë. Mos u jep të njëjtin pozicion e trajtim njerëzve të virtytit e të vesit, ndryshe i virtytshmi zverdhet prej virtytit, ndërkohë që perversi gjen mbështetje për vesin e tij. Jepi secilit vendin që i takon.

C. Drejtësia

1. Përzgjedhja e gjykatësit

Zgjidh për sheshimin e mosmarrëveshjeve të njerëzve më të shquarit ndër njerëzit e tu. Ai që merret me këtë punë, nuk nervozohet nga problemet që duhet të zgjidhë. Hetimi nuk ia sos dot durimin dhe nuk është kryeneç nëse tregohet këmbëngulës. Ai s'e ka të vështirë ta pranojë të vërtetën sapo e shquan, lakmia nuk ia errëson sytë e nuk kënaqet me vlerësime të cekëta të çështjeve, por thellohet mirë në to, është i gatshëm të ndalet në pikat e dyshimta dhe tregohet i vëmendshëm ndaj provave. Atë nuk e nervozojnë, as e neveritin grindjet e ngatërrestarëve, sepse është i durueshëm në zhbirimin e mistereve dhe i guximshëm kur vjen koha për vendim. Atij nuk i rritet mendja nga lëvdatat dhe lajkat nuk e bëjnë dot të anshëm. Njerëz të tillë ka pak.

2. Analiza e vendimeve, dhënia e shpërblimit gjyqtarit dhe pavarësia e gjykatësit

Vendimet e tyre t'i kontrollosh shpesh e t'i shpërblesh sa të mos kenë shfajësim, pse nuk kanë qenë të ndershëm e të mos drejtohen tek ata që gjykojnë për të zgjidhur hallet që kanë. Jepu rang e prestigj në rrethin tënd që të ndihen të mbrojtur nga kërcënimi i pushtetarëve të tu e të mos kenë frikë nga hakmarrjet e tyre. Në këto gjëra duhen sy të mprehtë, sepse kjo fe' ka qenë peng i njerëzve perversë, sa kohë që punët bëheshin pas qejfit dhe kamja ishte e vetmja vlerë e kësaj bote.

D. Aparati ekzekutiv

1. **Emërimi i tyre pas përzgjedhjes dhe testimit**

Pas kësaj, vendos për nëpunësit që merren me zbatimin e vendimeve. Jepe këtë post vetëm pasi t'i kesh vënë nën provë e mos bëj emërime për hatër e favore, sepse kështu vret nderin dhe drejtësinë. Zgjidh nga ata që kanë përvojë e thjeshtësi, pinjollë të familjeve të virtytshme e që janë futur herët në islam, sepse njerëz të tillë kanë nder të pastër dhe dinjitet. Njerëz si këta shohin fundin tek çdo gjë, prandaj edhe nuk priren drejt lakmisë.

2. **Dhënia e mjeteve të bollshme të jetesës**

Jepu mjete të bollshme jetese me anë të pagës që të përmbahen e të mos u shkojë ndërmend të vënë dorë mbi fondet që kanë nën kontroll. Kështu do kesh një argument kundër tyre nëse nuk u binden urdhrave të tua e nëse shkelin besimin tënd.

3. Kontrollimi i punëve të tyre dhe dënimi i atyre që tradhtojnë

Mbaje nën kontroll punën e tyre e vura pas shpine spiunë besnikë e të besueshëm, sepse përgjimi është mjeti që i bën të ta ruajnë besën e të sillen njerëzisht. Ruhu nga nëpunësit e pandershëm. Nëse ndonjëri prej tyre shtrin duart drejt abuzimit e kjo provohet nga raportet e agjenturës, ato duhen parë si prova të mjaftueshme. Atëherë, ndëshkoje trupërisht e merrja prapë atë që ka marrë, pastaj vendose në një vend të turpshëm, fute në listën e zezë, si të fajësuar për shpërdorim dhe shtrëngoje të mbajë kularin e turpit për krimin që ka bërë.

H. Çështjet ushtarake

1. Përcaktimi i komandantëve të ushtrisë

Cakto të komandojë njerëzit e t'u atë që ti mendon se është besnik i paepur i Zotit, pejgamberit të Tij dhe imamit tënd, atë më të dëlirin në zemër e më të lartin në qëndresë, atë që është i ngadalshëm në të zemëruar, që pranon ndjesë, është i ëmbël me të dobëtin dhe i pamposhtur me të fortin. Dhuna nuk e shpie në ekstazë dhe dobësia nuk e rrëzon në limonti. Prandaj mbaj shoqëri me njerëz kurajoz, trima, bujarë e mirëdashës, sepse ata janë bastione të nderit dhe burime të virtytit.

2. Inspektimi i komandantëve të ushtrisë dhe nderimi i atyre që janë punëmirë

E, pasi t'i gjesh, kujdesu për punët e tyre ashtu siç kujdeset prindi për fëmijën e tij. Asgjë që ke bërë për të mirën e tyre, nuk duhet gjykuar si e madhe dhe asgjë që ke marrë përsipër që të bësh për të, nuk duhet gjykuar e vogël, qoftë edhe sikur të jetë vërtetë e vogël. Kjo do t'i bëjë besnikë të tu për kokë dhe do krijojnë mendim të mirë për ty. Mos lër pas dore përkujdesjen për problemet e tyre të vogla duke u harruar në problemet e tyre të mëdha, sepse për ta kanë vlerë edhe favoret e tua të vogla, kurse angazhimet e mëdha janë vetë të atilla, që nuk mund të shpërfillen.

Vendos në postet më të larta ata që ndihmojnë njësoj të gjithë luftëtarët e shpenzojnë për ta e për familjet e tyre që mbeten pas, që të mos kenë merak tjetër, përveç shkatërrimit të armikut. Vetëm me mirësi do t'i kthesh e lidhësh pas teje zemrat e tyre. Gjëja më e pëlqyer për një prijës është bërja e drejtësisë në sektorin që drejton dhe fitimi i besimit të vartësve, e nëse zemrat janë të

pastra, këto arrihen vetvetiu. Pastaj ata bëhen gardh rreth tij për t'ia mbrojtur jetën me jetët e tyre, duke dëshmuar fisnikërinë e përkushtimit të tyre ndaj tij. Pra, askush s'e sheh si barrë detyrën e tij e nuk pret me padurim ditën kur nuk do të jetë vartës i tij. Prandaj, ji i gjerë në gjërat që duan, jepu zemër e tregoju bëmat e mira të atyre që kanë bërë të tilla, sepse shembulli i mirë ngjeth guximtarët dhe trimëron të dobëtit. Mate veprën e secilit veç e veç, mos ia vish punën e njërit tjetrit dhe mos e ul shpërblimin nën nivel të punës. Mos i shih si të mëdha punët e vogla të eprorëve të tyre dhe si të vogla punët e mëdha të vartësve të tyre. Besoja Zotit dhe Pejgamberit të Tij problemet e mprehta dhe çështjet e paqarta, sepse Zoti u ka thënë njerëzve që donte t'i shpinte në rrugën e mbarë: "**O ju që besoni! Binduni Zotit, binduni Profetit dhe binduni të veshurve me pushtet mes jush; e në se pas kësaj nuk do pajtoheni në diçka, drejtohuni për të tek Zoti dhe Profeti, ne se besoni tek Zoti dhe Dita e Fundit**"[1].

Këtu, t'i drejtohesh Zotit do të thotë të veprosh në pajtim me atë që shpreh qartë Libri i Tij dhe t'i drejtohesh Profetit do të thotë të veprosh në pajtim me synetin e tij, të pranuar nga të gjithë.

3. Paqja me armiqtë

Mos e refuzo paqen, kur ta kërkon armiku. Zoti kënaqet me të, sepse u sjell prehje ushtarëve të tu, lehtësim halleve të tua dhe siguri vendit tënd. Veç tregohu i matur me të dhe vepro me pjekuri. Ruaje dyshimin tënd për armikun edhe pas vendosjes së saj, sepse mund të ndodhë që paqja të jetë kurth për vigjilencën.

1 Suretu En Nisa, ajeti 59.

4. Mbajtja e premtimit

E nëse bën marrëveshje me armikun e hyn në traktate me të, zbatoi me korrektesë kushtet e saj dhe mbaji premtimet që ke marrë. Bëje veten peng të premtimit, sepse asnjë nga detyrimet që na ka vënë Zoti nuk i bën njerëzit aq të ndjeshëm sa thyerja e premtimit, pavarësisht dallimeve në pikëpamjeve. Jo më myslimanët, por edhe të pafetë i respektojnë marrëveshjet, sepse edhe ata i kuptojnë rreziqet që sjell shkelja e tyre. Prandaj mos i dil fjale armikut, sepse askush nuk mund ta fyejë Zotin, veçse në qoftë pervers dhe i paditur. Marrëveshjet dhe premtimet e bëra në emër të mëshirës së Zotit, janë simbolet e sigurisë që Zoti u jep njerëzve të tij, ato janë streha ku gjendet mbrojtja e Tij dhe kërkohen bekimet e afërsisë së Tij. Prandaj, mos fut në to mashtrim, dredhi apo hipokrizi.

Mos hyr në marrëveshjen që lejon interpretime, po nëse ke hyrë, mos provo të kapesh pas fjalëve të saj të paqarta. E nëse një e tillë të vë në gjendje të vështirë, mos kërko ta hedhësh poshtë pa asnjë shkak, sepse është më e mirë paqja e përballjes me problemin, se sa shkelja e marrëveshjes që tremb. Zoti do kërkojë llogari për të kur të mos mundesh më t'i lypësh ndjesë, qoftë në këtë jetë apo në jetën tjetër.

5. Shmangia e gjakderdhjes me të padrejtë

Shmange gjakderdhjen e kotë, sepse asgjë tjetër nuk e ndjell më shumë shpagimin e Zotit, se sa derdhja e gjakut pa asnjë shkak. Pasojat e saj janë fatale në shkatërrimin e bekimeve të Tij dhe në shfarosjen e krijesave të Tij. Prandaj dhe Dita e Fundit do fillojë me gjyqin e gjakderdhësve. Mos e rrit pushtetin me derdhje gjaku të ndaluar, se kjo ta dobëson dhe ul prestigjin dhe çon në shkatërrimin e zhvendosjen e tij. Ti nuk mund të përligjësh para

Zotit dhe meje për vrasjet e qëllimshme, sepse për to ka hakmarrje. Por ndodh që vdekja vjen edhe nga shkaqe të vogla ose shkaktohet gabimisht, nga teprimet në kërbaç apo shpatë dhe ashpërsia në ndëshkim, në këto raste posti yt si pushtetar nuk ta jep të drejtën të mos ua paguash çmimin e gjakut njerëzve të afërm të viktimës.

E-Qeveria dhe populli

1. Udhëheqja e opinionit të përgjithshëm

Lakmo të ecësh më shumë në rrugën që është më e paanshme në lidhje me të drejtën, më e gjithanshme në bërjen e drejtësisë dhe më e favorshme në sigurimin e mbështetjes së popullit. Pakënaqësia e njerëzve të thjeshtë nuk do t'ia dijë për argumente, ndërkohë që kundërshtimi i pak njerëzve të rëndësishëm edhe mund të shpërfillet, po qe se ndjen pas shpine mbështetjen e njerëzve të thjeshtë, sepse asnjë shtetas tjetër nuk është për sundimtarin më i bezdisshëm në çështjet e jetës së përditshme, më pak i gjendur në vështirësi, më armiqësor ndaj trajtimit të paanshëm, më i ngjitur në kërkimin e favoreve, më pak mirënjohës në kohën e shpërblimit, më i paqartë në shkaqet e mospranimit dhe më i paqëndrueshëm në çaste delikate, se sa njerëzit e elitës. Janë njerëzit e zakonshëm të shoqërisë shtyllat e fesë, fuqia e vërtetë e myslimanëve dhe mburoja kundër armiqve. Prandaj simpatitë e tua duhet të jenë për ta dhe prirja jote duhet të jetë drejt tyre.

2. Shtresat e shoqërisë

Dije se popujt përbëhen nga grupe që përparojnë vetëm me ndihmën e njëri-tjetrit e që nuk ekzistojnë dot pa njëri-tjetrin. Në ta bëjnë pjesë ushtria e Zotit, drejtuesit që qeverisin punët e

njerëzve të thjeshtë së bashku me nëpunësit e tyre. Pastaj ata që bëjnë drejtësinë e punojnë për ligjet e rendin, mbledhësit e taksave e të ardhurave nga myslimanët e thjeshtë dhe paganët që janë nën mbrojtjen e islamit, tregtarët dhe njerëzit e prodhimit dhe së fundi klasa më e ulët e nevojtarëve dhe mjeranëve. Zoti e ka fiksuar pjesën e secilit me Librin e Tij dhe praktikën e pejgamberit të Tij *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* duke shpallur të drejtat dhe detyrat e çdo grupi në një rregullore që duhet respektuar e mbajtur parasysh.

3. Tiparet e shoqërive

E pra, me vullnetin e Allahut, ushtria është fortesa e popullit, stolia e sundimtarëve, fuqia e fesë dhe garanti i paqes. Populli nuk e ruan dot pa të ekzistencën e tij, po edhe ushtria nuk mund të mbahet, veçse me fondet që caktoi Zoti në të ardhurat e tij, me to ajo forcohet për të luftuar kundër armiqve, në to mbështetet për pajisjen e saj dhe ato përmbushin nevojat e njerëzve të saj. Këto dy shtresa nuk mund të bëjnë pa një grup të tretë, që janë gjykatësit, përmbaruesit dhe sekretarët, të cilët marrin vendime për kontratat, mbledhin të ardhurat dhe trajtojnë çështje të veçanta e të përgjithshme.

Pa tregtarët e prodhuesit nuk mund të ekzistojë asnjë prej tyre, sepse ata i sigurojnë mjetet e nevojshme, krijojnë tregjet dhe u mundësojnë njerëzve të mos merren vetë me gjithë këto gjëra. Pastaj është shtresa më e ulët e të varfërve dhe mjeranëve. Ndihma dhe mbështetja e tyre përbën detyrim për hir të Zotit, sepse secili nga ata ka pjesë në mjetet e jetesës sonë dhe secili nga ata e ka tek sundimtari të drejtën e tij për çfarë i duhet për të jetuar normalisht. E sundimtari nuk mund ta shfajësojë veten për detyrimet që i ka vënë Zoti në këtë pikë, veçse duke u përpjekur, duke kërkuar ndihmë prej Tij, duke e vënë veten në anën e të

drejtës dhe duke bërë durim për gjërat që kanë të bëjnë me këtë çështje, qofshin ato të lehta apo të vështira.

4. Nuk ka tatime pa kultivimin e tokës

Bëj kujdes në mbledhjen e tatimeve, paguaji mirë nëpunësit e tyre, sepse nga mirëqenia e tyre varet mirëqenia e të gjithë shoqërisë. Askush nuk mund të ketë bollëk pa punën e tyre, sepse shteti mbahet me tatimet dhe nga paguesit e tyre. E kjo nënkupton që të kujdesesh më shumë për kultivimin e arave se për mbledhjen e tatimeve, sepse nuk ka të ardhura pa bujqësi. Kush kërkon të ardhura në rrugë tjetër, rrënon vendin, mjeron njerëzit dhe shkurton ditët e sundimit të vet. E nëse ka ankesa për detyrimet, sëmundjet, mungesën e teprinë e ujit apo varfërimin e tokës, përmbytjet e thatësira, kthejua prapë tatimet në masën që nevojitet për të ndrequr gjendjen.

5. Mirëqenia e popullit është mbështetje e arkës së shtetit

Mos shpenzo me gjysmë zemre fonde që shkojnë për përballimin e fatkeqësive, sepse ky është investim që rikthehet në formën e lulëzimit dhe përparimit të vendit tënd, përveç që do fitosh nderimin e shtetasve dhe paqen e drejtësisë që bëre për ta. Ky investim për lehtësimin e halleve të tyre dhe drejtësia që u dhe do të japin të drejtën të kërkosh prej tyre dhe të gëzosh besimin e tyre. Mund të ndodhë të nevojitet ndihma e tyre, e ata do të jenë të lumtur të ta japin, sepse mirëqenia përball gjithçka që i kërkon. Kur bujqit varfërohen vendi rrënohet, por ata varfërohen edhe kur nëpunësit e tyre e kanë mendjen vetëm t'u marrin taksa, pa kuptuar që kjo shteron çdo shpresë për t'i mbajtur gjatë postet e tyre dhe pa nxjerrë dobi nga shenjat që ndjellin keq.

6. Tregtia dhe prodhimi

Tani ca këshilla për tregtarët dhe zejtarët. Trajtoi mirë këta njerëz dhe këshilloi, qofshin të ngulur (tregtarë me dyqane), shitës ambulant apo zejtarë, sepse prej tyre burojnë të ardhurat që vijnë mallrat e nevojshme që nga vende të largëta e të panjohura, në rrugë detare e tokësore, nëpër fusha e male dhe prej viseve ku të tjerët nuk shkojnë dot e as guxojnë që të nisen. Kjo sepse janë njerëz paqësorë, nuk përzihen me trazira dhe nuk e njohin pabesinë. Kujdesu për ato punë të tyre që kanë të bëjnë me ty, pavarësisht se ku ndodhen në territoret që ke nën kontroll.

7. Luftimi i monopolizimit

Po mos harro, pjesa e tyre më e madhe janë mendjengushtë, egoistë dhe dorështrënguar. Shpesh heqin mallra mënjanë për të rritur fitimet dhe vendosin çmime të larta. Veprimet si këto u sjellin njerëzve kokëçarje dhe njollosin nëpunësit që janë ngarkuar të merren me ta. Mos i lejo të fshehin mallra, sepse pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e ka ndaluar këtë gjë. Kushdo që fsheh mall pasi është ndaluar fshehja e tij, duhet dënuar rreptë për aq sa ka bërë shkelje, qoftë shitës apo blerës.

8. Caktimi i çmimeve dhe kontrollimi i peshoreve

Shitja duhet bërë me mirësjellje, me pesha dhe çmime korrekte dhe pa i hyrë në hak asnjërës palë.

9. Siguria shoqërore

Mbaje Zotin parasysh në lidhje me shtresën e ulët, atë që përbëhet nga njerëz me pak mjete jetese, nga të varfër dhe mjeranë, nga ata që nuk kanë grosh në xhep dhe janë të gjymtuar. Kësaj shtrese i përkasin të pakënaqurit dhe ata që vetëm lypin. Për hir të Allahut përmbushi detyrimet që Ai ka ndaj tyre e që t'i ka lënë në dorë ty. Cakto për ta një pjesë të fondeve publike, si dhe një pjesë tjetër nga prodhimet që vijnë si plaçkë lufte nga vendet e tjera, sepse këto u takojnë njësoj të gjithëve, të largët a të afërt

qofshin. Këta janë ata njerëz, për të drejtat e të cilëve ti do përgjigjesh, prandaj as posti dhe as jeta jote private nuk duhet të mbajnë larg tyre. Nuk të lejohet të përligjësh lënien pas dore të problemeve të vogla, ngaqë trajton probleme të mëdha. Prandaj, mos ji shpërfillës me ta e mos ua kthe shpinën me arrogancë.

Kujdesu për problemet e atyre që s'të afrohen dot, ngaqë kanë pamje të pakëndshme dhe sëmundje të liga apo sepse mbahen si tepër të ulët. Caktoju kujdestarë të besuar, të përvuajtur e të përkushtuar ndaj Zotit dhe kërkoju raport për ngjarjen e tyre. Sillu me të mjerët me shqetësimin e përgjegjësisë ndaj Zotit në Ditën kur do t'i dalësh përpara, sepse janë ata që e meritojnë më shumë vëmendjen dhe përkrahjen tënde nga gjithë shtetasit e tjerë. Por, mos lër mënjanë as të drejtat e ca mjeranëve të tjerë, për të cilët do përgjigjesh veçmas përpara Zotit. Kujdesu për jetimët dhe të moshuarit, që s'kanë asnjë mjet jetese e që as të lypin nuk e bëjnë dot. Nuk është e lehtë për njerëzit e t'u që ta përballin këtë detyrë në fakt, çdo e drejtë është e rëndë, po Zoti ua bën të lehtë atyre që e duan botën tjetër, që durojnë për hir të saj dhe që besojnë në përmbushjen e premtimit të Tij.



I PARI QË KA REFORMUAR SISTEMIN E BURGJEVE NË ISLAM[1]

1. Para islamit, e deri në kohën e kalifëve të udhëzuar, burgjet në Medine kanë qenë si puse të errëta dhe kur Zuberkan ibn Bedri i bëri apel kalifit Omer ibn Khatabit për degradimin e poetit dhe i pohoi se ai e satirizuar atë duke thënë: Qetësohu dhe qëndro në punët e mira e mos u largo nga harami i tyre, por qëndro ulur se me të vërtetë ti je i ushqyer dhe veshur mirë.
Omeri i tha: Unë nuk mendoj se kjo është satirë, kurse Zebërkani thotë: Pyet të birin e Feriut do me thënë Hasan ibn Thabitin e nëse nuk është satirike, atëherë mos vepro kundër tij dhe ai dërgoi një njeri tek Hasani dhe e pyeti: A e ka satirizuar atë me fjalën e tij (dhe rri ulur se ti je i mirëushqyer dhe i veshur mirë)? Ai tha: Po e ka satirizuar në formën më të shëmtuar. Kalifi e burgosi atë në një burg të errët dhe ai filloi të bënte vjersha gjatë kohës që ishte i burgosur duke kërkuar mëshirë dhe falje.

1 Dijuanul Hatie /206-208. Kitabul Khuraxhi i Ebi Jusuf /149,150. El Akdul Feridu 4/183. Xhumhuretul emthali 1/79. Dijuanu Sherif Murteda 3/162-164. Lisanul arab lënda (kha, ja. sin). El Uesailu ila musameretil Auail /45,55. Taxhul Arus, lënda (kha, ja, sin). El Gadiru 4/279.

Kalifi e liroi atë pasi mori premtimin se nuk do të satirizojë askënd, por është thënë: Se i ka blerë prej tij nderet e myslimanëve për tremijë derhem. Kur imam Aliu e zhvendosi selinë e kalifatit në Kufe, ndërtoi në të burgun e parë në islam dhe e quajti atë me emrin dobia dhe ishte i ndërtuar me kallame, jo shumë i fortë si ndërtim, pastaj e prishi atë dhe në vend të saj ndërtoi një burg më të fortë dhe ishte i ndërtuar prej balte.

2. Autoritet gjykuese shpenzonin për njeriun e burgosur prej pasurive të veçanta nëse kishte, ose në të kundërt, nëse nuk kishte para për ta burgosur, ai lihej i lirë i lidhur me zinxhirë duke ecur nëpër rrugë që të jepnin njerëzit sadaka për të, e më pas me ato lekë e mbanin në burg. Kur çështja shkoi tek imam Aliu *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij),* ai këshilloi që të merrej nga arka e myslimanëve para për të burgosurit aq sa u duhej atyre për t'u mbajtur me ushqim, bashkë me veshjet dimërore dhe verore.

Muavija ibn Ebu Sufjani u inatos kur iu plotësua atij urdhri, pastaj riktheu në rrugë një pjesë të beni Mervanëve që të nxirrnin të burgosurit në rrugë që njerëzit të jepnin ndonjë sadaka për ata. Ndërsa në kalifatin e Omer ibn Abdulazizi, ai ndoqi rrugën e imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe askush tjetër më pas nuk e kundërshtoi këtë, pastaj zakoni i amnistisë në ditët e kalifatit të disa prej beni Abbasëve.



ËSHTË I PARI QË KA THEMELUAR RREGULLIN E POLICISË[1]

(Esh-shurta) e ka njëjësin (shurtatu) do me thënë policë dhe ata janë një grup ushtarësh që prijësi i besimtarëve i ka zgjedhur vetë dhe i ka ndarë ata në grupe për një luftë të shpejtë, blic dhe detyra e tyre është përgatitja për të vdekur dhe që të jenë në krye të ushtrisë, kur ajo sulmon armiqtë, ata janë njësoj siç u thuhet sot policisë me emrin forcat e ndërhyrjes së shpejtë dhe imami i pati vënë emrin atyre trupat e policisë ose policia ushtarake.

Më pas punët e kësaj agjencie u zgjeruan shumë në kohën e kalifatit të imamit *(Paqja qoftë mbi të!)*kur iu shtua atyre edhe përkrahja e kadive në realizimin dhe përfundimin e akuzës dhe mbështetjen e qeverisë në zbatimin e ligjeve të saj dhe ata i bëri të kenë një shenjë dalluese të veçantë dhe u vuri atyre një kryetar që mori emrin shefi i policisë dhe i caktoi atij ndihmës dhe sekretarë.

Ky lloj profesioni kishte një rëndësi të jashtëzakonshme, pasi në të nuk emërohej askush, vetëm nëse njihej për guximtar, të besueshëm dhe të drejtë dhe rëndësia e tyre shkonte deri aty sa

1 Uak'atu Sifijni /406. Tarikhu Tabirij 5/163,164. En Nihaje i ibn Ethir 2/460. Keshful Gummeh i Erbelij 1/275. Lisanul arab, lënda (shin, ra, ta). A'janu Shi-ia 12/271. El Gadiru 2/103. En Nudhumul islamijjeh /333. El kamusul Islamij 4/78. Hajatul imam el-Hasan 2/385. Nidhamul hukume uel idare fil Islam /377,388.

dëshmia e tyre ishte baras me dëshminë e dy burrave, pozita e shefit të policisë ishte prej pozitave shumë të larta dhe ai zbatonte detyrat e guvernatorit në mungesë të tij. Prej kryetarëve të policisë në kohën e imamit kanë qenë: Asbagu ibn Nebate et Temimi dhe kur prijësi i besimtarëve po u fliste shokëve të tij në një prej ditëve të Safeinit duke i nxitur ata për luftën, Asbagu u ngrit e tha: O prijësi i besimtarëve, ti më ke bërë mua në krye të trupave policore dhe më ke dhënë mua përparësi ndaj të tjerëve dhe nuk ka dyshim se ti sot nuk do ta humbësh as durimin e as triumfin.

Një prej tyre është edhe shoku i nderuar Kajs ibn Sa'di ibn Ubade el Ensarij dhe ka qëndruar në detyrë deri në periudhën e imam Hasanit ibn Aliu dhe kur u bë paqja mes Hasanit dhe Muavijes, Kajsi u betua bashkë me policët e tij që të luftonin Muavijen derisa t'i kushtëzohet atij ndjekja e rrugës së imam Aliut, prijësit të besimtarëve dhe të kushtëzojë pasuritë dhe gjaqet e tyre, por Muavija iu përgjigj kushteve të tij dhe i pranoi ato. Ajo që meriton të përmendet është se i pari që ka themeluar sistemin e patrullimit që janë ata të cilët patrullojnë natën për të ruajtur njerëzit dhe zbulojnë njerëzit e terrorit është kalifi Omer ibn Khatabi dhe dihet se rëndësia e patrullimit nuk është si rëndësia e policisë.



ËSHTË I PARI QË KA ZGJERUAR HETIMIN E NGJARJES DHE KA NDARË ARMIQËSITË[1]

Një vajzë jetime shumë e bukur jetonte tek një burrë, mirëpo gruaja e tij u frikësua se mos burri i saj mund ta martojë atë, kështu që e rrëmbeu atë dhe e vuri në gjendje të dehur. Ajo u ndihmua nga disa fqinje që i besonte, e kapën atë dhe ia mori virgjërinë me gishtin e saj. Kur burri i saj erdhi, ajo e akuzoi vajzën për gjënë e shëmtuar dhe ia provoi atë nëpërmjet fqinjëve të saj, mirëpo çështja shkoi deri tek imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe e pyeti gruan për faktin, provën dhe ajo tha: Këto janë komshinjtë e mi dhe imami nxjerr shpatën nga milla e tij dhe e mban përpara. E fton gruan e atij burrit dhe e solli atë rrotull në çdo lloj mënyre, por ajo refuzoi të lëvizte nga qëndrimi i saj, mirëpo imami nuk e pranoi atë version dhe urdhëroi që ta izolonin të vetme dhe ftoi një nga dëshmitaret dhe imami ra në gjunjët e tij dhe i tha asaj: Gruaja e atij burri tha diçka por nëse ti nuk më thua të vërtetën do

1 Dijvanu Sahib ibn Ubad 68/71. El Euailu i Ebi Hilal el Askerij/168. Xhumhuretul Emthal 1/93. El Irshad /115. El Menakibu i ibn Shehri Ashub 2/33,34,359,372,379. En Nihajetu i ibn Ethir 3/273. Meathirul enaka fi mealimil khilafe i Kalkashendij 3/342.

ta këpus kokën me këtë shpatë dhe ajo tha: Më mirë garancinë e sinqeritetit o babai Hasanit, ai tha: Atëherë thuaje të vërtetën, e ajo tha: Jo për Zotin, me të vërtetë ajo grua e pa bukurinë e asaj vajze dhe u frikësua se mos burri i asaj e dashuronte atë, kështu që e dehu, na thirri neve dhe ne e kapëm atë, kurse ajo e ç'virgjëroi me gishtin e saj, kurse imami tha: Allahu është më i madhi, unë jam i pari që i ka ndarë dëshmitë e dëshmitarëve.

Kështu që asaj gruaje i dha dënimin me goditje gurësh, kurse dëshmitarët i ngarkoi me pagesën e virgjenitetit të vajzës dhe e caktoi si çmim katërqind derhem "el-akru". Ajo është pagesa që gruaja jep nga bashkimi i dyshimtë dhe e urdhëroi gruan që të harrojë burrin dhe burri ta ndajë atë pastaj të martohet me jetimen.

Një ditë prijësi i besimtarëve hyri në xhaminë e Kufes dhe pa një djalë që po qante dhe e pyeti atë se pse qante, kurse ai tha: Me të vërtetë që trupi gjykues nuk dha një vendim të drejtë për mua dhe ai tha: E çfarë problemi ke ti? Ai tha se një grup njerëzish dhe bëri me shenjë te një grup që ishte aty prezent e morën babain tim me vete në një udhëtim, por ata u kthyen pa të dhe i pyeta ata për të dhe thanë: Ai vdiq, i pyeta ata për pasurinë e tij që kishte me vete dhe thanë se nuk dimë gjë për pasurinë e tij, kurse trupi gjykues i vuri të bëjnë betimin dhe më urdhëroi mua që të mos kontradiktohesha më me ta. Imami *(Paqja qoftë mbi të!)* u kthye nga Kunberi djali i tij dhe i tha: Mblidhi njerëzit dhe thirri të vijnë këtu policia ushtarake, pastaj u ul në karrigen e gjykatësit dhe i pyeti njerëzit për atë që pretendonte ai djalë, por ata iu përgjigjën njësoj si më parë: Se ai vdiq dhe nuk e dinin në kishte pasuri me vete.

Imami pa me imtësi në fytyrat e tyre dhe tha: A mendoni se unë nuk e di se çfarë keni bërë me atë njeri? Atëherë unë me të vërtetë që paskam pak njohuri. Pastaj urdhëroi që t'i ndajnë dhe

thërriti sekretarin e tij Ubejdullah ibn Ebi Rafiu që të regjistrojë deklaratat. Ai kërkoi që të thërriten të akuzuarit dhe i pyeti ata një e nga një, se si kishin shkuar dhe ishin kthyer për vitin, muajin dhe ditën e tyre, për sëmundjen e atij burri dhe vdekjen, larjen dhe qefinosjen, për faljen e xhenazes, për varrosjen dhe vendin e varrit të tij.

Sa herë imami merrte dëshminë e njërit e madhëronte Allahun me zë të lartë prej asaj që përfitonte prej secilit prej tyre, pastaj urdhëronte që ta çonin atë në vendin e tij dhe t'i sillnin tjetrin. Kur i erdhi radha personit të katërt, ai filloi të belbëzonte dhe imami që e qortonte ashpër dhe e frikësonte duke e lajmëruar atë për informacione kontradiktore nga ata që ishin para tij. Ai e kuptoi që ata e kishin vrarë atë dhe i kishin marrë pasurinë dhe se e kishin varrosur diku. Më pas imami u kthye dhe thërriti ata persona që ishin përgjigjur më parë një e nga një dhe i thoshte atij: Personi që ishte para teje më konfirmoi duke thënë të vërtetën për situatën tënde dhe unë tani e kam të qartë çështjen tuaj, kurse ai e pohonte atë njësoj si shoku i tij.

Kështu dha urdhër që djalit t'i kthehej pasuria dhe ia la atij në dorë gjykimin e tregimit të vrasësve. Djaloshi i ri e mori pasurinë dhe ua fali atyre gjakun, kurse disa burime thonë se imami i vrau ata. Poezia dëshmoi se prijësi i besimtarëve, Malikut ibn Zejd Menati e ka thënë atë kur ka parë vëllain e tij Sa'din që kishte përmendur devenë e tij, por nuk kishte mundur dot të qëndronte në të dhe ai dërgoi një shembull të një njeriu për t'i rënë shkurt çështjes duke preferuar qetësinë.



ËSHTË I PARI QË KA BËRË LIGJ TË DREJTËN PUBLIKE NË ISLAM[1]

Një njeri solli dikë tjetër tek Ebu Bekri dhe i tha: Me të vërtetë, ky ka thënë se ka parë në ëndërr nënën time, kalifi u habit shumë me fjalët e tij, aq sa ia dërgoi çështjen e tyre imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe ai tha: Çoje atë dhe mbaje në diell, zija hijen sepse me të vërtetë ëndrra është njësoj si hija, mirëpo ne do ta rrahim atë derisa ai të mos i lëndojë më njerëzit.

Një ditë, imami *(Paqja qoftë mbi të!)*doli nga Hemdanët një nga fiset Jemene në Kufe, kur pa dy grupe njerëzish që po ziheshin dhe i ndau ata, pastaj kur filloi duke ecur, dëgjoi një zë: O shpëtimtari Allahut më shpëtoni dhe ai u drejtua kah tij duke nxituar dhe tha: Të erdhi ndihma, kur pa një njeri që mbante një tjetër dhe tha: O prijësi i besimtarëve, i kam shitur këtij një rrobë për nëntë derhem ose shtatë me kusht që të mos më japë para të panjohura dhe as të prera, unë i solla atij këto derhemë që të mi zëvendësojë por ai refuzoi. Unë e kapa, por ai më ra me shuplakë. Imami i tha blerësit: Zëvendësoja ato, kurse shitësit i tha më jep

1 Tarikhu Tabriji 5/156,157. El Menakibu i ibn Shehri Ashub 2/358. El Kamilu i ibn Ethir 2/201. El Aleuijatul Ishrun /4-8. el-Abkarijatu /741. Ed Dirhemu umovijju mu'reb /16,17.

provën tënde për shpullën dhe ai ia dha provën. Imami e uli atë që e goditi me shuplakë dhe i tha atij që u godit me shuplakë, ti merre hakun, kurse ai tha: Me të vërtetë unë e kam falur atë o prijësi i besimtarëve, ai tha: Unë vetëm desha që të ruaj hakun tënd dhe e goditi atë njeri me nëntë perla dhe tha se ky është haku u sulltanit.

Derhemi i panjohur (magmuruz), i cili u përmend është ai që ju kanë fshirë shkronjat apo skalitjet e tij prej vjetërsisë apo prej përdorimit të tepërt. Sa i përket derhemit të prerë (maktu'un) lidhet me faktin se disa fukarenj kur fitonin ndonjë derhem nga frika se mos e shpenzonte atë, ai refuzonte ta këmbente dhe ai e priste në disa pjesë. Kjo pjesë quhej (karada) dhe e shiste atë me peshë, por me çmimin e argjendit ama qeveria e ndëshkonte këtë veprim.

Por, në prerjen e derhemit ka edhe një shkak tjetër, që është ekzistenca e derhemëve fallso do me thënë se ata vendosnin një rreth prej bakri midis dy shtresave të argjendit, pastaj goditej me hekur dhe mbi të stampohej teksti dhe mbulohej bakri. Ajo ishte shumë e vështirë të dallohej, vetëm nëse e prisje një copë të vogël prej saj.

Një ditë prijësi i besimtarëve doli nga porta e kështjellës në Kufe kur pa dy veta që po ziheshin, i kapi të dy për gjoksi dhe u tha: Ndaloni, kurse njëri prej tyre i tha: O prijësi i besimtarëve, ky njeri më ka blerë një dhi dhe unë e kushtëzova atë që të mos më jepte as derhem (magmurun) dhe as (maktuun), por ky më dha mua derhemë magmure dhe unë ia ktheva atij, ky më goditi. Pasi i dëgjoi imami pyeti atë tjetrit, çfarë ke për të thënë? Ai tha: Ka thënë të vërtetën, o prijësi i besimtarëve, ai tha: Atëherë jepi atij kaparin e tij, pastaj i tha atij që e qëlloi: Ti ulu, kurse atij që u qëllua i tha: Merre hakun, e ai tha: A është më mirë që ta fal, o

prijësi i besimtarëve? Ai tha: Kjo është në dorën tënde. Kur ai person u la i lirë, imami u tha atyre që ishin rrotull tij: Merreni atë dhe ata e morën, njëri prej tyre e barti atë mbi shpinë njësoj, siç e mban fëmija çantën, e goditën pesëmbëdhjetë herë, pastaj tha: Ky është ndëshkimi për atë që është i dhunshëm.

Profesor Ukadi tek libri i tij "El Abkarijat" ka bërë një koment për një nga këto çështje duke thënë: E përsëriste këtë ligj në të gjithë atë që ishte analoge me shembujt e armiqësisë, e cila është më e ngjashme me mënyrën e ndëshkimit të qeverive aktuale, fliste shumë për mënyrat e imamit në qeverisje dhe në politikën e shtetarëve me të cilën pasurohej në të ky universalitet, por edhe analizën e gjerë e te thellë.



ËSHTË I PARI QË KA PRERË PARANË ISLAMIKE[1]

Paratë me të cilat myslimanët bënin tregti me njëri-tjetrin priteshin në territoret romake apo perse me emrin e mbretërive të tyre, siç është e njohur në histori, i pari që ka anulluar paranë e huaj dhe ka bërë prerje islamike është Abdulmelik ibn Mervani.

Më pas është përmendur në botimin e trembëdhjetë të enciklopedisë britanike në vëllimin e shtatëmbëdhjetë/faqe 904 ku flitet për prerjet e vjetra të parasë. E përkthyer në arabisht në mënyrë përmbledhëse "Me të vërtetë i pari njeri i cili ka urdhëruar për prerjen islamike të argjendit është Aliu ibn Ebi Talibi, në qytetin e Basras, në vitin dyzet të hixhretit".

I nderuari Muhamed Bahrul Ulum, hulumtuesi i librit të parave islamike të quajtur "Pjesët e marrëveshjeve në përmendjen e parave të Makrizit" e ka komentuar këtë lajm me fjalën e tij nga kjo mund të supozojmë mendimin se ka prerje me emrin e imam Aliut, mirëpo akoma nuk kanë rënë në duart e eksploruesve. Ky pohim ka nevojë për mbështetje, vërtetim dhe mbase koha dhe kërkimi shkencor i hollësishëm do të na e zbulojë neve këtë".

---

1 En Nukudul islamijeh el musemma shudhurul ukudi fi dhikri nukudi i El Mukrizij /62. Sherh Nehxhul Belaga 1/16. A'janu Shi-ia 3/2/273 dhe 328-330. Ed Derhemul emevijjul mu'rebu /11,12.

Sejjid Muhsin Emini shkrimin e tij "A'janu Shiah" e ka përmendur në enciklopedinë Britanike dhe pas fjalës së tij ka shtuar në të: Në Basra vitin e dyzetë të hixhretit, pastaj e ka plotësuar çështjen kalifi Abdulmelik ibn Mervani në vitin 76 të hixhretit. Ajo që është e dukshme është se kjo shtesë nuk është pjesë e lajmit, por ajo është prej komentimeve të autorit.

Më pas na u shfaq libri "Ed Dirhem El Umeuij el Muareb" i dy profesorëve Nasir Nakshibandij dhe Muhab el Bukri dhe në të ka një konfirmim të ekzistencës së derhemit të prerë në Basra në kohën e imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* në vitin e dyzet të hixhretit dhe se ajo gjendet në muzeun e Parisit, në të cilën nuk ka asnjë dyshim në printimin e tekstit, e cila bart historinë e prerjes. Mirëpo ata kanë transmetuar thënie të disa specialistëve në prerjet antike që hedhin hije dyshimi për derhemin e Aliut dhe supozojnë ekzistencën e një gabimi në histori. Njëri prej tyre ka thënë: Mbase e vërteta e saj është (nëntëdhjetë e katër), kurse tjetri ka thënë: Nuk ka asnjë hapësirë pas fjalës (dyzet) dhe është konsideruar më e mundshme që më sakta të jetë viti (nëntëdhjetë) në vend të (dyzet).

Argumenti i të gjithë dyshimeve është mosgjetja në kopje të tjera të këtij derhemi. Sikur ata në fjalën e tyre kanë krehur të gjithë tokën, pëllëmbë për pëllëmbë dhe janë të sigurt se nuk ka kopje tjetër si ajo. Me të vërtetë mosgjetja e një kopje tjetër në kohën e sotme të derhemit të kohës së Aliut për t'ia treguar syve të botës, i ka bërë ata të besojnë ekzistencën e një gabimi në historinë e prerjes së saj. Ata nuk janë bindur akoma se shumë thesare vazhdojnë të jenë të groposura poshtë këmbëve të tyre dhe se koha është garante për daljen në dritë të tyre ashtu, siç kanë dalë të tjera gjurmë të cilat janë mbyllur nëpër muze.

Ka edhe një supozim të besueshëm, që nuk e di se si nuk u shkon ndërmend atyre se derhemi i kohës së Aliut i cili është prerë në vitin dyzet të hixhretit, do me thënë në vitin kur imami *(Paqja qoftë mbi të!)* ra dëshmor. Këtë e kanë tubuar armiqtë e tij emevitë pas tij dhe janë ata të cilët e kanë luftuar atë më shumë të vdekur se sa të gjallë, kanë përhapur fjalë të rrejshme në turpërimin dhe defektet e tij. E kanë mallkuar në minderet e islamit për njëmijë muaj. Kanë kërcënuar çdokënd që transmeton një hadith që përfshinte në të nderimin e tij apo e lartësonte kujtimin e tij në luftë, derisa edhe i paralajmëruan njerëzit që të mos emërtonin askënd me emrin e tij. I bënë miqtë e tij të zgjidhnin mes vrasjes dhe pafajësisë dhe zgjodhën dëshminë që ata dyshues nuk e supozuan se njerëzit e kësaj armiqësie të tmerrshme, i mblodhën kopjet e derhemit në kohën e Aliut me detyrim duke menduar se ata tani do të mund të fiknin dritën e mbrojtësit të Allahut dhe vëllait të të Dërguarit të Tij. Ta fshihnin kujtimin e tij përgjithmonë, por harruan se ajo që është e Allahut, rritet dhe kujtimi i babait të Hasanit u rrit, pavarësisht dominimeve të tyre, derisa u bë që askush nuk e fisnikëronte pas të Dërguarit të Allahut. Armiqësia e tij shkoi bashkë me atë që grumbulluan floririn dhe u ngjit ashtu, siç u larguan të gjithë tiranët dhe u mbetën atyre gjynahet e pasurisë haram që mblodhën, mëkateve të tjera që bënë dhe dije se Zoti yt nuk është zullumqar ndaj robit të Tij.



ËSHTË I PARI QË KA THËNË MË PYESNI PARA SE TË MË HUMBISNI[1]

Kur imami u bë kalif shkoi në xhami dhe kishte vënë çallmën e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kishte veshur rrabat e tij, u ngjit në minder, e falënderoi Allahun dhe i thuri lavde Atij, pastaj u ul paksa e tha: O ju njerëz, më pyesni para se të më humbisni, se me të vërtetë unë kam diturinë e të parëve dhe të fundit. Për Zotin edhe po të më jepej një jastëk edhe shtrirë po të rri do të gjykoja mes ithtarëve të Teuratit me librin e tyre dhe mes ithtarëve të Ungjillit, me librin e tyre edhe mes ithtarëve të Zeburit, me librin e tyre po edhe ithtarëve të Kur'anit me librin e tyre.

Pasha Allahun, vërtetë unë jam më i dituri për Kur'anin dhe komentimin e tij se çdokush që e pretendon se e bën këtë, edhe sikur të mos kishte një ajet në librin e Allahut do t'ju lajmëroja juve se si do të jetë deri në ditën e kijametit. Më pyesni

1 Emali El Kalij 2/101. El Irshadu/23. Zehrul adab 1/40. El Istiabu /1103,1104,1107. Tarikhul Bagdadij i Khatib el-Bagdadij 13/163,166. Muhaderatul Udibba i Ragib el Esbehani 1/304. El Menakibu 2/32,33, 45, 266. Usdul Gabe 4/372. Sherh Nehxhul Belaga 7/44,46 dhe 13/ 101,106. Dhekhairul Ukba /83. Hajatul Hajvani i Demirijj 2/368. Tarikhul Khulefai /170,171. A'janu Shia 3/k1/63. El Gadiru 4/372. Fadailu Khamse fi Sihahi Siteh 2/231-252.

mua para se të më humbisni, se pasha Atë, i cili e ka ndarë farën dhe ka krijuar shpirtin, nëse ju do më pyesnit për çdo ajet do ju lajmëroja juve për kohën e zbritjes dhe për çfarë ka zbritur, do t'ju lajmëroja për anuluesin dhe të anuluarën e tyre. Për ajetet specifike dhe të përgjithshme, të pakontestueshmen dhe të dyshimtën, nëse ka zbritur në Mekë apo në Medine. Për Zotin, nuk ka asnjë grup që e humbet rrugën e drejtë dhe unë të mos e njoh komandantin dhe udhëheqësin dhe ndjellakeqësin e tyre deri në ditën e kijametit.

Imami *(Paqja qoftë mbi të!)* ka edhe një fjalim tjetër që e ka thënë pas ngjarjes së Nehreuanit: O ju njerëz, me të vërtetë se unë ia nxora sytë fitnes (provës së rëndë së turbullirës) dhe askush tjetër veç meje nuk do të guxonte ta bënte. Pasi u shtua errësira dhe u rrit lakmia e saj, prandaj më pyesni mua para se të më humbisni, se pasha Atë që ka në dorë shpirtin tim. Edhe sikur të më pyesni se çfarë do të ndodhë në mesin tuaj dhe për kijametin, apo për një grup që udhëzon njëqind dhe i çon në rrugën e gabuar njëqind njerëz, pa dyshim se unë do t'ju lajmëroj juve për ndjellakeqësin, komandantin dhe udhëheqësin e tyre, klimën dhe stacionin e udhëtimit të tyre. Atë që vret një person në familjen e tij dhe atë i cili vdes, nëse ju më humbisni mua do të zbrisnin mbi ju gjëra jo të pëlqyeshme dhe fatkeqësi të ndryshme, do të heshtnin shumë prej atyre që pyesin dhe shumë prej atyre që kanë përgjegjësi do të dështonin.

Ka edhe një hytbe të tretë ku ai *(Paqja qoftë mbi të!)* thotë: O ju njerëz, më pyesni para se të më humbisni, se unë jam më i ditur për rrugët e qiellit se sa ato të tokës, para se një fitnes të lirohet nga këmbët dhe të ecë për kapistre të kafshës dhe të fshijë flamujt e kombit të saj. Transmetohet nga ibn Abdul Berri në librin El Istiabu për një grup muhadithash, njerëzish të ditur se kanë thënë: Asnjë prej sahabeve *(Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!)* nuk ka thënë

(më pyesni mua), përveç Aliut ibn Ebi Talibit. Ebu Xha'ferri el Iskafi në librin e tij "Nakdul Uthmanijeh" nga Ali ibn el Xha'di dhe ibn Shebreme transmeton: Askush prej njerëzve nuk ka thënë në minder (më pyesni mua), përveç Aliut ibn Ebi Talibi *(Paqja qoftë mbi të!).*

Ibn Ebi Hadidi ka komentuar hytben e tretë të imamit: Të gjithë njerëzit kanë rënë dakord njëzëri se askush prej sahabeve, por edhe askush prej dijetarëve të kenë thënë (më pyesni mua), përveç Aliut ibn Ebi Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)*, dhe ajo që nënkuptohet me fjalën e tij "Unë jam më i ditur për rrugët e qiellit se sa ato të tokës". Kjo është një dije e posaçme e tij për çështjet e së ardhmes, sidomos për luftërat e përgjakshme dhe shtetet. Fjala e tij është vërtetuar me rishfaqjen e lajmeve të dijeve të fshehta jo një herë, as edhe njëqind herë, derisa u largua dyshimi se ai është lajmëtar i diturisë.

Disa të tjerë e kanë komentuar atë në një mënyrë tjetër dhe kanë thënë se ai ka dashur të thotë se unë kam më tepër njohuri për ligjet dhe opinione legale të jurisprudencës se sa me çështjet e dynjasë. Këtë e ka shprehur nëpërmjet rrugëve të qiellit, sepse ato janë ligje hyjnore dhe e ka shprehur me rrugët e tokës, ato janë prej çështjeve të tokës. E para është më e qartë, sepse esenca e fjalës dhe pjesa e parë e saj tregojnë se ai është nënkuptimi.

Shumë njerëz kanë folur për imam Aliun dhe thënien e tij (më pyesni mua) dhe sikur një pjesë e tyre i rikthehet fjalës së Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)*: "Unë jam qyteti i dijes, kurse Aliu është dera e saj" dhe fjalën e imamit" I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)* më ka mësuar mua njëmijë dyer të diturisë, për çdo derë më hapeshin edhe njëmijë dyer të tjera" do ta kuptonte arsyen dhe do ta mundte habinë. Një herë është pyetur për një çështje, por ai hyri me shpejtësi në shtëpi, pastaj

doli i buzëqeshur dhe iu përgjigj pyetjes, për të cilën i është thënë: O prijësi i besimtarëve, ti kur pyetesh për diçka e ke në majë të gjuhës përgjigjen, kurse ai tha: Nuk po mbaja dot urinën dhe një i tillë nuk mund të japë mendim.

Historia gjithashtu na tregon se disa njerëz e kanë thënë me zë këtë thënie të prijësit të besimtarëve (më pyesni mua). Njerëzve iu është bërë e njohur dhe e qartë injoranca e njerëzve të tillë si Mukatil ibn Sulejmani el-Belkhi, i cili ka thënë një herë (më pyesni mua çfarë të doni përveç Arshit) dhe një burrë i thotë atij: Po Ademi kur e ka bërë haxhin, kush ia ka rruar atij kokën? I tha atij: Kjo nuk është puna juaj, por Allahu deshi të më sprovojë mua me pëlqimin e vetes time.

Ky luftëtar kthehet edhe një herë tjetër dhe thotë (më pyesni mua për çdo gjë përveç Arshit), kurse një njeri i thotë atij: O babai i Hasanit, a e ke parë atomin apo milingonën, organet e saj të brendshme i ka përpara apo mbrapa? Dijetari mbeti pa fjalë dhe nuk dinte se ç'të thoshte. Ebu Sufjani ibn Ajine i cili ishte prezent ka thënë se mendova se ai ishte një dënim për të.

Nga Katade tregohet se ai hyri në Kufe, njerëzit u grumbulluan rreth tij dhe ata thanë: Pyeteni për çfarë të doni, mirëpo Ebu Hanifeja ishte prezent dhe në atë kohë ishte djalë i ri dhe tha: Pyeteni atë për milingonën e Sulejmanit (a.s), a ishte mashkull apo femër? Ata e pyetën, kurse ai heshti. Ebu Hanifeja tha: Ajo ka qenë femër dhe i është thënë atij: Po nga e din ti? Ai tha: Nga fjala e Tij të Madhërishmit "kaalet" (ajo tha) sepse nëse do ishte mashkull do thoshte "kale nemletun". Milingona është njësoj si pëllumbi dhe dhia në lidhje me gjininë mashkullore dhe femërore.

Kush kërkon të tregojë lajmet e imamit *(Paqja qoftë mbi të!)*në histori do të gjejë se dituritë e tij nuk janë një mrekulli, sepse ajo është e përfituar. Mrekullia fshihet në përbërjen e saj, ku

Allahu i ka dhuruar një zemër të logjikshme, një gjuhë që pyet shumë, kërkon, veshë që dëgjon dhe ka memorie të paparë. Një profesor i tha atij që është më i kulluari i pejgambereve, mbreti i diturisë së të parëve dhe atyre të fundit, i mbështetur me shpallje hyjnore prej Zotit të botërave, profesori e zbrazi të gjithë diturinë tek nxënësi dhe djali i xhaxhait të tij, bashkëshortit të vajzës së tij lulja e virgjëreshës dhe babait të dy nipave, Hasanit dhe Hysejnit dhe ai që ia largon stresin, shqetësimin prej fytyrës së tij.

Për hir të qëndrimit të lidhjes së fortë të nxënësit me mësuesin e tij, i cili përfitonte në çdo çast që kalonte për të marrë dije prej tij dhe dëshmia e mësuesit për tejkalimin e nxënësit të tij, do të përmendim disa lajme dhe hadithe të trasmetuara në lidhje me këtë çështje. Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* hynte te i Dërguari i Allahut çdo mëngjes dhe mbrëmje për të marrë dije prej tij pa u preukopuar me asgjë tjetër veç dijes. Si është e mundur që ti di më shumë hadithe se të gjithë sahabet? Ai tha: Kur unë e pyesja atë, ai më tregonte dhe kur heshtte e niste vetë nga e para.

Nga hadithet e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)* në të janë:

"Aliu është ai që thotë nga dituria ime"

"Aliu është më i dituri ndër ju dhe që do rrijë më shumë në paqe"

"Më i dituri në ymetin tim pas meje është Aliu".

"Ustësia (hikmeti) është ndarë në dhjetë pjesë, mua më janë dhënë nëntë pjesë, kurse të gjithë njerëzve vetëm një pjesë"

"Më i dituri ndër ju në simetri dhe në gjykim pas meje është Aliu ibn Ebi Talibi"

"Aliu është shenjtori i këtij ymeti"

"Aliu është më i dituri në ymetin tim dhe gjykatësi më i drejtë në lidhje me atë që do të kontradiktohen pas meje"

"Unë jam qyteti i diturisë, kurse Aliu është porta e saj"

Abdulmelik ibn Ebi Selmani ka thënë: I thashë Atait ibn Ebi Er Rabah: A ka pasur në mesin e sahabeve të Muhanedit *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)* njeri më ditur se Aliu ibn Ebi Talibi? Ai tha: jo, për Zotin nuk njoh njeri. Nëna e besimtarëve, Aisheja ka thënë: Aliu është njeriu më i ditur për traditën profetike. Omer ka thënë: Nuk ka mbetur gjë që të mos e dijë babai i Hasanit. Abdullah ibn Abbasi ka thënë: Pasha Allahun, Aliut ibn Ebi Talibit i është dhënë nëntë të dhjetat e dijes, cilit prej jush Allahu i ka dhënë një të dhjetën. Darar ibn Damre kur ai ia përshkruante Muavijes Aliun ka thënë: Ai flet qartë dhe gjykon me drejtësi, dituria i shpërthen në të gjitha anët e tij dhe mençuria zbarkon nga anët e tij.

Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* i ka thënë Kemilit ibn Zijadit: Me të vërtetë se këtu ka një dituri të madhe dhe bëri me shenjë në gjoksin e tij, nëse ke mundësi ta bartësh atë. Jahja ibn Ekthemi i ka thënë Me'minit: Për Zotin. Ai të ka mbushur plot, o prijësi i besimtarëve. Nëse ne nxitohemi në mjekësi, ti je xhalinusi e nëse ne përmendim yjet, ti je njeriu për këtë dhe nëse përmendim diturinë, atëherë ti je Aliu ibn Ebi Talibi.

Ibn Ebi Hadidi ka thënë: Çfarë është thënë për një njeri që i atribohet çdo mirësi dhe çdo ndarje përfundon tek ai, atë e tërheqin të gjitha ndasitë, grupet, sepse ai është kryetari i mirësive dhe burimi i tyre dhe babai i arsyes së tyre. Ai që i ka paraprirë në përmbajtje, çdokush që është shfaqur në të pas tij, ka marrë prej tij dhe ndjek shembullin e tij. Pjesët e mëparshme kanë përfshirë shumë gjëra prej lajmeve të diturive të prijësit të besimtarëve. Në pjesët që vijnë do të përmendim disa të tjera, tani mjaftohemi me kaq sa kemi shkruar.



ËSHTË I PARI QË KA FOLUR PËR THERTORET DHE KA LAJMËRUAR PËR MASAKRAT PARA SE ATO TË NDODHIN[1]

Kemalud-din Muhamed ibn Talha en-Nesibiniju el Advij esh Shafiu ka thënë: "Me të vërtetë kerameti (mirësi, mrekulli) është një mënyrë të shprehuri e situatës që shfaqet për ata që janë të ngarkuar me detyrë, një gjë e jashtëzakonshme që zakonisht nuk besohet edhe me shfaqjen e saj. Me këtë kusht shfaqet dallimi mes saj dhe mrekullisë, sepse mrekullia është e urdhëruar që të dalë hapur, të shihet për shkak të qenit një argument i sinqeritetit i pejgamberit në thirrjen e tij profetike. Pra, mrekullia që është specifike për pejgamberin është e domosdoshme duhet të bëhet patjetër, pasi nuk ka pejgamber që të mos ketë mrekullinë e tij, kurse sa i përket kerametit (që është një shkallë më poshtë mrekullisë) ajo është specifike për miqtë e Allahut si respekt ndaj

1 Tabekat i ibn Sa'dit 5/43. El Kamilu 2/217. El Irshadu /13-15. Mekatilu Talibine /30, 71,71. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebi Hadid 2/286-295 dhe 3/169 dhe 7/47-50,277 dhe 8/125-215 dhe 10/10-15. Keshful Gummeh 1/276-282. El Gadiru i Eminit 6/384 e më pas. Fadailu Khamseh fi Sihahi Siteh 2/253-256.

tyre. Mirëpo kjo nuk është e domosdoshme për të, pasi ekzistojnë mbrojtje pa pasur nevojë për keramet, sa prej miqve të Allahut nuk është parë diçka e pazakontë prej tyre".

Nga sa thamë më sipër përfitohet se prijësi i besimtarëve *(Paqja qoftë mbi të!)*i cili është prej miqve më të hapur të Allahut ka shumë keramete të jashtëzakonshme që Allahu e ka nderuar me to. Kurse sa i përket lajmërimit të tij për ngjarjet para se ato të ndodhnin, ajo është një dituri e përfituar nga Pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)* dhe imami i ka lajmëruar shpesh shokët e tij për to. Njëra prej tyre është se ai *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*ka treguar në një prej hytbeve të tij për fitnen e tartarëve dhe njëri prej shokëve se i thotë: Ti po na jep një dituri të fshehtë o prijësi i besimtarëve, kurse ai i thotë atij njeriu që ishte prej fisit benu-kelbit: "O vëlla i Kelbit, ajo nuk është dituri e fshehtë, por është dituri e përfituar prej atij që ka shumë dije dhe se dituri e fshehtë është dituria e kijametit dhe ajo çfarë thotë Allahu i Madhërishëm në fjalën e Tij: "**Me të vërtetë tek Allahu është dituria e kohës së fundit dhe Ai e zbret shiun dhe Ai e di se çfarë ka në mitrat e nënave dhe askush nuk e di se çfarë do i ndodhë nesër dhe asnjë shpirt nuk e di se në cilën tokë do të vdesë**".

Allahu i Madhërishëm e di se çfarë ka në mitrat e nënës, djalë apo vajzë, a është i shëmtuar apo i bukur, a do jetë dorëlëshuar apo koprrac, a do të ketë jetë të vështirë apo të lumtur, a do të jetë lëndë djegëse e zjarrit apo në Xhenete duke shoqëruar pejgamberet. Kjo pra është dituri e fshehtë, të cilën nuk e di vetëm se Allahu, përpos kësaj është një dituri që Allahu ia ka mësuar pejgamberit të Tij *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)* dhe ai ma ka mësuar mua dhe ai ka bërë lutje për mua që ta ruaj në gjoksin tim dhe krahët e mi janë prerë bashkë me të.

Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*ka thënë: Më pyesni mua para se të më humbisni, një njeri është ngritur e ka thënë: Më thuaj mua se çfarë kam në kokën time dhe për tufën e qimeve të mjekrës time, kurse ai i ka thënë: Pasha Allahun, miku im, i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)* më ka thënë mua se mbi çdo tufë flokësh të kokës tënde qëndron një melek që të mallkon ty dhe në çdo tufë qimesh të mjekrës tënde është një shejtan që të ngatërron ty, se në shtëpinë tënde ke një mbeturinë, mbetje që vret djalin e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)* dhe djali i tij ishte ai që ia këputi kokën e Hysejnit *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij)*, ai është Sinan ibn Enes en Nakhli.

Një ditë në një nga hytbet e tij ka thënë: Pasha Allahun dua të lajmëroj çdo njeri prej jush për hyrje-daljet dhe të gjitha problemet e tij do ta bëja, mirëpo unë kam frikë se do të mohoni prej meje të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)*. A nuk jam unë kontribuuesi i tij në specifikë nga ajo çfarë ata kanë marrë garancinë e tij? Pasha Atë që e ka dërguar me të vërtetën dhe e ka përzgjedhur nga krijesat, nuk them vetëm se të vërtetën dhe ma ka premtuar mua atë të gjithë, për të shkatërruarin që shkatërrohet, për shpëtimtarin që shpëton dhe shpresat e kësaj çështjeje nuk ka mbetur asnjë gjë që të kalojë në kokën time vetëm se e kam futur në veshin tim dhe e kam ruajtur në brendinë time.

Ibn Ebi Hadidi ka bërë një komentim për këtë. E përgjithshmja është se është e pamundur që disa shpirtra të jenë të specifikuara me cilësinë e kuptimit të të fshehtave. Mirëpo nuk mundet që një njeri të kuptojë të gjitha të panjohurat, sepse fuqia e pafundme nuk i përfshin çështjet e pafundme, kështu që është obliguar që të supozohet, se fjala e prijësit të besimtarëve

nënkupton se ai është përgjithësimi i diturisë, por që njeh çështje të kufizuara të të fshehtave nga ajo që ka caktuar mençurinë e Krijuesit të Madhërishëm që ta bëjë të merituesëm për diturinë e tij. Po kështu është fjala për të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, se ai ka ditur çështje të kufizuara dhe jo çështje të pafundme. Kaq.

Sa prej thertoreve dhe lajmërime të ngjarjeve ka ngritur prijësi i besimtarëve *(Paqja qoftë mbi të!)*para se ato të ndodhnin. Sikur të donim të tregonim atë do të dilnim nga kufiri i korespondencës së këtij libri, prandaj do mjaftohemi me një cekje të lehtë të atyre ngjarjeve, të cilat i kanë përfshirë edhe librat e historisë të detajuara.

Në fjalën e tij imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*i ka thënë një njeriu duke e lajmëruar se Khalid ibn Artafe ka vdekur në luginën e fshatrave "për Zotin nuk vdiq dhe nuk do të vdesë derisa të udhëheqë ushtrinë e humbjes, ai që do të mbajë flamurin e tij është Habib ibn Hamadi".

Një njeri tjetër iu afrua dhe tha: O prijësi i besimtarëve unë jam Habib ibn Hamadi, unë ty të ndjek dhe të dua, dhe ai tha: Po për Zotin, ti je bartësi i saj dhe do të hysh me të nga kjo derë dhe bëri me shenjë nga dera e elefantit në xhaminë e Kufes. Thabit eth Themali ka thënë: Për Zotin nuk vdiqa derisa pashë ibn Zijadin që kishte dërguar Omer ibn Sa'din në luftimin e Hysejnit djalin e Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe e vuri Khalidin ibn Artafe në krye të ushtrisë së tij, kurse Habib ibn Hamadit i dha flamurin e tij dhe hyri nga porta e elefantit.

Mejthem et Temarit në mbledhjen e një grupi të shokëve të tij ka thënë: "Me të vërtetë se ti do të merresh pas meje dhe do të kryqëzohesh tek dera e shtëpisë së Amër ibn Harithit. Me të vërtetë, ti je një nga ata të dhjetë dhe më i shkurtri ndër ta dhe do

të tregoj ty palmën, në rrënjët e të cilës ti do të varesh". Mejthemi shkonte tek kjo palmë dhe falej, por nuk zgjati shumë kur e prenë dhe më pas ai rrinte në rrënjët e saj, takonte Amrin ibn Harithin dhe i thoshte: Me të vërtetë unë do të bëhem komshiu yt, por Amri nuk e dinte se çfarë donte dhe i thoshte atij: A do të blesh shtëpinë e ibn Mes'udit apo shtëpinë e ibn Hakimit?

Më vonë erdhi Ubejdullah ibn Zijadi në Kufe dhe burgosi shumë prej kundërshtarëve të tij, prej tyre edhe Mejthem et-Temarin. Pastaj e nxorri nga burgu dhe e vari tek rrënja e palmës, dhjetë ditë para se të vinte në Kerbela Hysejni *(Paqja qoftë mbi të!)*. Pas kësaj Amru ibn Harithi e urdhëronte robëreshën e tij çdo natë që të fshinte me fshesë poshtë qivurit të tij dhe ta spërkaste me ujë atë.

Reshid el-Hixhrit ka thënë se do të presin këmbët, duart, gjuhën dhe pastaj do të kryqëzojnë. Kur ia sollën Zijadit djalit të babait të tij, ai i tha: Çfarë të ka thënë ai shoku yt? Ai i tha se çfarë i kishte thënë, kurse Zijadi tha: Për Zotin unë do ta përgënjeshtroj fjalën e tij dhe urdhëroi që ta linin të lirë, por kur po dilte, tha: Kthejeni mbrapa nuk shohim diçka më të mirë se sa ajo që i ka thënë shoku i vet, kështu që ia prenë organet e trupit, pastaj e kryqëzuan. Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* i ka thënë Amru ibn el Hamk el Khuzaij: "Me të vërtetë ti do të vritesh pas meje dhe koka jote do të jetë koka e parë që do të transportohet në islam", pastaj ai u vra në kohën e Muavijes dhe kokën e tij e çuan nga Iraku në Siri.

Siç ishte thënia e tij kur zbriti në Qerbela dhe ishte rrugës për në Sifin dhe u fal me shokët e tij dhe sapo dha selam, ngriti lart nga dheu i tij, e nuhati dhe tha: Lum si ti moj dhe', prej teje do të tubohet një popull që do të hyjë në Xhenet pa asnjë llogari. Ja këtu është vendi i udhëtimit të tyre dhe klima e udhëtarëve të tij.

Pastaj bëri me shenjë një vend tjetër dhe tha: Këtu është vendi i derdhjes së gjakut të tyre.

Fjala e tij për popullin e Kufes në një nga hytbet e tij duke treguar për Haxh-xhaxh ibn Jusufi eth-Thekafijju është: "Do t'i nënshtroheni një djali të aftë me prirje me bishta të dendur, që do të hajë të mbjellat tuaja e do të shkrijë dhjamin tuaj, eeh është i veshur me gëzof". Po ashtu është edhe tregimi i tij për sprovën e madhe të Tartarëve në një nga hytbet e tij: "Sikur po i shoh ata një popull me fytyra të mprehta dhe me forma, që veshin rrobat e vjedhura dhe elegante, hipur mbi kuaj të vjetër dhe do të ketë skuqje të të vrarëve, derisa ai që është i plagosur të ecë mbi të vrarin dhe humbësit të jenë më pak se robërit.

Ibn Ebi Hadidi e ka komentuar atë me fjalën e tij: Di se këtë të fshehtë të cilën e lajmëroi për të ai *(Paqja qoftë mbi të!),* ne e kemi parë më sytë tanë dhe ka ndodhur në kohën tonë. Njerëzit e prisnin atë që në fillim të islamit, derisa erdhi kaderi në kohën tonë dhe ata janë Tartarët, të cilët dolën nga lindja e largët. Kuajt e tyre arritën Irakun e Sirinë dhe vendet nga prapa lumit, Khurasanin bënë atë që nuk e kanë parë historitë që kur Allahu i Lartësuar e krijoi Ademin e deri në kohën tonë. Kur ka treguar për el-Kurametën ka thënë: Na serverin neve dashurinë e tyre dhe na fshehin inatin, mërinë dhe argumenti i kësaj është vrasja e trashëgimtarëve tanë prej tyre dhe lënia në shkretëtirë e kufomave tona. Ibn Ebi Hadidi në komentimin e tij rreth kësaj thënie ka thënë: Është e vërtetë ajo që ka thënë, sepse el Kurametah ka vrarë nga familja e Ebi Talibit shumë njerëz, siç është përmendur në librin "Mekatilu Talibin" i Ebi Ferexh El-Esabhanij.

Imami *(Paqja qoftë mbi të!)*në këtë hytbe duke treguar me gisht kolonën tek e cila ishte mbështetur në xhaminë e Kufes ka thënë: Sikur unë jam afër gurit të zi i mbërthyer këtu për një çast

dhe tregoi drejtimin kah Bahrejni një çast pastaj kthehet në vendin e vet. Kur ka parë Mervan ibn Hakemin ka thënë: Do të mbajë në dorë flamurin e humbjes pasi t'i zbardhen flokët në tëmth dhe bashkë me të është një grua që është njësoj siç e lëpin qeni hundën e tij.

Fjala që Abdullah ibn Abbasit *(Paqja qoftë mbi të!)*i ka thënë kur erdhi tek ai për ta përgëzuar për lindjen e djalit të tij "I falënderuar është Dhuruesi i kësaj dhurate dhe i bekuar qoftë i linduri, si ia ke vënë emrin? Ai tha: A më lejohet mua t'ia vë emrin para teje o prijësi i besimtarëve? Prijësi i besimtarëve u tha që t'ia nxirrnin djalin, e mori atë dhe e shijoi, u lut për të, pastaj u kthye nga ai dhe tha: Merre tani o babai i mbretërve, sepse e kam quajtur Ali.

Lajmet për shfaqjen e flamujve të zinj nga Khorasani dhe diktimi i tij për një popull nga familja e saj që njiheshin si beni-Rezik, të cilët ishin familje e Mus'abit. Prej tyre ishte Tahir ibn Husejn el Khuzai dhe ata ishin thirrësit e shtetit Abisit (Abasëve). Ajo që ka lajmëruar në çështjen e havarixhëve me Nehrevanët kur ka thënë se prej nesh nuk vriten as dhjetë vetë, kurse prej tyre nuk shpëtojnë dhjetë.

Lajmi që i ka dhënë shokëve të tij për numrin e ushtrisë që vjen nga Kufeja kur ka shkuar në Basra për luftimin e popullit të saj. Në lajmin e tij për Abdullah ibn Zubejri është thënë: Eh, aspiron në diçka por nuk e merr atë, i lidh fort litarët e fesë me të dynjasë, por ai është i kryqëzuari i kurejshëve.

Lajmërimi i tij për imamët që do të shfaqeshin nga djali i tij në Taberstan, si Nasiri dhe Dai, e të tjerë veç tyre, kjo sipas fjalës së tij: Pa dyshim familja e Muhamedit ka një thesar që do ta zbulojë Allahu nëse do. Lajmërimi për vrasjen e shpirtit të pastër Muhamed ibn Abdullah el-Muhidd në Medine dhe fjala e tij për

vëllain e tij të vrarë në Bakhamra, Ibrahimin do t'i vijë si një shigjetë nga ana perëndimore që do të sjellë vdekjen e tij, e sa keq për harkëtarin, dora e tij u drodh dhe krahu i tij u dobësua.

Lajmërimi i tij për një mbretëreshë alevite në Marok dhe sqarimi në përmendjen e Katames, që janë ata të cilët ndihmuan Ebu Abdullahun, thirrësin mësues, apo si fjala e tij kur po tregonte për Ebu Abdullah el Mehdi. Pronari i Kajravanit shfaqet me lëkurë të butë e shikim në bisht të syrit, me prejardhje të pastër që është i lindur nga një zinxhir me të parë që janë të mbështjellë me mbulesë safani. Lajmërimi i tij për Beni Bevihet ku është thënë nga Duvejlmani se bijtë e gjahtarit do të dalin duke folur për ta dhe babai i tyre ka qenë peshkatar.



I PARI QË KA KLASIFIKUAR LIBRAT NË ISLAM[1]

Nga prijësi i besimtarëve Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ka disa klasifikime të cilat burojnë nga Libri (Kur'ani) dhe tradita profetike, të cilat janë përmendur në librat e historisë, prej tyre janë:

1. **Libri Emelij** që ka në të gjashtëdhjetë lloje të shkencave të Kur'anit dhe për secilin lloj ka përmendur një shembull që e specifikon atë.

Besniku i nderuar në librin A'janu shi-ia ka thënë atë e ka publikuar dijetari i asamblesë në pjesën e nëntëmbëdhjetë të librit të tij Buharul Envari "Oqeanet e dritave" dhe ne kemi disa mënyra në trasmetimin e tij tek ibn Ukde. Trasmetuesi i këtij libri me mbështetjen nga imam Xhaferri i sinqerti ia atribuon prijësit të besimtarëve Aliut. Ne do të përmendim këtu një mënyrë të lidhjes së atributit të tij me të, pastaj do të përmendim senedin e plotë.

1 Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebi Hadidit 17/ 30 e më tej. Tarikh ibn Khaldun 1/594. Miftahu Seadeh ue Misbahu Sijadeh 2/594. Keshfu Dhununi 1/591, 606, 607 dhe 2/1684. Te'sisu Shi-ia li Ulumil islami /318. Mu'xhemu metn el la'neh lënda (xhim, fe, ra). A'janu Shi-ia 1/k1/244-247 dhe 3/ k2/273,274 dhe 41/35. Dijuanu Ebi el Mehasin el Kerbelaij [1,2.

Ndrësa i nderuari Hasan es-Sadri në librin e tij ka përmendur se formimi i shkencave të Kur'anit të Shi'itëve këtë libër njësoj siç është përmendur më parë, pastaj ka thënë: Kjo është rrënja për secilin që shkruan në llojet e shkencave të Kur'anit.

2. Libri Nehxhul Belaga ka në përmbajtje hytbet e tij *(Paqja qoftë mbi të!),* mesazhet dhe këshillat, qortimet dhe gjykimet e tij, të cilat i ka tubuar Sherif Raziu. Dijetarët kanë hyrë në garë në shpjegimin e tij dhe kanë arritur deri në pesëdhjetë pjesë të detajuara dhe të përmbledhura. Ndërsa nga shpjegimet më të njohura, më të përhapura e më gjithpërfshirëse në shkenca dhe kulturë është shpjegimi i dijetarit Izzudin Abdulhamid ibn Ebi Hadidi, libër që është botuar në disa vëllime në Iran, Egjypt dhe Bejrut kurse nga shpjegimet e përmbledhura më të njohura është shpjegimi i imam Muhamed Abduh.

3. **Libri i Detyrave** apo obligimet e Aliut kanë qenë i imamët e Ehli Bejtit që e kanë transmetuar. Shumë prej përmbajtjeve të saj janë transmetuar në librat e jurisprudencës të shi'itëve, sipas transmetimeve të besnikëve nga burimet autoritare deri në ditët e sotme.

4. **Libri për xekatin e të mirave** e ka transmetuar Rebia ibn Semi'i dhe en-Nexhashiu (Ebu Abbas Ahmed ibn Aliu) e ka përmendur tek njerëzit e tij.

5. **Libri për jurisprudencën islame**, e ka transmetuar autori, shkrimtari Ali ibn Ebi Rafiu dhe e ka tubuar atë në ditët e tij.

6. **Mesnedul imam Aliu**, e ka tubuar atë en-Nesaijju (Ebu Abdurrahman Ahmed ibn Shuajbi) dhe ajo është çka ka mbetur prej gjurmëve të tij *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*prej haditheve dhe trasmetimeve. Atë e ka përmendur edhe kalifi Haxhi në Keshfu Dhununi (zbulimi i mendimeve).

7- **Libri gjykimet e tij të mahnitshme**, atë e ka tubuar Ubejdullah ibn Ebi Rafi'i dhe dijetarë të tjerë, prej tyre është botuar me emrin gjykimi i prijësit të besimtarëve.

8. **Kitabu Xhenetul esma** (kopshti i emrave) e ka shpjeguar imam Ebu Hamid el-Gazaliu. E ka përmendur autori i Keshfudh Dhununi, por nuk e ka bërë të qartë subjektin e librit, kurse es-Sejjidul Emini në A'janush –Shi'ia ka thënë: Mbase ka ndodhur falsifikim në fjalë.

9. **Premtimi i tij** *(Paqja qoftë mbi të!)* kur emëroi Malik el-Eshtriu si guvernator të Egjiptit e përmendur më parë në faqet e mëparshme të këtij libri është një kushtetutë e plotë për çdokënd që ka përgjegjësinë e menaxhimit të çështjeve të shtetit.

10. **Es-Sahifetul Uluvijjeh** në të janë tubuar ato që janë trasmetuar prej tij *(Paqja qoftë mbi të!)*prej lutjeve dhe thirrjeve (e botuar).

11. **Kitabul Xhefri** dhe elxhefru në gjuhë është i vogli i dhisë që ju ka rritur barku dhe han vetë, apo që i ka kaluar katër apo gjashtë muajt. Elxhefru është dituria që i atribuohet imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*e që flitet shumë për të dhe mendimet janë kontradiktore e të ndryshme.

Duke vazhduar planifikimin tonë të shkurtimit në mënyrë përmbledhëse, mjaftohemi me transmetimin e katër thënieve të dijetarëve rreth kësaj diturie me shpresën se do të hedhë pak dritë mbi librin e përmendur. Dijetari ibn Khalduni në prezantimin e tij ka thënë: Dije se kitabul Xhefri e kishte origjinën nga Harun ibn Seidi el-Axhli që është koka e Zejdëve, kishte një libër që e transmetonte nga Xha'ferr es-Sadiku dhe në të kishte dituri rreth asaj se çfarë do t'i ndodhte në përgjithësi Ehli Bejtit dhe disa personave në veçanti.

Ai parashikim bashkë me fenomenet e tij ndodhi për njerëzit e tyre nëpërmjet kerameteve dhe sublimeve njësoj, siç u ndodh eulijave, miqve të Allahut. Ka qenë e shkruar tek Xhaferri në lëkurën e një viçi të vogël dhe prej tij e ka transmetuar Harun el-Ixhli, e shkroi dhe e emërtoi me emrin e lëkurës në të cilën ishte shkruar, sepse fjala (el xhefru) në gjuhë do të thotë i vogli dhe ky emër u bë i njohur me këtë libër tek ata.

Në brendësi ka pasur komentim Kur'ani dhe kuptime të çuditshme të transmetuara nga Xhafer es-Sadiku. Por, ky libër nuk e ka lidhur transmetimin dhe as nuk është parë, por vetëm shfaqen prej tij fjalë të pazakonta e të pashoqëruara me ndonjë argument. Sikur të vërtetohej senedi i Xhafer es-Sadikut do të ishte mbështetja më e mira për veten dhe për burrat e popullit të saj, sepse ata janë njerëz të kerameteve. Prej saj është vërtetuar se ai i paralajmëronte disa prej të afërmve të tij për ngjarjet që do i ndodhnin. Ato që thonte ai vërtetoheshin, Jahjanë djalin e xhaxhait të tij Zejdit e kishte paralajmëruar për vdekjen e tij, por ai e kundërshtoi atë, shkoi dhe u vra në Xheuzxhan.

Nëse kerametet ndodhnin për të tjerët, çfarë të bën të mendosh për diturinë, fenë dhe gjurmët nga profecia, kujdesin, ruajtjen nga Allahu për origjinën e nderuar që dëshmon për degët e tij të mira dhe shumë fjalë mund të thuhen për Ehli Bejtin, por pa ia atribuuar askujt. Këtu është i domosdoshëm komentimi i pikës së përmendur në librin e ibn Khaldunit që është se me të vërtetë Haruni i biri i Seid el-Ixhli e ka transmetuar librin nga imam es-Sadiku, e ka shkruajtur atë (do me thënë Haruni) dhe e ka emërtuar si elxhefru (parashikimi).

Është e vërtetë se libri i parashikimit i atribuohet imam Aliut me konsensusin e historianëve dhe është i njohur që në atë kohë me këtë emër. Katër imamë para imam Sadikut e kanë

konsultuar atë, ashtu si Harun el-Ixhli, i cili është i pari i Zejdëve nuk e njeh, nuk e pranon imamatin e Sadikut dhe nuk merr prej tij dituri lidhur me të, përkundrazi, ai e mbështet trasmetimin e tij nga të parët e tij.

Ahmed ibn Mustafa i njohur për guximin e madh ka shtuar në librin e tij çelësi i lumturisë duke thënë: Profecia, parashikimi dhe gjithpërfshirja është shprehje e diturisë totale për pllakën, tabelën e gjykimit (kada) dhe caktimit (kader) që përmban gjithçka ka qenë dhe si do të jetë, totale dhe e pjesshme. Profecia është një shprehje e pllakës së vendimit, i cila është logjika e gjithçkaje, kurse gjithpërfshirja është pllaka e kaderit (caktimit), e cila është shpirti i gjithçkaje. Një grup ka pohuar se imam Aliu ibn Ebi Talibi *(Paqja qoftë mbi të!)*i ka vendosur të njëzet e tetë shkronjat në mënyrën e shtrirjes më të madhe në lëkurën e parashikimit, duke nxjerrë prej tyre nëpërmjet mënyrave specifike dhe kushteve të përcaktuara, shprehje specifike, duke nxjerrë prej tyre atë çfarë ka në pllakën e vendimit (kadasë) dhe të caktimit (kaderit).

Këtë dituri e ka trashëguar Ehlul Bejti dhe ata që rrjedhin prej tyre, komunitet e kanë marrë prej tyre dhe ua kanë fshehur plotësisht të tjerëve. Asnjë e vërtetë nuk qëndron në këtë libër, përveç imam Mehdiut që pritet të dalë në fundin e kohës, Haxhi Kalifi në librin e tij Zbulimi i mendimeve, ka përmendur tekstin e plotë të fjalës dështimi i madh i informacioneve të shtuara.

Dijetari i nderuari Muhsin el-Emini në librin A'janu Shi'ia pas një fjale të gjatë ka thënë: Ajo çfarë duket qartë tek lajmet është profecia, parashikimi është një libër që ka në të dituri profetike, hallallin dhe haramin, ligje dhe dispozita që njerëzit kanë nevojë për ligjet e fesë së tyre, atë që u duhet në këtë botë. Por, mundet që të ketë edhe komentime të disa dyshimeve nga

Kur'ani Famëlartë, kurse sa i përket konsiderimit të parashikimit një dituri, shkencë prej shkencave, prej tij derivojnë dituria e ngjarjeve dhe të fshehtës, siç kuptohet mirë nga libri zbulimi i mendimeve dhe të tjerë është fiksuar në mendjet e disa njerëzve. Prandaj ne nuk e kemi lexuar atë që ai shtron dhe si mund ekzistojë një libër që quhet profecia, parashikimi e t'i atribuohet prijësit të besimtarëve *(Paqja qoftë mbi të!)* të pajtur për të mes shi'itëve dhe traditës profetike.

Në fund dijetari i madh Ahmed Rida në librin e tij "Fjalori i tekstit të gjuhës" ka thënë: Profecia është dituria totale nëpërmjet mënyrës së shkencës së shkronjave për pllakën e vendimit dhe të caktimit, përmbajtës i asaj që si ka qenë dhe si do të jetë, u shkruajt mbi lëkurën e një gjedhi të vogël dhe u emërtuua me emrin e tij dhe thanë: Me të vërtetë kjo është specifike në historinë e familjes së profetit *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)*. Insituti i Damaskut e ka quajtur parashikuese, atë që sot ata e quajnë (es-Shifre) (kodi) të cilat janë korrespondencat sekrete të hartuara me simbole shkronjash dhe askujt nuk i lejohet përveç atyre që janë të përulur ndaj saj.



I PARI QË KA VENDOSUR GRAMATIKËN[1]

Në mesin e hulumtuesve dhe dijetarëve është e njohur se i pari që ka vënë rregullat e gramatikës, që ka themeluar shtyllat e saj dhe ka përcaktuar kornizat e saj është prijësi i besimtarëve Aliu ibn Ebi Talibi *(Paqja qoftë mbi të!)*. Prej tij e ka marrë Ebu el-Esvedi ed-Deuliju (Dhalim ibn Amri) dhe e ka zgjeruar shembullin e tij dhe e emërtoi (nahven) me emrin gramatikë.

Ebu el Esued për shkakun e formimit të kësaj shkence nga ana e prijësit të besimtarëve ka thënë: Hyra tek Aliu ibn Ebi Talibi *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe e pashë atë të thelluar në mendime dhe i thashë: Për çfarë po mendon o prijësi i besimtarëve? Ai tha: Me të vërtetë kam dëgjuar në qytetin tuaj gabime gramatikore, kështu që desha të hartoja një libër për bazat e arabishtes. Më pas, shkova tek ai pas tre ditësh dhe ai më hodhi disa letra që kishte në të Me emrin e Allahut, Gjithmëshirshmit, Mëshirëbërësit. Se gjithë fjalia

1 Emali Ez Zuxhaxhij /238. Dijuanu Keshaxhim /28. El Besairu ue Dhehairu i Ebi Hajan 1/216. Fehresetu i ibn Nedimit /39. Nuz'hetul Elbai /4,5. Mu'xhemul Udibba 14/48-49. Enbahu ruuati /1/4-9 dhe 15. El Muz'hiru 2/397. Tarikhul Khulefai /181,186. Neuadirul Makhtutat (Himetul Ishrak) 2/81. Reudatul Xhennat /341. El Abkarijatu /756.

është emër, folje dhe përemër. Emri është ai që rrjedh nga emërtimi, kurse folja është ajo që lind nga lëvizja e të emërtuarit, kurse përemri është ajo që buron nga kuptimi, që nuk është as emër e as folje.

Pastaj tha: Ndiqe atë o Ebu esvedi dhe shto në të ç'të gjesh dhe dije mirë se emrat janë tri llojesh: Substantiv, i panjohur dhe diçka mes të dukshmes dhe të panjohurës. Dijetarët thonë se janë superiorë në njohurinë në lidhje me atë që nuk është e dukshme dhe e panjohur. Ebu Esvedi ka thënë se grumbullova prej tij dy kapitujt e sintezës dhe mbiemrit, pastaj dy kapitujt e habisë dhe të pyetjes deri kur arrita në kapitullin e përemrave të rasës kallëzore, përmenda prej tyre përemrat; in, en, lejte, leal-le, ke'enne, mirëpo nuk e përmenda përemrin lakin-ne dhe ai më tha: Përse e le atë? I thashë që nuk e llogarita prej tyre, kurse ai tha: Përkundrazi ajo është prej tyre, prandaj shtoje edhe atë.

Sa herë që shtoja një nga kapitujt e gramatikës ia paraqisja atij derisa e përfundova plotësimin e saj. Kutufiju tek enbahu Ruvati ka thënë: Kam parë në Egjipt në kohën e kërkimit në dorën e shkrimtarëve një pjesë që kishte kapitujt e gramatikës që ishin në një mendje se ato ishin prezantim i Aliut ibn Ebi Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe i kishte marrë prej tij Ebu el-Esvedi ed-Deulijju. Prandaj, pjesa e imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*në shkencën e gramatikës, siç ka thënë el-Ukadi është madhështore, fillimi i saj është më i vështirë se përmbushja e vëllimeve të mëdha, të cilat i kanë regjistruar shpëtimtarët e gramatikës pas përparimit të diturisë dhe shtimit të mendimtarëve në të.



ËSHTË I PARI QË KA FORMUAR SHKENCËN E TEOLOGJISË NË ISLAM[1]

Teologjia është një shkencë që hulumton Njësinë e Allahut të Madhërishëm, sifatet e Tij (cilësitë), situatat e ndodhura të mundshme nga zanafilla dhe ditës së fundit dhe çdo gjë që lidhet me Xhenetin, Zjarrin, urën e Siratit, llogarinë, shpërblimin dhe ndëshkimin.

Kjo shkencë ka nisur në gjysmën e parë të shekullit të dytë të hixhretit dhe është quajtur (shkenca e teologjisë) dhe për shkakun e emërtimit është thënë se çështja e parë që kanë pasur kontradikta në të një pjesë e dijetarëve është: "Kur'ani që është fjalë e Allahut, a është i vjetër apo i ri?" Gjithashtu është thënë: Se një nga armët më të forta të kësaj shkence është fjala dhe janë dhënë argumente të prera dhe përsosje të mënyrës së shprehjes rreth qëllimeve.

1 Emali i Sejid el Murteda 1/148. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebi Hadid 1/17 dhe 57,58 dhe 6/398, 9/147, 152 dhe 10/64. 113, 170 dhe 11/51, 13/44, 64. Et Ta'rifatu /162. Dairetul Mearifil Karnil Ishrun 8/173. El Gadiru 11/330. El Abkarijatu /677, 749, 753. Imam Aliu, Seutul Adeletil Insanijeh 1/102.

Dijetarët i kanë marrë bazat e kësaj shkence nga fjala e prijësit të besimtarëve Aliut ibn Ebi Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)*dhe hytbeve të tij të shumta për teuhidin dhe pjesën tjetër të bazave të fesë. Siç ka thënë Sherif el-Murtedi ato kanë përfshirë metodat e teologjisë ç'ka nuk mund t'i shtohet gjë dhe që nuk kanë një objektiv më pas tij. Ai i cili i shikon me kujdes shkrimet në të prej fjalës së tij *(Paqja qoftë mbi të!)*do ta kuptojë se gjithçka kanë diskutuar folësit pas klasifikimit dhe tubimit të tij janë vetëm komente të atyre fjalive dhe shpjegime të atyre bazave.

Prej hytbeve të tij të shumta në këtë kapitull është thënia e tij *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*për cilësitë e Allahut (xh.sh): Zoti qoftë lëvduar, të Cilit nuk ia përshkruan dot vlerat asnjë gojëtar, të Cilit nuk mund t'ia numërojë të mirat asnjë numërues, të Cilit nuk mund t'ia njohin kurrë hakun ashtu siç i takon dhe deri në fund. Ata që përpiqen t'ia njohin dhe të Cilit nuk mund ta kuptojë e ta kuptojë e vlerësojë siç e meriton asnjë mendje e mençuri, sado e ndritur. Lëvduar qoftë Ai, për cilësitë e të Cilit nuk ka asnjë cak, nuk bëhet asnjë përshkrim, nuk mjafton asnjë lëvdatë (e denjë sa duhet për Të), nuk ekziston asnjë kohë fillimi dhe nuk është caktuar asnjë kohë mbarimi. Ai e pruri krijimin në qenie përmes Pushtetit të Tij, i lëshoi erërat nga Mëshira e Tij dhe e fiksoi dheun në lëkundje me anë të shkëmbinjve.

E para gjë në fe' janë dijet për Të, përsosmëria e dijeve rreth Tij synon dëshmimin e Tij, përsosja e dëshmisë së Tij arrihet me besimin në Njëshmërinë e Tij "në qënien e Zotit Një i Vetëm dhe pa partner në krijimin e Tij". Përsosmëria e besimit në Njëshmërinë e Tij nënkupton të jesh i ndershëm ndaj Tij, e qenia i ndershëm ndaj Tij e arrin përsosmërinë kur nuk i vishen cilësi, sepse vetë cilësia është një provë e qenies se saj ndryshe prej gjësë

së cilësuar dhe sepse gjëja, së cilës i vishet diçka është e ndryshme nga vet veshja.

Kushdo që i vesh Zotit tipare, pranon të ngjashmin e Tij dhe kush i njeh Atij të ngjashëm, e sheh Atë si dy, e kush e sheh Atë si dy, e pranon si të ndashëm, pra edhe të pjesshëm e të paplotë. Por, pranimi i paplotësisë së Tij është si ta marrësh Atë tjetër për tjetër dhe ngatërrimi i Tij tjetër për tjetër kërkon ta dëftosh, por të dëftosh në drejtim të Tij është njësoj si t'i veshë kufij dhe t'i veshë kufij do të thotë ta numërosh. Kush thotë në çfarë është Ai, e mendon Atë të përmbajtur në diçka dhe kush thotë se ku është Ai, thotë se Ai nuk është diku tjetër.

Ai është Qënie, po jo përmes ardhjes në ekzistencë. Ai është, por jo që del nga mosqenia. Ai gjendet në gjithçka, po jo përmes afërsisë fizike. Ai është jashtë gjithçkaje, por përmes ndarjes fizike. Ai vepron, por pa vënë në punë lëvizje dhe vegla. Ai e shikon krijimin e Tij edhe kur s'mund të shihet gjë në të. Ai është vetëm Një, një Një i tillë, që nuk ka një tjetër si Ai, me të cilin Ai do mundej të mbante shoqëri, e të cilit do t'ia ndjente mungesën, po t'i mungonte. Ai e solli krijimin në qenie në një mënyrë që s'i ngjan asgjëje tjetër, pa u menduar për ta menduar, pa asnjë eksperimentim, pa përmirësuar asnjë lëvizje e pa zbatuar asnjë ëndërr intelektuale. Ai i caktoi kohë çdo gjëje (duke i dhënë materies hapësirën e kohës), bëri bashkë në një, tiparet e ndryshme të tyre dhe u dha karakteristika e u veshi veti që i njihte që përpara se t'i krijonte, duke bërë fakt kufizimet dhe caqet e tyre dhe duke vlerësuar prirjet e thelbit të tyre dhe ndërlikimet e pritshme që lidhen me to. Kush dëshiron të qëndrojë më gjatë në një pjesë të shembujve të kësaj hytbeje le të përsërisë pjesët e shpjegimit të shtegut të elokuencës që janë përmendur në burimet e kësaj teme.

Ai *(Paqja qoftë mbi të!)*është pyetur*:* Si e njohe Zotin tënd? Ai tha: ashtu si e ka përshkruar Ai veten e Tij, është thënë: E si ta ka përshkruar ty? Dhe tha: Atij nuk i përngjan askush si pamje dhe as nuk e ka ndjeshmërinë e pesë shqisave dhe as nuk matet me mënyrën e matjes së njerëzve. Atij *(Paqja qoftë mbi të!)*i është thënë: Si do t'i peshojë Allahu punët e njerëzve? Ai ka thënë: Ashtu si Ai i furnizon ata. Po si do t'ua peshojë punët atyre kur ata nuk e shohin Atë? Ashtu si Ai i furnizon ata pa e parë Atë. Një njeri e ka pyetur: Ku ka qenë Zoti yt para se të krijohej qielli dhe toka? Ai ka thënë: (ku) është pyetje rreth vendit, ka qenë Allahu dhe Ai nuk ka vend.

Profesor Ukadi ka thënë: Aliu është dijetari dhe juristi më i mirë në islam, po ashtu siç është më i miri në adhurim dhe në vepra, kurse mendimet e tij kanë qenë pikë referimi i kalifave dhe shokëve në kohët e Ebu Bekrit, Omerit dhe Osmanit *(Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!)*. Ka qenë e rrallë ndonjë prej çështjeve të sheriatit për të cilën nuk është dhënë ndonjë mendim që të merrej për bazë apo t'i jepej ndonjë kundër argument mes mendimeve më të mira, vetëm se dallimi me të cilën shquhej me to Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*. Në mesin e dijetarëve islam në kohën e tij është se ai e ka pasur fenë temën, subjektin e mendimit dhe të meditimit dhe nuk ka neglizhuar fare ibadetin dhe zbatimin e vendimeve.

Po ta njihte dikush në kohën e tij njerëz që kanë marrë dije në fe', do të vërtetonin adhurimet e tij dhe do të merrnin prej tij gjykimet dhe vendimet e tij. Aliu është shquar në jurisprudencën e sheriatit me të cilën synohej mendimi nxitës dhe mësimi i pastër dhe ka këmbëngulur në të që të mbjellë në thellësitë e tij të vërtetën shkencore apo të vërtetën filozofike, siç e quajmë atë sot. Me të vërtetë Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*është babai i teologjisë në islam, sepse folësit kanë ngritur mez'hebin e tyre mbi bazat e tij

dhe kanë lidhur hallkat mes tij dhe dijetarëve të teologjisë dhe të teuhidit. Ashtu siç kanë lidhur hallkat mes tij dhe mes dijetarëve të jurisprudencës dhe sheriatit, dijetarëve të literaturës dhe retorikës, sepse ai është profesori i të gjithë këtyre me sened të përçuar.

Ibn Ebi Hadidi ka thënë: Nuk po them për një njeri që çdo mirësi i atribuohet atij dhe çdo kontradiktë përfundon tek ai për zgjidhje dhe se çdo grup është i tërhequr prej tij, pasi ai është kryetari i mirësive dhe burimi i tyre, babai i arsyes së tyre, i pari në fushën e saj dhe pastruesi i qumështit të saj. Çdo gjë që është shfaqur në të pas tij është marrë prej tij, kanë ndjekur atë dhe pas gjurmëve të tij kanë ecur.

Kam kuptuar se nga shkencat më fisnike është shkenca hyjnore, që flet rreth Zotit, sepse fisnikëria e shkencës është sipas fisnikërisë së dijes dhe dija e tij është nga krijimet më fisnike. Kështu ai ishte prej dijeve më fisnike, prej fjalës së tij janë kapur, prej tij kanë trasmetuar, tek ai përfundojnë çështjet dhe prej tij ka filluar. Pa dyshim se mut'tezilitët të cilët janë njerëz të teuhidit dhe drejtësisë dhe profesorët e mendimit, njerëzit, nxënësit dhe shokët e tij e kanë mësuar prej tyre këtë art, sepse më i madhi i tyre është Vasil ibn Atai, nxënësi i Ebi Hashimi Abdullah Muhamed ibn Hanife, Ebu Hashimi është nxënësi i babait të tij, kurse babai i tij është nxënësi i tij *(Paqja qoftë mbi të!).*

Kurse sa i përket esh'arijjes, pa dyshim se ata rrjedhin nga Ebi Hasani Ali ibn Ismaili ibn Ebi el Besher el Esh'arij dhe ai është nxënësi i Ebi Aliut el Xhebaijut. Ebu Aliu është një nga Shehat mu'tezilite, prandaj esh'arijët rrjedhin nga profesori i mu'tezilitëve dhe mësuesi i tyre që është Ali ibn Ebi Talibi *(Paqja qoftë mbi të!).* Sa i përket imamatit dhe zejdijes (që është një sekt shi'it i cili

rrjedh nga Zejd ibn Aliu ibn Hysejni *(Paqja qoftë mbi të!)* origjina e tyre prej tij është e qartë.

Profesor Xhorxh Xherdak ka thënë: Imam Aliu ka dhënë shumë mendime filozofike në lidhje me çështjet e jetës, gjithësisë dhe shoqërisë njerëzore, edhe në çështjet e njehsimit, hyjnisë (të qenit Zot) dhe diturisë së asaj që ka pas së natyrshmes. Ai ishte themeluesi i teologjisë dhe filozofisë hyjnore në islam dhe ishte një profesor që e ka pranuar udhëzimin e drejtë dhe origjinalitetin e tij, gjithkush që e ka ndjekur atë prej mendimtarëve dhe teologëve. Ata janë për të ndjekës dhe shpjegues, qartësues dhe në librin e tij madhështor shtegu i elokuencës ka një mori hikmetesh, mençurisë unikale të cilat qëndrojnë në rresht të parë në mesin e njerëzve të mençur të popujve. Pejgamberi (*Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)* ka thënë: "Dijetarët e ymetit tim janë si pejgamberët e beni-israilëve" a nuk ka pasur për qëllim vetë Aliun?



I PARI QË KA THEMELUAR METODËN E STILIT ARTISTIK NË GJUHËN ARABE[1]

Xhahidhi në librin e tij "El Bejanu ue et Tebjinu" e ka bërë të qartë kuptimin e fjalës "el bejanu", e ka përkufizuar atë me mënyrën shkëlqyer e të qartë dhe ka paraqitur një pjesë të thënieve të elokuentëve, atyre që flasin rrjedhshëm, pastaj ka thënë: Aliu ibn Ebi Talibi *(Paqja qoftë mbi të!)*ka thënë: "Vlera e çdo njeriu shihet në punët e mira" pastaj e ka komentuar këtë fjalë me thënien e tij, sikur në këtë libër të qëndrojmë vetëm në këtë fjalë do ta gjenim atë shëruese dhe të mjaftueshme, produktive dhe pasuruese, madje do ta gjenim atë superiore ndaj të mjaftueshmes, pa e neglizhuar fare qëllimin.

Fjalët më të mirë janë fjalët e pakta të pasurojnë ndaj fjalëve të tepërta dhe kuptimi i saj është në krye të shprehjes. Duket sikur

1 Dijvanu Ebi Temam 3/258. El Bejanu ue Tebjinu i El Xhahidh 1/83. El Akdul Ferid 2/285 dhe 3/304. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebi Hadid 1/24;6/437,451,452 dhe 16/66-122 dhe 20/255 e më tej. Sherh Nehxhul Belaga i shejkh Muhamed Abduh (el mukadimeh). Dijuanul Haxh Abdulhusejn el-Ezeriu. El Abkarijjatu i Ukadit /754,755,757. El Imam Ali, seutul adaletil insanijeh 3/186,187,207,213.

Allahu (xh.sh) e ka veshur atë me rrobat e madhështisë dhe e ka mbuluar me dritën e mençurisë, sipas nijetit të autorit të saj dhe devotshmërisë së folësit të saj. Nëse kuptimi është fisnik, shprehja është elokuente dhe natyra e vërtetë është larg urrejtjes, neverisë dhe i distancuar nga konfuzioni. I përmbajtur ndaj obligimit ka krijuar në zemra, instrumentin, mirësinë e shiut në tokat e bekuara. Kur fjala ndahet nga ky kusht dhe bëhet efektiv nga ai që e thotë për këtë cilësi, Allahu i Madhërishëm e shoqëron me sukses dhe i jep atij mbështetjen pa kufi në respektimin e saj nga gjokset e të fortëve dhe me kuptimin e saj nuk i habit mendjet e injorantëve, sepse nëse fjala del nga zemra futet në zemër dhe nëse del nga gjuha nuk e dëgjojnë as veshët.

Ibn Ebi Hadidi në prezantimin e dijeve të imamit dhe dhuntitë e tij ka thënë: Përsa i përket argumentimit, elokuencës, ai është imami i elokuentëve dhe i pari i atyre që flasin qartë, në fjalën e tij është thënë: Është poshtë fjalës së Krijuesit dhe sipër fjalës së krijesës, prej tij njerëzit kanë mësuar të flasin dhe të shkruajnë. Abdul Hamidi el-katibu ibn Jahja ibn Seidi ka thënë: Unë kam mësuar përmendësh shtatëdhjetë hytbe të tij që u shtuan dhe u pasuruan edhe më shumë.

Ibn Nebate Abdurrahim ibn Muhamed ka thënë se kam mësuar përmendësh prej mënyrës së të folurit një pasuri që vetëm shtohet dhe zgjerohet me rritjen e përdorimit. Kam mësuar përmendësh njëqind pjesë prej qortimeve të Aliut ibn Ebi Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)*. Në librin shtegu i elokuencës ka shumë hytbe, korrespondenca dhe fjalë të urta të cilat vërtetojnë se ai *(Paqja qoftë mbi të!)* është imami i mjeshtreve të krijimtarisë, kjo për shkak se ky art, nuk ka njeri që t'ia kalojë atij në fjalë përveç disa shprehjeve të lehta të paqëllimta.

Njëra prej tyre është fjala e tij në cilësinë e dheut dhe shtrirjen e tij mbi ujë: Zoti e hapi dheun mbi valët e stuhishme e të potershme, honet e deteve të fryra, aty ku tallazet shkatërronin njëri-tjetrin me dallgët e larta vërsuleshin furishëm mbi njëra-tjetrën. Shkuma e përplasjeve gufonte sikur derdhej prej bulçive të meshkujve të deveve kur kërkojnë femër. Masat e dheut e dobësuan vrullin dhe stuhinë e masave të rrjedhshme. Trazira e tyre e zhurmshme u zbut nën shtypjen e gjoksit të tij, e sapo dheu i mbështolli pështjellimet e tyre me brinjët e kraharorit të vet, ato u shtruan fare. Ndërkohë që dheu mpiksej e futej drejt thellësive të tyre të stuhishme, furia e shkumave të tyre pakësohej e mposhtej, si mposhtet dhe zbutet tërbimi i të burgosurit nga prangat e veprës së vet. Kështu i dha fund dheu kryelartësisë, mendjemadhësisë, fudullëkut dhe superioritetit të lëngut e i vuri fre' vërshimit të rrjedhjes së tij dhe kështu, ai u ndalua pas asaj stuhie të shfrenuar dhe poterja e tij nuk u dëgjua më.

Kjo pjesë e hytbes është e gjitha në këtë stil, por ne u mjaftuam me kaq pak duke u kujdesur për të ruajtur pak shkurtimisht. Ibn Ebi Hadidi ka bërë një komentim mbi këtë. Kjo pjesë e fjalëve të prijësit të besimtarëve *(Paqja qoftë mbi të!)* ka përfshirë në të një metaforë të mrekullueshme, përveç saj edhe kapitujt e krijimit sikur të ishte i pranishëm në koleksionin e poemave të një poeti të pasur apo korespondenti të pasur do ta meritonte avantazhin me të. A nuk e shikon atë se si i ka përshkruar dallgët sikur ato janë të stuhishme e të potershme, dhe se shkuma e përplasjeve gufonte sikur derdhej prej bulçive të meshkujve të deveve kur kërkojnë femër. Pastaj e bëri ujin kapriçoz dhe e përshkroi atë me dobësi, nënshtrim, e bëri dheun si kraharor dhe e përshkroi atë si mbështjellë të ujit, përshkroi ujin si të mposhtur e të dorëzuar, ashtu siç e bëri dheun që mpiksej e

futej drejt thellësive të tyre, ashtu siç përplaset apo zhgërryhet gomari apo kali dhe i vuri asaj pengesa, lëngut i vuri fre' dhe ujit i vuri frerët e mposhtjes, ashtu siç mposhtet dhe zbutet tërbimi i të burgosurit nga prangat e veprës së vet.

Pastaj e mbylli fjalimin e tij me fjalën: Për Allah është e çuditshme me disa njerëz që pohojnë se fjala i dallon nga njëri-tjetri për shkak të përmbajtjes së saj. Prej shembujve të kësaj natyre dhe nëse gjejnë në njëqind letra dy fjalë apo tre prej tyre do të bënin kijametin dhe do t'i frynin surit dhe do të mbushnin faqet duke kërkuar mirësinë me të. Dorështrënguarit e lejojnë këtë fjalë me këtë mënyrë me formën më të ëmbël dhe shprehjen më bombastike, kuptimin më preciz dhe qëllimin më të mirë. Më pas i përfshin pasioni dhe fanatizmi në heshtjen e preferencës së tij nëse kanë bërë punë të mira dhe nuk janë treguar mendjengushtë në preferencën e dikujt tjetër ndaj tij edhe pse nuk është çudi. Pa dyshim ajo është fjalë e Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe fati i fjalës është fati i folësit dhe njeriu më i dyshimtë është pjesë e rrobës së tij.

Nga ajo çfarë ka thënë imam shejkh Muhamed Abduh në prezantimin e shpjegimit të tij të shtegut të elokuencës është se shfletova disa faqe dhe vura re fjali prej shprehjeve të tij në tema të ndryshme dhe të ndara. Ajo më bënte mua të imagjinoja në çdo pozicion se luftërat janë ndezur dhe sulmet janë ndalur, për elokuencën ka një shtet dhe rrjedhshmëria e të folurit ka influencë, imagjinatat janë bërë mullar dyshimet janë liberalizuar, kurse buzët e hatibit, folësit dhe lapsat e mprehtë janë në instrumentet e disiplinës dhe safet e rregullores, mbrohen me kallaj të pastër dhe mistri të drejtë, zemrat zhvishen me dhëmbësin e argumenteve dhe bëjnë ecejake nga ç'thurja e ngacmimeve dhe shkaktojnë vrasjen e luanëve. Unë nuk them gjë tjetër vetëm se e vërteta është

triumfuese, kurse e kota është e thyer, e shkatërruar, përzieja e dyshimit është në shuarje dhe tepria e mëdyshjes është në rrjedhje të vazhdueshme dhe se kontrolluesi i atij shteti. Guximtari i atij atributi që është bartësi i flamurit te tij triumfues është prijësi i besimtarëve Ali ibn Ebi Talibi *(Paqja qoftë mbi të!).*

Profesor i madh Abbas Mahmud el Ukadi ka thënë: Imam Aliu nuk është i pari që ka shkruar mesazhe, ka lëshuar qortime dhe që ka mbajtur hytbe nëpër mindere për ymetin islam. Nuk ka asnjë dyshim ai është i pari që ka kuruar këto arte sipas kurimit të një edukuesi dhe është i pari që ka akorduar mbi to karakteristikat e themelimit, ndërtimit me të cilin e ndjekin në të metodika. Ata të cilët e paraprinë atë e kanë bërë fjalën e tij si shembulli i përçuesve të mesazhit dhe jo shembullin e themeluesve, kishte si qëllim të zbatohej nga atë që dëshironin dhe nuk kishin si synim artin e zbatimit dhe ndërtimin e shprehjes. Mirëpo imam Aliu e ka mësuar të shkruarin që kur ka qenë i vogël dhe e ka mësuar mënyrën e të folurit nga transmetimet e gjuhëve dhe leximit të letrave, e ka pritur me elokuencë derisa dolën nga faza e intuitës së parë në fazën e diversitetit dhe përmirësimit dhe i qëndroi atij drejt një metodë e printuar e ndërtuar që është një nga metodat e zhvillimit artistik, teknik në gjuhën arabe. Metoda e parë që u shfaq në gjurmët e studimit të Kur'anit dhe përfitimit nga modeli dhe konteksti i tij.

Profesor Xhorxh Xhordak ka thënë: Nuk ka asnjë dallim ndërmjet asaj që imam Aliu shkruan dhe asaj që e improvizon, pasi burimi është burim dhe shija e tij nuk llogaritet as natën e as ditën. Prej hytbeve të tij të improvizuara ka mendime të mrekullueshme të fiksuara me fuqinë e mendjes së mençur dhe logjikës së drejtë dhe se ti mund të habitesh para këtij vlerësimi për precizonin dhe sigurinë e të mëdhenjve kur të mësosh se Aliu

nuk i përgatiste hytbet e tij as para se ti mbante ato me minuta apo çaste. Ato buronin nga zemra e tij dhe shpreheshin me gjuhë nëpërmjet mendjes, pa u shqetësuar dhe pa asnjë stres, njësoj si ndriçimi i cili vezullon pa lajmëruar fare, apo t'ia japë atij para shkreptimës së tij dhe njësoj si vetëtima kur shpërthen nuk e përgatit veten e saj për oshtimë apo buçimë.

Pa dyshim ai e ka bërë të larmishme hulumtimin dhe përshkrimin dhe e ka bërë në mënyrën më precize dhe të mençur në çdo temë, pasi ai flet me logjikën e të mençurit ekspert, të mirinformuar për situatat e dynjasë dhe problemet e njerëzve. Ai flet për natyrat e individëve dhe të shoqërive, i bën një përshkrim vetëtimës, rrufesë, tokës dhe qiellit dhe ka folur shumë për historinë e natyrës duke i përshkruar qelizat e krijimit të lakuriqit, milingonës, palloit, karkalecit e shumë të tjera, duke i vendosur shoqërisë disa kushtetuta. Kurse në ligjet morale në mënyrë të shkëlqyer e të mrekullueshme flet për Krijuesin, universin dhe mrekullitë e ekzistencës dhe s'ka dyshim se ti nuk mund të gjesh në të gjithë kulturën arabe këtë vlerësim të cilin e gjen në shtegun e elokuencës prej mendimeve të mrekullueshme e të shëndosha, të pastra dhe logjikës së mençur si në shembullin e kësaj metode të rrallë.

Sa i përket vizionit tek shtegu i elokuencës ai është i gjatë, i shtrirë dhe ka hapur pulset e krahëve në çdo horizont dhe për hir të këtij vizioni të fortë prej të cilit janë privuar shumë prej dijetarëve të kohëve dhe mendimtarëve të popujve. Aliu merrte nga mendja dhe eksperiencat e tij, kuptimet që kishin subjekt të pastër. Pastaj e lëshonte atë me një shkëlqim të shpejtë dhe pa dyshim në kushtet e elokuencës që është pranimi i fjalës për situatën e nevojshme, nuk janë unifikuar për ndonjë autor arab, ashtu siç janë bashkuar për Aliun të birin e Ebi Talibit. Stili

frazeologjik i tij është shembulli më i lartë i kësaj elokuence, pas Kur'anit. Ai është përmbledhës i qartësisë, i fortë, i ri në mishërim të plotë të harmonisë i të gjitha shprehjeve të tij, kuptimeve dhe synimeve të tij.

Me të vërtetë është shumë e vështirë që të gjejmë në personalitet e historisë dikë që janë bashkuar tek ai të gjitha këto kushte, të cilat e bëjnë autorin e tyre një folës të shkëlqyer, përveç Aliut ibn Ebi Talibit *(Paqja qoftë mbi të!).* Ka shumë pak njerëz dhe ty nuk të mbetet gjë tjetër vetëm të ekspozosh këto kushte, më pas ekspozimi i oratorëve të famshëm në botë, nga lindja në perëndim, që të kuptosh se kjo fjala jonë është e vërtetë dhe në të nuk ka asnjë ekzagjerim.

Prijësi i besimtarëve *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë njëmijë fjalë prej fjalëve të urta të cilat ibn Ebi Hadidi i ka përmendur në fund të shpjegimit të shtegut të elokuencës. Gjithashtu ai ka me mijëra fjalë të mençura që janë përmendur në hytbet, letrat dhe këshillat e tij. Meqenëse po të përmendim shumë prej tyre do të na nxjerrë nga kufijtë e vendosura të librit, atëherë është e domosdoshme të citojmë një parti të vogël të cilat janë një pikë uji nga ai oqeani i madh:

Në çdo frymëmarrje, njeriu i afrohet vdekjes një hap më pranë.

Njeriu fshihet nën gjuhën e tij.

Ëndrra është tribu.

Ëndrra dhe ena janë dy binjake që vijnë si produkt i shqetësimit të madh.

Çdo enë ngushtohet për atë që është prodhuar përveç enës së diturisë, se pa dyshim ajo zgjerohet.

Mendimi i mirë për vendet pranohet kur shkon atje dhe largohet kur largohesh prej tyre.

Sa të shumta janë mësimet, por sa i pakët është vlerësimi.

Asnjë vetëpërmbajtje nuk ruan, sa shmangia e gjësë së ndaluar.
Askush s'e vendos dot ligjin e Zotit të Madhëruar, veç atij që nuk njeh ngurrime, s'bën dot keq dhe s'ka pasione e lakmi.
Kush bën mirë, është më i mirë se vetë e mira dhe kush bën keq, është më i keq se vet e keqja.
Ç'i zgjat ambicies ia shkurton veprimit.
Ji bujar, por jo dorëshpuar; ji i kursyer, por jo koprrac.
Nëse mundesh që mes teje dhe Allahut të mos ketë interes, atëherë bëje.
Idhtësia e dëshpërimit është më e mirë se sa t'i lypësh njerëzve.
Stolia e skamjes është nderi, stolia e kamjes është mirënjohja.
Njeriu e ruan vetë sekretin e tij.
Kush nuk thotë më "nuk di", i është futur shtegut të rrënimit.
Shoqërohu me njerëzit punëmirë që të jesh prej tyre.
Padrejtësia ndaj të dobëtit është padrejtësia më e urryer.
Mendja është magazina e eksperiencave.
Humbja e një rasti të volitshëm sjell trishtim.
Kush i mpreh dhëmbët e revoltës për hir të Zotit, mund të mundë dhe armikun e tij më të fortë.
Mos e fajësoni atë që e vonon marrjen e hakut që i takon, faj ka kush merr gjëra që s'i takojnë.
Kushdo që ka dalë kundër së drejtës, është shkatërruar.
Mos e shihni të keqe thënien, ku mund të gjeni diçka të mirë në të.
Kush e ka të shtrenjtë dinjitetin, rri larg sherreve.
Dëshpërimi mund të kaplojë nëse shpresa humbet.
Mund të ndodhë që ai që shikon, të humbasë rrugën kurse i verbri të gjejë udhëzimin.
Këputja e lidhjeve të injorantit është baras me lidhjen e atij që logjikon.

Pyet për shokun para se të udhëtosh me të dhe për komshiun para se të jesh komshi.
Respektoje shoqërinë tënde, sepse ata janë krahët e tu me të cilat ti fluturon.
Kulmi i edukatës është që njeriu të ketë turp nga vetja e tij.
Kush e njohu dynjanë nuk hidhërohet për belatë.
Lëre gënjeshtrën me mirësi, nëse nuk e lë atë me dhimbje.
Kush e njeh veten e tij, ka njohur Zotin e tij.
Të jesh mendjemadh ndaj mendjemëdhenjve është vetë modestia.
Njeriu më i ulët është ai që i kërkon ndjesë të keqit, të ligut.
Kënaqësia e njerëzve është një synim që nuk mund të perceptohet.
Durimi është çelësi i relaksit.

Në fund i mbyllim këto fjalë të mençura me thënien e tij *(Paqja qoftë mbi të!)* drejtuar Ash'ath ibn Kajs duke e ngushëlluar për humbjen e të birit: "O Esh'ath, e kuptoj që je helmuar për tët bir, se ishte gjaku e mishi yt, po Zoti e shpërblen durimin e dhembjes. O Ash'ash, në durofsh, punët do shkojnë prapë si bën ymër Zoti, përveç që do marrësh shpërblimin e Tij. E në mos durofsh, fati do bëjë prapë të tijën, po halli që të zuri nuk do jetë më i lehtë.



LLOGARITARI I PARË NË ISLAM[1]

Prijësi i besimtarëve Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* kishte pririe në shkencën e llogarisë që askush nuk i afrohej në kohën e tij. Shumë çështje problematike që iu paraqitën atij, përgjigjet rreth tyre kanë qenë të menjëhershme dhe të improvizuara prej mrekullive.

Nuk ka mbetur çështje e minderit pa përmendur dhe që njerëzit të mos mbeteshin të habitur, pa e përmendur dijetarët dhe historianët me një çudi dhe habi. Kur një njeri e pyeti imamin kur ai ishte mbi minder ai tha: O prijësi i besimtarëve, një njeri ka vdekur dhe ka lënë pas tij dy vajza, dy prindërit dhe gruan, kurse imami iu përgjigj atij në mënyrë rrufe: Një e teta e saj, u bë një e nënta.

Kjo çështje është e bazuar mbi ligjin e ndarjes së pasurisë është futja e pakësimit tek ngushtimi i pasurisë nga pjesa e detyrueshme për të gjithë trashëgimtarët në lidhje me pjesën e tyre trashëguese, prandaj këtu bashkëshortja ka një të tetën kurse dy prindërit kanë një të tretën dhe dy vajzat kanë dy të tretat. Kështu u ngushtua pasuria e pjesës së trashëguar, sepse me një të

1 El Besairu ue Edh Dhekhairu 2/148. El Irshad /117. El Istiabu /1105. En Nihajetu i ibn Ethir 3/321. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebi Hadijd 1/19. Lisanul Arab lënda (ajn dhe lam). Nihajetul Ereb i Neuirit 20/ 6-8. A'janu Shi'ia 3/k1/58,59. El Abkarijatu /753,754. Imam Aliu, seutul adaletil insanijeh 1/98,101. Er Reudatul Mukhtare /136,144.

tretën e prindërve dhe dy të tretat e dy vajzave, plotësohet pasuria, kështu nuk i mbetet gjë bashkëshortes.

Për ndalimin e ligjit të ndarjes së pasurisë, një pjesë e dijetarëve të fik'hut kanë thënë: Pa dyshim pjesa që pakësohet, apo u hiqet është pjesa e dy vajzave, pasi obligimi është njëzet e katër pjesë: Për bashkëshorten një e teta e saj është tre, kurse për dy prindërit një e treta e saj është tetë. Pjesa që mbetet prej trembëdhjetës është e dy vajzave dhe prej pjesës së atyre të dyjave ka pakësuar tre hise.

Prej atyre që e mbështesin ligjin e ndarjes së pasurisë ka thënë: Pakësimi futet tek të gjithë dhe njëzet e katrës i shtohen tre pjesë, kështu bëhet njëzet e shtatë pjesë, prej tyre. Bashkëshortja ka tre pjesë, dy prindërit tetë dhe dy vajzat gjashtëmbëdhjetë, bashkë me tre të bashkëshortes bëjnë njëzet e shtatë, pra ky është kuptimi i fjalës së imamit (një e teta, është bërë një e nënta). Në këtë çështje ibn Ebi Hadid thotë: Nëse mendohet hipotetikja e kësaj çështjeje do të merrej më e mira prej saj pas një shikimi të gjatë kjo përgjigje, pra çfarë mund të thuash ti për atë që ka thënë në mënyrë impulsive dhe e ka prerë shkurt në mënyrë improvizuese?

Imami ka përgjigje për një çështje tjetër të rëndësishme që quhet çështja e dinarijes (dinarëve). Kur një grua shkoi tek imami, ai sapo kishte dalë nga shtëpia, po i hipte kalit dhe e la këmbën e tij varur mbi të dhe ajo i tha: O prijësi i besimtarëve, vërtetë vëllai im vdiq dhe ka lënë pas si trashëgimi gjashtëqind dinarë. Mua më kanë dhënë vetëm një dinar prej asaj trashëgimie, unë të lutem të bësh drejtësi për mua, kurse ai i thotë: Vëllai yt, a ka lënë dy vajza dhe nënën dhe një bashkëshorte, dymbëdhjetë vëllezër dhe ty? Ajo tha: Po dhe ai tha: Ti ke marrë hakun tënd, ajo tha: Po si kështu? Ai tha: Për dy vajzat i takon një e treta katërqind dinarë,

kurse nënës një e gjashta njëqind dinar bashkëshortes një e teta shtatëdhjetë e pesë dinarë dhe secilit vëlla i takon dymbëdhjetë dinarë, kurse ty të mbetet një dinar.

Dijetari Sejjid Muhsin el-Emini i ka komentuar këto dy lajme me thënien e tij: Kjo çështje është e bazuar mbi ngacmim, presion, ashtu çështja e minderit është e bazuar mbi ligjin e ndarjes së pasurisë dhe presioni është marrja e komunitetit, ajo që është e obliguar në librin Famëlartë. Ajo që është e fiksuar nga Ehli Bejti është anulimi i ngacmimit, presionit. Pasi pjesëtarëve nuk i shtohet pjesa e trashëgimisë së tyre dhe ka mundësi që imami ka dhënë fetvanë, opinionin për të sipas mënyrës që ka qenë e njohur në atë kohë edhe pse nuk e ka bërë vetë.

Asnjë libër fik'hu nuk mund të linte pa përmendur këtë çështje e atë para saj për të dyja çështjet, profesor Ukadi thotë: Në lajmet e tij, ka çështje që tregojnë për diturinë e tij me instrumentet e fik'hut, ashtu si dituria me literaturat dhe ligjet e tij. Njëra prej këtyre instrumenteve është shkenca e llogarisë në të cilën ai kishte njohuri më shumë se njohuria e një dijetari fek'ih në enigmat e trashëgimisë, sepse ai kishte një inteligjencë të shpejtë në dinamikat e tij të cilat kanë qenë mistere në atë kohë, zgjidhja e të cilave i lodhte mendjet. Pastaj citoi dy çështjet e përmendura.

Ka edhe një çështje të njohur, shumë më të komplikuar se dy të parat, që e kanë transmetuar një mori dijetarësh, prej tyre është ibn Abdulberri në librin El Istiiabu me zinxhir transmetimi të vlerësuar si të përçuar dhe ka thënë: Dy veta u ulën për të ngrënë drekë dhe njëri prej tyre kishte pesë feta bukë, kurse tjetri kishte tre feta. Kur e vunë përpara drekën, aty afër u kalon një njeri, i cili i përshëndet me selam, kurse ata të dy i thonë: Urdhëro, ulu të hash drekë dhe ai u ul dhe hëngri drekë me ata të dy, u ngopën me tetë fetat e bukës dhe ai njeri u ngrit dhe u dha atyre

tetë derhem dhe tha: Merrini këto si kompensim i asaj që hëngra prej jush dhe mora prej ushqimit tuaj.
Ata filluan të grindeshin dhe ai që kishte pasur pesë feta thotë: Unë do të marr pesë derhem, kurse ti do të marrësh tre derhem; ai që kishte pasur tre copa buke thotë: Unë nuk pranoj fare, vetëm nëse i ndajmë në mënyrë të barabartë dhe e dërguan çështjen tek prijësi i besimtarëve, Aliu dhe i treguan historinë e tyre, ai i thotë personit që kishte pasur tre feta buke: Shoku yt të ka ofruar atë që të ka thënë, por ai ka pasur më shumë bukë se sa ti, prandaj pranoi tre derhemët, kurse ai thotë: Jo, për Zotin, nuk pranoj ndryshe vetëm se të më japë hakun tim, por prijësi i besimtarëve i thotë: Ty nuk të takojnë më shumë se një derhem, kurse atij i takojnë shtatë derhemë, ai i thotë: I madhëruar është Allahu, o prijësi i besimtarëve, ai më ofron mua tre derhem dhe unë nuk pranova kurse ti më the që t'i marr dhe unë prapë nuk pranova dhe tani ti më thua mua: Me të vërtetë se ty nuk të takon nga haku yt vetëm se një derhem? Kurse prijësi i besimtarëve i thotë atij: Shoku yt të dha tre të mira dhe the: nuk jam i kënaqur vetëm nëse më jep hakun tim dhe për hakun tënd nuk të takojnë më shumë se një derhem, kurse ai njeri i thotë: Ma thuaj të qartë për hakun tim derisa ta pranoj atë dhe ai thotë: Tre fetat e bukës, a nuk janë një e njëzet e katërta pjesë që ju të tre vetët i keni ngrënë dhe nuk e dimë se kush ka ngrënë më shumë e kush më pak që ta keni në mënyrë të barabartë ngrënien tuaj? Ai tha: Po! Pra, ti ke ngrënë tre të tetat, mirëpo ti ke nëntë të tretat. Shoku yt ka ngrënë tre të tetat por ai ka pesëmbëdhjetë të tretat, kështu që atij i mbeten shtatë kurse ty të mbetet një, pra ti ke një derhem kurse shoku yt ka shtatë derhem, dhe ai njeri thotë: Tani e pranoj o prijësi i besimtarëve.



I PARI QË KA VËNË NJË SHTËPI NË DISPOZICION PËR TË SHTRUAR NË TË PROBLEMET, ANKESAT[1]

Ibn Sirini ka thënë: I pari që ka caktuar një vend që njerëzit çonin në të ankesat, problemet është prijësi i besimtarëve Aliu. El-bejtu (shtëpia) është treguese e një dhome të vogël, të mbyllur, që kishte një dritare të vogël ku hidheshin ankesat, kurse (el-kasas) është shumësi i fjalës (el-kissatu) do të thotë problem, çështje, thuhet e ngriti çështjen e tij te gjykatësi. Ajo që njihet tani me emrin akuza që ka në të ankesë nga ai që i është bërë padrejtësi apo ai që është në nevojë. Kjo pikëpamje fisnike u neglizhua derisa pas tij erdhi kalifi Muhdi ibn Ebi Xha'ferr el Mensuri, i cili bëri një dhomë të tillë për ankesat dhe kërkesat.

1 El Euailu i Ebi Hilal el Askerij /167. Meathirul Aakati fi Mealimil Khilafeti 3/341. Dijuan Hasan Abdulbaki el Meusulij /19,20.



I PARI QË KA TESTUAR PREDIKUESIT NË ISLAM[1]

Predikimi është një detyrë e rëndësishme të cilën nuk mund ta praktikojë atë askush tjetër veç atij që është i njohur në mesin e njerëzve për fenë dhe të mirën dhe cilësitë e mira. Ai është i ditur me shkencat e sheriatit dhe të arsimit, hafiz i Kur'anit dhe i haditheve profetike, të njohë mirë historinë profetike dhe thëniet e sahabeve, tregimet e njerëzve të cilët kanë jetuar në kohë të turbullta dhe që ka pasur në të qortime për besimtarët.

Imam Aliu ka gjetur në xhaminë e Basras njerëz që binin në kundërshtim me predikimin dhe që ishin duarbosh dhe që nuk i plotësonin instrumentet e predikimit. Kështu i nxori jashtë xhamie dhe ua ndaloi atyre që të predikonin dhe kur erdhi në një mbledhje dhe në të ishte Hasan el-Besarij duke folur, në atë kohë ishte djalë i ri, e dëgjoi atë me vëmendje dhe i pëlqeu fjala e tij, pastaj i tha atij: O djalosh, do të pyes për dy gjëra. Nëse u përgjigjesh do të lë që t'i predikosh njerëzve, ose në të kundërt do të nxjerr edhe ty, ashtu siç nxora shokët e tu, ai i tha: Më pyet o prijësi i besimtarëve, dhe ai i tha: Kush është rregulluesi i fesë dhe shtylla e saj? Ai tha: Devotshmëria. Ai tha: Cila është sëmundja dhe prishja e saj? Ai tha: Lakmia. Ai tha: Të vërtetën ke thënë, fol sepse njerëz të tillë si ti është mirë që t'u flasin njerëzve.

1 Dijvanu Sejjid Humejri /130. Mealimul Kurbeti fi Ahkamil hisbeh /179. Et Teseuuf El El Islamij 2/12.



KALIFI I PARË QË QËNDRON BASHKË ME KUNDËRSHTARIN E TIJ PËRBALLË KADIUT[1]

Imam Aliu tek e drejta dhe drejtësia, zënë një pozitë të lartë që nuk mund të barazohet asgjë tjetër pas dy dëshmive, sepse njerëzit për të ashtu siç ka urdhëruar Allahu janë të barabartë në të drejta. Nuk ka dallim për të fortin dhe as padrejtësi për të dobëtin. Ai i cili i ka thënë ibn Abbasit kur imami po rregullonte një sandale të tijën, nëse kjo sandale tek unë ka një vlerë, edhe dynjaja juaj tek unë ka një vlerë, nëse nuk vë drejtësi apo të shkatërroj një të pavërtetë.

Fjala e tij për Allahun, me çdo kusht do të bëja drejtësi për atë që i është bërë padrejtësi nga zullumqari i tij, do ta orientoja zullumqarin me padrejtësinë e tij derisa ta çoja tek burimi i drejtësisë edhe nëse nuk do ta dëshironte. Thënia e tij: I dobëti tek unë është i fortë derisa ta marr hakun e tij për të, kurse i forti tek unë është i dobët derisa t'ia marr hakun atij.

---

1 Akhbarul Kudat 2/200. Muruxhu Dhehebi 2/345. El Eganij 17/148. El Kamilu i ibn Ethir 3/201. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebi Hadid 9/31 dhe 11/245. El Bidaje ue Nihaje i ibn Kethir 8/4. Dijuanu Sejjd Ali Sadrud-dini ibn Ma'sumi el-Medeni. El Abkarijatu /676. En Nudhumul Islamijeh /476.

Në njërën nga hytbet e tij ai ka thënë: Për Allahun, sikur të shtrihem mbi gjemba si majmuni i privuar nga gjumi apo të tërhiqem zvarrë me zinxhirë është më e dashur për mua se sa të takoj Allahun dhe të Dërguarin e Tij ditën e kijametit si zullumqar ndaj disa robërve, apo si uzurpues i diçkaje prej gjërave të dynjasë. Në fund thotë: Për Allah, sikur të më jepen shtatë tokat dhe ç'ka ka poshtë qiejve të tyre që të kundërshtoj Allahun duke i bërë keq qoftë një fije floku një milingone nuk do ta bëja.

Imami *(Paqja qoftë mbi të!)*në këtë kapitull ka shumë thënie të tjera që s'mund të zgjatemi me to, por ajo gjë duhet të përmendet është se imami se ka filluar punën e tij që në rini si, ruajtës dhe zbatues, përçues i rregullave të së drejtës dhe drejtësisë në mesin e njerëzve. Ai ka qenë në kohën e Pejgamberit *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)* i ngarkuar me rregullimin e çdo problemi dhe gabimi që buronte nga disa myslimanë dhe kalifat e udhëzuar i kanë lënë atij dorë të lirë në zbatimin e çdo gjëje që e gjykonte të vërtetë e të drejtë. Mendimi i tij është i ndjekur, gjykimi i tij është i zbatuar, deri atje sa ka marrë përsipër vetë që t'i tregojë kufirin Velid ibn Akabes në tubimin e vëllait të tij nga nëna, Othman ibn Affanit. Në atë ai kohë ka qenë kalifi i myslimanëve dhe kjo nga frika se mos neglizhojë zbatuesi i detyrës nga dashuria për të afërmit dhe me në krye të tyre vetë kalifin.

Kur iu afrua koha e kalifatit atij *(Paqja qoftë mbi të!)*ai i shkuli me mbretëri dhe pasuri të gjitha ato që Othmani i kishte dhuruar dhe ua kishte dhënë një grupi të vogël prej myslimanëve dhe ia riktheu thesarit të shtetit. Një ditë i shkon Xha'de ibn Hubejre thotë: O prijësi i besimtarëve, të vijnë dy njerëz dhe tek njëri prej tyre, ti je më i dashur për të se sa pasuria e tij dhe familja e tij, kurse tjetri, nëse do të kishte mundësinë për të therur ty, do

të therte dhe do të gjykosh armikun tënd ndaj atij që të do ty. Imami e goditi atë pak dhe i tha: Me të vërtetë, se nëse kjo gjë do të ishte në dorën time, do ta bëja, por kjo është diçka që i takon Allahut.

Një çifut u ankua për të tek kalifi Omer ibn Khatabi dhe kur ata u paraqitën para tij, Omeri i foli çifutit në emrin e tij, ndërsa imamit i foli me epitetin e tij (o babai i Hasanit). Aliu u inatos, kurse Faruku u çudit nga inatosja e tij dhe tha: A mos e urren që kundërshtari yt të jetë çifut, kur ti paraqitesh bashkë me të para gjykatësit? Imami i thotë: Jo, për Zotin, por unë u inatosa sepse ti nuk u tregove i barabartë mes meje dhe atij, përkundrazi ti më dallove mua ndaj tij kur i fole në emër pastaj më fole mua në epitet. Çfarë të bëri ty që të më preferosh mua ndaj tij kur ne jemi njësoj para të vërtetës.

Më në fund imami iu dha mundësia që në ditët e kalifatit të tij t'u jepte myslimanëve një mësim praktik në vërtetimin e të vërtetës dhe realizimin e drejtësisë mes njerëzve. Nuk ka asnjë dallim mes prijësit dhe popullit të thjeshtë, as ndaj gjykatësit dhe të gjykuarit, as myslimani nga jomyslimani dhe kjo për shkak se ai e gjeti mburojën, parzmoren e tij tek një njeri kristian. Bashkë me të shkoi te arbitri i gjykatës që ta kundërshtojë atë njësoj si gjithë njerëzit e tjerë dhe se në të kundërt ai e kishte mundësinë që t'ia merrte atij, sepse ai është prijësi i besimtarëve pa e akuzuar në lidhje me atë çfarë thoshte, ose t'ia linte kristianit dhe ai e din mirë se prova e tij është e dobët.

Gjykatësit i tha kadiut: Kjo është mburoja ime, as nuk e kam shitur, as nuk e kam dhuruar, kurse gjykatësi e pyet kristianin: Çfarë ke për të thënë në lidhje me ato që ka tha prijësi i besimtarëve? Kristiani tha: O prijësi i besimtarëve, a ke ndonjë provë ti që është e jotja? Ai qeshi dhe tha: Godite në shenjë, nuk

kam provë, kështu që gjykatësi vendosi t'ia lërë kristianit mburojën, kështu që ai e mori atë, bëri disa hapa, pastaj u kthye përsëri dhe tha: Epo unë dëshmoj se këto janë rregulla të pejgambereve. Prijësi i besimtarëve më drejton mua në gjykatën e tij dhe ai, kadiu vendos kundër tij, Dëshmoj se nuk ka tjetër Zot veç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Allahut. Për Zotin që kjo mburojë është e jotja o prijësi i besimtarëve, unë ndoqa ushtrinë kur ti po shkoje në Safin dhe mburoja jote doli nga vendi që e mbaje në kalin tënd, kurse Aliu i thotë: Por, tani që ti u bëre mysliman, atëherë është e jotja dhe e hipi atë mbi kalin e tij. Pas kësaj, njerëzit e dëshmojnë këtë njeri si ushtari më besnik në luftimin e havarixhëve në ditën e Nehrevanit.



ËSHTË I PARI QË KA GJYKUAR PA URREJTJE[1]

Kur u vra kalifi Othman ibn Affani, njerëzit filluan të ndjekin imam Aliun për t'i dhënë besën, kurse ai rezistonte duke e refuzuar pozitën e prijësisë dhe pas shtatë ditësh rezistence dhe kundërshtimi. Ata e rrethuan atë nga të gjitha anët dhe u futën në shtëpinë e tij, gati sa nuk ia shkelën me këmbë edhe dy fëmijët dhe e vunë në pozitë të vështirë, por ai nuk ua shtriu dorën për t'ia dhënë atyre, kështu që doli por ata rrinin rrotull tij si dallgët e ngritura lart derisa erdhi tek xhamia. U ngjit në minderin e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)* dhe myslimanët i dhanë besën atij dhe i pari që ia dha besën ishte Talha ibn Ubejdullah, pastaj e pasoi atë Zubejru ibn el-Avami.

Një grup njerëzish mbetën pa qenë prezent prapa marrëveshjes së njohjes së lidershipit dhe që el-Mes'udijju i ka përshkruar ata se ishin prej njerëzve të Othmanit. Prej tyre ishte Abdullah ibn Omer, i cili më pas njohu si lider Jezid ibn Muavije,

1 Futuhul Buldan /395. Muruxhudh Dhehebi 2/361. El Irshadu /130. El xhemelu eu En Nusretu fi harbil Basrah /89. el-Istiiabu (asimilimi) 3/1121. El Menakibu 2/113,114. Usdul Gabe 4/32. Sherh Nehxhul Belaga i ibn Ebi Hadid 4/9. A'janu Shi'ia 3/k2/4,5. El Abkarijatu /664,665. El Gadiru 11/392.

që Haxh-xhaxh ibn Jusufi eth-Thekafijju ka njohur si prijës Abdulmelik ibn Mirvani. Por edhe Sa'd ibn Ebi Vekkasi nuk qe prezent, edhe Kadame ibn Mad'uni, Ahban ibn Sajfi, Abdullah ibn Selami, Mugire ibn Shu'beti eth-Thekafijju dhe prej ensarëve janë ndarë veçmas: Ka'b ibn Malik, Hassan ibn Thabiti, Ebu Seid el-Khidrij, Muhamed ibn Musel-leme, Zejd ibn Thabiti, Fedale ibn Ubejdi dhe të tjerë veç tyre prej benu-umejjëve dhe nipat e tyre.

Imam Aliu në hytbe ka folur shpesh duke lajmëruar për metodën e tij në përhapjen e drejtësisë dhe barazisë dhe frenimit të padrejtësisë. Se njerëzit janë të barabartë në fenë e Allahut dhe se ai e respekton lirinë e individit me një respekt të plotë deri aty sa nuk i shkakton dëm dikujt tjetër. Çdo gjë që kishte në thesar ua ndau myslimanëve në mënyrë të barabartë pa asnjë hatër apo preferencë ndaj dikujt dhe ndau në mënyrë të barabartë mes Zubejrit dhe pronave të tij. Lakmuesit filluan të pëshpëritnin dhe u fut dëshpërimi në zemrat e tyre, u penduan që nxituan në njohjen e prijësisë dhe i kërkuan leje Zubejri dhe Talhai që të udhëtonin në Mekë për të bërë umren dhe u dha leje atyre, por i lajmëroi ata të dy se ata dëshironin të largoheshin duke tradhëtuar.

Ibn Abbasi shkoi tek prijësi i besimtarëve dhe e pyet atë se çfarë donin ata dhe tha: Pashë se Zubejri dhe Talhai dëshironin dhe ishin të vendosur për udhëtim dhe unë i dhashë leje pasi u mora besën me besim që të mos tradhëtonin, të mos rebelonin dhe të mos përhapnin shkatërrim. Për Zotin o ibn Abbasi me të vërtetë unë e di mirë se ata nuk kishin qëllim tjetër veç fitnes dhe unë sikur jam me ta dhe kanë shkuar në Mekë që të përpiqen luftimin tim, kurse ibn Abbasi tha: Nëse këtë ti e dije o prijësi i besimtarëve, atëherë përse i lejove ata të dy? A nuk i kërkove atyre llogari që të garantosh dhe mbrosh myslimanët prej të keqes

së tyre? Ai tha: O ibn Abbasi, a po më urdhëron mua për të bërë padrejtësi dhe që të filloj me punë të keqe para të mirës dhe të dënohem për mendimin e keq dhe akuzën dhe të dënohem për një vepër para se ta veproj atë? Kurrë, për Zotin nuk do vija drejtësi për atë që i kam dhënë fjalën Allahut për ligjin dhe drejtësinë.

Një herë ka folur dhe i ka lajmëruar njerëzit për mendimin e tij në lidhje me atë që kanë tradhtuar njohjen e prijësisë. Kush e pranon dhe rebelohet ndaj prijësisë së tij, tha: O njerëz, me të vërtetë ju më dhatë besën e më njohët për prijës, ashtu siç i keni dhënë besën atyre që kanë qenë para meje. Por, zgjedhja është e njerëzve para se të japin besën dhe nëse e japin besën, atëherë ata nuk kanë më zgjedhje në dorën e tyre dhe se detyra e imamit është që të qëndrojë në rrugën e drejtë kurse shtetarët kanë për detyrë t'i dorëzohen dhe kjo është një besë e përgjithshme. Kush nuk është i kënaqur prej saj është i pakënaqur ndaj islamit dhe nuk ka ndjekur rrugën e popullit të tij dhe besa juaj ndaj meje nuk ka qenë e papritur, surprizë dhe nuk është njësoj çështja ime me çështjen tuaj. Vërtetë unë ju dua për Allahun kurse ju më doni për veten tuaj, betohem për Allah se do të këshilloj kundërshtarin dhe do t'i bëj drejtësi atij që i është bërë padrejtësi, për Sa'din, ibn Musel-leme, Abdullah ibn Omerin dhe Hassan ibn Thabitin kam marrë lajme që i urrej dhe e drejta është mes meje dhe mes atyre.

Imami dëshiroi që të shpaloste argumentin e tradhtarëve dhe të dëgjonte prej tyre shkaqet të cilat i çuan ata të dilnin nga fjala për të cilën shumica maxhoritare e myslimanëve kishin rënë dakord unanimisht. Ai urdhëroi që t'i sillnin Abdullah ibn Omerin dhe i kërkoi betimin e besnikërisë ndaj kalifatit dhe ai tha: Nuk ta ofroj besën e besnikërisë derisa ta japin të gjithë njerëzit dhe tha ai*:* Më jep mua një dokument që ti nuk do të largohesh, ai i tha: Nuk ta jap atë, kurse Eshteriu thotë: O prijësi i besimtarëve,

ky me të vërtetë ka garantuar fshikullimën dhe shpatën tënde, ai i tha: nuk e dua me forcë atë prej tij, hapeni rrugën e tij. I vogël ke qenë një krijesë e keqe, por tani që je i madh, je krijesë edhe më e keqe.

Pastaj kërkoi Muhamed ibn Musel-lemen dhe kur i erdhi i tha atij: Betohu për besnikëri, ai tha: me të vërtetë se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)* më ka urdhëruar mua nëse njerëzit kanë kontradiktë, që të dal me shpatën time dhe të godas me të anën e malit Uhud dhe kur të ndahej në pjesë vija në shtëpinë time dhe nuk e vazhdoja më derisa të më vinte një dorë mëkatare apo një trup i vdekur, kurse imami i thotë: Shko, atëherë dhe bëhu siç je urdhëruar.

Pastaj sollën Sa'din ibn Ebi Vekasin dhe i thotë atij: Betohu për besnikëri, ai i thotë: O babai i Hasanit, më lër, sepse nëse do të mbetesha vetëm unë, do ta jepja betimin e besnikërisë, po për Zotin prej meje nuk do të vijë ndonjë gjë që ti e urren, kurrë, ai tha: Të vërtetën the, lëreni të lirë. Nuk kërkoi njeri tjetër veç këtyre dhe i është thënë atij: A nuk po e kërkon Hassan ibn Thabitin, Ka'b ibn Malikun dhe Abdullah ibn Selamin? Ai ka thënë: Ne nuk kemi nevojë për atë që nuk ka nevojë për ne. Malik el-Eshteriu, zuri rob ditën e Xhemelit, Mervan ibn el Hakemi dhe kur ia sollën prijësit të besimtarëve, ai e fali dhe e la të lirë.

Po ashtu ditën e Xhemelit i sollën Musain ibn Talhanë ibn Ubejdullahin dhe i thotë atij: Thuaj, të kërkoj falje o Allah dhe pendohem tek Ti, tre herë dhe kur ai e tha këtë, e la të lirë dhe i tha: Shko ku të duash, e nëse gjen ndonjë kafshë apo armë në ushtrinë tonë, merre dhe kije frikë Allahun në çështjen tënde më pas. E mundi Abdullah ibn Zubejrin dhe Seid ibn Asin edhe Mervan ibn Hakem, pasi triumfoi në betejën e Xhemelit dhe ata

janë armiqtë më të egër dhe ata që e nxitën popullin kundër tij, por ai i fali ata dhe nuk ndërmori asnjë ndëshkim kundër tyre.

Ai ishte bërë gati të dilte për në Sifijn, kur i foli shokëve të tij duke u thënë: Cilido prej jush që nuk dëshiron që të luftojë me ne Muavijen, le të marrë gjërat e tij e të dalë në Dejlem e nëse dëshiron le t'i luftojë ata. Prej tyre u ndanë një grup prej katër mijë vetash dhe është thënë: pesë mijë veta në ushtrinë që ishin drejtuar në luftën e Dejlemit. Imami kishte zakon nëse kapte një rob prej Sirianëve në luftën e Sifijnit, i merrte armën dhe kafshën e tij dhe i merrte betimin që të mos luftonte më kundër tij pastaj e linte të lirë.

Imami mësoi se një grup ushtarësh prej havarixhëve po përçanin ushtrinë e tij për ta luftuar dhe i është thënë atij: Me të vërtetë ata kanë dalë kundër teje, prandaj bëje ti hapin e parë duke i sulmuar ata para se ta bëjnë ata të parët, kurse ai tha: Unë nuk do t'i luftoj ata derisa ata të më luftojnë mua dhe do ta bëjnë. Atë ditë, një grua e bukur kaloi aty afër dhe njerëzit i ngulën sytë nga ajo dhe prijësi i besimtarëve thotë: Pa dyshim se shikimet e kësaj burrërie, potence janë ambicie dhe pa dyshim se ajo është shkaku i të metës së saj, nëse ndonjëri prej jush e shikon një grua që i pëlqen, atëherë le të kontaktojë me familjen e saj, sepse në fund të fundit ajo është një grua si gratë e tjera, por njëri prej havarixhëve thotë: Allahu e vraftë atë jobesimtar sa injorant që është, por njerëzit iu sulën atij për ta vrarë, kurse imami thotë: Avash, prisni, ai vetëm sa shau pak apo kërkoi falje për një mëkat.



ASKETIKU I PARË NË ISLAM[1]

Nga Omar ibn Jasiri *(Zoti qoftë i kënaqur prej tij!)* transmetohet se ka thënë: I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "O Ali, me të vërtetë Allahu të ka zbukuruar ty me një bukuri që askush nga robërit nuk është zbukuruar, me një bukuri të dashur tek Allahu se sa ajo, të ka zbukuruar ty me asketizëm në dynja dhe të ka bërë ty të mos privohesh nga ajo asgjë. Të të mos privojë ty në asgjë, të ka dhuruar ty dashurinë e të vobektëve dhe të ka bërë ty që të jesh i kënaqur me ta si ndjekës të tu dhe ata të jenë të kënaqur me ty si prijës".

Njerëzit i kanë përkujtuar asketikët tek kalifi Omer ibn Abdulazizi. Ai është nga një familje analfabete e cila e ka ekzagjeruar shumë në urrejtjen e imam Aliut dhe e ka mallkuar atë. Një mijë muaj nëpër minbere ka thënë: Njeriu më asketik në dynja është Ali ibn Ebi Talibi. Sufjan ibn Ajineh ka thënë: Sahabiu më asketik është Aliu ibn Ebi Talibi. Imam Bakiri ka thënë: Prijësi i

1 Ujunul Akhbar i ibn Kutejbe 1/53. Hiljetul Eulija 1/71,81,83. El Istiabu /114. El Menakibu i ibn Shehri Ashub 2/94-104. El Kamilu i ibn Ethir 3/200,201. Sherh Nehxhul Belaga 1/26 dhe 2/200-202 dhe 16/286,287,289. Keshful Gummeh 1/162-164. El Bidaje uen-Nihaje i ibn Kethir 8/5. El Gadiru 7/42. El Abkarijatu /669. Fadailul Khamseh fi Sihahi Siteh 3/3,4.

besimtarëve i ka menaxhuar pesë vite pa vënë asnjë tullë, asnjë qerpiç as nuk ka dhuruar një copë tokë e as ka lënë trashëgimi të kuqe apo të bardhë.

Pasi ai me dëshminë e këtyre dhe të tjerëve, sipas historisë së tij të njohur është njeriu dhe shembulli i asketikëve. Të pazëvendësueshëm, pas tij lidhen udhëtarët dhe askush nuk ka parë njeri më asketik se ai, në kënaqësinë e dynjasë dhe pozitat e shtetit. Ai që nuk është ngopur kurrë me ushqim thotë: Një ditë më mori uria shumë dhe dola në rrethinat e Medines duke kërkuar ndonjë punë. Kur pashë një grua që kishte grumbulluar baltë dhe donte që t'i hidhte ujë për ta zbutur më shumë, iu afrova dhe ramë dakord që për çdo kovë të më jepte një kokër hurmë. Kështu që shtrova gjashtëmbëdhjetë kova dhe mora shpërblimin tim në hurma, pastaj shkova tek i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe ai hëngri një pjesë të hurmave, kurse unë pjesën tjetër.

Zuvejdi ibn Gafle ka thënë se shkova tek prijësi i besimtarëve dhe e gjeta të ulur. Përpara kishte një enë të vogël, në të kishte qumësht të thartuar, e kuptova nga era e fortë e thartirës që mbante, kurse në dorë kishte një fetë bukë thekre të fortë që e shikoja në fytyrën e tij kur e thyente me dorën e tij ndonjëherë. Nëse nuk mundej e thyente me gjurin e tij dhe e hidhte në enë ai tha: Afrohu dhe merr nga ushqimi jonë, unë i thashë: Me të vërtetë unë jam i agjërueshëm, kurse ai tha: Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të thotë: Atë që agjërimi e frenon që të shijojë ushqimin e tij që e pëlqen, Allahu ia bën hak që ta ushqejë atë nga ushqimi i Xhenetit dhe t'i japë ujë nga uji i Xhenetit.

Suvjedi ka thënë: Unë i thashë shërbyeses së tij, e cila qëndronte në këmbë afër tij: A nuk ke turp moj vajzë, a nuk e frikë

Allahun për këtë njeri të moshuar? A nuk mund t'ia sitësh atij ushqimin, se unë po shikoj shumë krunde? Ajo tha: Ai na urdhëroi që të mos ia sitnim ushqimin, kurse ai tha: Pasi e kishte dëgjuar fjalën time se nuk iu ka situr atij ushqimi, nuk hëngri për tre ditë bukë të pastër, derisa Allahu i Madhërueshëm ia mori shpirtin Pejgamberit *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).*

Ai e ka mësuar veten e tij që të jetë i durueshëm, e ka familjarizuar atë me ushqime antipatike dhe me veshje të papëlqyeshme. Duke shpresuar mëshirën e Allahut dhe duke u ngushëlluar me të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).*

Ditën e festës së bajramit, njëri nga shokët e tij hyri në shtëpinë e tij kur pa përpara tij një grusht bukë të zezë dhe një enë që kishte në të çemlek (miell i gatuar me qumësht) tha: O prijësi i besimtarëve, po edhe ditën e festës ke gatuar miellin me qumësht? Kurse ai i tha: Me të vërtetë, kjo është një festë për atë që i falen gjynahet.

Adij ibn Hatemi et-Taijju e ka parë atë dhe në dorë kishte një pagure të vogël me ujë të pastër dhe disa copa buke prej thekre me kripë dhe tha: O prijësi i besimtarëve, ditën e kalon i uritur duke u përpjekur, kurse natën rri zgjuar duke vuajtur, pastaj ky është iftari yt? Kurse ai thotë se është më mirë t'ia japësh vetes këtë kënaqësi, sepse në të kundërt do të kërkojë prej teje më tepër se sa i mjafton asaj.

Akabe ibn Alkame i ka folur atij për jetesën e vështirë, veshjen e tij të pahijshme dhe ai i thotë: O babai i jugut, e kam parë të Dërguarin e Allahut të hajë më thatë se sa kaq, të vishet më pahijshëm se kaq, por unë nëse nuk e ndëshkoj veten time, se kam frikë se nuk do ta shoqëroj atë.

Ai nuk ushqehej me gjë tjetër vetëm se me uthull dhe kripë apo me diçka prej bimëve të tokës dhe e rriste pak nivelin me qumësht deveje. Hante shumë pak mish dhe thoshte: Mos i bëni barqet tuaja varre kafshësh. Ai thoshte gjithashtu: Unë jam sikur një folësi juaj që thotë: Nëse ky është ushqimi i ibn Ebi Talibit, atëherë tek ai është ulur dobësia e luftimit të gjeneratave dhe dyluftimit të guximtarëve. A nuk e shikoni pemën e shkretëtirës që ka drurin më të qëndrueshëm dhe zjarrin më të fortë dhe shuarjen më të avashtë, kurse mrekullitë e gjelbërta kanë lëkurë më të hollë. Është ai që ka thënë: Sikur të doja do të zgjidhja rrugën drejt filtruesit të këtij mjalti, kallinjve të këtij gruri dhe pëlhurave të thurura prej mëndafshi. Por, pasioni im nuk mund të më mundë, kurse uria nuk mund të më drejtojë në përzgjedhjen e ushqimeve.

Pastaj përmend shkakun e braktisjes së tij të këtyre ushqimeve dhe thotë se sikur të mos ketë rripa apo pëllumba që nuk kanë ngrënë asnjë kafshatë. Nuk janë ngopur ndonjëherë, a duhet të fle unë i ngopur kur rrotull meje ka barqe të pangopur dhe zemra të lira apo të bëhem siç dikush thotë: Turp të kesh që flenë me barkun plot kur rrotull teje ka njerëz aq të uritur sa shtrëngojnë rripat.

A kënaqem unë me veten time që t'i thuhet prijësit të besimtarëve dhe unë të mos marr pjesë në vështirësitë e vitit apo që të jem për ta një model në antipatinë e jetesës. Unë nuk jam i krijuar që të më angazhojnë ngrënia e gjërave të mira, njësoj si kafsha e lidhur që vetëm shëndoshet apo si aparati transmetues, që ka për detyrë shtrirjen e saj në hapësirë që rrudhet prej ushqimit të saj dhe zbavitet si të dojë me to.

Asketizmi i tij në veshje nuk është më i pakët se asketizmi i tij në ushqimin e tij. Një herë njëri prej shokëve shkoi tek ai në

shtëpinë e tij në Khurnik dhe e gjeti atë duke u dridhur nga i ftohti. Ai ishte i mbuluar me një gunë të arnuar dhe i tha atij: O prijësi i besimtarëve, me të vërtetë Allahu të ka bërë ty dhe familjarët e shtëpisë tënde pjesëtar në këtë pasuri dhe të bësh çfarë të duash vetë? Ai i tha: Për Zotin, nuk dua të prek asgjë nga pasuria juaj dhe ajo është guna ime me të cilën kam dalë me të nga Medineja.

Një njeri prej banorëve të Basras, e kundërshtoi atë për mungesën e rëndësisë me veshjen e tij dhe i tha atij: Çfarë halli ke ti me veshjen time, nuk ka dyshim se veshja ime është shumë larg mendjemadhësisë dhe është më e merituar çdo mysliman të më ndjekë mua. Një ditë e kanë gjetur duke arnuar këmishën e tij dhe i është thënë: Përse po e arnon këmishën tënde? Ai tha: Që të frikësojë zemrën dhe që besimtari të lidhet pas tij. Pas kësaj thërriti me zë në xhami: Kush është ai që do ta blejë këtë shpatën time, sepse sikur të kisha aq sa për të blerë një pelerinë, nuk do ta shitja. Një njeri u ngrit dhe tha: Ne të japim ty çmimin e një pelerine, o prijësi i besimtarëve. Bleu një rrobë që i pëlqeu dhe pastaj e dha sadaka atë.

Shkoi tek tregtarët dhe i tha një njeriu më blij mua dy rroba, kurse ai njeri i thotë: O prijësi i besimtarëve, e paguaj unë për ty, por kur ai e njohu atë u largua prej tij dhe qëndroi tek një djalë. Mori prej tij dy rroba, njërën me tre derhem, kurse tjetrën me dy derhem dhe i tha pupëzës shërbëtorit të tij: Ti merr atë për tre derhem, kurse ai i tha: O i nderuari im, ti je më meritor për ta marrë atë, sepse ti hipën në minder dhe u flet njerëzve në hytbe, ai tha: Ti je djalë i ri dhe e ke të keqen tek rinia, por mua më vjen turp nga Zoti im që të dukem më bukur se ti. Një ditë duke mbajtur një hytbe në Kufe ka thënë: Unë kam hyrë në vendet tuaja me këto rreckat e mia me gjërat dhe kafshën time, shërbyesin tim,

dhe nëse unë dal nga ky vend me gjëra të tjera përveç këtyre, atëherë unë jam prej tradhëtarëve.

Ai ka thënë: Jam martuar me Fatimenë, vajzën e Muhamedit *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk kam pasur as dyshek përveç një lëkure dashi që natën flinim mbi të. Mbi të hanim e pinim dhe mbështilleshim, nuk kam pasur asgjë tjetër që të më shërbente veç saj. Më pas bleu një kokërr hurmi për një derhem dhe e mbajti atë në mbulesën e tij, një njeri i thotë: O prijësi i besimtarëve, a ta mbaj unë për ty? Ai tha: I pari i shtëpisë është më meritor për mbajtjen e saj.

Ruajtësi i thesarit i tha atij: Shtëpia e thesarit të shtetit është mbushur me të verdha (flori) dhe të bardha (argjend), për këtë tha: "Allahu është më i Madhi, Aliu është afër Kufes dhe kur arritën, e ndau gjithçka kishte në shtëpinë e thesarit, nuk mbeti në të asnjë dinar dhe derhem. Pastaj urdhëroi për pastrimin e shtëpisë dhe larjen e saj me ujë dhe fali në të dy rekate namaz. Paratë i vinin nga Iraku nga burimi i prodhimit në Medine dhe me to ai i ushqente njerëzit me bukë e mish, kurse vetë hante qullë me vaj. Ai, bekimi i Allahut qoftë mi të, ka liruar nga skllavëria njëmijë robër nga puna e rëndë, me të drejtë bënte ç'ti zinte dora dhe djersa e ballit. Pasi ai e mori kalifatin, pasuritë i vinin, por ëmbëlsirat kanë qenë vetëm hurmat, kurse rrobat e tij, vetëm gunat.

Një njeri nga Ezarika i ka thënë Hasan el Basrijut: O babai i Seidit çfarë ke për të thënë për Aliun ibn Ebi Talibin? Sytë e tij u skuqën dhe tha: Allahu e mëshiroftë babain e Hasanit, ka qenë i zbehtë për Allahun, korrekt për armiqtë. Në pozitën e tij ka qenë më fisniku, më i nderuari dhe më i afërti tek i Dërguari i Allahut dhe ka qenë nga ata që i kishin lënë punët e kësaj bote, kënaqësitë e saj dhe të veçuar nga njerëzit e tjerë të këtij ymeti. Kurrë nuk e

ka vjedhur pasurinë e Allahut dhe as nuk e ka zënë gjumë për urdhëresat e Allahut. I ka dhënë Kur'anit vendosmërinë e tij, veprën dhe diturinë e tij dhe ka qenë në një devotshmëri të plotë dhe dijeni të qarta. Ky ishte Aliu ibn Ebi Talibi, o injorant.



I PARI QË ËSHTË DIVORCUAR ME DYNJANË[1]

Muavija i biri i Ebi Sufjanit i ka thënë Darar ibn Damres i cili kishte ardhur për ta vizituar tha: O Darar, ma përshkruaj mua Aliun, ai tha: Të më ndjesh o prijësi i besimtarëve do ta përshkruash se s'bën, ai tha: Meqë duhet ta përshkruaj se s'bën atëherë ai për Zotin ka qenë largpamës, ruajtës i fuqishëm që fliste pak dhe gjykonte drejtë. Dituria shpërthente nga ai prej të gjitha kaheve, kurse mençuria fliste nga të gjitha anët, ndjente neveri prej dynjasë, bukurive të saj dhe bëhej miqësor natën me vetminë e tij. Për Zotin ka qenë i mbushur me eksperiencë dhe mendonte gjatë, i fërkonte duart e tij dhe i fliste vetes, rrobat i pëlqente të shkurtra, kurse ushqimin të fortë.

Në mesin tonë ishte njësoj me ne, na afrohej kur shkonim tek ai, na përgjigjej kur e pyesnim dhe kur ne i afroheshim atij. Kurse ai na afrohej neve nuk guxonim t'i flisnim atij për vetizolimin e tij apo të fillonim duke e respektuar atë. I respektonte ndjekësit e fesë dhe i donte të vobektit. Atij të fortit

1 Emalil Kaal 2/148. Hiljetul eulija 1/84. El Istiabu 1107. El Menakibu i ibn Shehri Ashub 2/102,103. Sherh Nehxhul Belaga 16/292-295. Dijuanu Abdulbaki el Amr /77. A'janu Shiia 36/355. El Abkarijatu 764,765. Fadailu Khamseh fi Sihahi Siteh 3. 27. MehrexhanulAlemij bi Meulud el Imamu Ali /83.

nuk i jepte pëlqimin në të kotën e tij, por edhe të dobëtin nuk e dëshpëronte me drejtësinë e tij.

Dëshmoj se e kam parë disa herë kur nata kishte lëshuar perdet e saj. Qëndronte ulur në mihrab duke mbajtur mjekrën më dorë, duke rënkuar si njeri të cilin e ka kafshuar gjarpri dhe duke qarë me të qarët e tij që është i pikëlluar. Atëherë thoshte: "Oj botë! Oj botë! Ik prej meje! Më vjen?

A të ka marrë malli për mua? Nuk do të kesh rast të impresionosh! Mashtro ndonjë tjetër! Mua nuk më intereson! Jam ndarë nga ti tri herë dhe pas kësaj nuk ka më kthim në gjendje të mëparshme. Jeta jote është e shkurtër, vlera jote është e vogël dhe shpresa jote është e pavlerë. Eh! Sa e vogël është pajisja, sa e gjatë rruga, sa i gjatë udhëtimi, e sa i vështirë caku për të qenë i arritshëm?!" Darari qau bashkë me të edhe Muavija, i cili tha: Allahu e mëshiroftë babain e Hasanit, sepse i tillë ka qenë, po si e hidhërove atë ja Darar? Ai tha: U mërzit nga therja e të parit të tyre në vendin e tyre. Prijësi i besimtarëve në letrat e tij i ka thënë Othman ibn Hunejfit se ishte mëkëmbës i tij në Basra.

Largohu nga unë oj botë! Litari yt është në supet e tua, meqë jam liruar nga kthetrat e tua, kam shpëtuar nga rrjetat tua dhe i jam shmangur ecjes nëpër terrenet e tua rrëshqitëse. Ku janë brezat që i ke mashtruar me dredhitë e tua? Ku janë popujt të cilët i ke larguar nga rruga e drejtë me stolitë e tua? Të gjithë ata janë syrgjynë të varreve brenda vendeve të groposura. Për Zotin, po të ishe person i dukshëm dhe organizëm i aftë për ndijim, do të gjykoja me dënim që e ka caktuar Allahu. Për arsye se ke mashtruar njerëzit dhe njerëzit i ke hedhur në shkatërrim, sundimtarët i ke lënë në dorë të asgjësimit dhe i ke dëbuar në vende të mjerimit, pas të cilit nuk ka shkuarje as kthim. Vërtet, kushdo që ka kalëruar mbi valët e tua është fundosur, ndërsa

kush i shpëton kurtheve të tua, do të ketë sukses. Ai i cili arrin të mbrohet nga ti, nuk brengoset edhe nëse punët i ka shumë keq, kjo botë i duket si dita e cila po mbaron.

Ik nga unë! Sepse, për Zotin, nuk përkulem para teje ashtu që të më poshtërosh, as t'i lë frerët në duart e tua që të më udhëheqësh. Të betohem në Zot, me betimin nga i cili e nxjerr vullnetin e Zotit, se do ta ushtroj ashtu shpirtin tim sa do të gëzohet nëse për ushqim ka kothere buke. Do të jetë i kënaqur nëse ka vetëm kripë për ta kriposur. Do t'u lejoj syve të mi të mbeten të zbrazët pa lot, si lumi, uji i të cilit ka shterruar. A duhet Aliu të hajë çdo gjë që ka dhe të bëjë gjumë si kafsha, e cila e ka mbushur stomakun me kullosë dhe është shtrirë të pushojë ose si dhitë të cilat brejnë gjethet dhe shkojnë në torishtën e tyre? Sytë iu verbofshin, nëse ai pas shumë vitesh do të bëjë si kafshë e shpenguar dhe shtazë që kullosin.

Personi i cili i përmbush obligimet e tij ndaj Zotit të vet është i mëshiruar dhe që i duron fatkeqësitë e tij, që nuk i lejon vetes gjumin natën. Kur gjumi e pushton shtrihet në tokë duke përdorur dorën e tij si jastëk. Bashkë me ata të cilët i mbajnë hapur sytë e tyre nga frika prej Ditës së Gjykimit, trupat e të cilëve janë gjithnjë larg shtretërve, buzët e të cilëve pëshpërisin duke kujtuar Zotin dhe mëkatet e të cilëve janë eliminuar me lutjen e tyre të vazhdueshme për falje. Ata janë pjesëtarë të palës së Allahut! Eh, vërtet këta janë ata pjesëtarë të palës së Allahut të cilët do të arrijnë gjendje të lumtur" (Kur'an- sure 58, ajeti 22). Në lidhje me këtë temë Profesor Ukadi ka thënë një fjalë të artë dhe ne mjaftohemi me vlerësimin e nevojës tonë prej tyre. Ai ka thënë se imamit nuk i ka thënë askush tjetër veç tij, është ajo fjalë që i ka thënë dynjasë ku thoshte: Oj dynja, ik, shko mashtro dikë tjetër.

Me të vërtetë ajo është më shumë se një fjalë, më shumë se një dua, vërtetë ajo është gjuha e vlerësimit dhe adresa e jetës së tij. Pasi ai, morali i imamit në çdo cilësi prej cilësive të tij të mëdha është një akt guximi ndaj dynjasë, me çdo formë të formave të guximit. Cilësia e guximit të madh në trimëri dhe indiferent karshi saj në mënyrën më të qartë të indiferencës, studiues dhe i dashuruar, për të vërtetën fetare duke e hetuar dhe zhytur në to atje ku ajo e drejtonte. Guximtari është trim ndaj dynjasë, sepse atij nuk i intereson jeta. Kurse indiferenti ndaj saj është trim ndaj dynjasë, sepse atij nuk i interesojnë mirësitë e saj.

Kërkuesi i të vërtetës është guximtar ndaj dynjasë, sepse ajo është rruga e tij drejt qëllimit që ka pas saj. Njerëzit para tij kanë agjëruar ndaj dynjasë duke e privuar veten nga çdo gjë, por pastaj e kanë pranuar atë dynja të gjerë me gjithçka kishte brenda. Zelli i thirrjes profetike ka heshtur dhe ata janë rikthyer tek e zakonshmja, e cila e sulmonte me fjalë. Kurse pasuritë kanë shpërthyer nga tokat e çliruara në atë formë që gadishulli arabik nuk i kishte parë kurrë më parë në historinë e saj të vjetër dhe njerëzit iu drejtuan dynjasë madje nxituan me vrap drejt saj. Kurse kalifi bën guximtarin, indiferentin me të, i qëndron në këmbë në rrugën e saj dhe i pengon ata të shkojnë drejt saj.

Po çfarë pengon?

Pengon tufanin që është fshehur nga prapa digave.

Pengon natyrën njerëzore që largohet nga prangat e devotshmërisë.

Pengon atë që nuk ka asnjë mënyrë ta pengojë atë në çdo situatë.

Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi ty, o prijësi i besimtarëve, e jetove të gjithë jetën tënde si indiferenti i aneksuar nga dynjaja dhe çfarë ka në të. Ke punuar dhe derdhur mund që të fitosh dhe të ushqesh të uriturin, pastaj bie të flesh i shtrirë në

tokë për të ngushëlluar atë që nuk ka çati mbi kokë dhe atë që nuk mund të ngopë barkun. Ty, o prijësi i besimtarëve, të vinin pasuritë nga çdo cep i tokës, kurse ushqimi yt ishte buka e thekrës, gjella jote ishte kripa ose qumështi dhe ti thua: A do isha unë i kënaqur me veten time, sikur të thuhej për mua se ky është prijësi i besimtarëve dhe të mos marr pjesë në vështirësitë e jetës?

Ti kishe neveri për arin dhe e shikoje atë si sfidë, shqetësim të madh, kurse të dashurit e tu, të cilët shpenzojnë në rrugën tënde, gjëja më e dashur për ta në dynja është floriri. Kështu që e ndërtuan prej saj kubenë e shtratit tënd të pastër e të kulluar dhe minaret e saj, dyert dhe pragjet e saj. Po edhe varrin, i cili është poshtë saj dhe i morën të gjitha xhevahiret e rralla të magazinave të tua duke e konsideruar atë veprim si sinqeritet dhe dashuri e tyre. Kurse ti ua shpërndaje ato çfarë kishte në thesarin e shtetit myslimanëve, pastaj e pastroje dhe e spërkasje me ujë, falje namaz në të dhe thoje: Ky është një krim që zgjedhja e tij është në gojën e tij që e bën dhe çdo kriminel dora e tij është në gojën e tij.

I lumtë atij që e ka krahasuar këtë shpenzim të begatshëm me veprën e mirë dhe ndjekjen pas të një pjese të historisë dhe udhëzimit tënd, pasi ti je ai që i ke thënë njërit prej mëkëmbësve të tu. Akoma ju nuk po e vlerësoni atë gjë, por të paktën më ndihmoni mua në devotshmëri dhe përkushtim, në virtyt dhe drejtësi, se pasha Allahun nga kjo dynja e juaja nuk kam akumuluar as edhe një grosh dhe nga plaçkat e luftës nuk kam kursyer asnjë dhe nuk i ma dhënë interes veshjes time, përveç rreckave dhe nuk jam tronditur nga toka e saj as edhe një pëllëmbë dore.



I PARI QË I KA DHËNË PËR BAMIRËSI TË GJITHA TË ARDHURAT E TIJ FUKARENJVE DHE I KA PREFERUAR ATA PARA VETES DHE FAMILJES SË TIJ[1]

Po cilat janë të ardhurat e Aliut, prijësit të besimtarëve dhe cili është burimi i tyre? Kjo është një pyetje që i vjen ndërmend, gjithkujt që e lexon titullin e kësaj pjese dhe mund të çuditet prej saj, prandaj po japim përgjigjen për këtë para se të futemi në temë. Kur imami hyri në Medine si muhaxhir (migrues), atij i bëri përshtypje kultivimi bujqësor dhe shkonte që të fliste me ata që ishin angazhuar me këtë punë sa herë që i jepej rasti, për të mësuar më shumë rreth punëve të tyre dhe të përfitonte nga eksperienca e tyre.

Omar ibn Jasiri *(Zoti qoftë i kënaqur prej tij!)* ka thënë: Unë dhe Aliu kemi qenë dy shokë në betejën e tribuve dhe kur i

1 Futuhul Buldan /14. Siretu e ibn Hishamit 1/599. El Kamilu i Mubredit 3/207. El Akdul Ferid 5/96. Muruxhu Dhehebi 2/341. Tefsir El Keshaf 4/670. Mexhmaul Bejan 28/29 dhe 29/140. El Menakibu i ibn Shehri Ashub 2/122. Tefsir Fakhru Razij 30/244. Usdul Gabe 4/24 dhe 5/530. Sherh Nehxhul Belaga 1/21. Dijuan El Haxh Abdulhusejn El Ezri.

Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* arriti, u vu në krye të betejës, ne pamë njerëz prej beni-medlexhi që po punonin në një pus të tyre, në pemtarinë e palmave dhe Aliu më thotë mua: O babai i Jakadhanit, si thua sikur të shkojmë tek ky popull që të shikojmë se si punojnë? Unë i thashë: Nëse dëshiron shkojmë. Shkuam tek ata dhe i pamë se si punonin për një orë, por më pas na mori gjumit dhe u shtrimë në buzë të palmës.

Kur Pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vdiq, barrat e imamit u lehtësuan, ai shkoi tek bujqit dhe ndau një pjesë të madhe të kohës së tij në gjallërimin e tokës së vdekur dhe mbjelljes së palmave dhe zbulimin e ujrave nëntokësore derisa formoi një numër të madh të ngastrave të tokës buqësore dhe kopshteve të mbjella me palma.

Këto janë emrat e përfituara në diturinë e tij prej atyre tokave:

1- Kosherja e parë
2- Kosherja e dytë
3- Pusi i Kajsit
4- Pema

Këto ia ka dhuruar atij Pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

5- Burimi - këtë ia ka dhënë atij kalifi Omer ibn Khatabi
6- Një pjesë toke në Khajber
7- Një pjesë toke në luginën e fshatrave

Mendohet se ai i ka marrë ato në pronësi duke i blerë

8- Erbaxha
9- Erine
10- Ra'da
11- Rezina
12- Rebaha

13- el-Bugajnega
14 -Burimi i Ebi Nejzerit
Të tëra këto toka kanë qenë të vdekura, kurse ai i gjallëroi ato dhe shpërtheu ujërat e tyre. Kurse për dy fshatrat e tjera (el-Bugajbiga dhe Ebi Nejzer) ka një histori të rrallë për të cilat na flet për të el-Muberrid në librin e tij El-Kamilu dhe thotë:

Ebu Nejzeri ka thënë: Një nga djemtë e Nexhashiut e ka pranuar Islamin që i vogël që kur i erdhi të Dërguarit të Allahut dhe u bë mysliman. Ai ishte bashkë me të dhe kur Pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ndërroi jetë. Fatimeja dhe djali i saj shkoi tek ai dhe i tha: Aliu ibn Ebi Talibi erdhi kur unë qëndroja tek dy fshatrat Ajnu Ebi Nejzeri dhe el Bugejbita dhe më tha mua: A keni ndonjë gjë për të ngrënë? Kurse unë i thashë: Kam pak ushqim që nuk më pëlqen të ta jap ty o prijësi i besimtarëve, kam kungull prej kungullit të fshatit që e ka prodhuar me farë vendase (dhjamë i shkrirë me erë variabile), ai tha: Ma sill atë dhe shkoi tek rebi'i ku është një përrua, i lau duart dhe hëngri pak ushqim.

Pastaj u kthye prapë tek përroi dhe i lau duart me rërë derisa i pastroi mirë. I bashkoi duart me njëra-tjetrën duke e bërë si gotë dhe piu ujë duke e shijuar ujin e rebiut, pastaj tha: O Ebu Nejzer, pa dyshim duart janë më të pastra se enët, pastaj e shijoi vesën e atij uji në barkun e tij dhe tha: Atij që i futet zjarri në bark, Allahu ia largon atij, pastaj mori kalin dhe e uli poshtë në burim, ia ngadalësoi pak vrullin e ujit që të pinte ujë dhe pastaj doli. Balli i tij po pikonte djersë, iu shtuan djersët dhe i fshiu me gishtin e tij nga balli, pastaj mori shatin dhe u kthye tek burimi. Nisi të punojë me të duke e goditur dhe filloi të gurgullojë, kur shpërtheu sikur të ishte rrënjë doli me nxitim dhe tha: Dëshmoj Allahun se ajo është sadaka, më sillni diçka për të shkruar dhe një letë. Unë

nxitova që t'i merrja ato dhe ia solla, kurse ai shkruajti: Në emër të Allahut, Gjithmëshirshmit, Mëshirëbërësit, kjo është ajo çfarë ka dhënë sadaka, robi i Allahut, Aliu ibn Ebi Talibi, ka dhënë sadaka dy fshatrat e njohura si Ajnu Ebi Nejzeri dhe el-Bugajbiga për fukarenjtë e popullit të Medines dhe udhëtarëve që Allahu me ato të dyja ta mbrojë fytyrën e tij nga nxehtësia e zjarrit të Ditës së Kijametit. As mos i shisni dhe as mos i dhuroni, derisa ato të dyja t'i trashëgojë Allahu, i cili është Trashëguesi më i mirë, vetëm nëse ato të dyja i nevojiten Hasanit dhe Hysejnit, sepse ato të dyja janë të lënë për ata të dy dhe askujt tjetër veç atyre të dyve.

Në këtë mënyrë i posedoi duke i dhënë dhuratë pasuritë e tij të tjera ndaj të varfërve myslimanë. Duke parë tek ai peshën e farës një njeri i ka thënë atij: Ç'është kjo o babai i Hasanit? Ai tha: Këto janë njëmijë robër në dashtë Allahu (do me thënë që do të jenë bërthama palme dhe nga prodhimi i tyre do të lirohen njëmijë robër). Pasi e mbolli atë, asnjë farë nuk ngeli pa çelur, pastaj u bë prej dhuratave të tij dhe me të vërtetë me punën dhe djersën e ballit të tij lëroi nga skllavëria njëmijë robër.

Vetë ai bashkë me shatin e tij nxorri ujë burimi nga Jenbei dhe hapi puse në rrugën e Mekës dhe Kufes. Ka shpenzuar para në ndërtimin e xhamisë së Fet'hit në Medine, xhamisë në Mikat, xhamisë në Kufe, në Basra dhe në Abadan. Nga ato që ka shpërndarë dhe ka dhuruar i shtohet edhe shpërndarja e tij nga thesari i myslimanëve, që është një shpërblim gjigand. Në mënyrë të veçantë në kohën e kalifit Osman ibn Affanit, kur u shtua edhe numri i çlirimeve të tokave të reja dhe të ardhurat u rritën dhe tek sahabët u krijuan pasuri të mëdha.

Mes'udi ka thënë: Ditën kur është vrarë Osman ibn Affani ka lënë pesëdhjetëmijë dinarë, mijëra e mijëra derhemë, kurse vlera e gjërave të tij arrinte në njëqindmijë dinarë dhe pati lënë

trashëgimi shumë kuaj dhe deve. Kurse pasuria e Zubejrit ibn Avamit, pas vdekjes së tij arriti në pesëdhjetë mijë dinarë dhe la pas njëmijë kuaj, njëmijë skllevër, prona në Basra, në Egjypt dhe në Aleksandri.

Të ardhurat e Talhasë ibn Ubejdullahut çdo ditë ishin njëmijë dinarë apo më shumë. Me to ndërtoi një shtëpi në Medine dhe një tjetër në Kufe. Ndërsa Abdurrahman ibn Aufi kishte njëqind kuaj, njëmijë kafshë dhe dhjetëramijë krerë dele, pas vdekjes së tij një e katërta e vlerës së pasurisë së tij arriti në tetëdhejtë e katër mijë. Zejd ibn Thabiti la trashëgimi flori dhe argjend aq shumë sa nuk mund t'i mbanin mushkat. Ai la pas trashëgimi prej pasurive dhe gjërave të tjera me vlerë njëqind mijë dinarë. Kur vdiq Ja'la ibn Munebbih la trashëgimi pesëdhjetë mijë dinarë dhe borxhe që ua la njerëzve pa marrë, pasuri të patundshme e trashëgimi të tjera që kapnin vlerën e treqind mijë dinarëve.

Këto pra ishin ato pjesa e mbetur e atij që posedonte dhe kënaqej me pasurinë në jetën e tij që i la trashëgim pasardhësve të tij pasi vdiq. Sa i përket Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, ai e shtoi pasurinë e tij me punë dhe me djersën e ballit, i ndante ato njëra pas tjetrës dhe prej tyre nuk kishte gjë tjetër veç ruajtjes dhe shpërndarjes me ata që e meritonin. Veten e tij e çoi në shkallët më të larta të përkorjes me qëllim që të ngushëllonte shtresat e ulëta të nevojtarëve. Ai ishte prej atyre që punonte si punëtor me mëditje, aq sa i mjaftonte për vlerën ushqimore ditore. Kurrë nuk e zgjaste dorën e tij tek gjëja më e lehtë prej atyre sendeve që kishte dhënë për bamirësi.

Kur u ngarkua me çështjet e myslimanëve atë e rrethuan vështirësitë e kalifatit. Përveç punësimit të tij me mëditje e konsideroi veten e tij prej myslimanëve të varfër. Menjëherë nisi të

mbledhë forcën e tij të veçantë nga Medineja dhe përfitimet e dhuratave të bamirësisë. Ndërsa sa i takon dhuratës së tij nga thesari, ai merrte prej tij sa masa e dy grushteve për familjen e tij dhe kujdesej në mënyrë të veçantë për pjesën tjetër të myslimanëve të varfër.

Me të vërtetë, më e pakta që është thënë për sadakatë e tij të dhëna për bamirësi janë: Katërmijë dinarë në ditë, do me thënë më shumë se një milion e katërqind mijë dinarë në vit. Disa burime thonë se kanë qenë katërqind mijë dinarë në ditë dhe sikur të trashëgohej, pas vdekjes nuk do të linte më shumë se gjashtëqind derhem që i ka kursyer, do të blinte me to një shërbëtor.

Altruizmi është për shkak të karakteristikave të eulijave dhe asnjë njeri nuk mundet që të ngrihet në këtë gradë të lartë, vetëm pas një kujdesi dhe përpjekje të gjatë. Por, imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*e ka filluar këtë eksperiencë që ditën kur erdhi tek pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* po i ankohej për urinë. Kur pejgamberi nuk kishte gjetur asnjë gjë për të ngrënë tek bashkëshortet e tij, babai i Hasanit e ftoi atë mysafir dhe e solli në shtëpinë e tij. E pyeti lulen virgjëreshë se çfarë kishte për të ngrënë, ajo thotë: Nuk kemi asgjë tjetër veç ushqimit të fëmijëve, por ne e respektojmë mikun tonë dhe i tha asaj: Vëri në gjumë fëmijët dhe fike dritën, pastaj i shtroi mysafirit ushqimin e fëmijëve të tij dhe Allahu i Madhëruesëm zbret mbi të Dërguarin e tij të nderuar: "**Madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre para vetes**".[1]

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*e ka përsëritur këtë vepër të vështirë disa herë. Më e famshme ndër to është ajo që ndodhi ditën kur u sëmur Hasani dhe premtoi se nëse Allahu do t'i

1 Sure el-Hashr /ajeti 9.

shëronte ata të dy do të agjëronte tre ditë në shenjë falënderimi, Fatimeja dhe robëresha e saj Fidda e ndoqën në këtë premtim.

Kur ata të dy u shëruan e mbajtën premtimin e tyre duke agjëruar. Ehli Bejti në shtëpi kishin aq ushqim sa u mjaftonte për ato tri ditë. Mirëpo në ditën e parë i vjen një njeri i vobektë, kështu që iftarin e tyre ia dhanë sadaka atij, pa shijuar asgjë nga ushqimi. Ditën e dytë u erdhi një jetim, kurse ditën e tretë u erdhi atyre një njeri i zënë rob dhe ia dhanë atij të gjithë ushqimin që kishin. Në këtë situatë ata qëndruan të uritur duke shijuar vetëm ujin dhe Allahu i Madhëreshëm zbrti ajetet (5-22) të sures el-Insan dhe prej tyre "**Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të Allahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim**"[1]

Babai i Hasanit vazhdoi në këtë situatë duke e trajnuar veten e tij në përkorje dhe në luftimin e pasioneve, dedikimit të dashurisë së veprës së mirë, shërbimit njerëzor të të gjithë njerëzve. Në optikën e tij ata janë vëllezër në fe', e të barabartë në krijim. Muavije ibn Sufjani ka thënë: Sikur babai i Hasanit të kishte një shtëpi prej floriri dhe një shtëpi prej kashte do ta kishte dhënë dhuratë shtëpinë e floririt para asaj të kashtës.

1 Sure el-Insan / ajei 8-9.



ËSHTË I PARI QË KA LINDUR NË XHAMI DHE I PARI QË ËSHTË VRARË NË XHAMI[1]

Në kapitullin e parë të këtij libri kam thënë: Aliu ka qenë i pari që ka lindur në Qabe dhe tani duke shkruar kapitullin e fundit të përparësive të tij them: Vullneti i Krijuesit (xh.sh) deshi që ta përfundojë jetën trupore të imamit në një nga shtëpitë e tij madhështore, që është xhamia e Kufes, ashtu siç filloi lindja e tij në Qabe.

Shpirti i tij i pastër është i përhershëm dhe do të mbetet i gjallë në mesin e popujve duke jetuar me dituritë e tij dhe anën njerëzore të tij. Duke dhënë kontributin e tij, i cili nuk shuhet derisa të ekzistojnë qiejt dhe toka: "**Kurrsesi të mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre**".[2]

Komploti për vrasjen e tij

1 El Imame ue Sijaseh /166. Tarikhu Tabrij 5. 145. El Akdul Feridu 3/195. Muruxhu Dheheb 2/423-430. Mekatilu Talibine /24. El Irshadu /12. El Istiabu /1122. El Kamilu i ibn Ethirit 3/194,196, 207. Usdul Gabe 4/33. Sherh Nexhul Belaga i ibn Ebi Hadid 17/5 dhe 69. A'janu Shi-ia 3/k2/249. El A'lamu i Zerkelij 2/174 dhe 4/114. Idul Gadiri /173.

2 Sure Al-Imran / ajeti 169.

Historianët kanë rënë dakord se tre burra prej havarixhëve kanë komplotuar në vrasjen e Aliut ibn Ebi Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe Muavijes ibn Ebi Sufjanit dhe Amr ibn Asin. Sipas mendimit të tyre ata janë thelbi i ngatërresave që ndodhnin në mesin e myslimanëve dhe me këtë rast ata ia hapnin rrugën ymetit që të zgjidhnin imamin, që e kënaqnin feja dhe dynjaja e tij.

Aburrahman ibn Mulxhem ishte banor i Egjiptit, ndërsa dajat i kishte në Irak, ai mori përsipër vrasjen e imam Aliut dhe e kreu detyrën e tij me sukses. Kurse el-Burku, emri i të cilit ishte Haxhaxh ibn Abullah ishte nga një fis në Basra, ai mori përsipër vrasjen e Muavijes por nuk ia doli dot, sepse ai për fat të mirë të Muavijes e goditi me anën e mbrojtur të shpatës dhe Muavija u kurua dhe shpëtoi.

Zadhuvih, i pari i beni Anber quhej Amru ibn Bekri u nis përpara për të vrarë Amru ibn Asin, i cili në atë kohë ishte mëkëmbës i Egjiptit nga ana e Muavijes. Mirëpo ibn Asi u vonua për të falur namazin dhe kështu që atë e zëvendësoi shefi i policisë së tij (Kharixhe ibn Hudhafetu el Uduij) atë e vrau Kharixhen dhe ibn Asi shpëtoi.

Kjo është pjesa që historianët dhe transmetuesit e lajmeve kanë rënë dakord, por ai që e përqendron shikimin e tij në kronologjinë e ngjarjeve të komplotit do t'i bëhet e qartë, pa dyshim se komplotuesit e vërtetë janë: Muavije ibn Ebi Sufjani dhe Amru ibn Asi, Esh'athu ibn Kajsi. Kurse ekzekutori i vetëm është Abdurrahman ibn Mulxhemi me ndihmën e Esh'ath ibn Kajsiit, i cili është parë gjatë ngjarjes duke e shtyrë ibn Mulxhemin që të nxitonte dhe i thoshte atij: Nxito, nxito, mbaroje punën tënde se u zbardh dita dhe pa dyshim se komploti nuk synonte asnjë njeri tjetër, veç Aliut ibn Ebi Talibit (Paqja q Allahut qoftë mbi të!).

Sa i përket historisë së vrasjes së Muavijes dhe Amru ibn Asit, ajo është një teatër që Muavija dhe ibn Asi në Siri e kanë luajtur mirë pjesën. Me mashtrimin e saj të tregojë kujdesin e Muavijes për dërgimin e disa shokëve të tij në Kufe, para kohës së zbatimit të komplotit, me qëllim që të përhapnin lajmin e vrasjes së tij në kohën e përshtatshme. Viktimë e komplotit të kontrolluar ra Kharixhe ibn Hadhafe dhe dy burrave të tjerë të mashtruar bashkë me ato të dy, kurse tradhtari Esh'ath ibn Kajsin nuk e mori në dorëzim shpërblimin e pjesëmarrjes së tij. Komplot të cilën Muavija e sprovoi duke i ngjallur shpresë, që është të qenit mëkëmbës i Kufes, sepse sprova e vdekjes e mori atë pak ditë pas vdekjes së imamit.

Prijësi i besimtarëve e deklaroi vdekjen e tij pak para vrasjes së tij

Në ditët e tij të fundit, imami kur imami po deklaronte vdekjen e tij, përsëriste shpesh duke thënë: Çfarë e pengon të fortin tuaj që të lyejë këtë dhe këtë, e kishte fjalën për mjekrën e tij me gjakun e kokës së tij. Mes'udi ka thënë: Me të vërtetë Aliu nuk fjeti atë natë, por vazhdonte të ecte mes dhomës dhe korridorit duke thënë: Për Zotin as nuk kam gënjyer dhe as nuk jam mashtruar, nuk ka asnjë dyshim se ajo është nata që më është premtuar. E sapo doli, një rosë që ishte e fëmijëve bërtiti dhe bashkë me ta bërtitën një pjesë e atyre që ishin në shtëpi dhe tha ai *(Paqja qoftë mbi të!)*lëri ato se janë në vajtim.

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*i thotë djalit të tij, Hasanit: Kam parë në ëndërr të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe unë i thashë: O i Dërguari i Allahut! Sa shumë shpirtligësi dhe urrejtje më ka rënë

të takoj ndër ithtarët e tu!? Ai ma ktheu: "Mallkoi!" mirëpo unë i thashë: "Të m'i zëvendësojë mua Allahu me më të mirë se ata, kurse mua të më zëvendësojë për ata me një më të mirë se unë!"

Vrasja e imamit *(Paqja qoftë mbi të!)*

Nuk ka asnjë kontradiktë se ai *(Paqja qoftë mbi të!)*është vrarë në muajin e Ramazanit, në vitin dyzet të hixhretit. Mirëpo në përcaktimin e ditës ka shumë kontradikta, sepse orvatet mes datave (11 dhe 21) dhe se transmetimet më të përhapura thonë se ai është vrarë natën e (17) ose (19) ose (21). Mirëpo, ajo që është më tepër e fiksuar është transmetimi i imamëve të Ehli Bejtit që thotë se ai është goditur natën e të mërkurës, ditën e nëntëmbëdhjetë të Ramazanit dhe ka ndërruar jetë natën e njëzet e një (natën e xhuma).

Mes transmetuesve ka pasur kontradikta se ibn Mulxhemi e ka goditur kur ai ka qenë brenda në xhami apo para se të hynte? Kush e ka falur namazin me myslimanët, imami ka pas lënë zëvendës apo e ka falur ai vetë? Ibn Abdul Berri në librin *El Istiabu* dhe ibn Ethiri në librin *el Kamilu* kanë thënë se ai është goditur gjatë faljes së namazit, atë e pasoi Xha'de ibn Hubejre el Makhzumi, i cili ishte djali i motrës së tij Ummi Hani, e bija e Ebi Talibit dhe u fal me njerëzit, edhe transmetuesit shi'itë qëndrojnë në këtë transmetim.

Amaneti i imamit për djemtë, familjarët dhe për të gjithë myslimanët

Kur ibn Mulxhemi e goditi atë, rreth tij u mblodhën djemtë dhe familjarët në mënyrë të veçantë shokët e tij, ai u la atyre një amanet. Në fjalën e tij specifikoi djemtë e tij Hasanin dhe Hysejnin dhe tha: Ju këshilloj t'i jepeni Zotit e të mos i lakmoni kënaqësitë e

kësaj bote, edhe sikur vetë ajo t'ju rendi pas. Të mos ju vijë keq, kur ju mohohet gjë e saj. Flisni të vërtetën e veproni në mënyrë të tillë, që të prisni shpërblim. Të jeni armiq të shtypësve dhe ndihmës të të shtypurve.

Këshilloj që ju dhe gjithë fëmijët e mi e anëtarët e familjes time, si dhe këdo tjetër, të cilit mund t'i bien në dorë shkrimet e mia, që të keni frikë prej Zotit. T'i mbani parasysh punët tuaja dhe të mbani raporte të mira me të tjerët, sepse kam dëgjuar gjyshin tuaj, që thoshte: "Sheshimi i mosmarrëveshjeve me njëri-tjetrin është më i mirë se lutjet dhe agjërimi". Mbani parasysh Zotin në sjelljet me jetimët dhe mos i lini të vuajnë nga uria e të rrënohen nën sytë tuaj.

Mbani parasysh Zotin në marrëdhëniet me fqinjët tuaj, sepse Pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* këshillohej me ta. Ai na nxiste e këshillonte, ne në të mirë të tyre, aq sa mendonim mos u linte pjesë në trashëgimi. Mbani parasysh Zotin në çështjet e Kur'anit. Askush nuk duhet t'jua kalojë në veprimin mbi bazën e tij. Mbani parasysh Zotin në punët e namazit, sepse namazi është shtyllë për fenë tuaj. Mbani parasysh Zotin në punët e shtëpisë së Tij, Qabes në Mekë si dhe të xhamisë në përgjithësi. Mos e braktisni sa të jeni gjallë, se nuk do t'ju kursejnë, po ta braktisni. Mbani parasysh Zotin në punët e xhihadit, duke përdorur në rrugën e Tij pasurinë, jetën dhe gjuhën tuaj.

Nderojeni farefisninë dhe shpenzoni për të tjerët. Mos u bëni të huaj e mos i prishni lidhjet me njëri-tjetrin. Mos hiqni dorë nga urdhërimi në të mirë dhe ndalimin e së keqes, ndryshe do ju mund djallëzia dhe Zoti nuk do t'jua vërë më veshin, kur të doni t'i kërkoni.

O bij të Abdul Mutalibit, mos derdhni gjak myslimani duke u përligjur me vrasjen e imam Aliut. Hapni sytë: Mos vrisni për llogari time, përveçse atë që vrau. Prisni sa të vdes nga goditja që më ka dhënë vrasësi. Vetëm atëherë mund t'ia merrni jetën, por vetëm me një të goditur, mos e torturoni e mos ia prisni gjymtyrët, se kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që thoshte: "Mos i prisni duart e këmbët, edhe sikur të jenë të një qeni të tërbuar".

Kur imami *(Paqja qoftë mbi të!)*shkoi afër Zotit të tij, në Medinen e ndriçuar erdhi për të dhënë lajmin e vdekjes së tij, Kulthum ibn Amri. Lajmi i vdekjes së tij ishte i ngjashme me lajmin e vdekjes së të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nga të qarat e të gjithëve, burra e gra dhe ata që ulërinin nga hidhërimi. Derisa njerëzit u qetësuan nga të qarat një grup shokësh të të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thanë: Ejani të shkojmë tek Aisheja, bashkëshortja e Pejgamberit *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Të shikojmë mërzinë e saj për djalin e xhaxhait të të Dërguarit të Allahut dhe kur ata i morën leje asaj për të hyrë, panë se lajmi kishte shkuar tek ajo dhe se ishte në një dëshpërim të thellë, saqë nuk po qetësohej dot nga të qarat dhe vajtimi.

Të nesërmen ajo shkoi tek varri i të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe nuk mbeti asnjë nga xhamia pa e mirëpritur dhe duke e përshëndetur me selam. Ndërsa ajo nuk e kthente selamin, nuk përgjigjej dhe nuk fliste as edhe një fjalë prej lotëve dhe të qarët e tepërt. E mbytur në lotët e saj dhe e hidhëruar njerëzit qëndronin prapa saj, derisa iu afrua dhomës u ul në pragun e derës dhe tha: Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi ty, o Pejgamberi i udhëzimit,

paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi ty, o babai i Kasemit, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi ty, o i Dërguari i Allahut dhe mbi shokët e tu. O i Dërguari i Allahut, unë po të lajmëroj për vdekjen e të dashurit tënd më të nderuar tek ti, duke të kujtuar ty për një nga amanetet e tua më fisnike për ty është vrarë, për Zotin, i dashuri yt i zgjedhur dhe shoku yt më besnik është vrarë, për Zotin ai që ti e martove me gruan më të mirë në faqen e dheut.

Për Zotin, është vrarë ai që të besoi ty dhe të dha besën, kurse unë po qaj sikur të kem humbur djalin tim. Çdokush ka qarë me shumë lot dhe sikur ty të zbulohej dheu, të ngrihesh nga varri do të thoshe se është vrarë njeriu më bujar në mesin tuaj dhe njeriu më i nderuar dhe fisnik ndër jush.

Fundi i udhëtimit

Kështu pra imami i devotshëm ra dëshmor në sabahun e ditës së xhuma, kur ai ishte duke bërë sexhde për Allahun xh. sh. Kështu ishte fundi i jetës së tij, ashtu siç e nisi, kur nëna e tij e pastër e lindi ditën e xhuma në shtëpinë e Qabes, duke rënë në tokë në sexhde për Allahun e Lartësuar. Kjo është një mirësi që askush para tij nuk e ka marrë dhe askush pas tij nuk do ta ketë.

Profesor Ukadi ka thënë: Imam Aliu ka dalë në këtë dynja dhe shehadeti (fjala e dëshmisë) ka qenë e shkruar në ballin e tij. Iku nga kjo dynja ku shehadeti ishte i shkruar në atë ballë me goditjen e një shpate, kurse fotografia e tij përmbledhëse nuk është e vështirë për ndonjë përshkrues e as për dikë që ka shikim ngulmues. Ajo është fotografia e luftëtarit në rrugë të Allahut me dorën e tij, zemrën dhe mendjen e tij ose fotoja e dëshmorit.

Ai thotë: Cili fund është i ngjashëm me këtë dëshmor të përshkruar me këtë përfundim. Pasi ai ka lindur në Qabe, siç e mësuam është goditur në xhami, siç e mësuam, pra cili fillim dhe

fund është më i ngjashëm me jetën mes atyre të dyjave se sa ai fillim dhe ai përfundim.

Imamin e kanë falënderuar trashëgimtarët e tij me qindra poezi gjatë katërmbëdhjetë shekujsh në gjuhë të ndryshme. Qindra poetë në shekujt që do të vijnë do të vazhdojnë ta lavdërojnë dhe ta nderojnë atë derisa të vijë kijameti, sepse ai është shembulli më i lartë, pas Pejgamberit *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për njeriun e përsosur i cili shëmbëllehet në të gjitha cilësitë e tij.



THËNIE TË PERSONALITETEVE JOISLAME PËR IMAM ALIUN [11]

Shumë prej dijetarëve kristianë, filozofë dhe shkrimtarë nga lindja në perëndim kanë shkruar për imam Aliun. Vetë kristianët kanë një lidhje dashurie të vjetër me imam Aliun, pasi shumë prej poetëve të tyre të vjetër kanë thurur lavde për të dhe e kanë ndjekur para e prapa. Për këtë lidhje e tyre të fortë, gjejnë Mesian (a.s) me asketizmin dhe adhurimin e tij, të qenit shumë njerëzor. Rënia e tij dëshmor është harmonizuar tek prijësi i besimtarëve, i cili e ka lënë këtë dynja në tre ndarje dhe e ka jetuar të gjithë jetën e tij në shkallët më të vështira të refuzimit të kënaqësisë së kësaj bote dhe në gradat më të larta të sakrificës.

E pashë të përshtatshme që ta përfundoj librin tim me një pjesë që përmban pjesë të shkëputura nga thëniet e tyre për imamin, sepse mendimi më erdhi me vonesë dhe nuk ishte i lehtë largimi nga tema në kërkimin e gjithçkaje është thënë, prandaj do të paraqes fragmentet e perceptimeve nga çfarë është mësuar prej proze dhe poeme.

---

1 El Menakibu i Khavarizmit /14. El Menakibu i ibn Shehri Ashub 2/70 dhe 3/30. Mealimul ulema /151. El Mehasinu uel Mesaui i Bejhekiut /69. El Kamilu i ibn Ethirit 5/288. Nefkhu Et Tajib 2/377. El Gadiru /10-13. El Musteshrikune /225, 481. Imam Aliu, Seutul Adaleti Insanijeh 5/213, 226, 228, 235, 236, 239, 247.

1- Proza

Filozofi anglez Tomas Karlil, autori i librit *"El Ebtalu"* qw ka vdekur në vitin 1881 ka thënë: Përsa i përket Aliut, neve nuk na mbetet gjë tjetër vetëm ta duam atë, sepse ai pa dyshim është një djalë fisnik me shpirt të lartë, qenia e të cilit lëshon mëshirë dhe devotshmëri, zemra e të cilit digjet për të ndihmuar të tjerët dhe për t'i mbrojtur. Ai ka qenë më guximtar se një luan, mirëpo ajo është një trimëri e përzier me butësi, dhembshuri, mirësjellje dhe dashuri të merituar nga kalorësit kryqtarë të shekujve të mesëm. Ai u vra në Kufe në mënyrë të pabesë, nga drejtësia e madhe kjo gjë i bëri dëm atij. Ai llogariti çdo njeri të drejtë si ai vetë dhe para se të kur iu bë komplot tha: Nëse unë jetoj më takon mua ta marr hakun, por nëse unë vdes ju takon juve dhe nëse mundeni që ta vrisni me një gjuajtje pa e torturuar atë, bëjeni, por nëse ju e falni, kjo është prej punëve të devotshme.

Baroni francez Karadifu ka thënë në librin e tij" Mendimtarët e islamit" ka thënë: Aliu ka luftuar përkrah Pejgamberit si një hero i guximshëm, ka korrur arritje të mrekullueshme dhe ka bërë mrekulli. Në betejën e Bedrit, kur Aliu ka qenë në të njëzetat e tij, i ndante më dysh kalorësit peshkaqenë vetëm me një goditje të shpatës së tij, kurse në luftën e Uhudit u armatos me shpatën e harkuar me spirale të Pejgamberit dhe i çante helmetat me goditjet e shpatës së tij dhe mburojat i shkatërronte. Në sulmin ndaj kështjellave të çifutëve në Hajber, ai vetëm lëvizi nga vendi një portë të madhe prej hekuri, pastaj e ngriti atë sipër kokës së tij duke e përdorur si mburojë, kurse Pejgamberi *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e donte shumë atë dhe kishte shumë besim tek ai dhe një ditë ka thënë duke bërë me shenjë nga Aliu: "Nëse për dikë jam mbrojtësi i tij, atëherë edhe Aliu është mbrojtësi i tij". Pastaj Baroni thotë: Aliu është ai hero që

shkakton dhimbje, kalorësi mistik dhe imami shehid me një shpirt të thellë e të vendosur, i cili mban të fshehur brenda devotshmërive të tij sekretin e ndëshkimit hyjnor.

Orientalisti francez Kazanova, një profesor i diturisë së gjuhës arabe në universitetin e Egjyptit, i cili ka vdekur në vitin 1926 në librin e tij "Muhamedi dhe fundi i botës", i kthen përgjigje edhe thënieve të orientalistit Belg. Babai i Lamanshit Emevi Heva në librin e tij (Muavija është i pari), i cili e ka vënë në plan të dytë imam Aliun në mesin e të gjithë emevitëve, e ka ekzagjeruar sulmin ndaj Aliut dhe ndihmësve të tij, ashtu si e ka ekzagjeruar në lavdërimin e emevitëve dhe ndihmësve të tyre.

Në mënyrë të padiskutueshme, mentaliteti i emevitëve ka qenë i ndërtuar mbi zilinë, ambicien e pasurisë deri në kufijtë e pangopjes dhe dashuria për të çliruar toka të reja me qëllim plaçkitjen. Interesi për t'u bërë pronarë, për të shijuar kënaqësitë e kësaj bote, prandaj ne, me të drejtë habitemi me Lamanshin, i cili del vullnetar në mbrojtje të atyre plaçkitësve e duke u tallur me Aliun të cilit i ngritën kurth. Nuk është më e çuditshme se këto diskutime që shfaqen nga ky autor i mirinformuar për historinë e asaj kohe me një informacion të admirueshëm, duke i shoqëruar në vend të këtyre dhe të cilat e ndjekin procedurat mbrojtëse kur faktet e qarta akuzuese palosen sipër njëra-tjetrës. Me këtë krahasim i kthejmë një përgjigje të qartë si kristali, profesorit Xhorxh Xherdak për shpifjet e babait Lamansh duke ia bërë të qarta arsyet e saj.

Xherdaku ka thënë: Me të vërtetë Lamanshi është një enciklopedi i një shembulli të rrallë rreth asaj që di dhe asimilon, pasi pa dyshim atij nuk i humbet asnjë gjë, qoftë e vogël qoftë apo e madhe. Nga hollësitë e historisë arabe, ka një material të dendur

dhe një dituri të gjerë që asnjë orientalist tjetër nuk i afrohet atij, atë e ka mbrojtur një fuqi mrekullie.

Kjo është një fjalë e vërtetë për orientalistin me dituri të gjerë, por ajo që na intereson neve tani është zbulimi i qëllimit, i cili e ka prishur këtë dituri të madhe. Pasi pa dyshim, Lamanshi, nuk ka vënë në përdorim diturinë e tij në shërbim të së vërtetës. Nuk është mbështetur në vërtetimin e predikimeve të mëdha në librat e tij, për të bërë më të kthjellët realitetin dhe për ta qartësuar atë çfarë është fshehur prej çështjeve të njerëzve në lindje të Arabisë së vjetër. Madje me keqardhje themi se ky dijetar me të vërtetë i ka bërë keq diturisë dhe njohurisë së tij të gjerë, në momentin që shqetësimi i tij në shumicën e rasteve ishte refuzimi i asaj që historia ka vërtetuar dhe atë që logjika e ka pranuar mendja dhe natyra e ngjarjeve. Madje ai kundërshton edhe emocionet e sponsorizuara që njeriu i ndjen kundër atyre njerëzve gjigantë të myslimanëve të parë dhe përpiqet që të prishë çdo emocion që njeriu e ndjen nga ana e mirë njerëzore për njerëzit e mirë e punëmirë e të zgjedhur.

Lamanshi nuk përmend asnjë gjë prej cilësive të Aliut, përveçse ta cenojë apo të fabrikojë shpifje. Edhe kur ky njeriu kolloz i përmend cilësinë e tij të zgjuarsisë se është i kufizuar dhe ka refuzuar që të besojë elokuencën e autorit të "Shtegut të elokuencës". Pastaj tallet, ashtu si tallet një mashtrues me transmetimet e vërtetuara të cilat flasin për guximin dhe mjeshtërinë e kalorësimit. Më e çuditshmja është se mund t'i rezultojë një lexuesi që ta zhveshë Aliun nga elokuenca, zgjuarsia, mjeshtëria e kalorësimit dhe ato janë cilësi që e shoqërojnë atë, ashtu siç e shoqëron ngrohtësia zjarrin. Madje nuk ka asnjë dyshim se ato cilësi nuk i ka mohuar as Muavija ibn Ebi Sufjani dhe as Amër ibn Asi, dy të dashurit e zemrës së Lamanshit dhe po

na i mohon vetë Lamanshi. Nëse dikush dëshiron të mbështetet në metodikën që është mbështetur Lamanshi në mohimin e karakteristikave superiore do të mundej ta bënte pa asnjë mundim dhe lodhje të mohonte ekzistencën e Aliut, Muhamedit, Mesiut, Sokratit, Shekspirit, Napoleon Bonapartit dhe jo të mohojë tek ata vetëm disa cilësi të veçanta.

Lamanshi nuk paska gjetur asnjë cilësi të mirë të vetme, por ai ngulmon në zhveshjen prej cilësive të tij të mira, deri edhe në situatat që një njeri duhet të përkulet në shenjë përshëndetjeje dhe respekti. Shembulli është se ky orientalist e sulmon Aliun në devotshmërinë dhe qasjes së tij të dynjasë, metodës së tij bujare në përfitimin e nevojave jetësore me punë dhe djersën e ballit, dhe jo si preukopim dhe mashtrim. Ai që gjen një mangësi në sjelljen e Aliut në kohën kur ka qenë duke punuar me dorën e tij, pas hixhretit në Medine për të siguruar bukën e gojës, pastaj i vjen bashkëshortes së tij, Fatimesë me kokrra hurme nga ajo që kishte fituar nga puna e tij fisnike duke i thënë merre, ha ti dhe ushqeji fëmijët e tu.

Mirëpo kur çështja e Benu-umejave dhe çështja e kundërshtimit të imamit bëhen bashkë, atëherë pa dyshim Lamanshi kthehet në besimtar me cilësitë e tyre të mira. Ebu Sufjan ibn Harbi është burri i vjetër i respektuar i Mekës, i cili ia kalon në tolerancë, durim dhe në modesti djalit të tij të madh, Muavijes. Ai dhe bashkëshortja e tij, Hindi, është ngrënësja e zemrave të poetëve, madje Ebu Sufjani vetë është prej poetëve të kurejshëve.

Sa i përket Muavijes ai është gjeniali unik, toleranti mikpritës, politikani gjeni, reformuesi ekonomik i civilizimit dhe ushtarak, bashkëshorti punëmirë dhe gjykatësi i drejtë, i vetëdijshëm, mbreti shembullor, dashurues i poemës dhe

muzikës, madje poet autor me shije të lartë artistike. Ai pa dyshim është shkrimtari i zgjedhur, i cili e edukon djalin e tij, Jezidin me dituri, durim dhe të mira. Lamanshi nuk shikon tek Muavija qoftë edhe një mangësi të vetme që t'ia sosë durimin atij, të cilin e ka huazuar nga Muavija siç duket në justifikimin e krimeve të kalifit të parë emevit. Duke e argumentuar justifikimin e tij me një argument qesharak, e duke thënë: "Muavija nuk ka qenë nga ata burra që të kryente një vrasje pa pasur interes në të" që do të thotë se ai nuk vriste njeri po të mos kishte dobi në vrasjen e tij.

Po ia lë lexuesit që t'i përgjigjet këtij justifikimi të çuditshëm në krim. Qëndrimi i Lamanshit nuk ndryshon për Jezidin ibn Muavije dhe Zijad ibn Ebihi, Amru ibn Asin dhe Mirvan ibn Hakemi nga ky qëndrimi i tij për të gjithë emevitët dhe të gjithë ndihmëtarët e tyre. Mjafton që të kujtoj ty se ai e ka zgjatur shumë fjalën për guximin e Jezidit ibn Muavije dhe të pranojë me zemër të qetë për përshkrimin e tij si "djali arab", ashtu siç bie dakord në përshkrimin e tij si "*me durim hekuri*". Si mundet që babai Lamansh, besimtari katolik, siç duket në pamje të parë të sulmojë Aliun ibn Ebi Talibin, krijesën më të afërt me Mesiun, amanetin, devotshmërinë, modestinë, vendosmërinë e tij në të drejtën dhe moralit të tij madhështor. Fuqisë së besimit, ndjenjës së tij të thellë njerëzore, të respektit dhe ngushëllimit të tij të madh, nëse qëllimi i tij i librave të fillimit dhe të fundit nuk do të ishte bërja keq ndaj shpirtit të lindjes në përgjithësi dhe të Arabisë në veçanti, me në krye ata që përfaqësojnë imam Aliun.

Po si mundet që babai Lamanshi, besimtari katolik, ashtu siç duket në pamje, të thurë lavde për Muavijen, Jezidin dhe ata që i rrinin afër atyre të ndërtonte metodën e atyre të dyve që të arrinte të merrte kompetencat. Nëse nuk do të kishte tendencë të pastër megafile që e nxisnin atë në nderimin e atyre të cilët kanë

punuar me parullën *"përfundimi justifikon qëllimin"*. Sado që të jetë numri i viktimave të shkaktuara nga justifikimi? Po si mundet Lamanshi që të sulmojë atë që thotë "Duaj për tjetrin atë që dëshiron për veten tënde dhe ure për tjetrin atë që urren për veten tënde", "Këshilloje vëllain tënd me mirësjellje dhe përgjigju atij me mirësi", "ushqimi më i urryer është ushqimi haram, kurse padrejtësia ndaj të dobëtit është padrejtësia më e ulët", "Mos ndalo së punuari vepra të mira nëse dikush nuk është falënderues" dhe "Bëhu armik ndaj atij që të ka ndaluar ty mirësinë".

Pastaj si mundet që të ai tallet me metodën e tij madhështore dhe kushtetuta e tij e respektuar për kompetencën, të kthehet e të thurë lavde per gjenialitetin e atij që thotë "Me të vërtetë Allahu ka ushtarë prej mjalti" e përzier me helm, i cili blen tradhtarët e njerëzit, ç'thurur me pasuritë e njerëzve apo urdhëron gjakderdhjen e njerëzve të vobektë dhe të dobët, nëse ata nuk janë në të njëjtën linjë në sharjen e njeriut me moralin më madhështor dhe shpirtin më fisnik, më të diturin ndër ta dhe më superiorin në logjikë? Si mundet që të sulmojë e të tallet me të, ta lavdërojë duke e përdorur të gjithë atë dituri që ka dhe zellin që iu ka dhuruar në rrugën e këtij lavdërimi. Edhe nëse qëllimi i parë dhe i fundit i shkrimeve të tij nuk do të ishte keqbërja e shpirtit të pastër arab, të cilin e përfaqëson Aliu, dhe jo Muavija, edhe sikur të mos jetë me tendencë megafile?

Pa dyshim kjo metodë në të cilën është mbështetur ky orientalist, në sulmimin e Aliut ibn Ebi Talibit nuk i bën asnjë dobi autorit të saj, përveçse në një situatë të vetme. Që është sulmi ndaj çdo vlere morali dhe në shpirt dhe gjenialitetit të orientuar në historinë e njeriut antik, modern dhe respektimit e çdo zemërguri.

Çdo njeriu të vrazhdë në natyrë dhe çdo lloj devijimi në ekzistencë dhe çdo egoizmi poterexhi të ç'thurur në çdo anë.

Xhebran Khalil Xhebran, shkrimtari dhe artisti i njohur, i cili ka vdekur në vitin 1931 ka thënë: Në bindjen time është se ibn Ebi Talibi ka qenë arabi i parë që në mënyrë të vazhdueshme e ka mbajtur afër shpirtin e tij dhe i ka folur natën. Ai është arabi i parë që buzët e tij kanë zënë etjen ekstreme të këngëve nga dëgjimi i një populli që nuk kishin dëgjuar më parë, kështu që humbën mes metodave të elokuencës së tij dhe errësirave të kaluarës së tyre. Kënaqësia e tij ishte e natyrshme, ai që e kundërshtonte atë ishte prej bijve të injorancës.

Aliu ibn Ebi Talibi vdiq si dëshmor i madhështisë së tij.

Ai vdiq dhe namazi ishte në buzët e tij.

Ai vdiq dhe në zemër kishte mallin për Allahun dhe arabët nuk e njohën të vërtetën e pozitës së tij të lartë dhe vlerën e tij, derisa u ngritën nga gjiri i komshinjve të tyre, persëve, njerëz që e kuptuan dallimin mes xhevahirit dhe gurit.

Ai vdiq para se bota të merrte mesazhin e tij të plotë dhe të mjaftueshëm, pavarësisht se unë e përfaqësoj atë me buzëqeshje para se të mbyllte sytë e tij në këtë tokë. Vdiq prestigji i të gjithë pejgambereve të cilët vinin në një qytet që nuk ishte qytetit i tyre. Tek një popull që nuk ishte populli i tyre në një kohë që nuk ishte koha e tyre, mirëpo Zoti yt ka një çështje në këtë dhe Ai është më i Dituri.

Filozofi dhe shkrimtari Mikail Neime në një letër që ia ka dërguar profesor Xhorxh Xhardak ka thënë: Ti më pyete për mendimin që kam për imam Aliun, që Allahu ia bekoftë fytyrën, e mendimi është se ai pas pejgamberit. Ai është i pari i arabëve në mënyrë të padiskutueshme në elokuencë, mençuri, botëkuptim, entuziast për të drejtën dhe konkurrues rreth defekteve. Nga

gjithçka që kam lexuar rreth arabëve nuk kam njohur ndonjë njeri që gjuha t'i bindet, ashtu si ju ka bindur ibn Ebi Talibit për kështillat e tij fetare. Për hytben entuziaste dhe shkrimet e tij orientuese, apo ato fragmente të shkëputura të cilat i shpaloste kohë pas kohe të shoqëruara me mençurinë e kohës dhe të shpirtit, vezulluese me shkëndijat e imanit (besimit) të gjallë. Të kuptueshme nga bukuria në sqarim afër mrekullisë, dukej sikur ato janë mekanizma që ka arritur përsosjes dhe sikur ai është deti që kapet pas atyre mekanizmave nën kujdes ose me dhimbje.

Nuk ka në mesin e arabëve ndonjë që të ketë një perceptim aq të qartë sa perceptimi i Aliut dhe as nga ata që i është dhënë aftësia në gjuetinë e fotove, të cilat reflektojnë perceptimin e tij. Paraqitja e saj në një kornizë të bukur është një magjike e lejuar. Rimimi i tij të sulmon me ngjyrat dhe muzikën e tij, të cilën as stuhia e fjalëve të rrymave që duken, sikur ato kanë zbritur mbi poetin nga qielli. Ato kanë zënë vendin e tyre në fund të bejteve vetëm nëse bëjnë një detyrë që është e pamundur për të tjerët që ta bëjnë.

Me të vërtetë ajo do të thotë gjëra që nuk mundet dikush tjetër t'i thotë ato fjalë, sepse ato janë në shënjestër të harkut. Pastaj thotë: Nuk ka asnjë dyshim se Aliu është prej gjigantëve të mendimit, të shpirtit dhe sqarimit në çdo vend dhe në çdo kohë. Profesor Pols Selame ka eposin e ditës së lamtumirës që i kalon të tremijë bejtet të organizuara në historinë e imam Aliut dhe luftës së Qerbelasë, në të duket qartë një fjalë e mrekullueshme që vjen në fund. Një kundërshtar mund të thotë: Çfarë pune ka ky kristian që përplaset direkt me eposin islamik?

Po, unë jam një kristian, por që shikon në një horizont i gjerë dhe jo nga një dritare e vogël e ngushtë. Një kristian mendon: Të gjitha krijesat janë të ruajtur nga Allahu dhe ai

mendon "Nuk ka asnjë dallim mes një arabi dhe jo arabi, përveç atij që është i devotshëm". Një kristian që përulet para madhështisë së një njeriu që emri i të cilit thirret qindra milionë herë nga njerëzit nga lindjet e tokës në perëndimet e saj. Një njeri që nuk ka më të lartë se ai në pozitë, më largpamës, e përkujtim më të përhershëm. Një njeri që u shfaqet nga errësirat e injorancës dhe bashkë me të u shfaq dynjaja. Jetoi me simbolin e lavdishëm të shkruar në të me shkronja prej drite "Nuk ka tjetër Zot, veç Allahut. Allahu është më i Madhi".

Dikush mund të thotë: A është Aliu i vetmi që është favorizuar në këtë epos, nga shokët e pejgamberit *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*? Kësaj pyetje nuk i përgjigjem ndryshe vetëm se me fjalë. Eposi (thertorja) është e gjitha përgjigja për të. Në kontekstin e saj do të shohësh një pjesë të madhështisë së njeriut që myslimanët e përmendin dhe thonë: *(Paqja qoftë mbi të!)* apo *(Allahu ia ndriçoftë fytyrën!)*. Kristianët e përmendin atë në tubimet e tyre dhe sjellin shembuj të mençurisë, i frikësohen devotshmërisë së tij, kurse ata që janë veçuar nga kjo botë e marrin atë si shembull në qeliza dhe shtohen. Më shumë në lënien mënjanë të kësaj bote dhe pashpresë, mendimtari shikon nga ai dhe ndriçohet me këtë pol të pastër, ndërsa shkrimtari që flet tërthorazi e lexon atë dhe vërteton sqarimet e tij. Dijetari në fe' e synon atë në dije dhe kërkon të udhëzohet me mençuritë e tij.

Folësit i mjafton që të qëndrojë në rrezë dhe të ngrejë kokën lart nga ky mal dhe prej andej të derdhen ajetet dhe zhvendoset gjuha e tij me fjalën e qartë arabe, rregullat e së cilës i ka ngulur babai i Hasanit. Ku Ebi Esvedit ed-Deuli i tha: Ndiqe këtë gramatikë. Po ta lexojë frikacaku historinë e Aliut, gjoksi i tij do të oshtijë nga entuziazmi dhe do të apasionohet pas heroizmit. Ku të huajt nuk kanë parë dhe qielli nuk i ka bërë hije ndonjë njeriu më

guximtar se ibn Ebi Talibi. Islami është mbështetur mbi atë krah të përdredhur që ditën kur ai ka qenë fëmijë. Aliu është heroi i Bedrit, hajberit, i hendekut dhe hunejnit, i luginës së rërës, Taifit dhe Jemenit.

Më e mahnitshme se heroizmi i tij trupor është heroizmi i tij shpirtëror. Nuk është parë njeri më i durueshëm se sa ai ndaj vështirësive, fatkeqësive, pasi jeta e tij ka qenë e mbushur vazhdimisht me dhimbje, që kur sytë e tij kanë parë dritën në Qabe dhe derisa i mbylli ato në të vërtetë në xhaminë e Kufes. Përsëri, përse më pyet mua për babain e Hasanit? A nuk janë ngritur gjatë periudhave grupe njerëzish që e hyjnizojnë atë njeri? Nuk ka asnjë dyshim se kjo është një humbje e madhe, mirëpo, një humbje që të tregon ty të vërtetën, pasi të tregon ty për masën e joshjes së njerëzve me këtë personalitet të madh.

Prandaj, çfarë të them për ty o babai i Hasanit, kur shkrimtarët kanë thënë në mbështetje të teorisë se me të vërtetë ai që e mbush dynjanë dhe i preokupon njerëzit, nuk është gjë tjetër veçse një poet që ka një grusht perlash përballë kodrinave me gurë. Personaliteti i tij rreth madhështisë tënde nuk është veçse një copë balte e Nilit si shenjë modestie për madhështinë e piramidave. Vërtetë, nuk ka asnjë dyshim se ajo që është e qartë do të gëlltitet dhe pa dyshim se poema ime është një guralec prej bregdetit tënd, o princi i fjalës. Por ato janë guralecë të lyer me gjakun e shtrenjtë të Hysejnit. Prandaj, pranoje këtë epos dhe shiko nga raftet e përjetësisë tek i dobëti i cili e ka nderuar lapsin e tij me përmendjen tënde. Poezinë që prijësi i besimtarëve ia dëshmoi Malikut ibn Zejd Menati e ka thënë atë kur ka parë vëllain e tij Sa'din, kur kishte përmendur devenë e tij, por nuk kishte mundur dot të qëndronte në të. Ai dërgoi një shembull të një njeriu për t'i rënë shkurt çështjes duke preferuar qetësinë.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Parathënie.....5
I pari që ka lindur në Qabe.....11
I pari që i parapriu në islam të tjerët.....13
I pari që është falur me Pejgamberin.....20
Nxënësi i parë i Pejgamberit.....25
I pari që i dha fjalën Pejgamberit.....29
I pari i shkruajtësve të shpalljes.....32
Ai është i pari që ju ka lidhur atij mbrojtja ndaj mysliamnëve.....36
I pari që është quajtur si trashëgimtar.....43
Imami i parë në islam.....46
I pari që ka marrë epitetin si prijësi i besimtarëve.....52
I pari që sakrifikoi veten e tij për Pejgamberin.....58
I pari që ka shlyer borxhet e Pejgamberit.....61
I pari që e ka vëllazëruar atë Pejgamberi.....66
I pari që ka punuar me ajetin e bisedës konfidenciale.....71
I pari që është quajtur i pluhurosuri.....76
Luftëtari i parë në rrugë të Allahut.....80
I pari që ka mbajtur flamurin e islamit para të Dërguarit të Allahut.....85
Sfiduesi i parë në luftën e Uhudit dhe i pari që ka qenë i vendosur bashkë me Pejgamberin.....90
Sfiduesi i parë në luftën e hendekut.....96
I pari që ka shkruar një marrëveshje mes Pejgamberit.....104
I pari që shkuli portën e një kalaje dhe u mbrojt me të.....110

I pari që ka hipur mbi supet e Pejgamberit dhe që ka thyer statujat.....115
Nga të vendosurit e parë bashkë me Pejgamberin.....119
I pari djalë i ri në islam.....125
Kadiu (gjykatësi) i parë në islam.....131
I pari që i është përcjellë mesazhi nga i Dërguari i Allahut.....139
I pari që Pejgamberi e ka bërë ortak në kurbanin e tij.....146
I pari i më të afërmve të Pejgamberit.....151
Pejgamberi mori përsipër edukimin e tij pasi ai lindi.....152
Pejgamberi e vëllazëroi atë dy herë.....153
Martesa e tij me Fatime Zahranë.....154
Ngjarja e zogut të pjekur.....155
Mbyllja e dyerve dhe dritareve që të çonin në xhaminë e të Dërguarit të Allahut, përveç derës së Aliut.....157
Amaneti që i la i Dërguari i Allahut që të marrë përsipër larjen, qefinosjen dhe varrosjen e tij.....158
Disa hadithe profetike të përmendura për të.....169
I pari që i mundi heronjtë kampionë me sfidën e tij në duel dhe mundi të vrarët me shpatën e tij.....163
I pari që tuboi Kur'anin, e mësoi atë përmendësh dhe themeloi shkencat e tij.....168
Tubimi i Kur'anit.....168
Nxënia përmendësh e Kur'anit dhe leximi i tij.....172
Shkenca e komentimit.....173
I pari mysliman që Pejgamberi nuk ka prijës askënd mbi të.....176
I pari që ka veshur një mburojë pa pjesën e pasme të saj.....181
I pari që është shmangur për të qenë i pari që e lufton dikë.....184

I pari që e mori në pronësi ujin nga armiqtë e tij pastaj ua dha atyre.....189
I pari që ka bërë traditë kërkimin e faljes ndaj armikut të tij që e sfidonte kur iu ka zbuluar kundërshtarit pjesa e turpshme e tij.....194
Myslimani i parë që ka folur për teknikat ushtarake.....198
Kalifi i parë që e ka emrin Ali.....203
Kalifi i parë nga fisi i hashimijëve.....206
I pari që vuri një kushtetutë të plotë për shtetin islamik.....208
Paraqitja e marrëveshjes.....210
Detyrat e administratorit.....211
Lidhja e administratorit me ata që ka nën kujdes.....211
Dedikimi ndaj nevojtarëve.....211
Domosdoshmëria e të bërit vetë të disa punëve nga ana e administratorit.....212
Zbatimi i obligimeve.....213
Moszgjatja e shfaqjes përpara ndaj shtetasve.....213
Kontrolli specifik dhe rutinë.....213
Leksione në moral, politikë dhe fe'.....214
Zgjedhja dhe testimi i tyre në emërim.....215
Zhvendosja e atyre që kanë sekrete të këqija.....216
C. Drejtësia.....217
Përzgjedhja e gjykatësit.....218
D. Aparati ekzekutiv.....218
Emërimi i tyre pas përzgjedhjes dhe testimit.....218
Dhënia e mjeteve të bollshme të jetesës.....219
Kontrollimi i punëve të tyre dhe dënimi i atyre që tradhtojnë...219
H .Çështjet ushtarake.....219
Përcaktimi i komandantëve të ushtrisë.....220

Inspektimi i komandantëve të ushtrisë dhe nderimi i atyre që janë punëmirë.....220
Paqja me armiqtë.....221
Mbajtja e premtimit.....222
Shmangia e gjakderdhjes me të padrejtë.....222
E-Qeveria dhe populli.....223
Udhëheqja e opinionit të përgjithshëm.....223
Shtresat e shoqërisë.....223
Tiparet e shoqërive.....224
Nuk ka tatime pa kultivimin e tokës.....225
Mirëqenia e popullit është mbështetje e arkës së shtetit.....225
Tregtia dhe prodhimi.....225
Luftimi i monopolizimit.....226
Caktimi i çmimeve dhe kontrollimi i peshoreve.....226
Siguria shoqërore.....226
I pari që ka reformuar sistemin e burgjeve në islam.....228
Është i pari që ka themeluar rregullin e policisë.....230
Është i pari që ka zgjeruar hetimin e ngjarjes dhe ka ndarë armiqësitë.....232
Është i pari që ka bërë ligj të drejtën publike në islam.....235
Është i pari që ka prerë paranë islamike.....238
Është i pari që ka thënë më pyesni para se të më humbisni.....241
Është i pari që ka folur për thertoret dhe ka lajmëruar për ngjarjet para se ato të nodhin.....247
I pari që ka klasifikuar librat në islam.....255
I pari që ka vendosur gramatikën.....261
Është i pari që ka formuar shkencën e teologjisë në islam.....263
I pari që ka themeluar metodën e stilit artistik në gjuhën arabe.....269
Llogaritari i parë në islam.....278

I pari që ka vënë një shtëpi në dispozicion për të shtruar në të problemet, ankesat.....282
I pari që ka testuar predikuesit në islam.....283
Kalifi i parë që qëndron bashkë me kundërshtarin e tij përballë kadiut.....284
Është i pari që ka gjykuar pa urrejtje.....288
Asketiku i parë në islam.....293
I pari që është divorcuar me dynjanë.....300
I pari që i ka dhënë për bamirësi të gjitha të ardhurat e tij fukarenjve dhe i ka preferuar ata para vetes dhe familjes së tij.....305
Është i pari që ka lindur në xhami dhe i pari që është vrarë në xhami.....312
Thënie të personaliteteve joislame për imam Aliun.....320

شاكر هادى شكر

الاول ... على عليه السلام

الترجمة الى اللغة الألبانية: ادموند عبازى

تيرانا: 2015

نام کتاب: **الاول ... علی علیه السلام**

نویسنده: **شاکر هادی شکر**

ترجمه با زبان آلبانی: **ادموند عبازی**

زیر نظر: **شیخ ولنت (عباس) مریا**

ویرایش: **سونیلا کاظمی**

مقابله: **برونیلدا کاظمی**

صحافی: **صبریه فزا**

طراحی جلد: **صبریه فزا**

ناشر: جمعیت "**نسیم**"

چاپ اول: **1000 نسخه**

چاپ: انتشارات "لیلو"